Arsimimi është faktori vendimtar për një komb që nxit rritjen ekonomike. Friedman (2002) ka thënë: "Përfitimi nga arsimimi i një fëmije nuk i dedikohet vetëm fëmijes si individ apo prindërve të tij, por gjithashtu edhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Edukimi i fëmijës tim kontribuon në mirëqenien tuaj me promovimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike. Prandaj krijohet një efekt shumë i rëndësishëm i emëruar si "efekt fqinjësie". Mitra (2011) ka thënë që një popull i arsimuar mirë shoqërohet me normë më të ulët të papunësisë, zvogëlon dukshëm varësinë prej programeve për ndihmë dhe asistencë sociale, duke rritur njëherësh të ardhurat nga tatimet. Nga arsimimi i "mirëfilltë" i popullit përfiton mbarë shoqëria. Që një popull të arsimohet, duhet të nxitet. ***Nxjtja për përmirësim dhe zhvillim jo vetëm në rrafshin ekonomik, por në të gjitha sferat e jetës varet nga pritshmëria.*** Becker (1993) është i qëndrimit që për arsimimin norma e kthimit për tatimpaguesit në përgjithësi jo vetëm për prindërit, duhet të jetë përfitimi publik që marrin nga shkollimi si:

- Rritja e produktivitetit,
- Unitetit,
- Civilizimit,
- Shëndetësisë etj.

Një perspektivë tjetër e ofruar së bashku nga Musgrave dhe Adam Smith e përcaktojnë arsimin në fushën e të mirave të merituar për faktin se përfitimet nga arsimi kanë një ndikim, sidomos në informim dhe kështu justifikohet nevoja për ndërhyrjen e shtetit në financimin e këtij aktiviteti (Musgrave, 1959, Smith, 1937). Ky lloj i të mirës konsiderohet aq e rëndësishme sa që financimi privat i të njëjtës është zëvendësuar me fonde publike. Arsimi rrit vlerën e ardhshme të potencialit të një populli. Arsimi dita-ditës po bëhet promotori më i fuqishëm i rritjes dhe i suksesit global. Arsimi po ashtu konsiderohet si shtylla më kryesore që denjësisht ndikon në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Në shumë studime është treguar se në vendet e Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri ka një hiperprodhim të pakontrolluar të kuadrove brenda kornizës së sistemit arsimor aktual, i cili gjithashtu identifikohet si një nga gjeneruesit kryesorë të krizës në thellimin dhe sforcimin e hendekut midis të punësuarve dhe të papunëve.

Meqë fuqia e një vendi interpretohet përmes fuqisë punëtore të arsimuar dhe të kualifikuar, atëherë një forcë punëtore e aftë dhe në moshë të re duhet të llogaritet në vendet e origjinës si inovacion dhe të ketë impakt në tregun e punës në veçanti dhe në përgjithësi të nxisë rritjen ekonomike.

Analizuar përgjithësisht, tregu i punës paraqet një platformë të hapur që kërkon përshtatjen e ofertës dhe kërkesës për punë si në sasi po ashtu edhe në cilësi, por realisht ky treg në Maqedoni, në Kosovë, në Shqipëri dhe në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nuk funksionon në këtë mënyrë, por nga vetë struktura e punëdhënësve kategorizuar këtu sektorin publik dhe atë privat. Kur jemi të njoftuar pak a shumë se ofertat janë të “mbyllura në sektorin publik”, në atë privat marrë parasysh se një përqindje e konsiderueshme e bizneseve janë me 1-4 punëtorë dhe konsiderohen familjarë, mbetet për t’u diskutuar një pjesë shumë e vogël e kompanive ndërkombëtare për të siguruar një ofertë të hapur pune.

Nga ana tjetër, janë të diplomuarit universitar ata të cilët pritet të jenë lokomotivë të cilët do të sjellin inovacionin në tregun e punës, duke ndikuar në afat të gjatë në rritjen ekonomike të vendit. Por çfarë ndodh realisht? Të diplomuarit universitarë janë në strukturë të normës së përgjithshme të papunësisë në përqindje më të madhe dhe kjo situatë është paradoksale aqsa ka filluar të shihet si një eksternalie negative, që nënkupton një hiperproduksion që tkurrë aktivitetin e punës në sektorin privat. Arsimimi i një populli është arma më e fuqishme e atij vendi?! Ne në asnjë mënyrë nuk duhet pranuar hipotezën se arsimi ka filluar të merr permasat e hiperproduksionit, por bartim peshën te tregu i punës vendore. Me fjalë të tjera, ekziston një mosharonomizim i shprehur mes ofertës dhe kërkesës për profesione reale pothuajse në të gjitha vendet e BP-së. Por nga ky spektër, është e nevojshme hulumtimi thelbësor dhe i realizuar nga burime primare të dhënash për të vënë në pah kërkesën për profesione reale në tregun e punës (sektori real) dhe më pas të rishikohen programet akademike të institucioneve të arsimit të lartë.

Në këtë zhvillim të hovshëm ekonomik dhe të kalimit nga ekonomia e tregut drejt ekonomisë së dijes, edhe përmasat e tregut të punës i thyejnë kufijtë “gjeografikë”, shfaqet ose shprehet tregu ndërkombëtar që thith ajkën, pra të diplomuarit universitar. Është e nevojshem funksionimi zinxhiror ndërmjet qeverisë, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat. Të investosh në arsim do të thotë investim në dije - në kapitalin njerëzor, që njëherësh paraqet faktorin

më të rëndësishëm të funksionit të prodhimit, që është i lidhur drejtpërsëdrejti me nivelin e zhvillimit të vendit dhe me standardin jetësor.

Literatura e konsultuar

Në teori ekzistojnë një mori të modeleve ekonometrike të cilat pasqyrojnë lidhjen pozitive ndërmjet shpenzimeve publike të destinuara për arsim dhe rritjes ekonomike. Duke e ndjekur modelin e Solow (Solow 1956), në qoftë se shpenzimet publike në arsim janë produktive, kjo ndoshta synon në pretekstin për të investuar në kapitalin njerëzor, por kjo ndikon vetëm në ekuilibrin faktorial e jo në rritjen ekonomike, ndërsa në përgjithësi ka efekte anësorë në rritjen ekonomike. Sipas modelit të Solow-t, ne gjithashtu mund të themi se kjo teori nuk shfaq rezultate të njëjta në qoftë se e marrim për bazë nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit, si edhe produktivitetin e shpenzimeve të dedikuara për arsim. Kjo qasje dallon nga zhvillimi ekonomik i vendit dhe politikat e shpenzimeve publike të dedikuara për arsim.

Siç e elaboruam më lart, edhe përkundër faktit se në literaturën botërore ekzistojnë një numër enorm i studimeve në këtë drejtim, edhe pse ata vinë në konkluzione të ndryshme, gjithsesi gjetjet e autorëve të ndryshëm kanë ndihmuar të identifikohen efektet e arsimit në rritjen ekonomike qofshin ato pozitive, neutrale apo edhe negative. Studimet e kësaj natyre kanë hedhur dritë mbi korrelacionin e shpenzimeve publike për arsim dhe rritjen ekonomike. Fenomeni i produktivitetit të shpenzimeve publike dedikuar arsimit është shumë i ndjeshëm veçanërisht për vendet në tranzicion të cilat kanë fituar statusin kandidat për në UE. Këto vende posaçërisht duhet të kujdesen për hartimin e politikave të mirëfillta drejt krijimit të fuqisë punëtore, cilësore dhe zbatimin e të njëjtave, ngase arsimi i identifikuar njëherësh si motor i një shoqërie e cila e bën vendin të lëviz duhet mirë të promovohet në çdo sektor brenda dhe jashtë vendit.

Shpenzimet publike të arsimit duhet të destinohen racionalisht me qëllim që të mundësojnë krijimin e një force punëtore të kualifikuar mirë që do ta promovonte ekonominë e vendit dhe rritjen e saj denjësisht në mbarë botën. **Një nga fokuset kryesore e politikëbërësve në Europë është të përmirësojnë cilësinë e shpenzimeve publike të dedikuara për arsimin.** Kjo paraqet një

përgjegjësi për ekonominë europiane që të krijojnë fuqi punëtore të kualifikuar e cila do t'u përgjigjet nevojave të tregut të punës me të vetmin qëllim që të përfitojnë konkurrencën globale. Njerëzit e kualifikuar me shkathtësi të duhura mund të rrisin ekonominë e Bashkimit European duke udhëhequr me risitë dhe përmirësimin e konkurrencës. (Financimi i arsimit në Europë 2000 - 2012, ndikimi i krizës ekonomike).

Morgasova et. al (2015) në raportin nga FMN “Ballkani Perëndimor – 15 vite në ekonomi në tranzicion” janë të qëndrimit që puna dhe kapitali njerëzor në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kontribut shumë të ulët në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto. Ky qëndrim është po ashtu në linjë me studimet tjera të tilla si (Campos et al 2002); (IMF 2009); dhe (EBRD 2013). Sipas autorëve dhe stafit të FMN-së, në këtë studim papunësia e vazhdueshme në shtetet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht kushteve ciklike, është konfirmuar përmes analizave ekonometrike të përgjigjeve bashkëkohore të nivelit të papunësisë me ndryshimet në rritjen ekonomike, e cila sugjeron se përgjigjet e marra nga rezultatet e tregut të punës për të luatur ciklet ekonomike janë të vogla dhe statistikisht të parëndësishme.

Dmitriy et.al, (2014) në raportin nga FMN-ja mbi “*Rritjen e punësimeve në Ballkanin Perëndimor*” i konsideron vendet e Ballkanit me normë më të lartë të papunësisë së moshës së re dhe me normë më të lartë të kohëzgjatjes në mbarë shtetet e UE-së. Autorët vijnë në konkluzion se performanca e dobët e tregut të punës në vendet e Ballkanit është një shqetësim kyç social që njëherësh e dëmton rritjen ekonomike afatmesme dhe afatgjatë dhe paraqet sfida të madhe për politikëbërësit. **Mojsoska** (2012) në një hulumtim dedikuar reformave drejt politikave të suksesshme të punësimit në rajon - *drejt më shumë vendeve të punës, fuqisë punëtore të kualifikuar dhe konkurrencës më të madhe, vendet e Ballkanit Perëndimor* (WBIF – Korniza e investimeve në Ballkanin Perëndimor), potencon se arsimimi është i lidhur pozitivisht me rritjen e normës së punësimit, konkretisht norma e punësimit rritet me rritjen e nivelit të arsimimit.

Investimi në arsim para së gjithash nënkupton investimin në resurse humane, që nënkupton krijimin e një force të kualifikuar punëtore e cila do të ndikojë në krijimin e inovacioneve, do të rrisë produktivitetin dhe pagat, do të ulë kërkesat nga shteti për financim të programeve të ndryshme sociale, do të rrisë buxhetin e shtetit nga akumulimi i tatimeve dhe e gjithë kjo pritet të ketë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të vendit. Përfitimet nga investimi në Arsim nuk


përfundojnë këtu, ekziston një listë e gjatë për të mos thënë pa mbarim nga përfitimi i shtetit dhe i mbarë shoqërisë nga arsimimi i mirëfilltë i popullatës, duke filluar nga rritja e numrit të fuqisë punëtore të kualifikuar, krijimi i profileve adekuate bazuar në kërkesat e tregut të punës duke plotësuar njëherit nevojat e tregut, rritja e produktivitetit, rritja e pagave dhe përmirësimi i standardit jetësor duke e rritur në këtë mënyrë ekonominë e vendit të shoqëruar me rritjen e mirëqenies sociale.

Po ashtu kohëve të fundit, në rastin e Maqedonisë politikën arsimore janë të orientuara drejt trendeve të krijimit të një eksternalie negative të krijuar nga arsimimi masiv. Papunësia në Maqedoni prej pavarësisë së shtetit e deri më tani luhetet në normën 30%, që parimisht duket se nuk ka ndryshuar, por më e dhimbshme është fakti se ka ndryshime në strukturë, ku normën më të lartë të papunësisë sot e përbëjnë diplomëmbajtësit (ata të cilët kanë shkollim universitar e më lart) dhe kjo ndikon negativisht në produktivitetin e punës.

Pra, lind pyetja pse janë rezultatet e tregut të punës kaq shumë të pavolitshme jo vetëm në rastin e Maqedonisë, por gjetiu në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor krahasuar me vendet e tjera? Një nga arsytet është se vendet e Ballkanit Perëndimor janë të reja në fushën e procesit të tranzicionit dhe kështu investimet e huaja direkte, diversifikimi nga sektorët tradicionalë dhe krijimi i vendeve të punës në sektorin privat ende kanë ngecje në krahasim me shtetet anëtare të BE-së. Në të njëjtën kohë, këto vende janë ballafaquar me fenomenin e emigracionit shumë të madh dhe **ikjen e trurit**, duke rezultuar kështu në flukset e remitancave të larta që me gjasë kontribuojnë në rezervimin e pagave, pengojnë konkurrencën e jashtme dhe kështu kontribuojnë edhe në kohëzgjatjen e papunësisë (Kovtun et, al 2014; FMN 2013)

Meqë arsimimi është shtylla më e ndjeshme e çdo shoqërie, duhet të kemi kujdes të veçantë gjatë hartimit të politikave të financimit të të njëjtit, koncipimit të politikave arsimore të orientuara drejt tregut të punës dhe po ashtu krijimin e një ekonomie të bazuar në dije.

Figura 1. Mikro dhe makronivelet e efekteve të arsimit në rritjen ekonomike



Burimi: Michaelowa, Katharina (2000), "Kthimi nga arsimi në shtetet me të ardhura të ulëta"

Arsimi me cilësi të lartë do të thotë fuqi punëtore e kualifikuar, por akoma nuk është e qartë në çfarë mënyre kjo forcë punëtore e kualifikuar do të krijojë inovacione me qëllim të promovimit të rritjes ekonomike?! Çfarë konkretisht bëjnë të diplomuarit e nivelit të lartë së bashku në qoftë se nuk bëjnë që gjërat të ndryshojnë në margjina? - Aghion, et. al (2009). Hirst and Peters këmbëngulin se "arsimi" gjithmonë ka qenë "koncept normativ" nga i cili ata konkludojnë: "Kjo është arsyeja pse arsimi dhe qëllimet e tij janë kaq shumë të përfolura".

Metodologjia e hulumtimit

Duke u bazuar në studimet teorike dhe empirike të konsultuara, në këtë studim është specifikuar modeli i rritjes ekonomike endogjene që ngërthen në vete rolin e financimit publik të arsimit në rritjen ekonomike. Duke shfrytëzuar ekuacione strukturore mbi ndikimin e financimit publik të arsimit në rritjen ekonomike, në këtë studim kemi ndërtuar modelin ekonometrik me qëllim të identifikimit dhe matjes së ndikimit që ka arsimi në rritjen ekonomike.

Të dhënat në këtë studim janë të dhëna-panel për periudhën kohore 1991-2014 me qëllim të matjes dhe identifikimit të variablave që pritet të kenë ndikim në rritjen ekonomike, ndërmjet të tjerave impakti i shpenzimeve publike dedikuar arsimit në rritjen ekonomike,

modeli është përshtatur duke u bazuar në vlerësuesin IV (2SLS) ose thënë me fjalë të tjera në modelin e regresionit dyfazor (**Instrumental Variable Two Stage Least Squares (IV2SLS)**).

Modeli i aplikuar (IV - 2SLS) në këtë studim, duke u bazuar në instrumentet vlerësuese të modelit merr formën e përgjithshme:

$y = f(\text{capform}, \text{labforce}, \text{unepl}, \text{industry}, \text{gini}, \text{wages emplind}, \text{ict})$
ku:

- Y= GDP Annual growth rate
- Capform = Kapitali
- Labforce= Forca totale e punës
- Unepl = Norma e papunësisë
- Industry = Industria
- Gini = Gini index
- Eages= Pagat
- Emplin= Të punësuarit në industri
- Ict= Sistemet e teknologjisë së informimit
- Variabli i instrumentuar = eduexp
- Instrumenti (excluded) = set

Modeli i lartshënuar në bazë ekonometrike merr formën:

$$y = \alpha_0 + \beta_1 x_1 + \theta_1 \Sigma x_2 + u$$

$$x_1 = \pi_0 + \pi_1 z_1 + v$$

Ku:

y = variabla e varur

x_1 = variabla e instrumentuar

Σx_2 = variablat shpjeguese endogjene³

z_1 = variabla shpjeguese ekzogjene⁴ dhe

u = termi i gabimit

³ Variablat endogjene - një variabël vlere e të cilit është përcaktuar në kuadër të një sistemi të ekuacionit. Vlerat e variablave endogjene janë zgjidhja e sistemit të ekuacionit.

⁴ Variablat ekzogjene – një variabël vlere e të cilit është përcaktuar jashtë një sistemi të ekuacionit.

Interpretimi i rezultateve

Studimi në fjalë bazohet në të dhëna sekondare dhe fillon me interpretimin e statistikave përshkruese të trendit dhe tendencave të normës së papunësisë sipas moshës, gjinisë dhe nivelit të arsimimit në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri.

Statistikat përshkruese

Tabela1. Analizë trendit të papunësisë sipas gjinisë, moshës 15-24 dhe nivelit të arsimimit

	Unemployment				Youth unemployment				Unemployment by educational attainment		
	Male		female		Male		female		Basic	Intermediate	Advanced
	% of male labor force		% of female labor force		% of male labor force ages 15-24		% of female labor force ages 15-24		% total force with basic education	% total force with intermediate education	% total force with advanced education
	2000	2016	2000	2016	2000	2016	2000	2016	2013-16	2013-16	2013-16
Kosovo	..	..	..	..	..	..	..	..	47.6	36.7	8.2
Macedonia	32.2	24.3	32.2	22.7	55.5	47.9	54.7	48.7	26.1	22.7	21
Albania	18.2	15.7	29.3	14.5	42.5	34	27.6	30.4	11.5	22.9	21.5

Burimi: Te dhënat janë siguruar nga indikatorët e Bankës Botërore, kurse janë përpunuar dhe sistemuar nga ana e autorit,

<http://databank.worldbank.org/data/reports>

Nga tabela shihet se papunësia në Maqedoni nga viti 2000 – 2016 shënon trend ulës. Në vitin 2000 norma e papunësisë së të rinjve të moshës 15-24 të gjinisë mashkullore ka qenë 55.5%, kurse në vitin 2016 arrin në 47.9%. Norma e papunësisë së të rinjve të moshës 15-24 edhe për gjininë femërore shënon trend ulës në rastin e Maqedonisë, ku në vitin 2000 ka qenë 54.7%, kurse në vitin 2016 arrin në 48.7%. Në rastin e Shqipërisë norma e papunësisë së moshës së re të gjinisë femërore shënon trend rritës për dallim nga Maqedonia. Kjo normë në vitin 2000 në rastin e Shqipërisë ka qenë 27.6%, kurse në vitin 2016 rritet në 30.4%. Nga indikatorët e Bankës Botërore mungojnë shënime për rastin e Kosovës.

Tabela 2. Trendi i normës së papunësisë sipas nivelit të arsimit përfshirë asimin e ulët, të mesëm dhe arsimin e lartë

Year	Unemployment with basic education			Unemployment with intermediate education			Unemployment with advanced education		
	Kosovo	Albania	Macedonia	Kosovo	Albania	Macedonia	Kosovo	Albania	Macedonia
2010		13.8	36.6		19.7	33.4		14.4	24.8
2011		10.5	33.2		17.5	31.8		18.7	26.3
2012		8.4	31.3		13.2	31.9		19.2	26
2013		10.3	31.2		17	28.9		16.2	26.7
2014	49	10.8	29.9	45.2	20.7	29.8	27.1	18.2	24.6
2015	39.5	11.5	26.3	41.1	22.9	25.9	28	21.5	22.5
2016	47.6		26.1	36.7		22.7	8.2		21
2017			20.5			22.3			21.7

Burimi: Të dhënat janë siguruar nga indikatorët e Bankës Botërore, kurse janë përpunuar dhe sistemuar nga ana e autorit,

<http://databank.worldbank.org/data/reports>

Nga tabela shihet që norma e papunësisë në strukturë sipas nivelit të arsimit në rastin e Maqedonisë ka luhetje ndër vite. Në vitin 2010 norma e papunësisë me arsim të lartë, përfshirë bachelour, master dhe PhD ka qenë 24.8 deri në vitin 2013 kjo normë shënon trend rritës dhe arrin në 26.7, kurse nga viti 2013 – 2017 shënohet trend ulës ku arrihet në normën 21.7. Shënimet flasin se në Kosovë trendi i normës së papunësisë së të diplomuarve universitarë është rrënës edhe atë drastik. Në vitin 2014 norma e papunësisë ka qenë 27.1, kurse në vitin 2016 arrin në 8.2. Shqipëria shënon trend rritës të normës së papunësisë së të diplomuarve universitarë, meqë në vitin 2010 kjo normë ka qenë 14.4, kurse në vitin 2016 arrin në 21.5. (Të dhënat janë në përqindje.)

Analiza empirike

Ky seksion paraqet lidhjen ndërmjet ndikimit të shpenzimeve publike dedikuar arsimit në rritjen ekonomike dhe ndikimin e variablave të tjera të cilat janë të përfshira në model. Modeli empirik merë formën:

$$gdp = \alpha_0 + \beta_1 eduexp + \theta_1 capform + \theta_2 labforce + \theta_3 unempl + \theta_4 industry + \theta_5 gini + \theta_6 wages + \theta_7 empl \quad (24)$$

$$eduexp = \pi_0 + \pi_1 set + v$$

Nga rezultatet e mësipërme kemi vlerësuar modelin empirik, i cili duket si në vijim:

$$\begin{aligned} gdp = & -36.385 + 4.158 eduexp + 0.422 capform \\ & + 0.298 labforce + 0.394 unempl \\ & + 1.016 industry - 0.128 gini - \\ & 0.571 wages - 0.059 emplind + 0.877 ict \quad (26). \end{aligned}$$

Pas realizimit të modelit IV/2SLS, duke u bazuar në rezultatet e testeve, përfshirë: (i) f-test (*p-value* 0.0357), (ii) R square 0.99; (iii) weak identification test 317.76; (iv) *Sargan overidentification test* 0.000 (exactly identified) dhe vlerat kritike të Stock and Yogo testit, vimë në konkludim se modeli është i përshtatshëm dhe sinjifikant.

Tani pasi që bëmë testet e duhura mbi modelin dhe pamë se modeli IV (2SLS) i aplikuar në këtë studim është sinjifikant, mundemi që të vazhdojmë me interpretimin e koeficientëve. Me modelin e vlerësuar me *ivreg2* ne gjetëm koeficientët sinjifikantë për *eduexp*, *capform*, *lab force*, *unempl*, *industry*, *gini*, *wages* dhe *ict*, të cilat mund të interpretohen si më poshtë:

- **Koeficienti i *eduexc*** është pozitiv dhe sinjifikant. Gjithashtu theksojmë se kjo variabël është e instrumentuar me variablën ekzogjene *set*, andaj efekti në variablën e varuar përfshinë efektin e të dy variablave, dhe edhe koeficienti është më i madh nga koeficientët e tjerë. Kjo tregon se me rritjen e shpenzimeve publike për edukim do ketë një rritje në GDP. Lidhja pozitive ndërmjet rritjes së shpenzimeve publike dedikuar arsimit dhe GDP-së është në linjë me studime të tjera të aplikuara për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. **Koeficienti *capform***, që paraqet formimin e kapitalit bruto (më parë investimi i brendshëm bruto) përbëhet prej shpenzimeve në shtesa në asetet fikse të ekonomisë, plus ndryshimet neto në nivelin e inventarëve, është pozitiv.

Koeficienti pozitiv na tregon se një rritje në capform do të rrisë gdp-në për **0.422**.

- **Koeficienti *labforce* = 0.298.** Ky koeficient paraqet efektin pozitiv të forcës punëtore në rritjen ekonomike. Meqë ky indikator paraqet shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, konkretisht përqindja e moshave 15-64 e popullsisë që është ekonomikisht aktive (të gjithë njerëzit që ofrojnë punë për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë një periudhe të caktuar), pritet që me rritjen e shkallës së fuqisë punëtore për një njësi gdp-ja të rritet për 0.2985, që është në linjë me gjetjet nga studimet e shumta të konsultuara në këtë studim. **Koeficienti pozitiv i papunësisë 0.394 dhe koeficienti negativ i punësimeve 0.059** – janë dy koeficientët kundërshtimor me gjetjet teorike dhe empirike, por që njëherit dëshmojnë mospërputhshmërinë ndërmjet kërkesës dhe ofertës për profesione reale në tregun e punës në Maqedoni. Mayes dhe Virén (2002) gjejnë se një nga arsyet kryesore për një asimetri të tillë duhet të kërkohej në mënyrën se si vepron tregu i punës. Tendencat e shpejta në rënie në ekonomi mund të kenë efekt në një rritje joproporcionale mbi normën e papunësisë, dhe kjo është edhe për shkak të faktit se kërkesa dhe oferta jo domosdoshmërisht takohen në çdo sektor të aktivitetit ekonomik dhe në çdo aktivitet të tregut të punës. Kjo është karakteristike posaçërisht për vendet në zhvillim e sipër, siç është Maqedonia.
- **Koeficienti pozitiv i industrisë** që njëherësh paraqet vlerën e shtuar në miniera, prodhim (raportuar gjithashtu si një nëngrup i veçantë), ndërtim, energji elektrike, ujë dhe gaz dhe koeficienti pozitiv i ICT-së (teknologjia e komunikimit dhe informimit) dëshmojnë se me një rritje të këtyre dy indikatorëve, GDP-ja po ashtu do të rritet. **Gini Index** si një koeficient që mat pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave është negativ dhe ka kuptimin: sa më i lartë të jetë Gini indexi, aq më e lartë do të jetë pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave, kjo do të ketë ndikim negativ në GDP. **Pagat kanë koeficientin negativ prej -0.571.** Kjo do të thotë se rritja e pagave për një njësi do të ketë ndikim negativ në GDP (do të ulë GDP-në për 0.571). Ky koeficient na tregon se pagat nuk kanë ndikim në rritjen e produktivitetit të punës

në rastin e Maqedonisë (e elaboruar edhe te koeficienti i punësimeve dhe papunësisë – roli i pagës në rritjen e produktivitetit të punës).

Shkurtimisht, analiza empirike na sugjeron se rritja e shpenzimeve publike dedikuar arsimit, duke përfshirë edhe variablën e regjistrimit të përgjithshëm në arsimin terciar (theksojmë se kjo variabël është e instrumentuar me variablën ekzogjene *set*) do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike matur kështu sipas GDP-së. Mes të tjerave, duke u bazuar në koeficientët pozitivë dhe negativë të papunësisë dhe punësimeve, vijmë në konkluzion se edhe përkaj rritjes së shpenzimeve publike dedikuar arsimit, kjo rritje nuk ka ndikim në kërkesën dhe ofertën e tregut për profesione reale. ***Pikërisht në një trend të këtillë themi se rruga e transmisionit prej arsimit në punësim dhe rritja ekonomike është e zbehtë në rastin e Maqedonisë.*** Prandaj, duke u bazuar gjithmonë në gjetjet empirike, bazuar në teoritë e rritjes ekonomike dhe rezultateve nga hulumtime të tjera të shumta empirike, në kreun e radhës do të vijmë me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse dedikuar financimit publik të arsimit dhe rritjes ekonomike.

Konkluzione dhe rekomandime

Maqedonia ka planifikuar dhe realizuar një numër të madh të reformave veçanërisht në aspektet normative. Si rezultat i numrit të madh të reformave dhe ndryshimeve të shumta dhe të shpeshta në sferën e arsimit prej periudhës së decentralizimit të financimit publik të arsimit (2005) e deri më sot ekzistojnë një mori reformash, ligjesh dhe normash. Si rezultat i reformave dinamike dhe të vazhdueshme në këtë sferë, indikatorët ekonomikë na sjellin në rezultate të paqëndrueshme, madje edhe paradoksale. Reformat në arsim janë projektuar përgjithësisht mbi arsye politike ose të udhëhequra nga parimi, ***“more is better in state of better is more”*** (Bexheti 2015) – Edukimi masiv, populist kundrejt parimit të cilësisë dhe kështu nuk janë të lidhura me nevojat e tregut të punës. Por realisht “tregu i punës në Maqedoni karakterizohet me aktivitet të ulët, shkallë të ulët të punësimit, shkallë të lartë të papunësisë dhe pabarazi kualitative dhe kuantitative midis forcës së punës të ofruar dhe aftësive të kërkuara. Ngjashëm si edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, tregu i punës në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është vlerësuar si inkluziv i pamjaftueshëm edhe përkrah normës ligjore ekzistuese në

domenin e marrëdhënieve të punës dhe mundësive të barabarta për punësim. Inkluziviteti për grupe të caktuara të popullatës, siç janë të rinjtë dhe punëtorët shumë të vjetër, si dhe pakicat etnike edhe mandej mbetet nxitje e madhe për vendin, duke i pasur parasysh shkallët mjaft të larta të papunësisë së këtyre grupeve të popullatës” (Mojsoska et,al 2009).

Nga ato që u potencuan më lartë konkludojmë se:

- Qeveria duhet të rrisë shpenzimet produktive dedikuar arsimit në drejtim të përmbushjes së kërkesave të tregut të punës dhe të veprojë si një katalizator nga diplomëmbajtësit dhe tregu i punës. Dizajnimi i politikave arsimore duhet të bazohet në parim mbi analiza dhe hulumtime konkrete.
- Qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme në drejtim të menaxhimit të shpenzimeve publike dedikuar arsimit me qëllim që të rrisë shkathtësitë e forcës punëtore. Politikat arsimore duhet të udhëhiqen në parimin: **“better is more on state of more is better”** (Bexheti 2015). Shkollat profesionale duhet domosdoshmërisht të jenë prioritet në politikëbërjen e sistemit arsimor në vend.
- Qeveria duhet të drejtojë shpenzimet publike për arsimin në drejtim të sektorëve produktivë që do të kontribuojnë në përmirësimin e standardit të jetesës, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike në përgjithësi.
- Qeveria duhet të krijojë programe për trajnimin e të rinjve për t’u inkadruar në punë bazuar në eksperiencën e të mësuarit, duke përmirësuar kështu cilësinë e ofertës së fuqisë punëtore në tregun lokal të punës.
- Duhet të krijohet dhe të funksionojë një rrjet (network) që do të përputhë aftësitë e kërkuara në tregun e punës me ato të zhvilluara në sistemin arsimor.
- Institucionet e arsimit të lartë duhet të krijojnë programe të integruara akademike me kompanitë.

Limitimi i punimit

Meqë pritjet nga të diplomuarit, në çdo nivel arsimor, janë apriori - të përfundohet me njohuri dhe shkathtësitë e duhura që korrespondojnë me ciklin studimor, kjo nuk ndodh në të shumtën e

rasteve. Një fenomen i këtillë është më shumë i spikatur në vendet në zhvillim e sipër. Ashtu si ndodh edhe në rastin e BP-se, ku të diplomuarit universitarë janë në rritje e sipër (sipas parimit të sasisë), por nuk janë në tregun e punës. Kështu lind nevoja mbi studimin e cilësisë së arsimit. Ia vlen të thuhet se në rrugën drejt zhvillimit të sektorit të arsimit, sasia e arsimit e shprehur në terma të numrit të nxënësve të regjistruar dhe diplomimit të tyre është një kusht i nevojshëm që duhet plotësuar. Ndërsa **cilësia** është një kusht i mjaftueshmërisë së arsimit si e mirë publike. Megjithëse te kushtet, si sasia ashtu edhe cilësia mund të ndiqen dhe të jenë në të njëjtin hap, racionaliteti dikton, sepse para së gjithash plotësohet kushti i parë - ai i sasisë dhe më pas vijon ai i cilësisë. Kështu, në këtë studim theksi është në sasinë e arsimit. Përveç kësaj, të dhënat për masat e cilësisë së arsimit të tilla si raporti i nxënësve ndaj arsimtarëve është i mangët dhe nuk mbulon pjesën më të madhe të periudhës nën shqyrtim. Kjo mbetet edhe si një nga limitimet e këtij studimi.

THE IMPACT OF PUBLIC INVESTMENT IN EDUCATION IN ECONOMIC GROWTH - THE CASE OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Abdylmenaf BEXHETI

Academy of Sciences and Arts of Macedonia,
South East European University, Tetovo
a.bexheti@seeu.edu.mk

Besime ZIBERI MUSTAFI

Kolegji AAB.
besime.ziberi@aab-edu.net

Abstract

The main goal of this research is to study the link between public education financing after the decentralization process and its impact on economic growth in the Republic of Macedonia as a developing country. This study does not simply intend to present the education system and the structure of its financing, but it aims to answer the main question of the study: What human capital does education create in the country, as one of the most promoted indicators of economic growth everywhere.

In the absence of qualitative data in developing countries such as Macedonia, the application of empirical models to test the causal effects on public spending dedicated to education and their impact on economic growth, reveals that in most cases it is paradoxical and this explains why the manner through which expenditures devoted to education impact on economic growth is not known to the right extent. In order to promote economic growth, policies on public expenditures devoted to education should consider the quality of education and the qualification of the workforce expected to meet the labor market requirements, so the manner in which education impacts economic growth is not based on the rate of expenditures dedicated to education, but on the quality of the policy pursued by the country and its consistent implementation.

Using the IV-2SLS econometric model with panel data including Macedonia and Slovenia (1991-2014), dedicated to testing the phenomena in question, we conclude that education and labor market policies in the country are not conceptualized and oriented towards economic growth, by also raising for discussion the question: What does a qualified workforce concretely do, if it does not affect the improvement of labor market productivity?

Keywords: Education, public spending, qualified workforce, economic growth, labor productivity.

Bibliografia

1. Dana Mitra, Ph.D. Associate Professor of Education, State University Pennsylvania's Best Investment: The Social and Economic Benefits of Public Education.
2. Barro, R. J. (1990). "Government Spending in a Simple Model of Endogeneous Growth", *The Journal of Political Economy*, 98(5): 103-125.
3. Desired and Potential development in the Balkans within a New Global and European Development Framework, Acad. Abdylmenaf Bexheti, SEEU Tetovo, October 7-th 2013, Skopje
4. Musgrave, R.A. (1969). Fiscal Systems, London: Yale University Press Musgrave, R.A. and Musgrave, B. (1988), Public Finance in Theory and Practice, New York: McGraw-Hill Book Company
5. Noah Berger and Peter Fisher, Economic Analysis and Research Network, pg.2, 2013.
6. The Causal Impact of Education on Economic Growth: Evidence from U.S.P. Aghion, L. Boustan, C. Hoxby, J. Vandenbussche, March 2009, page 4.
7. Katharina (2000), "Returns to Education in Low Income Countries: Evidence for Africa.
8. Cooray, (2009). The role of education in economic growth. Proceedings of the 2009 Australian Conference of Economists (pp.1-27). \Cooray, Arusha, The Role of Education in Economic Growth, Department of Economics, University of Wollongong, Working Paper 14-10, 2010, 28.
9. A Well-Educated Workforce Is Key to State Prosperity By Noah Berger and Peter Fisher | August 22, 2013.
10. The Causal Impact of Education on Economic Growth: Evidence from U.S.P. Aghion, L. Boustan, C. Hoxby, J. Vandenbussche, March 2009 (Harvard University and CEPR, University of California-Los Angeles and NBER, Stanford University and NBER, International Monetary Fund).
11. Academician Abdylmenaf Bexheti and Besime Mustafi (2015), "Impact of Public Funding of Education on Economic growth in Macedonia", Bamberg University, Berg, Working Paper No. 98, ISBN 978-3-943153-15- http://www.uni-bamberg.de/vwl/forschung/wps/

EU FINANCIAL RESOURCES AND RURAL DEVELOPMENT IN THE REPUBLIC OF CROATIA

Vinko KANDŽIJA¹
Tomislav KANDŽIJA²
Ivan TOLIĆ³
Marko TOMLJANOVIĆ⁴

Abstract

Rural areas cover 92% of EU and 91.6% of Croatia and make a great share in total employment (52% in the EU and 47.6% in Croatia). The research in this paper work was carried out in order to determine the impact of use of EU financial resources in the period 2007 - 2013 on the development of rural areas in Croatia. In the paper, it was carried out a survey of agricultural business entities which used EU financial resources intended for agriculture and rural development, and after that statistical analysis of data was conducted. It was found that use financial resources had a positive impact on the increasing volume of production, profits, investment, market share and on the strengthening of competitiveness. Also, research has shown that users are partially satisfied with the EU financial resources and the determined their positive (partial) impact on the sustainability and competitiveness.

Keywords: European Union, EU financial resources, Republic of Croatia, rural development

FINANCIJSKA SREDSTVA EU I RURALNI RAZVOJ U REPUBLICI HRVATSKOJ

Originalni znanstveni rad

Ruralna područja zauzimaju 92% površine EU te 91,6% Republike Hrvatske i čine značajan udio u ukupnoj zaposlenosti (52% u EU i 47,6% u Hrvatskoj). Istraživanje

¹ University of Rijeka, Faculty of Economics Rijeka, Croatia.
vinko.kandzija@unri.edu.ba

² County of Primorje and Gorski Kotar, Hrvatska. tomljav.kandzija@pgz.hr

³ University of Rijeka, Faculty of Economics Rijeka, Croatia

⁴ University of Rijeka, Faculty of Economics Rijeka, Croatia.
Email: mtomljan@efri.hr

u ovom radu je provedeno u svrhu određivanja utjecaja korištenja finansijskih sredstava EU u razdoblju 2007.-2013. godine na razvoj ruralnih područja u Hrvatskoj. U radu je provedeno anketno ispitivanje korisnika finansijskih sredstava EU namijenjenih poljoprivredi i ruralnom razvoju, nakon čega je provedena statistička analiza. Istraživanje je pokazalo kako EU finansijska sredstava imaju pozitivan utjecaj na povećanje proizvodnje, profite, investicije, tržišni udio te jačanje konkurentnosti. Također, istraživanje je pokazalo kako su korisnici djelomično zadovoljni korištenim EU sredstvima, a određen je i njihov pozitivan utjecaj na održivost i konkurentnost.

Ključne riječi: Europska unija, finansijska sredstva EU, Republika Hrvatska, ruralni razvoj

Introduction

Rural areas cover large territories in the EU (92%) and in Croatia (91.6%) and are inhabited by a significant number of residents (52% in the EU and 47.6% in Croatia). Efficient use of EU funds fosters the development of rural areas and makes these areas more attractive for living and working in. The research in this work is oriented towards the EU funds available to Croatia during the pre-accession period i.e. before becoming a full EU member in 2013. The research problem stems from the inability and / or ignorance of the population and politicians in finding appropriate ways of allocating and directing available resources through well designed programs. Therefore, this research aims to determine the causality of EU funds and the development of rural areas in Croatia. The research was conducted to confirm the main hypothesis: Through scientifically founded notions on the effectiveness of financial resources of the EU, it is possible to confirm the impact of EU financial resources on the development of rural areas in the Republic of Croatia.

Literature review

The theory of rural development, given the variety of its approaches and methodologies, has no general definition. The theory is primarily related to economic, social and other features, which reflects its multi – dimensionality, complexity and multi-functionality. In general, the theory focuses on the backwardness and underdevelopment of rural areas. (Kandžija, Vinko, Cvečić, Igor, 2010.). The theory of rural development, as part of a more recent economic theory, is oriented towards the development of non –

urbanized and underdeveloped areas and the effective use of available resources in such areas. Efficient allocation of available resources makes it possible to achieve a balanced economic growth, reduce the pressure on rural areas and limit depopulation in order to accomplish a better employment and overall prosperity.

Rural development, as a special segment of economic development, was the subject of economic research from the very beginning of economic thought. However, in the beginning, rural development, as such, was not directly mentioned. In Arthur Lewis's (1954) *Dual sector model*, the emphasis is placed on the surplus of labour in agriculture and increasing productivity of food producers and domestic demand. In *Strategy for India*, John Mellor (1976) emphasizes the backwardness and inferiority of the rural sector and identifies the causes of underdevelopment of agricultural sector in employment and earnings. Michael Lipton (1977) continues Mellor's research by identifying the key problems and limitations in the agricultural sector. The most significant limitations mentioned include: geographical differences, disparities in rural and urban areas, unequal position of the poor and conflicts between capital and labor arising from different national and international interests. Later research (Gerald Meier, 1980) emphasized that agriculture should be analyzed as a dynamic source of growth and better earnings, and not just as a source of surpluses which support industrial growth. The research of rural development continues in 1990s in Michael Porter's (1990) and Alex Duncan's (1992) works. In his works, Porter agrees with the views of his predecessors on the problems and limitations of the rural population, but also emphasizes the potential benefits of adjustment programs as means of reducing the poverty in rural areas. Duncan, on the other side, points out that the promotion of export – oriented agriculture can result in increased food security for the poor (rural) population.

The issue of rural development is increasingly gaining the key position in the research and policies of the EU. The interest of the EU rural development policy has in the past years moved from improving the competitiveness of agriculture and fishery towards improving the quality of life and diversification of rural areas, with special emphasis on environmental protection. (Kandžija, Vinko, 2003). According to Ana Papadopoulos and Richard Harding (2012), the EU rural development policy, unlike in the previous period when founded on the sectoral approach, is now founded on regional approach.

According to David Midmore and associates, this approach results in greater opportunities and flexibility at national and regional level.

The EU has introduced a number of financial instruments intended for candidate and new – member states aimed at financing and promoting rural areas. The big problem in the allocation of the mentioned funds lies in the demanding system of application and complex administrative procedures. (Jakovac, Pavle, Maljković, Biljana, 2010). These features represent one of the most important causes of insufficient use of available resources. In Croatia, there is still no thorough analysis of the effects of the use of EU financial instruments on the development of the agricultural sector. Since this topic has not been fully researched and presented to the public, and since its comprehensive approach will represent a synthesis of previous research and provide some new insights, there is theoretical and practical justification for such research.

Research methodology

The research plan was to carry out a survey in form of a questionnaire among farms and businesses in Croatia involved in agricultural and livestock production and their satisfaction with the use of invested funds aimed for the development of rural areas. The questionnaire is structured to consist of 19 questions with more sub – questions. The first part of the questionnaire is based on demographic content, questioning the main characteristics of respondents. The second part of the questionnaire consists of open and closed questions. The possible answers are set according to the Likert scale ranging from 1 to 7. The data collected through surveying and interviewing were processed by SPSS.20. statistics program using descriptive statistics, graphics, the Shapiro Wilk test to verify the normality of distribution for the analyzed value, given that the sample of examined agricultural dealers is less than 50, and the chi – square test. In order to verify the tested samples which were collected, the Shapiro Wilk test was used to check whether the variables satisfy the assumption of normality, but only for samples less than 50. The score W is an empirical value, and the p – value, with a corresponding Shapiro Wilk test, is considered statistically significant if below 0.05. In this case, the hypothesis is accepted and the distribution of the analyzed variables satisfies the assumption of normality. In the analysis of the interdependence between qualitative variables with a small number of

modalities, the chi – square test of independence of two characteristics is used. If the p – value of the chi – square test, which follows the value for the chi – square empirically, is less than 0.05 (in case of an error of the first kind – 5%), there is interdependency between the variables included in the chi – square test according to crosstabulation, i.e. the variables are not independent.

Empirical research on the effects of EU financial resources on the development of rural areas in the Republic of Croatia

The analysis of the obtained data shows that the largest number of farms and businesses engaged in agriculture were established between 2000 and 2010 (32.4%), 29.7% were established by 2000, and 27% prior to 1992. Only 10.8% of them were established after 2010, which points to the stagnation of this sector in Croatia.

When the respondents were asked whether the source of their fixed income is exclusively related to their core business activity (agriculture), 78.4% of respondents answered positively, while 21.6% stated that agricultural production is a source of additional income. When the respondents were asked about the share of income from agricultural production in total income, their answers varied. The highest number of farms and businesses stated that this share is between 1% and 15% (12 entities or 32.4%). The same number of entities (12) generated 100% of income from agricultural production. The survey results show that 18.9% of entities realized between 16% and 30% of their income from agricultural production while 8.1% of respondents answered that this share was between 75% and 99%. The smallest number of entities are those generating between 61% and 75% of income from agricultural production (5.4%), and those between 46% and 60% (2.7%). Based on these data we can conclude that entities do not generate their income exclusively from agricultural production, but also perform other activities like livestock farming.

Chi – square test of independence showed that there is no significant difference between different groups of respondents i.e. between the years of establishment and the incomes generated from agricultural production).

The analysis of the data shows that the largest number of entities are those that employ between 1 and 5 workers (70.3%), which are followed by those employing more than 10 workers (16.2%), while

the smallest number of entities are those employing between 5 and 10 workers (13.5%). The chi-square test showed that there is no significant difference between the different groups of responses i.e. the year of establishment does not affect the number of full – time workers.

A very interesting fact is that there is no significant statistical difference between the number of workers and the share of income from agricultural production in total income. The reason for this could lie in the additional activities performed by these entities.

Moreover, the analysis of collected and processed data shows that entities mostly hire additional labor in the total volume of 1 to 5 workers (75.7%); 13.5% of them hire more than 10 additional workers, while only 10.8% of entities engage between 5 to 10 workers. The same as with the analysis of full – time workers, the test showed that the proportion of income generated from agricultural production in total income does not statistically differ between different groups of responses i.e. the number of seasonal workers does not significantly affect the generated income.

The analysis of the data shows that 24.3% of respondents farm feathered animals, 21.6% cultivate fruit, 16.2% of them cultivate vegetables, 8.1% deal with cattle breeding (pigs), and 29.7% of respondents said that their main business is not related to farming. According to that, slightly more than 70% of respondents are engaged in farming animals, fruit and vegetable while the rest of respondents are involved in some other agricultural activity. Most of the respondents (45.9%) answered they have no additional activity. Furthermore, 27% of respondents said that their additional activity is crop farming, 8.1% vineyard farming and the same percentage (8.1) of them are additionally engaged in fruit growing.

It is interesting to note that as much as 51.4% of respondents received over 40,000 HRK of incentive for the period 2007 to 2012 and in 2013. Moreover, 43.2% of respondents received up to 10,000 kunas, and only 2.7% of them received between 10,000 and 20,000 kunas, and between 30,000 and 40,000.

The data shows that during the observed period the amount of invested EU funds increased, which was accompanied by an increase in the development of the rural areas in Croatia. The incentives are proven to be very important to the development of rural areas. The chi-square test of independence showed no significant statistical difference between the year of establishment and the received amount

of incentives. Therefore, we can conclude that the length of entity's existence is not of significance in the allocation of incentives.

Respondents were asked about allocation of received funds in buying a modern technology, purchasing a land, buying a raw materials, employment of new workers and construction of facilities. Only 13.5% of respondents used between 16% and 30% of funds for the purchase of modern technology, which was shown by the high standard deviation and high coefficient of variation. Most of the respondents did not use the funds for the purchase of modern technologies (37.8% of them) which indicates that they invested it otherwise, which is analyzed later in the text. A small number of respondents (13.5%) used all of their received funds for the purchase of new technologies. The standard deviation is 2.16 and shows that the deviation around the arithmetic mean is not that small. The coefficient of variation is 72%, so it can be concluded that the variations are quite big and that the group is not homogeneous.

The surveyed respondents said that they allocated little or almost no funds for the purchase of land. The average answer of the respondents was 1.18, which implies that they invested 0.5 or very little. The standard deviation is 0.5694, which is a very small deviation and does not adversely affect the arithmetic mean. The coefficient of variation is 47%, so we can conclude that this is a homogeneous group. These results do not require further verification. The analysis showed that the respondents allocated little or almost no funds for the purchase of raw materials. The average response was 1.6216 and the standard deviation is not that low - 1.4405. This leads us to the conclusion that it may adversely affect the arithmetic mean. The coefficient of variation is 88%, which means that this is a non – homogeneous group of answers.

2. Antoncic, J. A. & Antoncic, B. 2011. 'Employee satisfaction, intrapreneurship and firm growth: a model.' *Industrial Management & Data Systems*, 111:4, 589-607.
3. Audretsch, D. B., Lehmann, E. E. & Wright, M. 2014. 'Technology transfer in a global economy.' *The Journal of Technology Transfer*, 39:3, 301-12.
4. Bae, T. J., Qian, S., Miao, C. & Fiet, J. O. 2014. 'The relationship between entrepreneurship education and entrepreneurial intentions: A meta-analytic review.' *Entrepreneurship Theory and Practice*, 38:2, 217-54.
5. Bandura, A. 1997. *Self-efficacy: The exercise of control*. Macmillan.
6. Bosma, N. & Kelley, D. 2019. *Global Entrepreneurship Monitor 2018/2019 Global report*. Global Entrepreneurship Research Association, London Business School.
7. Davidsson, P. & Honig, B. 2003. 'The role of social and human capital among nascent entrepreneurs.' *Journal of Business Venturing*, 18:3, 301-31.
8. EU 2008. 'Entrepreneurship in higher education, especially within non-business studies.' *Final report of the expert group*. European Commission, Brussels.
9. EU 2013. 'Entrepreneurship 2020 action plan: reigniting the entrepreneurial spirit in Europe.' European Commission Brussels.
10. Hahn, D., Minola, T., Van Gils, A. & Huybrechts, J. 2017. 'Entrepreneurial education and learning at universities: exploring multilevel contingencies.' *Entrepreneurship & Regional Development*, 29:9-10, 945-74.
11. Hallier, J. & Butts, S. 1999. 'Employers' discovery of training: self-development, employability and the rhetoric of partnership.' *Employee Relations*, 21:1, 80-95.
12. Krasniqi, B. 2012a. 'Building an Expanded Small Firm Growth Model in a Transitional Economy: Evidence on Fast Growing Firms.' *Journal of East-West Business*, 18:3, 231-73.

13. Krasniqi, B. 2014. 'Characteristics of self-employment: A refugee from unemployment or road to entrepreneurship.' *Small Enterprise Research*, 21:1, 33-53.
14. Krasniqi, B. & Branch, D. 2018. 'Institutions and firm growth in a transitional and post-conflict economy of Kosovo.' *Journal of Entrepreneurship in Emerging Economies*.
15. Krasniqi, B. A. 2009. 'Personal, household and business environmental determinants of entrepreneurship.' *Journal of Small Business and Enterprise Development*, 16:1, 146-66.
16. Krasniqi, B. A. 2012b. *Entrepreneurship and small business development in Kosova*. Nova Science Publishers.
17. Krasniqi, B. A. & Mustafa, M. 2016. 'Small firm growth in a post-conflict environment: the role of human capital, institutional quality, and managerial capacities.' *International Entrepreneurship and Management Journal*, 1-43.
18. Krasniqi, B. A., Shiroka-Pula, J. & Kutllovci, E. 2008. 'The determinants of entrepreneurship and small business growth in Kosova: evidence from new and established firms.' *International Journal of Entrepreneurship and Innovation Management*, 8:3, 320-42.
19. Kuratko, D. F. 2003. 'Entrepreneurship education: Emerging trends and challenges for the 21st century.' *White Paper, US Association of Small Business Education*, 22, 2003.
20. Kuratko, D. F. 2007. 'Corporate Entrepreneurship.' *Foundations and Trends® in Entrepreneurship*, 3:2, 151-203.
21. Lajqi, S. & Krasniqi, B. A. 2017. 'Entrepreneurial growth aspirations in challenging environment: The role of institutional quality, human and social capital.' *Strategic Change*, 26:4, 385-401.
22. Leitch, C., Hazlett, S.-A. & Pittaway, L. 2012. 'Entrepreneurship education and context.' *Entrepreneurship & Regional Development*, 24:9-10, 733-40.
23. Markman, G. D., Balkin, D. B. & Baron, R. A. 2002. 'Inventors and new venture formation: The effects of general self-efficacy and regretful thinking.' *Entrepreneurship Theory and Practice*, 27:2, 149-65.
24. McGee, J. E., Peterson, M., Mueller, S. L. & Sequeira, J. M. 2009. 'Entrepreneurial self-efficacy: refining the measure.' *Entrepreneurship Theory and Practice*, 33:4, 965-88.

25. Mueller, P. 2006. 'Exploring the knowledge filter: How entrepreneurship and university–industry relationships drive economic growth.' *Research Policy*, 35:10, 1499-508.
26. Mustar, P. 2009. 'Technology management education: Innovation and entrepreneurship at MINES ParisTech, a leading French engineering school.' *Academy of Management Learning & Education*, 8:3, 418-25.
27. Nabi, G., Liñán, F., Fayolle, A., Krueger, N. & Walmsley, A. 2017. 'The impact of entrepreneurship education in higher education: A systematic review and research agenda.' *Academy of Management Learning & Education*, 16:2, 277-99.
28. OECD/EU/EBRD/ETF/SEECEL 2016. *SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2016: Assessing the Implementation of the Small Business Act for Europe*. Paris: OECD Publishing.
29. OECD/EU/EBRD/ETF/SEECEL 2019. *SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2019: Assessing the Implementation of the Small Business Act for Europe*. Paris: OECD Publishing.
30. Parker, S. C. 2006. 'Entrepreneurship, self-employment and the labour market.' *Oxford handbook of entrepreneurship*, 435-60.
31. Shah, S. K. & Pahnke, E. C. 2014. 'Parting the ivory curtain: understanding how universities support a diverse set of startups.' *The Journal of Technology Transfer*, 39:5, 780-92.
32. Van der Sluis, J., Van Praag, M. & Vijverberg, W. 2005. 'Entrepreneurship selection and performance: A meta-analysis of the impact of education in developing economies.' *The World Bank Economic Review*, 19:2, 225-61.
33. Wilson, F., Kickul, J. & Marlino, D. 2007. 'Gender, Entrepreneurial Self-Efficacy, and Entrepreneurial Career Intentions: Implications for Entrepreneurship Education.' *Entrepreneurship Theory and Practice*, 31:3, 387-406.

SIGURIMI I CILËSISË SË ARSIMIT DHE I KËRKIMIT SHKENCOR NË ARSIMIN E LARTË SI NJË NGA FAKTORËT KRYESORË PËR LIDHSHMËRINË DINAMIKE ME TREGUN E PUNËS

Musa RIZAJ¹

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të tregohet rëndësia e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në arsimimin e lartë në përgatitjen e kuadrove për tregun e punës. Në vendet e zhvilluara me ekonomi tregu ekziston lidhja e drejtpërdrejtë e arsimimit të lartë dhe tregut të punës. Arsimimi i lartë është një aktivitet i cili në vazhdimësi iu nënshtrohet reformave dhe përshtatet në raport me të arriturat e shkencës dhe teknikës me qëllim që të ngritjes së cilësisë së dijes dhe kompetencës së studentëve për tregun e punës. Në këtë punim do të prezantohet problematika e sigurimit të cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në shkollimin e lartë, e cila për shkak të shumëllojshmërisë së saj nuk është objekt i kërkimeve shkencore dhe në politikën arsimore shpesh është e marginalizuar. Janë analizuar pozita e arsimit të lartë dhe e kërkimit shkencor në këto institucione, raportet ndërmjet këtyre kategorive dhe ndikimi i tyre në kompetencat profesionale për punësim. E gjithë kjo problematikë është parë nga perspektiva e globalizimit të arsimimit të lartë dhe kërkimit shkencor të cilët duhet të janë të lidhur ngushtë me tregun e punës duke iu përshtatur zhvillimit dinamik të tij. Këto objektiva mund të arrihen vetëm duke e ngritur cilësinë e mësimdhënësve dhe studenteve dhe duke investuar në krijimin e rrjeteve kërkimore shkencore. Rezultatet të cilat arrihen sot në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në përgatitjen e kuadrove për tregun e punës në vendin tonë janë për tu dëshiruar. Nëse universiteti duhet të ndërlidhë arsimin dhe punën kërkimore, komponent ky i obliguar për arsimimin e lartë, është rrezik se me këtë gjendje në të cilën ndodhen puna kërkimore, universitetet tona janë shndërruar në shkolla të mesme. Rëndësia e punës kërkimore-shkencore në ngritjen e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë nuk është shprehur mjaftueshëm as në dokumentet strategjike të institucioneve të vendit. Ndërrhyrjet politike dhe klanore në institucionet e shkollimit të lartë (themelimi i universiteteve, menaxhimi, punësimi, marrja e titujve akademikë, etj..) e kanë zbehur rolin e tij në aftësimin e studenteve për tregun e punës dhe autoritetin e nevojshëm në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Gjithashtu, ndërtimit i infrastrukturës dhe mbështetja financiare nuk e kanë përcjell mjaftueshëm këtë fushë në krahasim me vendet e rajonit dhe ato të zhvilluara. Buxheti i cili ndahet për shkencë në Kosovë është vetëm 09% nga BPSH, por i cili në pjesën më të madhe shpërndahet në të ardhura personale të instituteve ekzistuese.

¹ UMIB, Fakulteti i Gjeoshkencave, Depart. për Metalurgji dhe Materiale, Mitrovicë, Kosovë & FLOGEN Technologies Inc. Canada, USA.

Kjo vlerë na tregon për qasjen jo të mjaftueshme të institucioneve tona ndaj arsimimit dhe shkencës. Mbështetur në këtë mund të përfundohet se përgatitja e fuqisë punëtore të kualifikuar për tregun e punës është e lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e sistemit shkollor, i cili është proces dinamik dhe ka si synim avancimin e tij në të gjitha nivelet e shkollimit.

Fjalët çelës: Arsimi i lartë shtetëror dhe privat, tregu i punës, cilësia, puna kërkimore, mësimdhënësit, studentët.

Hyrje

Arsimimi është qëllimi më fisnik dhe gjithëpërfshirës i çdo shoqërie dhe ka një historik të gjatë, i cili kalon nëpër periudha të ndryshme dhe sot është integruar në hapësirën evropiane të arsimimit. Nëpërmjet arsimimit arrihet progresi në çdo sferë të jetës së individit dhe shoqërisë duke i ngritur ata në një kualitet më të lartë të jetës. Një individ i arsimuar i nevojitet çdo shoqërie, i cili duke e njohur të vërtetën ndikon që ajo shoqëri të këtë mirëqenie ekonomike dhe të jetë demokratike. E vërteta në një proces shoqëror dhe ekonomik mund të njihet vetëm nëpërmjet arsimit dhe shkencës dhe ndërlidhjes së tyre si një tërësi e pandarë pa të cilën nuk mund të këtë as zhvillim ekonomik dhe as mirëqenie shoqërore. Ndërlidhja mes arsimit dhe shkencës në epokën që po jetojmë është ngritur në sfidë e cila është objekt interesimi i institucioneve kërkimore dhe arsimore për shumë vende. Vendet të cilat kanë arritur që këtë sfidë ta adresojnë në drejtimin e duhur, mbështetur në standardet dhe përvojat e verifikuara kanë krijuar zhvillim ekonomik të rëndësishëm për mirëqenie dhe kanë krijuar shoqëri demokratike. Një segment i kësaj problematike në këtë punim do të jetë arsimi i lartë dhe puna kërkimore në institucionet e arsimit të lartë të vendit dhe ndërlidhja e tyre me tregun e punës. Duhet theksuar se kjo problematikë në vendin tonë nuk ka gjetur hapësirën e duhur si në dokumentet që duhet rregulluar këtë fushë, ashtu edhe në rolin e institucioneve të arsimit të lartë. Universitetet tona të cilët e kanë obligim të bëjnë ndërlidhjen ndërmjet arsimimit e punës kërkimore dhe ndikimin në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, për shumë arsye, nuk po arrijnë të sigurojnë cilësinë e studimeve dhe programeve. Kjo nënkupton edhe autoritetin e pamjaftueshëm që këto institucione kanë në proceset edukative në të gjitha nivelet e vendit. Në vendet e zhvilluara është arritur që kjo ndërlidhje të rregullohet në nivelin në të cilin mund të kontrollohet dhe matet cilësia e institucioneve të arsimimit të lartë në arsimin dhe punën shkencore. Duke e ditur

rrugëtimin të cilin e kishte sistemi arsimor i vendit, përqendrimi i potencialit shkencor dhe institucioneve kërkimore (instituteve) kryesisht ishte i shpërndarë nëpër fakultete, të cilat sot nuk janë funksionale në të shumtën e fakulteteve. Me këtë organizim që sot funksionojnë universitetet tona publike dhe private, pa institute ose ndonjë formë tjetër e cila e ndërlidh mësimin me kërkimin shkencor, ato më shumë i ngjajnë një shkollë të lartë ose të mesme se një universiteti. Duhet kujtuar se sot kërkimi shkencor nuk është punë dytësore e improvizuar e një individi por kërkon një punë ekipore interdisciplinare. Në këtë ndërlidhje mund të lindë edhe pyetja e zakonshme: si do të mbajë ligjëratat një profesor universitar rreth të arriturave të reja në një fushë shkencore, nëse ai nuk merret dhe nuk është marrë asnjëherë me punë kërkimore, si t'i shpjegojë ai proceset dhe dukuritë për studentët të cilat edhe vetë vetëm i ka lexuar. Ky aktivitet i punës në universitet sot matet dhe në bazë të rezultateve të punës kërkimore (numri i punimeve, kualiteti i revistave, citimi, etj) bëhet vlerësimi i një institucioni të arsimit lartë. Aty mund të shohim se sa pak janë të vlerësuara universitet tona. Me këtë gjendje në të cilën ndodhet arsimi i përgjithshëm në Kosovë nuk mund të flasim për cilësinë në arsimin e lartë, krahasimin me vendet e zhvilluara apo të rajonit.

Puna kërkimore kërkon kuadro të përgatitura për punë sistematike individuale dhe ekipore, por edhe mbështetje financiare e cila në vendin tonë është shumë simbolike. Të theksohet se në vendet tjera kjo mbështetje financiare për shkencë është në rritje të vazhdueshme, siç janë Finlanda, Suedia, Sllovenia, etj. Atëherë lind pyetja: Ku është shkenca në universitet? Si duhet të përgatitet kuadri kualitativ? Si të rritet autoriteti i institucionit dhe besimi në të dhe si të sillemi në rrjetin e sistemit arsimor të globalizuar? Pranimi i organizimit të arsimit të lartë sipas procesit të Bolonjës dhe adaptimet kozmetike janë më shumë improvizime, të aplikuara pa hartuar një strategji të bazuar. Duhet kujtuar se struktura e studimeve në universitet është ndryshuar disa herë gjatë këtyre viteve pa ndonjë analizë të mirëfilltë. Pra, pse duhet bërë këto ndryshime?!

Cilësia në arsimin e lartë

- Cilësia e mësimdhënësve dhe
- Cilësia e studentëve

Arsimimi pas nivelit të dytë në vendin tonë (sipas Ligjit) realizohet në institucionet e shkollimit të lartë të cilat janë universiteti dhe shkolla e lartë. Nga institucionet e shkollimit të lartë kemi universitet publike (7+2 universite) dhe shumë kolegje private (emërtim jo i kuptueshëm) dhe asnjë shkollë e lartë. Vendi ynë ka një traditë të organizimit të arsimit të lartë (mbi 50-vjeçare), organizim i cili i kishte edhe vështirësitë, por edhe të arriturat e tij. Ndërtimin e sistemit të shkollimit në botë, por edhe në vendin tonë e kanë përcjellë probleme të natyrës politike, materiale, strukturore edhe deri te koha e apartheidit, kur këto institucione edhe mbyllën. Të gjitha këto probleme e kanë penguar, po e ngadalësojnë dhe kanë lenë pasoja edhe sot në zhvillimin e shkollimit të lartë në Kosovë.

Sot duke e ndërtuar shtetin e Kosovës, numri i institucioneve të arsimit të lartë është rritur dukshëm si në arsimin publik ashtu edhe atë privat (tab. nr.1), andaj këtij zhvillimi duhet kushtuar më shumë kohë, hapësirë dhe mbështetje institucionale. Para se të themeloheshin këto universitete, nga themeluesi ishte dashur të shtrohen këto pyetje:

- Cili është qëllimi i arsimit që institucioni duhet përmbushur?
- Cilat kapacitete (infrastruktura dhe kuadri) i kemi që këto qëllime të përmbushen?
- Cila është alternativa tjetër që këto institucione të jenë më kompetente?
- Si mund të kemi informacionin kthyes për arritjen e këtyre qëllimeve? Etj., etj....

Universitetet tona duhet të fillojnë të marrin përgjegjësitë që iu takojnë që nëpërmjet arsimit dhe kërkimit shkencor të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike. Në gjithë këtë problematikë element parësor duhet të jetë cilësia e arsimit në arsimin e lartë, të cilit në Kosovë mendoj i referohemi vetëm në forma deklarative. Mungojnë mekanizmat e përhershëm të cilët janë kompetent për vlerësimin e tyre sipas standardeve evropiane të metodave pedagogjike, punës kërkimore dhe etikës profesionale dhe shkencore. Pa këto elemente nuk mund të pritet arsimimi cilësor i cili garanton kompetencë të studentëve të diplomuar për tregun e punës.

Sipas Ligjit për arsimin e lartë, të gjitha institucionet e arsimit të lartë ndahen sipas kategorive të mëposhtme: • *Universiteti* ofron arsim dhe kërkime shkencore/programe artistike. Institucionet e tilla mund të ofrojnë edhe programe profesionale. Universitet japin diploma dhe

kualifikime në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin e doktoratës... • *Kolegjet* ofrojnë programe profesionale apo akademike në nivelin Bachelor dhe Master. • *Shkollat profesionale* ofrojnë programe profesionale në një nga fushat gjegjëse. .

Për kualitetin e universiteteve tona nuk mund të flasim me argumente, sepse nuk kemi asnjë vlerësim zyrtar për cilësinë e tyre, gjegjësisht renditjen e tyre në vend. Por prezantimi ynë do të behët duke u mbështetur në ato argumente të cilat janë të njohura për një pjesë të madhe të pjesëmarrësve të arsimit të lartë: ministria, universitetet, fakultetet, mësimdhënësit, studentët, administrata dhe shoqëria civile. Por të theksohet se nuk mjafton që arsimimi i lartë të jetë i madh dhe gjithëpërfshirës (Kosova e ka më të lartin në Ballkanin Perëndimor, është 2.2 në 100.000 banorë), por të jetë arsimim cilësor i bazuar në standardët dhe përvojat e vendeve të zhvilluara.

Tabela 1. Institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor²

Vendet	IAL	IALSH	IALP	IAL 100.000 banorë
Shqipëria	39	16	23	1.3
BeH	47	10	37	1.2
Kosova	41	12	29	2.2
Maqedonia	16	5	11	0.8
Mali i Zi	12	1	11	2.1
Serbia	85	51	34	1.2

Tabela 2. Shkalla e papunësisë për studentët e diplomuar në vendet e Ballkanit Përendimor³

Vendet	Shkalla e papunësisë (%)	
	së përgjithshme	për studentët e diplomuar
Shqipëria	17.5	27.7
BeH	27.7	40.1
Kosova	35.3	50.7
Maqedonia	26.1	37.2
Mali i Zi	17.6	25.9
Serbia	19.4	42.4
BE	9.4	nuk ka

² Higher education and the labor market in the Western Balkans, quarterly monitor nr.47, Oct-Dec 2016.

³ Të dhënat nga Eurostat për vitin 2015.

Ky masivitet nuk duhet nënkuptuar vetëm në themelimin e fakulteteve të njëjta me programe studimore të njëjta, por duhet të përzgjidhen përmbajtje dhe programe studimore të cilat e arsyetojnë themelimin e tij.




Fig. nr.1. Numri i studenteve të regjistruar në vitin e parë të studimeve bachelor, viti 2004-2015

Numri i studentëve të regjistruar në vendet e Ballkanit për një periudhë 10-vjeçare është dhënë në fig.1. Nga figura mund të shihet se deri në vitin 2015 kishte rritje në të gjitha vendet, por nga ky vit rritja vazhdon vetëm në Republikën e Kosovës. Kjo është e dhënë e mirë të cilën duhet shfrytëzuar në drejtim të rritjes së cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

Kur flitet për cilësinë e arsimit të lartë, na paraqitën disa probleme: Kush duhet ta bëjë vlerësimin? Cilat janë mekanizmat dhe me cilat parametra duhet bërë këtë vlerësim? Pavarësisht se cili emekanizëm është caktuar për vlerësimin e cilësisë, ai duhet të mbështetet në cilësinë e mësimdhënësve dhe cilësinë e studentëve.

Cilësia e mësimdhënësve është elementi i parë i cili përcakton cilësinë e arsimit të lartë dhe e tregojë kapacitetin që mund ta këtë një institucion i shkollimit të lartë. Në mënyrë që mësimdhënësi i institucionit të lartë të plotësojë këtë kriter me kompetencë, ai duhet të vlerësohet në këto kategori:

- Në aspektin profesional,
- Në mësimdhënien pedagogjike,
- Në aftësitë komunikuese dhe
- Në aspektin shoqëror dhe etik.

Kompetenca profesionale nënkupton njohuri të mjaftuara për fushën përkatëse shkencore, mendim kritik dhe krijues, punë sistematike kërkimore shkencore dhe profesionale në fushën shkencore për të cilën është zgjedhur. Mësimdhënia në universitet nënkupton kompetencën e mësimdhënësit në aspektin pedagogjik dhe filozofik të mbajtjes së ligjëratave, aftësinë komunikuese gjatë punës me studentë, shfrytëzimin e metodave shkencore, teknikave dhe pajisjeve gjatë prezantimit. Mësimdhënësi universitar duhet të ketë arritur edhe njohuri të përgjithshme kulturore dhe komunikuese, por dhe të jetë me vlera etike profesionale dhe njerëzore.

Këto kritere rrjedhin nga funksionet e universitetit, të cilat kanë ndryshuar nga aspekti kualitativ dhe kuantitativ gjatë gjithë historikut të tij, por ato mund të përmbliken në:

- Funksionin profesional,
- Funksionin shoqëror,
- Funksionin shkencor dhe
- Funksionin kulturor.

Përcaktimi i kompetencës së mësimdhënësve në arsimin e lartë është rregulluar me statutin e universitetit. Në këto dokumente tregohet si mund të bëhet zgjidhja në tituj akademikë, kriter ky shumë me rëndësi, por nuk është përcaktuar mjaftueshëm si matet kjo kompetencë. Kriteri kryesisht bazohet në punën kërkimore-shkencore (botimin e punimeve), ndërsa për mësimdhënie nuk kemi kriter të kompetencës. Me interes është të analizojmë aktet normative të statutit të universitetit:

Neni 155, Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte: 1.1. Të ketë thirrjen Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare; Të tregojë aftësi për mësimdhënie; Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse...

Lind pyetja, a mundet nga ky nen të matet cilësia e mësimdhënësit universitar? Të përgjigjem menjëherë se jo, mungon mekanizmi i cili siguron cilësinë në mësimdhënie, si të tregohet se ka aftësi në mësimdhënie. Kosova ka pranuar standardet e hapësirës Evropiane të Bolonjës (viti 2002), ku në deklaratën e Lisbonës, viti 2005, janë dhënë standardet dhe orientimet e mjaftueshme për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Në këto standarde theksohet se mësimdhënësit duhet të kenë kompetencë profesionale për lëndën, të disponojnë aftësi dhe të kenë përvojë të duhur që t'i bartin këto

njohuri të studentët, por edhe t'i marrin informatat kthyesë për këtë proces.

Si mundet një mësimdhënës të ligjërojë një lëndë nga fusha që nuk është marrë asnjëherë me të, nuk ka zhvilluar punë kërkimorë në atë disiplinë shkencore dhe nuk ka të botuar ndonjë punim cilësor të asaj fushe shkencore.

Akreditimi i institucionit dhe vetëvlerësimi i institucionit të arsimit të lartë është vetëm një hap i bërë në këtë drejtim. Në institucionet e vendit tonë vetëm këto mekanizma janë funksionale dhe atë me shumë probleme. Instrumentet për vlerësimin e cilësisë duhet të janë të kuptueshme, të matshme, parimore, të bazuara në standardet evropiane (ENQA) dhe të aplikohen në të gjitha institucionet e arsimit të lartë të vendit në mënyrë të njëjtë. Vetëm atëherë mund të flasim për një cilësi në arsimin e lartë dhe për kuadro të përgatitura për tregun e punës. Mësimdhënësit duhet të mësojnë gjatë gjithë jetës për mbajtjen e mësimin në arsimin e lartë, duhet edhe të edukohen për këtë kompetencë. Vendet anglosaksone kanë përvojë të mirë në këtë drejtim, duke i përcaktuar standardët kombëtare për cilësinë në arsimin e lartë. Në Gjermani dhe disa vende evropiane ekziston procesi i habilitimit, i cili në fakt është kualifikim i obliguar, më i larti për mësimdhënien në universitet, kështu e përkufizon habilitimin Wikipedia: “Habilitimi përcakton kualifikimin për të kryer mësimdhënien të pavarur universitare dhe është çelësi për qasje në profesor në shumë vende evropiane”. Në institucionet e arsimit të lartë të vendit tonë mësimdhënësit janë edhe pa tituj shkencorë, të cilët as që i janë nënshtruar procesit të zgjedhjes. Kosova në këtë drejtim nuk ka asnjë program i cili do t'i aftësonte mësimdhënësit universitarë për mësimdhënien dhe do ta kontrollonte këtë kompetencë.

Nëse kësaj i shtohet edhe korrupsioni në arsimin e lartë për të cilin shumë pak flitet në hapësirat akademike të vendit, përveç ndonjë raporti nga media e shkruara apo elektronike, gjendja bëhet edhe më e vështirë. Forma e korrupsionit në institucionet e arsimit të lartë të vendeve në tranzicion, e në veçanti në vendin tonë, është nga më të ndryshmet si:

- mungesa e bazës ligjore transparente,
- mekanizmi joadekuat i kontrollit,
- politizimi i institucionit,
- mosaplikimi i njëjtë i procesit të Bolonjës të të gjitha institucionet,
- mosmbajtja e mësimin sipas sillobusit të aprovuar,

- akreditimi dhe licencimi,
- mosfunktionalizimi i kodi etik të institucionit të arsimit të lartë.

Këto praktika negative janë në kundërshtim me përkufizimin, vizionin dhe misionin e një institucioni të arsimit të lartë, kategori këto të domosdoshme për një zhvillim të mirëfilltë shoqëror. Nga kjo listë e dhenë, e cila mund të zgjerohet edhe më shumë, sjellë të dhëna se dëmi më i madh nga korrupsioni në arsimin e lartë është humbja e besimit në institucionet akademike nga studentët, personeli akademikë, tregu i punës dhe i gjithë sistemi shoqëror.

Faktor me ndikim në cilësinë e arsimit të lartë është pa dyshim edhe cilësia e studentëve, të cilët duhet ta plotësojnë një minimum të dijes së tyre për të regjistruar studimet në universitet. Me fillimin e punës së universitetit të Prishtinës, ky seleksionim fillonte nga prindërit, pastaj rezultati *3 Procesi i Bolonjes synon krijimin e hapësirës së përbashkët evropiane për arsimin e lartë dhe rritjen e kompetencës së universiteteve evropiane në konkurrencën ndërkombëtare nga shkolla e mesme e deri te vetë kandidati*. Pranimi i studentëve në shumë fakultete sot bëhet pa plotësimin e një kriteri minimal të njohurive bazike, të cilët në universitet regjistrohen edhe me shkolla joadekuate të mesme. Na është i njohur edhe organizimi i provimeve pranuese, në veçanti atëherë kur nuk plotësohet numri i kërkuar i studentëve. Nuk është normale që në fakultetet teknike të regjistrohen studentë të shkollës së mjekësisë, të shkollës ekonomike, bujqësore, etj.

Cilësia e kompetencës nga shkollat e mesme është gjithashtu problematikë në vete, e cila ndikon në cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë. Këto raste janë shumë të pranishme dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit edhe nëse kriteret tjera të cilësisë i plotësojnë institucionet e arsimit të lartë. Kjo dukuri është bërë më e pranishme që nga hapja e universiteteve të shumta publike dhe private në një vend të vogël siç është Kosova. Fakultetet regjistrojnë studentë pa përgatitje të nevojshme, atëherë kur kanë mungesë të studenteve apo universitetet private për të siguruar bazën e të hyrave të tyre janë të ngarkuara me këto dukuri. Nëse nuk kemi studentë të seleksionuar në një institucion, atëherë është vështirë të flitet për cilësinë e arsimit universitar, që nënkupton një kompetencë të mangët për tregun e punës. Meqenëse mungon një mekanizëm i kontrollit të cilësisë në sistemin arsimor të të gjitha niveleve, atëherë kemi improvizime apo ndonjë iniciativë individuale, i cili nuk përcillet me bashkëpunimin e të gjitha arterieve institucionale shtetërore dhe shoqërisë civile në mënyrë që ky proces të menaxhohet në tërë problematikën e tij. Duhet

theksuar dhe përsëritur shumëherë, se nëse nuk sigurohet një rrjet nacional i sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, i cili do të krijonte mekanizma obligues për të gjitha institucionet arsimore dhe do t'i përcaktonte detyrat dhe obligimet e secilit pjesëmarrës, nuk do të kemi arsimim cilësor.

Kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë

Rëndësia e punës kërkimore-shkencore në ngritjen e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë nuk është shprehur mjaftueshëm as në dokumentet strategjike të institucioneve të vendit. Nëse analizohen plan-programet e institucioneve të arsimit të lartë të vendit, shihet se mungon integrimi i punës kërkimore në procesin mësimor. Kjo gjendje në këto institucione shndërrohen në shkolla të mesme. Puna kërkimore kërkon personel të përgatitur, punë sistematike individuale dhe ekipore, por edhe mbështetje financiare e cila në vendin tonë është shumë simbolike. Buxheti i paraparë sipas Ligjit mbi punën kërkimore kryesisht shkon për rroga dhe shumë pak për punë kërkimore (eksperimente, pajisje, pjesëmarrje në takimet shkencore, etj.). Mbështetja financiare për shkencë në vendet tjera është në rritje të vazhduar, kështu Finlanda e ka rreth 4.0%, Suedia 3.6, Sllovenia 1.9 % (nga BPSH), etj. Nga kjo e dhënë statistikore shohim se ku gjendet niveli i kërkimit shkencor dhe shkenca në universitet tona, si mund të përgatitet kuadri kualitativ, si të rritet autoriteti i institucionit dhe besimi në të dhe si të sillemi në rrjetin e sistemit arsimor të globalizuar. Në universitet e Kosovës mbështetja financiare për shkencë është shumë e vogël, mund të themi simbolike. Kjo çështje nuk është rregulluar as me kriteret për zgjedhje në titujt akademikë, të cilat janë unifikuar me një udhëzim administrativ të MASHT-it, por ai na lë për të dëshiruar. Në shumë vende të botës (SHBA dhe Evropë) ekziston një ndërlidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet investimit në shkencë dhe zhvillimit të vendit. Kështu, në SHBA llogaritet që 70% e të ardhurave sigurohen nëpërmjet kërkimeve shkencore, në Evropë kjo shifër është deri në 50%, por ku është vendi ynë me 7 universitete publike dhe shumë institucione të arsimit të lartë privat, me një emërtim kolegje, që nuk është praktikë për emërtimin e institucioneve të arsimit të lartë (vetëm për rastet kur studiohen fusha specifike)? Nëse mendohet të zhvillohet puna shkencore në një vend, atëherë duhet plotësuar disa kriteret të cilat mund të përmbliken në:

- përzgjedhjen e kuadrit të ri të cilët mund të zhvillohen në punëtorë shkencorë,

- orientimi në kërkimet shkencore të cilat janë konkurrencte në tregun shkencor të botës, por edhe kanë specifikat ekonomike dhe kulturore të vendit,
- sigurimi i bazës materiale të domosdoshme për punë shkencore.

Kompetenca e mësimdhënësve në arsimin e lartë, e cila është e ndërlidhur me punën shkencore dhe pedagogjike, ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e kualitetit të mësimdhënies dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Në shumë institucione të arsimit të lartë mungon puna kërkimore, mungojnë institutet ku duhet realizuar ky aktivitet, mungojnë edhe projektet të cilat as që janë pjesë e vlerësimit të mësimdhënësve gjatë zgjedhjes së tyre. Vlerësimi i punës shkencore në universitet është shumë kompleks, i cili nuk përfundon me botimin në një bazë të dhënave, por duhet të prezanton punën shkencore të një mësimdhënësi dhe institucioni. Puna shkencore në vendet e zhvilluara është e renditur në investimet më rentabile për rritje ekonomike të vendit dhe është arsye për ekzistimin, gjegjësisht themelimin e një institucioni të arsimit të lartë.

Lidhja me tregun e punës

Rëndësia e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në arsimin e lartë në përgatitjen e kuadrove për tregun e punës është e madhe. Duhet të gjenden modele të cilat e ndërlidhin sistemin e arsimit të lartë me tregun e punës. Në vendet e zhvilluara me ekonomi tregu ekziston lidhja e drejtpërdrejtë e arsimit të lartë dhe tregut të punës. Kështu, në SHBA kjo ndërlidhje fillon që nga programi i studimeve dhe iu përshtatet kërkesave të tregut. Studenti merr informacionet e duhura që në fillim se sa e rëndësishme është gjatë studimeve dija e jo diploma fiktive. Këtë ndërlidhje e mundëson bashkëpunimi i shumë kompanive me universitetet gjatë gjithë studimeve, i cili bashkëpunim fillon që nga kontaktet me natyrën e punës ku studentët mund të konkurrojnë pas diplomimit, punëtoritë, ekspozitat e punës etj. Pra, vendoset një kontakt interaktiv gjatë gjithë kohës së studimeve, e cila mandej e bën me të lehtë punësimin e tyre pas diplomimit. Kjo ndërlidhje mundësohet edhe me mbajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar (Alumni) të cilët kanë krijuar karrierë dhe ndihmojnë në këto kontakte.

Arsimi i lartë mund dhe duhet të bëjë këtë ndërlidhje me tregun e punës për nevojat në afatet e shkurta dhe të gjata të tregut të punës. Në

rastin e parë mendohet në strukturimin e programeve mësimore, duke e bërë shkollimin shtesë dhe përshtatjen e tyre nëpërmjet rikualifikimeve. Ky model duhet të praktikohet vetëm për rastet specifike, duke e ditur se shkollimi i lartë zgjatë 3+2 vjet dhe është vështirë të aplikohet. Ndërsa në përshtatjen afatgjatë të arsimit të lartë me tregun e punës mendohet në ndërtimin e një koncepti të qëndrueshëm (strategji) i cili për periudha afatgjateja e krijon këtë ndërlidhje.

Këshilli evropian në vitin 2000, më qëllim të avancimin të kompetencës së studentëve nga arsimi i lartë, i identifikon disa kompetenca të përgjithshme të cilat duhet implementuar me qëllim të ndërlidhjes së AL me tregun e punës. Këto kompetenca janë të përbashkëta për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në sistemin evropian të shkollimit dhe mund të përmbliidhen në këto kategori:

- komunikimi në gjuhën amtare,
- komunikimi në gjuhë të huaja,
- njohja e matematikës dhe kompetenca në shkencë dhe teknologji,
- aplikimi i teknologjisë informative,
- të dihet si duhet mësuar,
- aftësia në profesionin përkatës,
- aftësitë qytetare: përgjegjësi, integritet, ndershmëri dhe
- kompetenca në kulturën e përgjithshme.

Pa përmbushjen e këtyre kompetencave nuk mund të presim përgatitje të kuadrove të diplomuara për tregun e punës.

Po e theksoj se e gjithë kjo ndërlidhje kërkon arsim të lartë cilësor dhe punë të vazhdueshme kërkimore, të cilat nuk mund të jenë të improvizuara. Në institucionet e arsimit të lartë të vendit kjo ndërlidhje është e zbehtë, andaj edhe kemi gjithnjë e më shumë studentë të diplomuar të cilët nuk mund të gjejnë vende pune në profesionet e tyre adekuate.

Përfundimi

Duke e respektuar temën bosht të kësaj konference, jemi ndalur te një segment i kësaj problematike, sa është i përgatitur një institucion i arsimit të lartë që të prodhojë kuadër kualitativ për tregun e punës? Përgjigjja është se në vendin tonë, por edhe në Ballkanin Perëndimor, këto rezultate janë për t'u dëshiruar. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë në numrin më të madh në gjithë

Ballkanin (2,2 në 100.000 banorë) të cilat po prodhojnë numër të madh të studentëve të diplomuar në krahasim me nevojat e tregut të punës, në veçanti në drejtimet ekonomike dhe juridike. Nga kërkimet e bëra në këtë drejtim rezulton që shumë studentë të diplomuar mbesin të papunë (në Kosovë kjo përqindje është më e larta, mbi 50%), disa gjejnë punë por jo në profesionin për të cilin janë përgatitur dhe gjithë kjo ndikon në kërkesat jo të përmbushura të tregut të punës dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi. Mbështetur në këtë të dhënë mund të konstatohet se nëse sistemi i arsimit të lartë do të kryejë misionin e tij, i cili nënkupton zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përgatitjen e tij për tregun e punës, atëherë duhet të bëhen reforma të thella në këtë drejtim. Kjo nënkupton reformimin e sistemit të arsimit të lartë dhe gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit të tyre me ndërmarrësin e cila siguron përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Nëse në këto dokumente edhe sipërfaqësisht flitet vetëm për punën kërkimore, ato mungojnë dhe nuk kemi kriter për kompetencën pedagogjike të mësimitdhënësit. Metodatat e mësimitdhënies duhet avancuar dhe duhet ndërlidhur me punën praktike gjatë studimeve. Të dy këta komponentë duhet të jenë të integruar në kurrikulat mësimore dhe të jenë pjesë integrale e punës interaktive me studentë para se ata të diplomohen.

Në të kundërtën, nëse kemi mungesë të kompetencave të profesorët universitar, atëherë do të kemi vështirësi edhe në përgatitjen e kuadrit me kompetencë profesionale për tregun e punës dhe integrimin në Bashkimin Evropian. Kjo e dhënë do të vështirësojë në përshtatjen afatgjatë të arsimit të lartë me tregun e punës, gjegjësisht në ndërtimin e një koncepti të qëndrueshëm (strategji) i cili për periudha afatgjatë e krijon këtë ndërlidhje.

Të përfundojmë këtë punim me konstatimin se funksioni bazë i mësimitdhënies në institucionet e arsimit të lartë nuk është vetëm mësimitdhënia, por është formimi dhe edukimi i personave që marrin pjesë në këtë proces dhe përgatitja e tyre për tregun e punës.

QUALITY ASSURANCE IN HIGHER EDUCATION IS ONE OF THE KEY FACTORS FOR DYNAMIC LINKAGE TO THE LABOR MARKET

Musa RIZAJ

University of Mitrovica "Isa Boletini"
mrizaj@hotmail.com

Abstract

The purpose of this paper is to show the importance of the quality of education and research in higher education for the preparation of the cadre for the labor market. Higher education is an activity that is constantly subject to reforms and adapts the achievements of science and technology in order to increase the quality of student knowledge and competence for the labor market. This paper presents issues of quality assurance of education and scientific research in higher education in Kosovo, which due to its diversity is not subject to scientific research and is often marginalized in education policies. It also analyzes the position of higher education and research in educational institutions, the relationships between these categories and their impact on professional competencies for employment. All this problematic is seen from the perspective of globalization of higher education and scientific research, which should be closely linked to the labor market, adapting to its dynamic development. These objectives can only be achieved by raising the quality of teachers and students and by investing in the creation of scientific research networks.

Keywords: education, research, quality, cadres, market.

Bibliografia

1. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), Raport i vetëvlerësimit, 2013, Prishtinë.
2. Altbach, P. G. (2004) *The question of corruption in academe*. International Higher Education, Winter 2004.
3. Delor Jacques, (1996). Education: the hidden treasure. UNESCO. 40.
4. Eurostat, 2016: Eurostat statistics, <https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php/>
5. S. Gvozdenović, UNIVERSITY BETWEEN NEEDS AND OPPORTUNITIES, Sociološka luča IV/1 2010, Nikšić.
6. Transparency International BiH (2008) *Korupcija u obrazovanju – stanje i preporuke*.
7. V. Bartlett, M. Uvalic, Higher education and the labor market in the Western Balkans, Quarterly monitor nr.47, Oct-Dec 2016, Project EU, Beograd.
8. Vlado A. Lubarda, Američki sistem obrazovanja i karakteristike njegovog razvoja, sa preporukama za obrazovanje u Crnoj Gori do 2030.

CILËSIA E ARSIMIT TË LARTË DHE TREGU I PUNËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Raman ISMAILI¹
Brikend AZIRI²
Isak AJRULI³

Përmbledhje

Sot gërshetimi i kurikulave universitare me kërkesat e tregut të punës është shndërruar në prerogativë të kohës. Ndonëse Republika e Maqedonisë, si dhe shumë shtete tjera të rajonit, ende ndodhet në fazë të masivizimit të arsimit të lartë, duke i kushtuar rëndësi të posaçme sigurimit të kuantitetit në bankat universitare, përsëri nuk mohohet rëndësia e mësimdhënies e në vend të parë mësimnxënies si dy komponentë që duhet të mundësojnë një përputhshmëri më të lartë të dijes së studentit me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Sot institucionet e arsimit të lartë duhet të orientojnë qasjen e tyre nga pajisja e studentëve thjesht në dituri, në pajisjen e tyre me shkathtësi, logjikë të shëndoshë të të menduarit si dhe në guximin për të përballuar sfidat dhe status quo-në që jo rrallëherë është prezente në tregun e punës. Nga këtu vijon dhe synimi parësorë i punimit, përkatësisht nevoja e identifikimit të përputhshmërisë së asaj që universitetet e ndërtojnë si kuadro dhe asaj që realisht i nevojitet tregut të punës. Në suaza të punimit rëndësi e posaçme i kushtohet edhe (mos)përputhshmërisë së sistemit trevjeçar studimor konform modelit të Bolonjës dhe kërkesave të tregut të punës në Maqedoni. Punimi bazohet në një mostër relativisht të gjerë të të anketuarve nga radhët e profesoriatit, studentëve dhe përfaqësuesve të biznesit.

Fjalët çelës: Arsimit sipëror, universitet, tregu i punës, mësimdhënie dhe mësimnxënie, bashkësia e biznesit.

Hyrje

Arsimi, përkatësisht institucionet arsimore në përgjithësi dhe ato të arsimit të lartë në veçanti pa pikë dyshimi janë ndër shtyllat kryesore që mundësojnë funksionalitetin e sistemeve shoqërore në mbarë botën. Kjo sidomos shprehet paralelisht me kalimin drejt shoqërisë së dijes nën trysninë e zhvillimit të gjithëmbarshtëm

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës. raman.ismaili@unite.edu.mk

² Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës. brikend.aziri@unite.edu.mk

³ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës. isak.ajruli@unite.edu.mk

shkencor dhe teknologjik. Institucionet e arsimit të lartë janë një burim i rëndësishëm i inovacioneve dhe invencioneve, burim i rëndësishëm i diturisë së re dhe ç'është më e rëndësishmja janë institucione që përkujdesen për shpërndarje të drejtë dhe efikase të diturisë deri te gjeneratat e reja si bartëse kryesore të zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror. Në fakt, sot në botën globale të ndryshimeve dhe zhvillimeve permanente, në botën e zhvillimit intensiv në të gjitha lëmenjtë, institucionet e arsimit të lartë janë shndërruar dhe në faktor kyç për realizim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik përmes gjeneratave të reja që krijojnë dhe nxjerrin në tregun e punës.

Jo rastësisht, sot shumë hulumtues preferojnë që treshit të faktorëve të prodhimtarisë, pra tokës, punës dhe kapitalit t'ia shtojnë edhe një element shtesë - atë të dijes, meqë dituria sot është një burim i rëndësishëm i përparësisë konkurruese si në nivel të bizneseve, ashtu dhe në nivele më të larta shoqërore në përgjithësi. Fitohet përshtypje se sot tregjet botërore të punës klasifikohen me dy trende të mëdha. I pari ai i ikjes së personave të kualifikuar, të mirarsimuar, të aftë dhe të mirëprofilizuar nga vendet me ekonomi të brishtë drejt atyre me ekonomi të zhvilluar. Por, nga ana tjetër, me sa duket zhvillohet dhe beteja ndërmjet shteteve të zhvilluara, përkatësisht tregjeve të tyre të punës për të tërhequr pjesën më të aftë, të ditur, inovatore dhe të veçantë të këtyre personave. Pra, ajo që është duke u shndërruar në kancer për disa shoqëri, përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë dhe rajonin përreth paraqet një lloj lehtësimi për shtetet me mungesë të fuqisë punëtore, por me kapacitete të mjaftueshme për përthithje të fuqisë punëtore nga pjesë të tjera të botës. Në këtë mes gjithsesi që arsimi ka rolin e vet.

Arsimi është parakusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm që një individ të gëzojë benefite në tregun e punës qoftë në sektorët ekonomik formal, qoftë në ato joformal. Kraharsimimit, për të pasur mundësi të mira për kandidatët e aftë, me rëndësi të veçantë është funksionaliteti i ekonomisë nacionale në tërësi, stabiliteti makroekonomik, atraktiviteti për investime të huaja si dhe tregjet eficiente të punës.⁴

Fatkeqësisht, shoqëritë tona kanë arritur në pikën kur në nivel të universiteteve bisedohet për ndryshim të paradigmës dhe për nisma që

⁴ Tazeen Fasih: Linking Education Policy to Labor Market Outcomes, International Bank for Reconstruction and Development, 2008, 49.

pasi trendi nuk ndalet, atëherë të vihen universitetet në disponim të krijimit të kuadrit më cilësorë për tregjet e huaja dhe, nënkuptohet, për kompanitë e jashtme që kanë përfaqësi dhe veprojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë. Shtrohet çështja, a është kjo për shkak të paaftësisë së institucioneve të arsimit sipërorë për krijim të kuadrove të afta ose ndoshta problemi qëndron në kapacitetet e ekonomisë nacionale për të përthithur kuadrin e ri të krijuar?

Është fakt i pamohueshëm se një pjesë e konsiderueshme e kuadrit që ik nga vendi arrin të sigurojë të ardhmen profesionale diku tjetër. Por shtrohet dilema se a thua vallë ky është rezultat i dijeve dhe i shkathtësive me të cilat janë pajisur gjatë studimeve ose thjesht suksesi i tyre mund dhe duhet t'i përshkruhet kapaciteteve, shkathtësive dhe në instancë të fundit edhe gjendshmërisë personale të tyre.

Fakt tjetër i pamohueshëm është se një pjesë e kuadrit që vazhdon të jetojë në vend nuk arrin ta gjejë veten në profesionin e tij në vend. Por edhe këtu shtrohen dilema të shumta: A thua vallë kjo ndodh meqë këta individë nuk disponojnë me aftësi të mjaftueshme për të qenë të suksesshëm në tregun e punës? A thua vallë politizimi i skajshëm i shoqërisë në të gjitha poret e saj është arsyeja e situatës së krijuar? A thua vallë faji duhet t'i përshkruhet një mungese të skajshme në planifikimin e nevojave për kuadro?

Në drejtim të kësaj, në rastin e Republikës së Maqedonisë është bërë më se e qartë se ekzistojnë profesione suficitare të cilat nuk i përthith dot tregu i punës dhe profesioneve deficitare që mungojnë në tregun e punës. Por edhe këtu ekziston problematika e përputhshmërisë së asaj që kuadrot e ofrojnë në tregun e punës dhe asaj që tregu, përkatësisht punëdhënësit i kërkojnë nga to. Nga njëra anë punëdhënësit ankohen për mungesë të angazhimit të kuadrove të reja në punë, por nga ana tjetër ekziston arsyetimi se këto kuadro se angazhohen në nivel të pagës që pranojnë nga ana e punëdhënësve.

Pra, bëhet fjalë për dilema të shumta që në Maqedoni kanë dalë në sipërfaqe kryesisht gjatë dekadës së fundit, por me të cilat shoqëritë perëndimore kanë filluar të ballafaqohen së paku një gjysmë shekulli më herët. Nuk janë të rastit tendencat permanente për reformim të sistemeve të arsimit të lartë në botën perëndimore, tendenca këto që në mungesë të eksperiencës dhe bazës materiale pa ndonjë sukses të veçantë mundohen t'i ndjekin edhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

Transformimi i sistemeve dhe institucioneve të arsimit të lartë në të gjitha vendet e zhvilluara gjatë disa viteve të fundit është karakterizuar me një ekspansion të numrit të studentëve dhe të të diplomuarëve universitarë (nga vitet e gjashtëdhjeta e këtej), vendosja e politikave dhe procedurave për sigurim të cilësisë (nga vitet e tetëdhjeta e këtej), si dhe nga përshtatshmëria e kurikulave universitare ndaj kërkesave të ekonomisë së re dhe tregjeve bashkëkohore të punës, kryesisht në drejtim të futjes së kompetencave (shkathtësive) si një qëllim fundamental i të mësuarit në suaza të programeve studimore (nga vitet e nëntëdhjeta e këtej).⁵

Shoqëria dhe ekonomia paguajnë çmim në rastet kur dështohet në sigurimin e harmonisë ndërmjet tregut të punës dhe sistemit arsimor. Në shoqëritë moderne timoni i zhvillimit ekonomik dhe social është numri i të diplomuarve nga institucionet e arsimit sipëror. Nevojiten investime të konsiderueshme personale dhe shoqërore (investime në kapitalin njerëzorë) që një person të përfundojë arsimin sipëror dhe të fitojë aftësi në një fushë specifike, andaj me rëndësi të veçantë është të bëhen investime adekuate që do të ndihmojë në mënyrë maksimale individin dhe ekonominë nacionale. Prandaj harmonizimi i strukturës, funksioneve dhe produkteve të arsimit të lartë me nevojat ekonomike dhe shoqërore është i pashmangshëm.⁶

Arsimi i lartë në Republikën e Maqedonisë

Shikuar nga këndvështrimi i ofertës së institucioneve të arsimit të lartë, Republika e Maqedonisë mund të thuhet se ka kaluar dy faza, edhe atë fazën e monopolizimit gati se të plotë të tregut të arsimit të larta në vend dhe fazën e hapjes gati se të plotë dhe në disa aspekte të tepruar të tregut të arsimit të lartë në vend. Në fakt, faza e monopolizimit të tregut të arsimit të lartë mund të shqyrtohet nga dy aspekte. E para, mund të shqyrtohet nga aspekti i trashëgimisë nga ish-sistemi monist dhe, e dyta, mund të shqyrtohet nga konteksti i marrëdhënieve ndëretnike dhe urrejtjes ndëretnike në vend. Sidoqoftë, që të dy çështjet janë ngushtë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Kështu,

⁵ Enric Corominas, Carme Saurina, Esperança Vilar: *The Match Between University Education and Graduate Labor Market Outcomes (Education-Job Match)*, Agència per a la qualitat del sistema universitari del Catalunya, 2010, 23

⁶ Paul Chatterton, John Goddard: "The Response of Higher Education Institutions to regional needs", *European Journal of Education*, 35(4), 475–496

trashëgimia nga periudha moniste e zhvillimit të vendit nënkupton një fazë të ekzistimit të vetëm dy universiteteve shtetërore në vend, ndërsa aspekti ndëretnik nënkupton refuzimin absolut të institucioneve shtetërore të cilësdoqoftë gjasë për arsim siperorë të shqiptarëve në vend, refuzim ky i ndjekur me protesta të shumta dhe greva të rinisë maqedonase kundër hapjes së një akademie pedagogjike në gjuhë shqipe në suaza të universitetit “Shën Kirili e Metodi” në Shkup⁷ e deri te intervenimi i drejtpërdrejtë i dhunshëm dhe gjakderdhja me aktin e themelimit të Universitetit të Tetovës nga ana e arsimdashësve nga Maqedonia dhe Kosova.

Krijimi i Universitetit të Tetovës në vitin 1994 është pa dyshim ngjarja më e rëndësishme në historikun e arsimit, kulturës dhe shkencës së popullit shqiptar në Maqedoni. Universiteti i Tetovës nuk ishte rezultat stihie, i bazuar në ndonjë eufori nacionale, por rezultat i analizave të bazuara në realitetin ekzistues. Intelektualët shqiptarë nga Maqedonia nismën e hapjes së universitetit të tretë e bazuan në shumë fakte dhe argumente që kishin një emërues të përbashkët: *Universiteti për shqiptarët e Maqedonisë është nevojë dhe domosdoshmëri*.⁸

Faza e dytë rastësisht korrespondon dhe me periudhën e ndryshimit të strukturave politike qeverisëse në vend, rrjedhën e luftës për çlirimin e Kosovës dhe filltet e konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoni, fazë kjo që filloi me ndryshimet ligjore me të cilat u mundësua hapja zyrtare e një universiteti me karakter multinacional nën ombrellën e bashkësisë ndërkombëtare me karakter publiko-privat që do të ofronte programe studimore edhe në gjuhën shqipe. Akti në fjalë nga një pjesë e publikut do të kundrohet si akt i tradhtisë së thellë kombëtare, që synonte hedhjen në haresë të Universitetit të Tetovës, ndërsa nga të tjerët si një mundësi e veçantë për avancim të arsimit të lartë në përgjithësi dhe arsimit të lartë në gjuhë shqipe në veçanti në Republikën e Maqedonisë. Sidoqoftë, ndryshimet e parapara ligjore mundësuan për herë të parë hapjen edhe të universiteteve private në

⁷ Në fillim të vitit 1992, Unioni i Inteligjencies Shqiptare i ndihmuar nga asociacionet tjera shqiptare dhe subjektet politike, ndërmori nismën për hapjen e një fakulteti në gjuhën shqipe në kuadër të Universitetit “Shën Kirili e Metodi” të Shkupit. Për këtë qëllim u përgatit edhe një elaborat ku prezentohej nevoja dhe arsyeshmëria shoqërore e nismës në fjalë. (Shih. Etem Aziri: Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik, 2012, fq. 185.

⁸ Etem Aziri: Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik, 2012, fq. 186.

vend. Sot, Republika e Maqedonisë me më pak se dy milion banorë numëron disa universitete shtetërore dhe private.

Sot jemi dëshmitarë të trendeve mjaft specifike në zhvillimin e arsimit sipëror në rajon dhe më gjerë, trende këto që në varësi nga filozofia e punës së institucionit të arsimit sipëror shkojnë në disa drejtime bazë si:

- Filozofia se arsimit sipëror duhet të jetë i qasshëm në nivel të barabartë për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë,
- Filozofia se arsimit i lartë duhet të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, por ata që mund t'ia lejojnë vetes duhet të kenë qasje në një arsim sipëror më cilësor në institucionet me repute të dalluar,
- Filozofia se institucionet arsimore duhet të përqendrohen në ruajtjen dhe zhvillimin e cilësisë,
- Filozofia se institucionet e arsimit sipëror fillimisht duhet të sigurojnë kuantitet të mjaftueshëm, meqë në kuantitet do të gjendet edhe kualiteti,
- Filozofia se arsimit sipëror duhet organizuar vetëm në suaza të institucioneve të financuara nga buxheti shtetëror, meqë në raste të tilla kriteret e notimit do të jenë më të drejta, e pse jo edhe më rigorozë,
- Filozofia se arsimit sipëror duhet të jetë i lejuar të organizohet edhe në institucione private, meqë në to studentët derdhen mjete dhe do të kërkojnë cilësi për të njëjtat e kështu me radhë.

Megjithatë, duhet theksuar fakti se ndoshta të gjitha logjikat e lartpërmendura janë të sakta dhe ndoshta asnjëra nga to nuk është e drejtë. Me sa duket institucionet e arsimit të lartë ende nuk kanë arritur të gjejnë formulën e suksesit dhe pozicionimit të tyre në tregun botëror të institucioneve të kësaj natyre. E vërteta e plotë, e pashmangshme dhe e pamohueshme, me të cilën një ditë do të duhet të ballafaqohen edhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë është se bota ec me tempon dhe kriteret e veta dhe se pa marrë parasysh cilën nga filozofitë e më lartcekura, institucionet e kanë adoptuar, përsëri ato kanë ngecur dukshëm pas të tjerëve.

Fatkeqësisht, e vërteta është se asnjë nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, universitet publike apo private, asnjë universitet publiko-privat, asnjë kolegji nuk ka arritur që të rrangohet gati askund në asnjë listë botërore të rangimit të universiteteve. Marrë parasysh filozofinë e adoptuar, realiteti objektiv

është se asnjë nga universitetet që ofrojnë mësim në gjuhë shqipe nuk kanë arritur të rangohen se paku në top 3.000 e universitetet më të mira në botë. Për dallim prej tyre, Universiteti i Ljubljanës dhe ai i Beogradit rangohen në mesin e 500 universiteteve më të mira të botës. Në pozitën 501-600 është i ranguar edhe Universiteti i Zagrebit, ndërsa Universiteti i Sofjes ka siguruar vend në grupin e 1000 universiteteve më të mira në botë.

Gjithsesi që është e nevojshme një analizë mjaft e thellë dhe e realizuar në bashkëpunim të të gjitha universiteteve në vend për t'u determinuar arsyet se përse asnjë nga këto universitete nuk ka siguruar pozitë të lartë në këto rangime ndërkombëtare.

Është më se e qartë se mungesa e mjeteve financiare, peripecitë e mbijetesës ditore, çrregullimi i tregut të arsimit të lartë janë në mesin e faktorëve në fjalë, por vlerësojmë se nuk mjafton me kaq. Ndoshta kjo listë duhet zgjeruar dhe përfshirë mungesën ose së paku mosardhjen në shprehje të kapaciteteve hulumtuese, motivimin e ulët për publikim të punimeve, faktin që shumë pak studiues nga universitetet tona arrijnë të jenë të cituar në suaza botërore, si dhe një varg faktorësh tjerë.

Shikuar nga këndvështrimi i cilësisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, është mjaft vështirë të bëhet dallimi në mes formales dhe reales. Në fakt nga konsultat permanente me përfaqësues dhe të punësuar të universiteteve në vend është bërë më se e qartë se në pjesën dërmuese të rasteve ekzistojnë probleme të shumta në kontekst të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, ndonëse për hir të së vërtetës duhet theksuar se së paku në aspektin formal disa institucione avancojnë në krahasim me tjerat. Kështu, pjesa dërmuese e universiteteve dhe e fakulteteve në vend kanë të ndërtuara rregulla formale që synojnë ngritjen e cilësisë, me atë që disa nga to kanë edhe strategji të veçanta për ngritje të cilësisë. Ato kanë të ndërtuara sisteme për ndjekje të vijueshmërisë së obligimeve të mësimdhënësve në kontekst të rregullshmërisë së tyre në mësimdhënie, një pjesë e madhe e universiteteve realizojnë aktivitete me të cilat përmes pyetësorëve mundohen të sigurojnë informata nga studentët për cilësinë e mësimdhënies së ligjëruesve, një pjesë e tyre kanë ndërtuar edhe politika për vëzhgime të mësimdhënies dhe kështu me radhë. Megjithatë, e vërteta është se masa reale për matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies gati praktikisht nuk funksionojnë aspak. Kjo mundet, para së gjithash, t'i përshkruhet gatishmërisë dhe mundësive të mëdha për manipulim të sistemeve nga

ana e vetë bartësve të tyre si rezultat i mungesës së një kulture të mirëfilltë profesionale dhe tradite në zhvillimin e arsimit të lartë, si dhe për shkak të mungesës së kuadrove realisht të avancuara në kapacitete për të zhvilluar vëzhgime të kësaj natyre. Krahas kësaj, gjasat për manipulim me trupin studentor janë një faktor shtesë vështirësues. Gjithashtu, duhet theksuar fakti që në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë janë gati inekzistente rastet e mbajtjes së përgjegjësisë reale për mësimdhënie joadekuate. Duke pasur parasysh rangimet ndërkombëtare të institucioneve në fjalë, është më se e qartë se jo që nuk ekzistojnë raste të ligjëruesve që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret, por thjesht me sa duket institucionet nuk kanë gatishmëri reale për ndërmarrje të masave. Nga njëra anë nuk disponojnë me kapacitete financiare dhe humane për të përmirësuar gjendjen dhe nga ana tjetër mungon kapaciteti dhe gatishmëria për ndërmarrje të masave korrigjuese dhe si opsion i fundit edhe ato ndëshkuese, masa këto që ekzistojnë në biznesin privat, por gati aspak nuk janë prezentë te institucionet e arsimit të lartë.

Megjithatë, për të qenë korrekt, duhet theksuar edhe fakti se në realitet edhe vetë institucionet ballafaqohen më vështirësi të shumta, para së gjithash për shkak të rënies permanente të perceptuar të cilësisë në një pjesë të madhe të shkollave të mesme. Pra, në një mënyrë universitetet ballafaqohen jo thjesht me vështirësi rreth cilësisë së mësimdhënies, por një rendi dhe me kapacitete të pamjaftueshme të një pjesë e studentëve për të përthithur atë që u ofrohet nga ana e ligjëruesve.

Së fundi, psikologët vlerësojnë se hapi i parë në ballafaqimin me problemin është vetëdijësimi për ekzistencën e tij. Ndoshta universitetet në Republikën e Maqedonisë duhet të zbatojnë të njëjtën logjikë. Ndoshta duhet që strukturat menaxhuese dhe personeli akademik fillimisht të vetëdijësohen se ekziston ndonjë problem me mënyrën e funksionimit të institucioneve në fjalë, që më pas të vijoje edhe faza e identifikimit të arsyeve dhe gjithsesi gjetja e alternativave kreative për tejkalimin e situatës në suaza të kufizimeve, problemeve dhe mundësive reale që janë në disponim.

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë

Kur bëhet fjalë për tregun e punës, para së gjithash duhet pasur parasysh katër elemente bazë:

- Fuqia punëtore,
- Norma e participimit të fuqisë punëtore,
- Proporcioni të punësuar - fuqi punëtore ose shkalla e punësimit dhe
- Shkalla e papunësisë.

Fuqia punëtore nënkupton të gjithë ata persona që i plotësojnë kushtet ligjore për t'u punësuar pa marrë parasysh se a janë të punësuar ose jo. Pra, në kategorinë e fuqisë punëtore përfshihen të gjithë personat e punësuar dhe të gjithë personat e papunësuar, duke përjashtuar nga analiza kategorinë e personave që nuk janë të aftë për punë. Norma e participimit të fuqisë punëtore nënkupton pjesëmarrjen e fuqisë punëtore në numrin e përgjithshëm të popullsisë, përkatësisht pjesën e popullsisë që i takon kategorisë së fuqisë punëtore. Shkalla e punësimit nënkupton participimin e të punësuarve në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Shkalla e papunësisë nga ana tjetër nënkupton participimin e të papunësuarve në fuqinë punëtore.

Pra, analizat e mirëfillta të tregut të punës gjithnjë duhet nisur nga determinimi i fuqisë punëtore. Në këtë drejtim, në rastin e Republikës së Maqedonisë duhet kushtuar rëndësi e veçantë disa trendeve bazë si: lëvizja natyrore e popullsisë, përkatësisht nataliteti dhe mortaliteti, numri i kurorëzimeve dhe shkuroëzimeve, struktura arsimore e popullsisë, struktura moshore e popullsisë, struktura etnike e popullsisë, struktura fetare e popullsisë si dhe lëvizjet migruese të popullsisë.

Ashtu siç mund të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën 1:

- Republika e Maqedonisë ballafaqohet me rënie permanente të natalitetit edhe atë nga 35.401, përkatësisht 16.6 promil në vitin 1990, në 29.308, respektivisht 14.5 promil në vitin 2000, në 24296, respektivisht 11.8 promil në vitin 2010 e që në vitin 2016 të jetë vetëm 23.002, respektivisht 11.1 promil.
- Republika e Maqedonisë karakterizohet me rritje permanente të mortalitetit edhe atë nga 6.9 promil në vitin 1990 në 8.5 promil në vitin 2000, në 9.3 promil në vitin 2010 që të arrijë në 9.9 promil në vitin 2016.
- Republika e Maqedonisë ballafaqohet me zvogëlim permanent të shtimit natyror të popullsisë. Në fakt shtimi natyror i popullsisë ka rënë nga 20758 në vitin 1990 me vetëm 2581 në vitin 2016.
- Gjatë dekadës së fundit në Republikën e Maqedonisë vërehet rritje e madhe e numrit të shkuroëzimeve krahasuar me periudhën paraprake.


Tab.1. Trende demografike të popullsisë në Republikën e Maqedonisë

Viti	Popullsia (Në mijë)	Të lindur	Të vdekur	Rritja natyrore	Kurorëzime	Shkurorëzime
1990	2028	35401	14643	20758	15688	749
1991	2039	34830	14789	20041	15311	496
1992	2056	33238	16022	17216	15354	578
1993	2066	32374	15591	16783	15080	636
1994	1946	33487	15771	17716	15736	612
1995	1966	32154	16338	15816	15823	710
1996	1983	31403	16063	15340	14089	705
1997	1997	29478	16596	12882	14072	1021
1998	2008	29244	16870	12374	13993	1027
1999	2017	27309	16789	10520	14172	1045
2000	2026	29308	17253	12055	14255	1325
2001	2035	27010	16919	10091	13267	1448
2002	2020	27761	17962	9799	14522	1310
2003	2027	27011	18006	9005	14402	1405
2004	2032	23361	17944	5417	14073	1645
2005	2037	22482	18406	4076	14500	1552
2006	2040	22585	18630	3955	14908	1475
2007	2044	22688	19594	3094	15490	1417
2008	2047	22945	18982	3963	14695	1209
2009	2051	23684	19060	4624	14923	1287
2010	2055	24296	19113	5183	14155	1720
2011	2059	22770	19465	3305	14736	1753
2012	2061	23568	20134	3434	13991	1926
2013	2064	23138	19208	3930	13982	2045
2014	2067	23596	19718	3878	13813	2210
2015	2070	23075	20461	2614	14186	2200
2016	2072	23002	20421	2581	13199	1985

Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë

Të dhënat statistikore dëshmojnë rënie permanente të numrit të të diplomuarve gjatë dekadës së fundit në Republikën e Maqedonisë, që nënkupton një rend dhe paraqitje potenciale të mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar, graf.1.


Graf.1. Numri i të diplomuarve në Republikën e Maqedonisë në periudhën 2000-2016



Burimi: Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë

Kur bëhet fjalë për nivelin arsimor të popullsisë në Republikën e Maqedonisë, gjithmonë duhet pasur parasysh vetë strukturën profesionale të të diplomuarve. Kështu, në strukturën e të diplomuarve në vitin 2016 dominojnë të diplomuarit në shkencat shoqërore me atë që vërehet një participim shumë i vogël i shkencave natyrore dhe atyre teknike-teknologjike. Këto trende gjithsesi që e determinojnë në masë të madhe mënyrën e rekrutimit dhe seleksionimit, përkatësisht qasjet e bizneseve për të siguruar një fuqi punëtore efektive, graf. 2.

Graf.2. Struktura e të diplomuarve sipas lëmenjve në vitin 2016



Burimi: Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë


Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e popullsisë së aftë për punë në Republikën e Maqedonisë në bazë të moshës dhe nivelit arsimor.

Tab 2. Popullsia e aftë për punë në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016

	Gjiths ej	Të punësuar	Të papunësu ar	Popullsi joaktive
Gjithsej	167889 0	723550	225049	730290
Struktura sipas nivelit arsimorë				
Të paarsimuar	30705	3266	1974	25465
Pa shkollë fillore të përfunduar	85230	14076	4177	66976
Me shkollë fillore të përfunduar	499552	121990	50907	326655
Shkollim i mesëm trevjeçar	126668	65097	19549	42021
Shkollim i mesëm katërvjeçar	646195	329168	102851	214176
Shkollë e lartë	35595	16853	2497	16244
Shkollim universitar	254945	173099	43092	38753
Struktura sipas moshës				
15-19	126289	5855	8380	112055
20-24	148153	38639	33072	76443
25-29	160778	79793	43422	37563
30-34	163928	103851	31387	28690
35-39	157218	103204	26707	27307
40-44	149883	98171	22365	29347
45-49	144572	90681	19675	34216
50-54	142848	87327	17018	38503
55-59	137133	69523	15837	51772
60-64	124754	36951	7080	80723
65 e më shumë	223333	9556		213671
Burimi: Të dhënat janë marrë nga raporti vjetori Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë				

Në tremujorin e dytë të vitit 2018 në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2016 vërehen lëvizjet e paraqitura në grafikun e mëposhtëm.

Graf.3. Analizë komparative e popullsisë aktive, numrit të personave të punësuar dhe numrit të papunësuarve në vitin 2016, 2017 dhe 2018




Pra, kur bëhet fjalë për aspekte të tilla si papunësia, punësimi dhe popullsia aktive mund të thuhet se trendet gjenerale në rastin e Republikës së Maqedonisë kanë qenë pozitive, duke u dëshmuar një zbutje e papunësisë dhe zmadhim i numrit të personave të punësuar. Në fakt në tremujorin e fundit të vitit 2017 norma e punësimit ka qenë 44.2%, kurse në tremujorin e dytë të vitit 2018 e njëjta është 44.9%. Në po të njëjtën periudhë shkalla e papunësisë ka rënë nga 21.9% në 21.1%. Pra, bëhet fjalë për ndryshime relativisht të vogla, por duke pasur parasysh periudhën e shkurtë kohore pesha reale e tyre është mjaft e madhe. Nga ana tjetër duhet theksuar fakti se mjaft inkurajues është edhe trendi afatgjatë. Kështu, në tremujorin e dytë të vitit 2011 shkalla e papunësisë zyrtarisht ka qenë 31.2%, ndërsa norma e punësimit 39.3%.

Ndonëse trendet dhe të dhënat e më lartcekura janë mjaft inkurajuese, duhet theksuar fakti se këto trende nuk kanë nënkuptuar edhe përmirësim permanent të standardit jetësor ose të mirëqenies së qytetarëve. Në fakt duhet theksuar se statistikat në rastin e Republikës së Maqedonisë në shumë raste janë konsideruar më tepër si mjet manipulativ se statistikë reale në pjesën e evidentimit të të punësuarve dhe të papunëve në vend. Kështu, me ndryshimet në mënyrën e mbajtjes së evidencës së të punësuarve dhe të papunësuarve janë paraqitur ulje të shprehura të normës së papunësisë falë shlyerjes së një pjese të papunëve nga evidencat zyrtare të Entit për punësim. Krahës kësaj, përmes regjistrimit të personave që kryejnë veprimtari vetanake siç janë bujqit në kategorinë e të punësuarve është bërë korrigjimi rritës i normës së punësimit në vend. Krahës kësaj, debatet publike të shumta kanë nxjerrë në pah dyshime të mëdha të opinionit

që çojnë në dy drejtime bazë. E para, dyshime të shprehura se rritja e numrit të të punësuarve rezulton në masë të madhe nga punësimet e shumta në administratën shtetërore dhe publike dhe e dyta, dyshime të shprehura se një pjesë e madhe e punësimeve të paraqitura janë në pjesën e kapaciteteve të reja prodhuese të drejtuara drejt eksportit e të cilat funksionojnë në suaza të zonave zhvillimore dhe teknologjike, përkatësisht zonave të lira ekonomike në vend e të cilët dyshohet se pranojnë të ardhura jo më të larta se paga minimale e përcaktuar në vend.

Sa i përket dyshimit të dytë, fatkeqësisht nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare. As sa i përket dyshimit të parë nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare statistikore konkluzive si rezultat i ndryshimeve në vendimin se cilët kategori të të punësuarve duhet të përfshihen në evidencat e entit shtetëror të statistikave. Megjithatë, të dhëna të përafërta mund të sigurohen përmes raporteve vjetore të zyrës së Ombudspersonit të Republikës së Maqedonisë. Kështu, autoriteti në fjalë në suaza të raporteve vjetore për përfshirjen e drejtë dhe adekuate të bashkësive etnike në strukturën e të punësuarve në institucione shtetërore dhe publike në vend në vazhdimësi ka raportuar rritje të numrit të personave në fjalë në periudhën 2007 - 2016.

Graf. 4. Rritje permanente e numrit të të punësuarve në administratën shtetërore dhe publike në Republikën e Maqedonisë



Burimi: Raporti vjetor për vitin 2016 i Ombudsmanit të Republikës së Maqedonisë

Gjithsesi që një pjesë e të punësuarve të raportuar kanë të bëjnë me atë që në mënyrë permanente është zmadhuar numri i institucioneve që kanë raportuar pranë zyrës së Ombudsmanit, megjithatë një pjesë e madhe e kësaj rritje ka të bëjë me punësime të reja. Kështu, vetëm për ilustrim ministrinë në vend në vitin 2016 kanë punësuar gjysmën e të

punësuarve që i kanë punësuar në vitin 2016. Krahës kësaj, duhet theksuar se në tabelën e mëlartme nuk janë të përfshirë edhe mijëra të tjerë të punësuar në administratat e njësive të pushtetit lokal, organeve dhe një pjesë të ndërmarrjeve të themeluara nga to.

Diskrepanca ndërmjet ofertës akademike dhe nevojave të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë

Me qëllim të hulumtimit të nivelit të përputhshmërisë midis ofertës akademike nga njëra anë dhe kërkesave, përkatësisht nevojave të punëdhënësve, nga ana tjetër, është realizuar një studim anonim me 475 ish-studentë të dy universiteteve me mësimdhënie në gjuhën shqipe, e të cilët pas përfundimit të studimeve kanë arritur të sigurojnë punësim në biznese private si dhe në ndërmarrje publike. Bëhet fjalë para së gjithash për studentë që kanë të përfunduar fakultet ekonomik ose të biznesit, fakultetin juridik dhe fakultetet e administratës publike. Rezultatet e fituara janë të paraqitura në mënyrë të sublimuar në tabelën vijuese.

Tab.3. Qëndrimet e respondentëve lidhur me diskrepancën ndërmjet cilësisë së arsimit të lartë dhe nevojave të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë (në %)

Përshkrimi	Pajtohem	Nuk pajtohem	Pa përgjigje
Pjesa më e madhe e ligjëruesve kanë qenë shumë të përkushtuar në mësimdhënie	32	33	
Pjesa më e madhe e profesorëve kanë dëshmuar njohuri të thelluara në mësimdhënie	31	43	
Pjesa më e madhe e profesorëve kanë dëshmuar njohuri të mjaftueshme pedagogjike	27	49	
Pjesa më e madhe e profesorëve kanë qenë të rregullt në mësimdhënie	53	19	
Pjesa më e madhe e profesorëve rregullisht u janë përmbajtur orareve të konsultave me studentë	53	20	

Pjesa më e madhe e profesorëve i kanë trajtuar të gjithë studentët në mënyrë të barabartë në klasë	82	16	
Kam dëgjuar për së paku një rast që nota të jetë siguruara përmes intervenimeve	97		
Në fakultet jam pajisur me njohuri të mjaftueshme teorike	42	36	
Në fakultet jam pajisur me njohuri të mjaftueshme praktike	16	74	
Një pjesë e madhe e njohurive të fituara në fakultet kanë gjetur zbatim të vendin e punës	18	69	
Diploma e siguruar në fakultet më ka lehtësuar aktin e punësimit	74	13	
Në kohën kur kamë qenë student jam angazhuar maksimalisht	36	49	
Në fillim të punësimit kam manifestuar zbrazëtira të thella në dije dhe shkathtësi për të kryer obligimet e punës	68	21	
Vlerësoj se duhet reformuar mënyra e mësimdhënies në fakultetet tona	69	13	
Një pjesë e madhe e profesorëve gjatë ligjëratave nuk kanë bërë gjë tjetër pos leximit të slajdeve	53	34	
Një pjesë e profesorëve në orë të ligjëratave nuk kanë ligjëruar asgjë jashtë literaturës bazë	53	34	
Një pjesë e madhe e profesorëve gjatë ligjëratave nuk kanë ofruar aspak shembuj nga praktika	55	34	
Një pjesë e madhe e profesorëve gjatë orëve të mësimin nuk na kanë ofruar mundësinë e parashtrimit të pyetjeve	54	34	
Një pjesë e madhe e profesorëve gjatë orëve të mësimin kanë ndërprerë ligjërimin për të biseduar në telefon	84	9	
Një pjesë e madhe e profesorëve në notim nuk kanë mbajtur të njëjtin kriter për të gjithë studentët	67	21	

Një pjesë e madhe e profesorëve nuk disponojnë librat adekuat për lëndët e tyre	74	13	
Një pjesë e madhe e profesorëve nuk e ndjekin aspak punën e asistentëve të tyre në orë praktike	64	17	
Fakulteti nuk na ka përgatitur për nevojat e tregut të punës	53	33	

Pra, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e lartcekur ish-studentët kanë theksuar një varg të mangësive që sipas të gjitha gjasave nuk kanë mund ose nuk kanë pasur gatishmëri t'i shprehin gjatë viteve të tyre studentore. Gjithsesi një pjesë e përgjigjeve të dhëna nga ana e respondentëve mundet të mos jenë krejtësisht të sinqerta, meqë tek e fundit vetë anonimiteti numërohet në aspektin metodologjik edhe si përparësi e edhe si mangësi e pyetësorit. Vetë natyra e pyetjeve që kërkon dhënie të qëndrimeve të sublimuara krijon hapësirë edhe për dyshime në rezultatet e realizuara. Megjithatë, nga ana tjetër duhet pranuar fakti se të gjitha përgjigjet e marra munden së paku të shërbejnë si sinjale rreth pikave ku duhet ndërhyrë dhe reaguar me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit sipëror dhe gjetjes së një shkalle më të lartë të përputhshmërisë ndërmjet ofertës akademike dhe kërkesave të punëdhënësve.

Përfundime dhe rekomandime

Problematika e cilësisë së arsimit të lartë dhe përputhshmërisë së ofertës akademike me nevojat dhe kërkesat e tregut janë mjaft komplekse për nga natyra e saj. E para, duhet theksuar se tek e fundit është baza financiare ajo që në masë të madhe e determinon cilësinë e arsimit të lartë, krahas faktorëve tjerë. Por, nga njëra anë, duhet edhe vetë këto institucione të jenë pak vetëkritike dhe të identifikojnë mundësi për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies konform mundësive dhe rrethanave reale.

Ç'është e vërteta, shumëçka është realizuar ndër vite në Republikën e Maqedonisë, por edhe shumëçka ka mbetur të realizohet. Gjithsesi që vetë rrethanat e funksionimit të institucioneve shtetërore, shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi kanë pasur te një pjesë e qytetarëve efekt dekurajues, përfshirë këtu edhe ligjëruesit, por edhe trupin studentor. Tek e fundit cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie

ka dy elemente bazë. Nga njëra anë, duhet pasur individë që kanë gatishmëri, interesim, kapacitet dhe mbi të gjitha motivimin për të ofruar mësimdhënie cilësore. Nga ana tjetër, duhet pasur edhe palën tjetër, pra studentët me kapacitetet, gatishmëri dhe përsëri mbi të gjitha motivimin e duhur për të qenë të përkushtuar ndaj të mësuarit dhe studimit, përqendrimit në klasë dhe respektimit të normave akademike si parakushte për një mësimxënie të mirëfilltë.

Analiza e qëndrimeve të ish-studentëve tanimë të punësuar në institucione publike dhe subjekte të ndryshme afariste ka nxjerr në sipërfaqe rezultate disi dekurajuese kur është çështja e cilësisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë. Ndonëse rezultatet e shprehura nuk duhet nënkuptuar si skajshmërisht pesimiste, përsëri duhet konsideruar si një kornizë për identifikim të pikave kyç për përmirësime të ardhshme në mënyrën e organizimit të sistemit të arsimit universitar në përgjithësi dhe vetëfunksionimit të institucioneve të arsimit të lartë në veçanti.

Gjithsesi që rekomandim bazë nga punimi në fjalë do të kishte qenë nevoja për reformim të qasjes së përgjithshme ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies, veçanërisht duke pasur parasysh ndryshimet e shprehura shkencore-teknologjike të cilat në mënyrë radikale kanë ndryshuar mënyrën e kundërimit të rolit të fakultetit dhe mësimdhënësit në relacion me studentin. Pra, institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë duhet të insistojnë në ndryshim të qasjes dhe kalim në një sistem të orientuar drejt studentit. Duhet kaluar nga qasja në të cilën profesori konsiderohet si figurë që duhet të ligjërojë dhe t'i mësojë studentët e këta të fundit të memorojnë të dhëna konkrete. Përkundrazi, profesori modern duhet të ndërtojë kapacitete që t'i pajisë studentët me më shumë shkathtësi dhe kapacitete për t'u gjendur në botën e re të informatave të pakufizuara. Bëhet fjalë për një proces që bota e zhvilluar e ka realizuar në mënyrë evolutive e që institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë do të duhej ta ecnin me hapa të përshpejtuar me qëllim të sigurisë së një përputhshmërie të rritur midis tyre dhe tempos së zhvillimit të tregjeve të punës në botën bashkëkohore.

THE QUALITY OF HIGHER EDUCATION AND THE LABOR MARKET IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Raman ISMAILI

Faculty of Economics, University of Tetova
raman.ismaili@unite.edu.mk

Brikend AZIRI

Faculty of Economics, University of Tetova
brikend.aziri@unite.edu.mk

Isak AJRULI

Faculty of Economics, University of Tetova
isak.ajruli@unite.edu.mk

Abstract

Today, combining university curricula with labor market demands has become the prerogative of the times. Although the Republic of Macedonia, as well as many other countries of the region, is still at the stage of broadening of higher education, paying particular attention to boost enrollment at universities, there is no denying of the importance of teaching and learning, two components that should enable a higher level of consistence between student knowledge and the requirements and needs of the labor market. Today, higher education institutions should orient their approach towards equipping students with more knowledge, skills, sound thinking logic, and courage to face challenges and the status quo, which is present in the labor market. From here is derived the primary purpose of the paper, respectively the need to identify the compatibility of what universities are building as cadres and what is really needed in the labor market. Within the scope of the paper, special importance is also given to the (non) compatibility of the three-year study system according to the Bologna model and the labor market requirements in Macedonia. The paper is based on a relatively large sample of professors, students and business representatives.

Keywords: Higher education, university, labor market, teaching and learning, business community.

Bibliografia

1. Enric Corominas, Carme Saurina, Esperança Vilar: **The Match Between University Education and Graduate Labor Market Outcomes (Education-Job Match)**, Agencia per a la qualitat del sistema universitari del Catalunya, 2010.
2. Etem Aziri: **Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik**, 2012.
3. Paul Chatterton, John Goddard: “*The Response of Higher Education Institutions to regional needs*”, **European Journal of Education**, 35(4).
4. Tazeen Fasih: **Linking Education Policy to Labor Market Outcomes**, International Bank for Reconstruction and Development, 2008.

ROLI I PROGRAMEVE TË BE-SË NË MBËSHTETJEN E ARSIMIT TË LARTË DHE TREGUT TË PUNËS NË KOSOVË

Gazmend QORRAJ¹

Përmbledhje

Edhe pse edukimi është komponentë shumë me rëndësi për konvergjencën ekonomike, në Ballkanin Perëndimor ekziston një mungesë e mbështetjes institucionale për të siguruar qëndrueshmërinë e institucioneve të arsimit si dhe rritjen e aktivitetetve hulumtuese dhe inovative. Kjo mungesë e mbështetjes institucionale mund të shikohet gjithashtu nga pamjaftueshmëria dhe kufizimet financiare të institucioneve lokale drejt krijimit dhe promovimit të qendrave, respektivisht intituteve hulumtuese, rritjen e numrit të publikimeve shkencore si dhe aktivitetetve tjera në drejtim të rritjes së cilësisë së edukimit. Vlerësuesi më i mirë i cilësisë së edukimit është punësueshmëria dhe produktiviteti. Pyetja kryesore kërkimore e këtij punimi është se institucionet lokale në Kosovë a mund të përfitojnë dhe absorbojnë projektet e BE-së në mënyrë optimale, duke marrë parasysh sfidat në lidhje me aftësitë, eksperiencën dhe sfidat e tjera të këtyre institucioneve lokale. Megjithatë Ballkani Perëndimor do të integrohet në Bashkimin Evropian, është e rëndësishme për këto shtete që të rrisin pjesëmarrjen në Erasmus, Horizont 2020 dhe programe të tjera të BE. Këto programe u mundësojnë këtyre vendeve të përshtatin sistemin e Bolonjës, të përmirësojnë sistemin e tyre të arsimit, të nxisin shkëmbimet midis universiteteve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu të rrisin mundësitë dhe partneritetet midis sektorit të NVM-ve dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Fjalët çelës: Edukimi, hulumtimi, inovacioni, Bashkimi Evropian, Programet e BE-së.

Hyrje

Në vitin 2000 Bashkimi Evropian në kuadër të Agjendës së Lisbonës ka krijuar “Zonën Evropiane të Hulumtimit” për shkencë dhe hulumtim në mënyrë që të koordinojë politikat nacionale me ato evropiane. Në të njëjtën kohë ka krijuar edhe mekanizmat për mbështetje financiare në mënyrë që të krijojë një kohezion në nivel evropian sa i përket shkencës dhe hulumtimit. Plani i aksionit për

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
gazmendqorraj@yahoo.com

hulumtim dhe zhvillim teknologjik ishte krijuar nga vendet anëtare të BE-se, ndërsa prej vitit 2003 pjesë e këtij programi është edhe Ballkani Perëndimor².

Programet e Bashkimit Evropian janë shumë me rëndësi për shtetet përfituese dhe sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor. Së pari, sepse në keto vende nuk ka mbështetje të mjaftueshme financiare për institucionet e arsimit të lartë nga institucionet lokale, prandaj programet e BE-së do të kontribuojnë në tejkalimin e këtij boshllëku financiar. Së dyti, ende nuk ka eksperiencë të mjaftueshme me sistemin e Bolonjes, prandaj korniza e Programeve të BE-se do të krijojë mundësi për komponente të tilla si kurrikula e re, programet e përbashkëta si dhe permiresimin e programeve ekzistuese. Shkëmbimi i studentëve dhe akademikëve nga Ballkani Perëndimor me institucionet e BE-se jo vetëm që do të sjellë përfitime arsimore, por gjithashtu do të krijojë një "shok pozitiv kulturor". Përveç kësaj, aktivitetet e Programeve Jean Monnet krijojnë një mbështetje të drejtpërdrejtë në procesin e integritimit në BE duke mbështetur studimet evropiane dhe projektet e tjera të integritimit në BE. Aspekt tjetër me rëndësi sa i përket programeve të BE-së është edhe komponenti i bashkëpunimit ose koalicioni universitet-industri, që krijon bashkëpunimin midis ekonomisë dhe IAL-ve. Përfundimi kryesor është se, për shkak të procesit të gjatë të tranzicionit, programet e BE-së për shumë vite mund të mbështesin krijimin dhe avancimin e projekteve arsimore, përmirësimin e programeve mësimore, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në Ballkanin Perëndimor.

Sipas raportit të (OECD-së 2015), kualiteti i arsimit në Kosovë është jo i kënaqshëm në të gjitha nivelet, përfshirë këtu edhe testin e PISA-s që e konfirmon këtë situatë. Ndërsa sipas Raportit të Komisionit Evropian 2018 mbështetja financiare për edukimin dhe trajnimet në Kosovë është vetëm 4.7% e GDP, ndërsa për shkencën ka shënuar zbritje, respektivisht arrin në 0.1% e GDP-së.

Programet kryesore të BE-së dhe sfidat në Ballkanit Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor gjenden ende në një nivel të ulët të zhvillimit pasi që kanë kaluar fazën e deindustrializimit, por edhe si pasojë e krizave politike si dhe e konflikteve dhe luftërave të

² History and Outlook on the cooperation in Higher Education and Research with the Western Balkans - A view from Austria.

ndryshme në rajon. Papunësia sidomos e moshave të reja është diku rreth 22%, prandaj rritja e fondeve publike nacionale, por dhe atyre të BE-së, është shumë e nevojshme jo vetëm për edukimin formal, po edhe për rritjen e aftësive konkurruese për tregun e punës (Polajnar, 2014). Në kuader të procesit të Integritimit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë pjesë në projektet Tempus, Erasmus Mundus, Lifelong Learning (të mësuarit gjatë gjithë jetës) si dhe programe të tjera. Disa nga programet kryesore të BE-së nga të cilat përfiton edhe Kosova në fushën e shkencës, hulumtimit dhe inovacionit janë:

HORIZON 2020, si programi më i madh i BE-së për hulumtim dhe inovacion me afro 80 miliard euro fonde në dispozicion përgjatë 7 viteve (2014 – 2020). Aspekti kryesor i Programit Horizon 2020 është Bashkimi Evropian i bazuar në inovacion dhe hulumtim që adreson:

- Krizen ekonomike duke investuar në sektorët që krijojnë rritje,
- Sfidat e njerëzve në lidhje me sigurinë e tyre, aspetin ekonomik dhe ambientin,
- Pozitën e BE-së në aspektin global në lidhje me hulumtimin, inovacionin dhe teknologjinë. Tre komponentët kryesorë të këtij programi janë:
- Përsosmëria në shkencë, lidershpi industrial dhe sfidat shoqërore.

ERASMUS PLUS paraqet kombinimin e të gjitha skemave aktuale për edukim, trajnim, rini dhe sport i cili ishte inicuar në janar të vitit 2014. Po ashtu ky program në vete përmban edhe programet (Erasmus, Leonardo da Vinci, Comenius, Grandtvig, Jean Monnet), Youth in Action si dhe programe të tjera.

COST si një kornizë ndërqeveritare për bashkëpunim evropian në shkencë dhe teknologji koordinon hulumtimet në nivel evropian, por edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor duke i shndërruar në produkte dhe shërbime të reja.

COSME është program për ndërmarrësinë. Qëllimi i këtij programi është rritja e aftësisë konkurruese të NVM-ve. Buxheti i programit është rreth 2.3 miliard euro për periudhën 2014-2020.

Këto programe e sidmos programi ERASMUS + iu mundësonë këtyre vendeve të përshtatin dhe avancojnë Procesin e Bolonjës, të përmirësojnë sistemet e tyre të arsimit dhe të rrisin shkëmbimin midis Universiteteve të BE-se dhe Ballkanit Perëndimor. Këto programe kanë lehtësuar lëvizshmërinë dhe shkëmbimin e studentëve (dhe stafit)

ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor.

Erasmus + si programi kryesor i BE-së për mbështetjen e IAL-së, përbëhet nga nënprograme të ndryshme arsimore të mëparshme të BE-së dhe ofron një gamë të gjerë të mundësive për IAL. Komponentet kryesore të programit janë: shkëmbimi i studentëve dhe stafit akademik, mobiliteti i kredive, programe të përbashkëta të masterit, bashkëpunimi ndërkombëtar, aktivitetet e Jean Monnet, sport dhe elemente të tjera të rëndësishme.

Përparësitë dhe sfidat

■ Financimi

Sipas hulumtimit të finalizuar nga SPHERE (2017) me institucionet e arsimit të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor konkluda kryesore është se nuk ekziston mbështetje financiare e qëndrueshme për shkencë dhe hulumtim, respektivisht 73% e përfaqësuesve të IAL kanë deklaruar se nuk ka fonde të mjaftueshme për shkencën si dhe shkenca nuk është trajtuar me prioritet nga qeveritë dhe institucionet e tjera të këtyre vendeve.

■ Partneritet ndërmjet universiteteve dhe programet e përbashkëta të studimit

Partneriteti dhe programet e përbashkëta të studimit janë instrumente shumë të rëndësishme për të promovuar sigurimin e cilësisë si dhe nohjen reciproke të kualifikimeve. Programi Erasmus Mundus ka ndikuar që afër 700 institucione të arsimit të lartë të Bashkimit Evropian, po edhe jashtë BE-së, të përfitojnë nga programet e përbashkëta të studimit. Sipas Komisionit Evropian, në kornizën kohore 2014-2020, Bashkimi Evropian ka mbështetur krijimin e programeve të përbashkëta master dhe të doktoratës përmes Programit Erasmus+ si dhe aktiviteteve të Marie Curie në kuadër të Programit Horizon 2020³.

■ Ngritja e kapaciteteve dhe e kulturës së bashkëpunimit

Rol shumë të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve në vendet jashtë BE-së luan edhe pjesëmarrja dhe partneriteti i IAL të BE-së me

³ European Commission: European Higher Education in the World, Brussels 2013.

këto vende, e sidomos me vendet që kanë përjetuar konflikte dhe probleme ekonomike dhe politike, siç është Ballkani Perëndimor. Vlen të theksohet asistenca në formë të pajisjeve, por edhe format e tjera, duke krijuar mundësi të bashkëpunimit afategjatë.

■ Rritje të këmbimeve reciproke

Rritja e këmbimeve reciproke të studentëve dhe stafit akademik është një instrument që shërben për ndërkombëtarizimin e institucioneve të arsimit të lartë, njohjen me përvojat evropiane, por edhe për rritjen e të hyrave të institucioneve përkatëse. Kur analizohet trendi i këmbimeve rezulton se tre vendet e Bashkimit Evropian si Britania, Franca dhe Gjermania pranojnë afer 63% të të gjithë studentëve jashtë zonës evropiane të arsimit të lartë⁴.

■ Partneriteti universitet - industri

Partneriteti universitet - industri është po ashtu një risi pozitive në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian. Bashkëpunimi universitet - industri është njëmundësi e mirë për krijimin e një ekuilibri ndërmjet aspektit teorik dhe atij praktik, respektivisht krijon efekte pozitive për universitetet. Nga ky bashkëpunim të diplomuarit përmes praktikave profesionale në biznese dhe industri mund të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale si dhe të punësohen. Efekti i dytë pozitiv për universitetet është se përfaqësuesit nga industria mund të ndikojnë në avancimin e programeve të studimit dhe përshtatjen e tyre për tregun e punës.

Sfidat

Konsiderohet se vendet që kanë institucione efikase dhe kapacitete institucionale kanë realizuar dhe përfituar në mënyrë më optimale nga programet dhe instrumentet e Bashkimit Evropian. Raporti i progresit për shkencë, hulumtim & edukim i Komisionit Evropian i vitit 2016, respektivisht politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian konkludon se:

- Kosova ka kapacitete të kufizuara për hulumtim dhe inovacion,

⁴ The European higher Education Area in 2012: Bologna Process Implementation Report.

- Buxheti për hulumtim është jo i mjaftueshëm në raport me GDP-në,
- Ligji për shkencën dhe aktivitetet shkencore është në proces,
- Kapacitete të kufizuara administrative për shkencë dhe hulumtim,
- Mospërputhje ndërmjet programeve studimore dhe tregut të punës.

Sipas raporteve të ndryshme të Komisionit Evropian, sfida shtesë janë edhe niveli i informacioneve dhe i njohurive për programet e Bashkimit Evropian, politizimi i procesit, sfidat apo vëshirësitë në përgatitjen e projekteve si dhe partneriteti i qëndrueshëm me universitetet e Bashkimit Evropian.

■ **Niveli i informacioneve dhe politizimi i procesit**

Për shkak të nivelit të ulët të njohurive si dhe përvojave të duhura për programet e Bashkimit Evropian ekziston një shkallë e ulët e aplikimit në këto programe. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2011 gjithashtu raportoi se kishte ndërhyrje politike në emërimin e zyrtarëve në sistemin arsimor të Kosovës. Në këtë kuptim është interesante të citojmë Churchill-in: "Një politikan gjithmonë mendon për zgjedhjet e ardhshme, ndërsa një burrë shteti e konsideron brezin e ardhshëm".

■ **Sfidat në përgatitjen e projekteve dhe menaxhimin e tyre**

Sa i përket Kosovës, në bazë të përvojave të mëparshme jo vetëm që është shumë e rëndësishme të kemi një nivel të lartë suksesi në fazën e aplikimit të projektit, por është gjithashtu e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje procesit të zbatimit me qëllim që të sigurohet përfundimi i suksesshëm i projekteve si dhe mundësia për vazhdimin e projekteve në të ardhmen.

■ **Partneriteti**

Një tjetër komponent i rëndësishëm për shtetet e Ballkanit Perëndimor është edhe nevoja për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet BE-se dhe pjesës tjetër të botës në menyrë që të krijohet një partneritet i qëndrueshëm sidomos me universitetet e njohura të Bashkimit Evropian, gjë që do të rriste gjasat për sukses në këto projekte.

Arsimi dhe ndikimi në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik

Një nga karakteristikat kryesore të tregut të punës në Ballkanin Perëndimor janë edhe normat e larta afatgjata të papunësisë. Sipas Bartlettit (2013), dhe pse në vitin 2000 kishte tendencë të rënies së normave të papunësisë, prapëseprap normat e papunësisë mbesin shumë të larta krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian. Në vitin 2015 në regionin e Ballkanit Perëndimor norma e papunësisë ishte rreth 23.9% krahasuar me normën e papunësisë në Bashkimin Evropian, respektivisht (BE 28) ishte rreth 9.5% (Arandarenko, 2015).

Sipas Kovun et al 2014, norma e ulët e punësimit ndikon në mënyrë negative në rritjen afatgjatë ekonomike, respektivisht norma afatgjatë e papunësisë ndikon po ashtu në mënyrë negative në humbjen e aftësive të të diplomuarve, e rrjedhimisht kjo ndikon që këta persona të kenë vështirësi të gjejnë punë dhe kjo reflektohet në rritjen e ulët ekonomike si dhe në varfërinë.

Prandaj koordinimi ndërmjet firmave ose punëdhënësve dhe institucioneve të arsimit të lartë është shumë me rëndësi dhe është një nga temat kryesore që shpesh quhet edhe “Bashkëpunimi universitet – industri” (Healy et al.,2012).

Ndërsa sipas Seker-it (2012), investimet në hulumtim dhe inovacion ndikojnë edhe në rritjen e performacës së firmave, respektivisht produktivitetit të firmave krahasuar me efektet që krijojnë investimet në infrastrukturë. Sipas Bankës Botërore (2009), bazuar në studimet e fundit investimi rreth 3% të GDP-së për hulumtime dhe zhvillim do të gjenerojë 6% rritje në GDP, si dhe 13% rritje te eksporteve, rasti i Kroacisë.

Një nga objektivat e Bashkimit Evropian është edhe “Rritja e mençur”, e cila duhet të mbështetet nga korniza e “Ekonomisë së dijes”. Ky komponent aplikohet edhe për Ballkanin Perëndimor përmes kornizës Evropa Juglindore 2020, që tenton të rrisë në mënyrë signifikante mesataren e produktivitetit të punës. Konsiderohet se një rritje e tillë e produktivitetit mund të arrihet vetëm nëse mbështetet me një rritje prej 18% të numrit të punëtorëve me kualifikim shumë të lartë⁵.

⁵ Regional Cooperation Council 2015: South East Europe 2020 Strategy: Jobs and Prosperity in a European Perspective.

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzioni kryesor në lidhje me programet e BE-së është se BE duhet të rrisë mbështetjen për vendet e Ballkanit Përendimor, pasi që këto vende vazhdojnë të ballafaqohen me sfidat institucionale, politike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të rrisin kapacitetin absorbues të tyre në mënyrë që të përdorin mbështetjen e BE-së, respektivisht këto programe në mënyrë sa më efektive.

Programet e BE-së dhe posaçërisht Erasmus+ do t'i ndihmojë këto vende që të zbatojnë reformat e nevojshme në kuadër të procesit të Bolonjës, të reformojnë metodat e mësimi, modernizojnë sistemin e edukimit, të krijojnë programe të përbashketa me vendet e BE-së, duke rritur nivelin e hulumtimeve shkencore dhe përfundimisht të rrisë dhe bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe universiteteve në mënyrë që t'i përgatisë studentët për tregun e punës. Komponenti shtesë është se programet e BE-së duke ndihmuar dhe rritur këmbimin e studentëve dhe stafit nga Ballkani në Bashkimin Evropian do krijojnë një "efekt pozitiv" jo vetëm në aspektin profesional, por edhe në integrimin kulturor. Bazuar në përvojën e disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në lidhje me programet e BE-së, rekomandimet kryesore për institucionet e Kosovës janë:

- Qeveria e Kosovës duhet të analizojë dhe diskutojë kostot - përfitimet e pjesëmarrjes në programet e Bashkimit Evropian me akademinë, universitetet, institucionet e arsimit të lartë (IAL) si dhe me shoqërinë civile;
- Universitetet duhet të krijojnë partneritet me industrinë, respektivisht bizneset në mënyrë që të ndikojë në rritjen e punësimit, respektivisht përgatitjen e kuadrove për tregun e punës;
- Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë financim shtesë në nivelin lokal në mbështetje të aplikimit në Programet e BE-se e sidomos në Programin Horizon 2020;
- Institucionet e Kosovës duhet të rrisin kapacitetet absorbuese në mënyrë që të shfrytëzojnë në mënyrë sa më optimale fondet, respektivisht programet e Bashkimit Evropian në fushën e edukimit dhe inovacionit, marrë parasysh faktin se në Kornizën e re Financiare të Erasmus+ do ketë rritje të financimit nga 14.7 në 30 miliard euro.

THE ROLE OF EUROPEAN PROGRAMMES ON SUPPORTING THE EDUCATIONAL SYSTEM IN KOSOVO

Gazmend QORRAJ

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
gazmendqorraj@yahoo.com

Abstract

Although the importance of education for the economic convergence in the Western Balkans there is a lack of the institutional support to provide sustainable educational institutions. Kosovo has limited capability on research and innovation as the budget for research remains insufficient. This lack of support could be seen also from institutional support from the local institutions towards enhance of the quality of the education respectively curricula development, new programs, establishment of research centers, scientific journals etc.

The other challenge for the education system in Western Balkans is the quality of this education. The best screening device for the quality of education is labor employability and productivity.

The main research question of this paper is: if local institutions in Kosovo could benefit and absorb the EU projects optimally taking into consideration challenges with regard to capability, experience and other challenges of these local institutions.

As the Western Balkans will join the European Union there is crucial for these countries to increase their participation on Erasmus, Horizon 2020 and other EU Programmes. These programmes enable these countries to adapt Bologna Process, improve their education system, promote the exchange between EU and Western Balkans Universities but also increase the opportunities and partnership between SME sector and Higher Educational Institutions.

Keywords: education, research, innovation, European Union, EU programmes

Bibliografia

1. Arandarenko, M. (2015) “The Political economy of unemployment in the Balkans”, Sarajevo, Regional Cooperation Council, available at: <http://www.rcc.int/seeds/focus/1/unemployment-the-biggest-challenge-facing-the-region>.
2. Bartlett, W (2013) “Structural unemployment in the Western Balkans: challenges for skills anticipation and matching policies”, *European Planning Studies*, 21.6: 890-908.
3. EIM Business & Policy Research (2010): Measuring Innovation performance and global competitiveness at macro level; European Communities 2007-2013.
4. Enlargement Strategy and Main Challenges 2011: Communication from the Commission to the European Parliament and the Council (Progress Report 2011).
5. European Commission (2016) “From University to Employment” *Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Western Balkans*” DG Education and Culture, Brussels.
6. European Commission (2018): Kosovo 2018 Report; 2018 EU communication on EU Enlargement Policy; Commission Staff Working Document, Strasbourg 2018.
7. H.Buchbauer and Ch. Gollubits (2014): History and Outlook on the cooperation in Higher Education and Research with the Western Balkans - A view from Austria. Austrian Federal Ministry of Science Research and Economy.
8. Healy, A., Perkmann, M., Goddard, J. and Kempton, L. (2012) *Measuring the Impact of University Business Cooperation, Final Report, (EAC/23/2012)*, Brussels: European Commission.
9. Kovtun, D., Cirkel, A. M., Murgasova, Z., Smith, D. and Tambunlertchai, S. (2014) “Boosting job growth in the Western Balkans”, *IMF Working Paper*, WP/14/16.
10. Laura Bottazzi, Marco Da Rin, Francesco Giavazzi (2003): ‘Research, patents and the financing of ideas: Why is the EU growth potential so low?’ European Commission.
11. Peter Polajnar (2014): How effects on Research and Innovation Contribute to Economic Development and Integration into the European Union; European Commission: DG Enlargement.

12. Regional Cooperation Council (2015): South East Europe 2020 Strategy: Jobs and Prosperity in a European Perspective.
13. Seker. M (2012): An evaluation of Innovation of Innovation Activities in the Western Balkans'' Background Paper for the Western Balkans Regional R&D Strategy for Innovation Technical Assistance Project, World Bank Washington D.C.
14. SPHERE (2017): Harnessing the potential: Research Capacity in the Western Balkans, Report, December 2017.
15. Vujovic, M (2012): Policies to enhance Competitiveness, Economics of Enterprise, SAE Journal of Business Economics and Management, IX , 5.6, 2012 pp/ 261-274.
16. World Bank (2009): Croatia's EU Convergence Report: Reaching and Sustaining Higher Rates of Economic Growth, Washington, DC, World Bank.

SFIDAT E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

Furtuna MEHMETI¹

Blerim REXHA²

Abstrakt

Liberalizimi i tregut të arsimit të lartë dhe rritja e ofruesve të shërbimit të arsimit të lartë në dy dekadat e fundit ka kërkuar që ofruesit e tillë të demonstrojnë cilësinë në aktivitet e tyre. Hulumtimet tregojnë që universitetet ishin mësuar të shohin ekselencën si një indikator kyç i vetëkuptueshëm i cilësisë në arsimin e lartë, mirëpo tani më ky indikator i vetëkuptueshëm është transformuar në një mekanizëm të kontrollit. Në Kosovë koncepti i sigurimit të cilësisë përmes Agjencisë së Kosovës për Akreditim është relativisht i ri, ani pse ky koncept po bëhet gjithnjë e më tepër pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e secilit institucion të arsimit të lartë. Mekanizmat për sigurimin e jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë në kuptimin formal janë vendosur baza ligjore mbi të cilën organizohet sistemi i sigurimit të cilësisë, përkatësisht kërkesat dhe standardet e sigurimit të cilësisë janë mirë të definuara dhe të aplikueshme. Në këtë punim janë paraqitur sfidat e sigurimit, të jashtëm dhe të brendshëm, të cilësisë duke krahasuar plotësimin e këtyre kriterëve ndër vite, pastaj duke krahasuar edhe me standardet dhe udhëzuesit evropian të sigurimit të cilësisë si dhe me praktikën e mira të disa shteteve të zhvilluara. Në punim janë paraqitur konkluzionet, mësimet e nxjerra gjatë këtyre viteve dhe në fund janë dhënë rekomandimet për akterët e sistemit të arsimit të lartë për tejkalimin e këtyre sfidave.

Fjalët çelës: Arsimi i lartë, siguri i cilësisë, akreditim, sfida, Kosovë.

Hyrje

Arsimi i lartë luan rol vital në zhvillimin e një shoqërie dhe është e drejtë fundamentale e çdo individi. Përpos përgatitjes së një individi për një profesion të caktuar dhe sigurimit të atij personi një jetë dhe një të ardhme më të mirë, arsimi i lartë përfshin në vete një sërë vlerash dhe elemente të rëndësishme të cilat e pasurojnë tutje jetën e njeriut. Ministrat evropian të arsimit të lartë në njërën nga mbledhjet e tyre në Londër në vitin 2002 (*Komunikata e ministrave*

¹ Kolegji AAB. furtuna.mehmeti@aab-edu.net

² Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". blerim.rexha@uni-pr.edu

evropian të arsimit, Londër, 18 maj 2017) kanë thënë se qëllimi i institucioneve të arsimit që ofrojnë arsim të lartë është:

- Përgatitja e studentëve si qytetarë aktivë në një shoqëri demokratike;
- Përgatitja e studentëve për karrierat e tyre të ardhshme;
- Zhvillimi personal i studentëve;
- Krijimi i një baze të gjerë dhe të avancuar të njohurive si dhe
- Stimulimi i hulumtimit dhe inovacionit në një shoqëri.

Në Kosovë arsimi i lartë, si çdo fushë tjetër, ka kaluar vështirësi të mëdha të zhvillimit dhe konsolidimit dhe ka qenë në një periudhë të gjatë të tranzicionit. Specifikisht arsimi i lartë në Kosovë ka qenë i pazhvilluar dhe për më tepër edhe përpjekjet për ta zhvilluar këtë sektor gjithmonë janë rrënuar nga kushtet politike të cilat kanë ekzistuar në vend. Kosova në asnjë moment nuk mund t'iu përafrohet shteteve evropiane për sa i përket arritjeve të sistemit të arsimit në përgjithësi, dhe specifikisht atij të lartë, meqenëse investimet e shteteve të Bashkimit Evropian në arsim, shkencë dhe hulumtim dallojnë jashtëzakonisht me investimet që bëhen në Kosovë. Përderisa në Kosovë shpenzimet për veprimtari kërkimore si % e BPV janë 0.10% (*Raporti i vlerësimit të PSAK 2016*), në Evropë mesatarja është 1.3% sipas BPV (*Eurostats*). Në anën tjetër, MASHT nuk është ministri prioritarë në mesin e ministrive të tjera, kur shohim ndarjen e buxhetit. Në vitin 2017 buxheti i përgjithshëm për këtë sektor ishte rreth 45 milion, ndërsa për vitin 2018 ky buxhet është rritur përreth vetëm 20%, përkatësisht rreth 55 milion euro, për arsimin e lartë specifikisht rreth 23 milion euro (*Ligji për Buxhetin i Republikës së Kosovës për vitin 2018*). Sa i përket institucioneve publike të arsimit të lartë, buxhetet e ndara për universitetet publike ndahen prej 2 milion deri në 3 milion euro ndarazi për 7 nga universitetet publike, (*Ligji për Buxhetin i Republikës së Kosovës për vitin 2018*) pa përfshirë Universitetin e Prishtinës i cili ka buxhet prej 34 milion euro, e që përsëri në krahasim me universitetet evropiane sikurse Universiteti i Vjenës (540 milion), Universiteti i Lubjanës (rreth 290 milion), apo Universitetit të Zagrebit (rreth 330 milion), ky buxhet është jashtëzakonisht i ulët.

Përderisa në Evropë ka lindur arsimi universitar, shkenca dhe hulumtimi dhe këtë me mburrje gjitha universitetet evropiane janë munduar ta promovojnë edhe jashtë Evropës, shteti i Kosovës ka traditë të shkurtër të sistemit universitar. Deri vonë ky sistem është

fokusuar vetëm në një universitet, i cili përpos qëllimit të arsimit ka shërbyer edhe si mjet i ruajtjes së vlerave tona kombëtare, qëndresës dhe kundërshtimit të okupuesve në Kosovë. Nuk mund të mos flasim për organizimin paralel të mësimi në gjuhën shqipe gjatë vitet '80 – '90, i cili përpos meritave që i ka në kuptim të mbajtjes gjallë të idealit për shkollim në gjuhën shqipe, ka lënë edhe pasojat të pariparueshme për sistemin arsimor. Kosova mbeti mbrapa nga zhvillimet e arsimit perëndimor dhe bashkëkohor dhe krijoi boshllëk në kuptim të krijimit të kuadrove, përkatësisht stafit akademik dhe profesionistëve të tjerë në përgjithësi.

Rritja e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë në raport me Evropën vjen vetëm pas vitit 2003, që karakterizohet me shtimin e numrit të institucioneve të arsimit të lartë, publike dhe private, si dhe shtimit të numrit të studentëve. Sektori privat, i cili shënoi rritjen më të madhe dhe më së paku në përputhje me standardet e cilësisë, për periudhën 2004-2007 numëronte rreth 20.000 studentë të regjistruar në 23 institucione private të ashtuquajtura universitete, kolegje universitare etj. (*Kosova Accreditation Project, July 2008, BAC*). Pas vlerësimit të bërë nga British Accreditation Council (BAC) për cilësinë e institucioneve private të arsimit të lartë, i cili rezultoi me mbylljen e tyre për një vit, numri i institucioneve me akreditim institucional megjithatë është zbritur. Në anën tjetër, sektori publik është zgjeruar me hapjen e gjashtë universiteteve të reja publike në Gjilan, Gjakovë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Ferizaj. Rritja e sistemit është argumentuar se është bërë në shpërputhje me kapacitetet që vendi ynë ka për ofrimin e arsimit cilësor, pa diferencim mes njërit-tjetrit dhe profilizimit të tyre, me struktura të brishta qeverisëse dhe vendimmarrëse, pa vlerësim të kërkesave të tregut të punës dhe me fokus të madh në mësimdhënie dhe fare pak në hulumtim (*European Commission, From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Kosovo**, 2016). Përderisa mbi 50% e studentëve studiojnë në fushën e shkencave shoqërore, biznes dhe drejtësi, rreth 7% e studentëve studiojnë në shkencat e natyrës - matematikë dhe kompjuterikë, ndërsa afro 10% e studentëve në shkenca humane dhe arteve dhe rreth 13% në inxhinieri, prodhimtari dhe ndërtimtari. Fusha të tjera, sikurse bujqësia dhe veterinaria, të cilat ofrohen vetëm nga institucionet publike përbëjnë më pak se 3% të studentëve të cilët studiojnë në arsim të lartë. (*Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHT, Prishtinë, krrik 2016, f. 29*). Këto të dhëna tregojnë se, varësisht ngopjes së tregut të punës me të diplomuar nga fusha shoqërore, përsëri oferta kryesore e

IAL-ve fokusohet në këtë fushë, meqenëse kërkesat e studentëve orientohen më së shumti në drejtimin ekonomi dhe juridik. Dokumenti i cili vlerëson zbatimin e Planit strategjik të arsimit të Kosovës të vitit 2011 vë në pah se në Kosovë zhvillimin ekonomik e pengon mungesa e fuqisë punëtore e pakualifikuar, e cila ka lidhje direkte cilësinë e arsimit. Sipas këtij vlerësimi, dy problemet strukturore të tregut të punës në Kosovë janë: a) shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët dhe trendi i vendeve të punës të krijuara viteve të fundit nuk garanton punësim të të diplomuarve dhe b) shpërputhja ndërmjet cilësisë së kualifikimit dhe tregut të punës (*Raport i vlerësimit të Planit strategjik të arsimit të Kosovës 2011 – 2016, MASHT, dhjetor, 2015, f. 83*), meqë sipas studimeve të bëra nga Banka Botërore dhe USAID-i në Kosovë, tregu i punës konsideron se shkathtësitë dhe shkollimi i fuqisë punëtore nuk është adekuat dhe se kurikulat e arsimit të lartë nuk janë relevante me tregun e punës në Kosovë.

Në kuptimin formal, arsimi i lartë në Republikën e Kosovës formalisht organizohet në përputhje me parimet e Bolonjës, respektivisht Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, ani pse zyrtarisht Kosova nuk është nënshkruese e Deklaratës së Bolonjës (*Ligji për arsimin e lartë i Republikës së Kosovës 04/L-037*). Arsimi i lartë në Kosovë organizohet në tri cikle kryesore të studimeve: atë të nivelit BA (180 - 240 ECTS); Të nivelit MA (60 - 120 ECTS) dhe PhD (180 ECTS) në përputhje me përshkruesit e Kornizës kombëtare të kualifikimeve (KKK). Sipas ligjit, arsimi i lartë mund të jetë edhe çdo arsimim pas shkollimit të mesëm në nivelin 5, 6, 7 dhe 8 të KKK-së, përkatësisht Kornizës evropiane të kualifikimeve (KEK), për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS) (*Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037, shtator 2011, neni 4*). Deri më tani formalisht janë ndërtuar dhe funksionalizuar gjithë mekanizmat institucionalë të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë arsimin e lartë, si dhe kërkesat e rekomandimet e dhëna nga institucionet dhe organizatat relevante të Zonës Evropiane për Arsimin e Lartë.

Koncepti i sigurimit të cilësisë

Sigurimi i cilësisë është zhvilluar në masë të madhe viteve të fundit në të gjithë botën në fushën e arsimit të lartë. Për më tepër, sistemi evropian i sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë është rritur me rastin edhe të paraqitjes së agjencive të reja që nga viti 2002, siç

janë: *Nathalie Costes, Fiona Crozier, Peter Cullen, Josep Grifoll, Nick Harris, Emmi Helle, Achim Hopbach, Helka Kekäläinen, Bozana Knezevic, Tanel Sits, Kurt Sohm: Quality Procedures in the European Higher Education Area and Beyond – Second ENQA Survey, Helsinki, Finland, 2008*. Institucionet e arsimit të lartë çdo herë e më tepër janë në kërkim të përmirësimit të ofertave të tyre studimore, të punës së tyre kërkimore dhe hulumtuese, shërbimeve ndaj studentëve dhe aktiviteteve të tyre të tjera akademike përmes zhvillimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Të qenit në hap me kohën në kuptim të përshtatjes së ofertave të tyre studimore dhe metodologjisë së mësimdhënies në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike, hapja e tregut për studentë ndërkombëtarë dhe shtrirja e ofertave të tyre jashtë kufijve gjeografikë është po ashtu një sfidë për çdo universitet në botë. Prandaj këto institucione janë duke investuar shumë në krijimin dhe mirëmbajtjen e mekanizmave të brendshëm të cilësisë, të cilat pastaj, varësisht nga legjislacioni në fuqi, duhet të dëshmojnë para ndonjë organi të jashtëm apo jo, se deri në cilën masë ata i përmbushin kriteret e vendosura për cilësi. Po ashtu për shkak të rritjes së presionit nga akterë të ndryshëm që përgjegjësia e IAL-ve të jetë më e madhe karshi shoqërisë në përgjithësi, nënkuptohet që IAL-të nuk mund të shprehin vetëm përkushtimin e tyre drejt ekselencës, mirëpo ata duhet në vazhdimësi të monitorojnë aktivitetet e tyre dhe të demonstrojnë cilësinë e tyre pranë akterëve të ndryshëm relevantë. (*EUA, Quality Culture in European Universities: A Bottom –Up Approach, Report on the three rounds of the quality culture project, 2002 – 2006*). Ky proces ngërthen në vete një sërë aktiviteteve të vazhdueshme të cilat shërbejnë si rregullator i sistemit të një institucioni të arsimit të lartë dhe përfshijnë mekanizma për kontrollimin e cilësisë, matjen e cilësisë, përshtatjen ndaj standardeve etj. Sistemi dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë garantojnë standarde të larta të arsimit dhe prandaj është bërë e domosdoshme që institucionet e arsimit të lartë të investojnë në këto mekanizma.

Sot ekzistojnë dy koncepte për sigurimi e cilësisë në arsimin e lartë (*Standardet dhe udhëzuesit evropian të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë 2015*), të cilat përfshijnë:

- *Sigurimin e brendshëm të cilësisë*, për çka përgjegjës kryesorë për të siguruar efektshmërinë e atij sistemi është vetë universiteti apo institucioni i arsimit të lartë dhe, në anën tjetër,

- *Sigurimin e jashtëm të cilësisë*, i cili menaxhohet dhe vendoset nga autoritetet shtetërore, dhe jo vetëm, dhe i cili duhet të adresojë me efektshmëri sigurimin e brendshëm të cilësisë të institucionit.

Në kuptim të definicionit, UNESCO përcakton se siguri i cilësisë në arsimin e lartë nënkupton një term gjithëpërfshirës që i referohet një procesi të vazhdueshëm, të pandërprerë të vlerësimit (monitorimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit) të cilësisë së sistemit të arsimit të lartë, të institucioneve dhe programeve të studimit (Lazar Vlasceanu, Laura Grunberg, and Dan Parlea, *“Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions”* UNESCO, Bucharest, 2007, f. 74). Sipas Rrjetit Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), roli i sigurimit të cilësisë është qenësor për të mbështetur sistemet e arsimit të lartë dhe institucionet që ato t’i përgjigjen këtyre nevojave në ndryshim, duke siguruar që kualifikimi i arritur nga studentët dhe përvoja e tyre përgjatë shkollimit të mbetet misioni kryesor dhe parësor i institucioneve (*Standardet dhe udhëzuesit evropian të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë* 2015). Për më tepër, angazhimi për proceset e sigurimit të cilësisë, veçanërisht ato të jashtmet, i mundësojnë sistemit të arsimit të lartë të demonstrojnë cilësi dhe të rrisë transparencën, duke ndihmuar kështu në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe njohje më të mirë të kualifikimeve të tyre, programeve dhe ofertave të tyre studimore. Në punimin (Ferizi - Miftari, J. and Rexha, B., 2018) është trajtuar ndërlidhja ndërmjet cilësisë dhe vendimmarrjes në sistemin e arsimit, më tej aty janë dhënë disa masa për përmirësimin e sistemit të vendimmarrjes në shkolla.

Për sa i përket sigurimit të jashtëm të cilësisë flitet për forma të ndryshme të sigurimit të cilësisë të cilat përgjithësisht përfshijnë akreditimin, licencimin, auditimin, monitorimin etj. Megjithatë, format më të përhapura (por pa u kufizuar vetëm në to) të sigurimit të jashtëm të cilësisë janë:

- *Akreditimi*. – Ky është një proces formal përmes të cilit një trup i jashtëm bën vlerësimin e ofruesit të arsimit të lartë dhe vërteton nëse ai subjekt plotëson një set të standardeve minimale të cilësisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Akreditimi është forma më e shpeshtë e përdorur në sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe mund të bëhet në nivelin institucional, në nivelin e programit të studimit apo në

një grup të programeve të cilat përbëjnë një fushë të caktuar të studimit. Sipas një fjalori të termave të sigurimit të cilësisë, akreditimi është “*krijimi i një statusi, legjitimiteti dhe përshtatshmërie të një institucioni, programi apo moduli të studimit*”. (Harvey, L., 2004-18, *Analytic Quality Glossary, Quality Research International*). Në anën tjetër, sipas UNESCO-s akreditimi është “*proces përmes të cilit një trupë (jo)qeveritare apo private vlerëson cilësinë e institucionit të arsimit të lartë si tërësi, apo të një programi specifik të arsimit në mënyrë që formalisht ta njeh atë si një institucion/program, i cili ka përmbushur disa kritere apo standarde të paracaktuara minimale*”(Lazar Vlasceanu, Laura Grunberg, and Dan Parlea, “*Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions*” UNESCO, Bucharest, 2007, f. 25). Rezultati i këtij procesi zakonisht është dhënia e një statusi të njohjes (pranimi) dhe ndonjëherë të licencës për të operuar brenda një periudhe të caktuar të vlefshmërisë. Në Kosovë akreditimi është proces zyrtar i vlerësimit të cilësisë, rezultati i të cilit ka konsekuenca juridike, sepse përmes këtij procesi legjitimohet operimi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Kjo mund të dallojë nga shtetet e tjera evropiane, duke qenë se procesi i akreditimit mund të mos prodhojë pasoja juridike për institucionin e arsimit të lartë.

• *Auditimi*. - Është një proces i kontrollimit (*Standardet dhe udhëzuesit evropian të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë 2015*) vërteton se ekzistojnë procedura të cilat sigurojnë cilësi, integritet apo standarde të ofertave dhe rezultateve. Roli i auditimit dallon nga një shtet në shtetin tjetër. Përderisa në disa shtete procesi i auditimit i jep institucioneve autonomi më ta madhe për ofrimin e programeve të studimit, në shtete të tjera procesi i auditimit është kusht për marrjen e fondeve nga shteti, apo i jep institucioneve të drejtën e vetakreditimit të programeve të tyre (AQ Austria, *Quality Audit in the European Higher Education Area: A comparison of approaches*, Wien, 2014, f. 17). Sipas përkufizimit të UNESCO-s, auditimi është “*proces i rishikimit të një institucioni apo programi të studimit i cili kryesisht fokusohet në llogaridhënien e tij dhe proces i përcaktimit nëse qëllimet dhe objektivat e përcaktuara të atij institucioni apo programi janë përmbushur (në kuptim të kurrikulës, stafit akademik, infrastrukturës, etj.)*” (Lazar Vlasceanu, Laura Grunberg, and Dan Parlea, “*Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions*” UNESCO, Bucharest, 2007, f. 31). Në Kosovë

auditimi në kontekst të cilësisë në arsimin e lartë nuk aplikohet, meqenëse procesi formal i vetëm i cili aplikohet është procesi i akreditimit.

• *Vlerësimi*. - Sipas UNESCO-s është “*procesi i mbledhjes sistematike të informacioneve dhe përdorimit të tyre me qëllim të gjykitimit të efektshmërisë së udhëzimit dhe përshtatshmërisë kurrikulare të një institucioni të arsimit të lartë në tërësi (vlerësimi institucional) apo të programeve të tyre të studimit (vlerësimi i programit)*” (Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions”UNESCO, Bucharest, 2007, f. 29). Vlerësimi është i nevojshëm për të validuar një vendim formal të akreditimit, mirëpo jodomosdoshëmrisht mund të shpiejë në një rezultat zyrtar të akreditimit. Rrjedhimisht, vlerësimi mund të bëhet pa pasur ndonjë pasojë juridike apo formale për institucionin e arsimit të lartë apo programet e tij të studimit. Në Kosovë përmes procesit të vlerësimit bëhet akreditimit i institucioneve të arsimit të lartë, që do të thotë indirekt vlerësimi institucional apo i programeve të studimit ka rezultat zyrtar dhe efekt juridik.

• *Referencimi* (benchmarking). - Është një formë tjetër e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Kjo formë nuk është gjerësisht e përdorur në shtetet evropiane dhe vetëm një numër i vogël i agjencive evropiane të sigurimit të cilësisë e aplikojnë këtë formë. Referencimi sipas UNESCO-s është “*më tepër një metodë e standardizuar e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave operacionale në atë mënyrë që mundëson bërjen e krahasimeve relevante të performancës në mesin e organizatave apo programeve të ndryshme, që kryesisht bëhen me qëllim të përdorimit të praktikave të mira*” (Lazar Vlasceanu, Laura Grunberg, and Dan Parlea, “Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions”UNESCO, Bucharest, 2007, f. 33). Referencimi i jep mundësi institucioneve që të gjejnë praktika të mira në bazë të së cilave ata mund të fillojnë një proces të caktuar të punës. Në Kosovë procesi i referencimit (benchamrking) nuk ekziston, meqenëse sistemi ende nuk ka arritur të dëshmojë që bën plotësimin e kriterëve minimale të cilësisë në mënyrë që pastaj të avancojë sistemin e saj në një stad tjetër. Ky proces në Kosovë mund të bëhet individualisht dhe në baza vullnetare të institucioneve, megjithatë nuk ka dëshmi të bazuara se një proces i tillë kryhet në të vërtetë.

Organizimi i sigurimit të cilësisë në Kosovë

Organizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë bëhet me legjislacion vendor të secilit shtet. Edhe Standardet dhe udhëzuesit evropian për sigurimin e cilësisë (*ESG 2015*) theksojnë rëndësinë që sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të krijohet bazuar në kontekstin nacional dhe prandaj standardet evropiane duhet t'i përshtaten atij konteksti. Nëse për një shtet të zhvilluar evropian koncepti i akreditimit, përkatësisht vendosja e kriterëve minimale të sigurimit të cilësisë dhe konstatimi se IAL-të plotësojnë ato kriterë në baza ciklike është koncept i tejkaluar, në shtete të tjera dhe sidomos me kontekst tjetër të zhvillimit ekonomik, specifikisht në Kosovë, procesi i akreditimit dhe siguri se kriteret minimale janë plotësuar është proces i domosdoshëm. Në Kosovë është Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, neni 15, i cili përcakton se *“Të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AKA-ja në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore”* (LAL nr. 04/L-037). Pra, procesi i akreditimit është procesi i vetëm i obligueshëm për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, publik dhe privat, dhe se ky proces ka efekt juridik. Mekanizmi kryesor i sigurimit të cilësisë në vend është Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) e cila u themelua në vitin 2004, ndërsa u funksionalizua tërësisht në vitin 2009 (*UA për themelimin e AKA-së, MASHT 2004*). Deri në vitin 2008, në mungesë të një agjencie shtetërore të sigurimit të cilësisë, sistemi i arsimit të lartë, sidomos atij privat, ishte zgjeruar shumë dhe atë në shpërputhje të plotë me kriteret për sigurimin e cilësisë. Meqenëse kjo rritje bëhej në kundërshtim të plotë me standardet e sigurimit të cilësisë dhe seriozisht cenohej cilësia e atyre studimeve dhe me qëllim të vlerësimit të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, MASHT në vitin 2008 ftoi Agjencinë Britanike të Akreditimit (BAC) që të bënte vlerësimin e gjithsej 30 institucioneve private të arsimit të lartë. Rezultati i këtij auditimi ishte dëshpërues dhe si rrjedhojë kjo rezultoi me mbylljen e të gjitha institucioneve private të cilat operonin në atë kohë për shkak të mungesës së mekanizmave të sigurimit të cilësisë, dhe mospërmbushjes së kriterëve dhe standardeve minimale të cilësisë (*Kosova Accreditation Project Report, July 2008*). Nga viti 2009, atëherë edhe kur për herë të parë filloi me procesin e vlerësimit dhe akreditimit me kapacitete të veta, deri në vitin 2016 AKA ka organizuar afërsisht 500 procese të vlerësimit dhe akreditimit dhe ka

publikuar qindra raporte të vlerësimit dhe akreditimit.³ Aktualisht në Kosovë ekzistojnë 31 institucione të arsimit të lartë, përkatësisht 7 universitete publike, 2 institucione të tjera publike (1 akademi dhe 1 fakultet) dhe 21 institucione private të arsimit të lartë.⁴

Tabela 1: Numri i institucioneve të arsimit të lartë privat dhe vendimet e AKA-së për riakreditimin e tyre institucional

Numri i institucioneve të arsimit të lartë - historiku i akreditimit të tyre					
	Aplikacione të reja	Akreditim fillestar	Riakredituara	Refuzuara	Gjithsej IAL
2008	23	23	1	22	23
2009	15	13		2	
2010	10	5	13	5	
2011	5	4	16	1	
2012	2		19	2	
2013	2	1	21	1	

Burimi: Të dhëna nga Agjencia e Kosovës për Akreditim

Sfidat drejt përmbushjes së kriterëve minimale në Kosovë

Në Kosovë aplikohet procesi i akreditimit i cili sipas legjislacionit në fuqi nënkupton njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtare të pranura të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull (*Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037, shtator 2011, Neni 4*). Përderisa në shumicën e shteteve më të zhvilluara evropiane koncepti i sigurimit të jashtëm të cilësisë është tejkaluar me anë të krijimit të strukturave të qëndrueshme dhe kredibile të brendshme nga vetë IAL-të, në Kosovë ky koncept është ende në ndërtim e sipër. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë për shkak të zhvillimeve historike, politike dhe ekonomike, janë institucione të reja të arsimit të lartë, përpos

³ Shënime nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), 2017.

⁴ Të dhëna nga ueb faqja e Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), 2017.
<http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/2015-09-16-11-39-57/2015-09-16-11-54-07>

Universitetit të Prishtinës i themeluar në fundvitet '60-ta të shek. XX dhe rrjedhimisht strukturat e tyre të menaxhimit dhe qeverisjes janë ende në konsolidim e sipër. Për sa i përket sigurimit të cilësisë, për shkak të përvojës relativisht të re të këtyre institucioneve, ky koncept ende nuk është zhvilluar. AKA përmes një procesi të vlerësimit të jashtëm përcakton nëse një IAL I përmbush kriteret minimale të cilësisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe rrjedhimisht bën njohjen formale të atij institucioni a programi të studimit përmes vendimit për akreditim.

Udhëzimi administrativ për akreditim nr.11/2017 është akt nënligjor i AKA-së i cili përcakton kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre në Republikën e Kosovës. Në këtë UA përcaktohen në mënyrë të detajuar procesi i akreditimit, kërkesat për akreditim, afatet kohore, vlerësimi, standardet etj. Gjitha kërkesat e dala nga ky UA duhet të përmbushen nga IAL-të në mënyrë që të merret vendimi pozitiv për akreditim.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) në vitin 2016 kishte filluar aplikimin e plotë të këtij udhëzimi. Në përputhje me kërkesat e tij, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) kishte trajtuar aplikacionet e institucioneve të arsimit të lartë dhe vetëm IAL-të të cilat i kanë plotësuar këto kriteret janë lejuar të futen në proces të vlerësimit dhe akreditimit. Institucionet e arsimit të lartë të cilat kishin pasur mungesë të stafit akademik, përkatësisht 3 doktorë shkence për çdo program të studimit si dhe të cilat kishin paraqitur staf akademik të cilët nuk kanë përmbushur kriteret formale sikurse nostrifikimi apo leja e qëndrimit për stafin me nënshtetësi të huaj nuk janë lejuar të futen të proces të vlerësimit dhe akreditimit. Deri në korrik të vitit 2016 ishin gjithsej 468 programe të akredituara të studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, përkatësisht 262 në publik dhe 206 në sektorin privat, të ofruara nga gjithsej 38 IAL. Megjithatë, me zbatimin e plotë të UA për akreditim (kërkesën për 3 doktorë shkence për program të studimit) ka pasur një zbritje domethënëse të programeve të akredituara të studimit për shkak se disa institucione kanë dështuar që t'i plotësojnë këto kriteret. Për më tepër, deri në atë kohë 6 institucione private të arsimit të lartë nuk janë lejuar të regjistrojnë studentë të rinj për shkak se nuk kishin arritur të marrin riakreditimin institucional. Deri në muajin gusht 2016 ekzistonin gjithsej 415 programe të studimit të akredituara e të ofruara nga 33 institucione të arsimit të lartë, që ishte zbritje domethënëse e

numrit të IAL-ve dhe programeve të tyre të studimit, siç është paraqitur te figura 1.




Figura 1. Numri i programeve të akredituara ndër vite

Meqenëse institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kishin kapacitete të limituara për sa i përket përmbushjes së kriterit ligjor për 3 doktorë shkence për një program të studimit, shumë nga IAL-të kishin kontraktuar profesorë nga rajoni dhe më gjerë, të cilët janë paraqitur si të rregullt në Kosovë. IAL-të kishin paraqitur këta individë si të rregullt në Kosovë pasi kanë nënshkruar kontratë për marrëdhënie të rregullt të punës, kishin arritur të bëjnë nostrifikimin e diplomave si dhe kishin arritur të marrin lejeqëndrimin në Kosovë të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, për shkak se shumica e këtyre individëve kishin marrëdhënie të rregullt të punës edhe në shtetin e tyre amë, ekspertët ndërkombëtarë të vlerësimit kishin vënë në dyshim angazhimin e vërtetë të tyre në institucionet e Kosovës. Për këtë qëllim AKA nga viti 2017 kërkoi nga gjitha IAL-të në Kosovë që për stafin me nënshtetësi të huaj, të cilët paraqiten si të rregullt në Kosovë, të sjellin një vërtetim apo konfirmim nga autoriteti përkatës në shtetin e tyre që nuk kanë marrëdhënie të rregullt të punës në shtetin e tyre amë. Në këtë mënyrë AKA do të siguronte se për qëllime të akreditimit do të lejoheshin të angazhohen vetëm stafi akademik i cili i përmbush detyrat dhe obligimet në IAL-të në përputhje me Ligjin e punës në Kosovë, UA-në për Akreditim, mirëpo edhe në përputhje me Standardet evropiane të sigurimit të cilësisë.

Si rrjedhojë, KSHC i AKA-së, duke analizuar gjendjen e stafit akademik të secilit institucion të arsimit të lartë dhe në mungesë të plotësimit të kriterëve sipas legjislacionit në fuqi në muajin qershor 2017 për herë të parë kishte marrë vendim për pezullimin e akreditimit të gjithsej 131 programeve të studimit të ofruar nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Në mbledhjet e tjera të radhës KSHC kishte vazhduar me qasjen e njëjtë ndaj analizimit të listave të stafit akademik dhe në rastet e përmirësimit të gjendjes kishte tërhequr masën e suspendimit. Në anën tjetër, në rastet e identifikimit të listave të manipuluar nga IAL-të, KSHC kishte marrë vendim edhe për tërheqjen e akreditimit të atyre programeve të studimit.

Ndërkohë, me qëllim të mbështetjes së institucioneve të arsimit të lartë, AKA kishte bërë rishikimin e Udhëzimit administrativ, i cili tani më përcaktonte kërkesat për stafin akademik në vijim: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve.”* Mirëpo pavarësisht zvogëlimit të kriterëve për stafin akademik, IAL-të në Kosovë ende ballafaqohen me këtë problem. Edhe në mbledhjen e fundit të KSHC-së të mbajtur në muajin korrik 2018, në mungesë të stafit akademik rreth 70 programeve të studimit iu është tërhequr akreditimi (të dhëna nga Mbledhja e 58-të e KSHC-së të AKA-së).⁵ Vendimet e AKA-së për tërheqje të akreditimit, përkatësisht në drejtim të përmbushjes së kriterëve minimale të cilësisë, posaçërisht kriterit për staf akademik, i kontribuon sistemit të sigurimit të cilësisë. Duke pasur parasysh që parakusht për një arsim cilësor është cilësia e stafit akademik, AKA duhet të vazhdojë të aplikojë këtë qasje konsistente, sepse në këtë masë siguron studentë që arsimimi i tyre të jetë cilësor.

Konkluzione dhe rekomandime

Komunikatat mnistrorë të mnistrave evropian për arsim përfaqësojnë një nga dokumentet kryesore politike të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Dhe pikërisht në njërën nga komunikatat e ministrave evropian, të lëshuar pas takimit të mbajtur në Pragë në vitin 2001 (*Prague Communiqué 2001*), është thënë se sistemet e sigurimit të cilësisë luajnë rol vital në sigurimin e standardeve të larta në arsim

⁵ <http://akreditimi-ks.org/docs/Reports/Withdrawn58.pdf>

si dhe lehtësimin e krahasueshmërisë së kualifikimeve përgjatë gjithë Evropës. Ky deklaram është mbështetur dhe konfirmuar në secilën komunikatë ministrore të lëshuar viteve në vijim duke e vënë çështjen e sigurimit të cilësisë agjendë të rëndësishme të ministrave evropian. Universitetet europiane kanë arritur një shkallë të madhe të progresit në këtë fushë dhe prandaj tani më sistemi evropian i sigurimit të cilësisë është duke u transformuar dhe duke u riformësuar. Një numër i madh i universiteteve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian nuk i nënshtrohen më procesit të akreditimit me qëllim të demonstrimit se përmbushin kriteret minimale të cilësisë. Ato tani më demonstrojnë se sistemet e tyre të brendshme janë plotësisht funksionale dhe efektive dhe janë këto mekanizma të cilat tani e luajnë rolin e procesit të jashtëm të akreditimit. Në momente të tilla kur procesi i akreditimit, përkatësisht procesi i demonstrimit të përmbushjes së kriterëve minimale të cilësisë nuk i kontribuon më qëllimit, nuk sjell përfitime dhe beneficione për universitetet si dhe krijohet besim i ndërsjellë mes universiteteve dhe agjencive shtetërore të akreditimit, këta të fundit heqin procesin e akreditimit si mekanizëm të kontrollit, mirëpo prezantojnë sistemin e përmirësimit të cilësisë (i njohur si *quality enhancement*), në të cilin sistem universitetet evropiane synojnë rritjen e cilësisë së universiteteve të tyre, llogaridhënien dhe transparencën e aktiviteteve të tyre.

Në Kosovë ende nuk mund të flasim për këtë evolucion të sistemit të sigurimit të cilësisë. Meqenëse në Kosovë ende ka mangësi dhe sfida serioze për përmbushjen e kriterëve minimale të cilësisë është shumë ambicioze dhe e parakohshme që IAL-të të marrin një autonomi të tillë të vlerësimit dhe akreditimit të vet programeve të tyre të studimit. Përpos kapaciteteve të mangëta të IAL-ve, fatkeqësisht në Kosovë ende nuk ekziston besimi i ndërsjellë ndërmjet institucioneve dhe autoriteteve relevante shtetërore çka paraqet një sfidë serioze në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të arsimit të lart në vend. Duhet të kujtohet se Karta e Bolonjës ka qenë deklaratë vullnetare e nënshkruar nga universitetet më me traditë të Evropës, të cilat duke qenë se e kishin krijuar traditën e cilësisë, kërkonin të avanconin tutje me forma të bashkëpunimit me universitete të tjera të cilat nënkuptonin shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira mes universiteteve të ndryshme evropiane. Edhe Deklarata e Bolonjës dhe Zona Evropiane e Arsimit të Lartë është një proces vullnetar i shteteve të Evropës të cilat e shohin aplikimin e këtij sistemi si diçka të mirë për sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë. Andaj shteti i Kosovës dhe gjithë akterët e arsimit të lartë duhet të

kuptojnë se të qenit pjesë e Bolonjës, përkatësisht Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, që Kosova substancialisht të krahasohet me universitetet evropiane nga aspekti cilësor i përgatitjes së studentëve, rritjes së transparencës së institucioneve të arsimit të lartë dhe kontribuimit të një Evrope të dijes sikurse universitetet e tjera. Nëse dëshirojmë që kjo të arrihet, gjithë akterët duhet të investojnë dhe të mbështesin politikat në këtë drejtim dhe duhet të krijhet besimi i ndërsjellë mes aktorëve, pra duhet të lirohemi nga aktivitetet që më tepër improvizojnë sistemin se sa që realisht i kontribuojnë rritjes së cilësisë.

Duke pasur parasysh faktet dhe analizën e argumenteve të shtjelluara në punim si dhe gjendjen aktuale të sigurimit të cilësisë në Kosovë ofrohen këto rekomandime për institucionet relevante shtetërore në Kosovë (Parlamenti, Qeveria, MASHT, AKA). Këto institucione shtetërore duhet:

- 1) Të mirëmbajnë sistemin shtetërorë të sigurimit të cilësisë përmes një strategjie afatgjate shtetërore, që i përshtatet kontekstit në të cilin arsimi i lartë zhvillohet në Kosovë me qëllim që ky sistem të jetë efektiv dhe të sjellë përfitime për arsimin e lartë në përgjithësi,
- 2) Të rrisin fondet për arsimin e lartë dhe rrjedhimisht ta bëjnë prioritet investimin e vazhdueshëm në një arsim të lartë cilësor,
- 3) Të sigurojnë se legjislacioni në fuqi zbatohet në vazhdimësi nga të gjithë akterët e arsimit të lartë në mënyrë të barabartë dhe dispozitat ligjore mos të jenë vetëm formale,
- 4) Të rrisin transparencën e aktiviteteve të IAL-ve dhe të rrisin llogaridhënien pranë studentëve, prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi dhe
- 5) Të udhëhiqen nga parimet e barazisë së IAL-ve me qëllim të trajtimit të barabartë të sektorit publik dhe atij privat të arsimit të lartë.

Ndërsa institucionet (publike dhe private) e arsimit të lartë në Kosovë duhet:

- 1) Të rrisin transparencën e aktiviteteve të tyre dhe rrjedhimisht llogaridhënien jo vetëm para tregut të punës, mirëpo edhe para shoqërisë në përgjithësi me qëllim të rritjes së besimit të tyre,
- 2) Të jenë autonome në udhëheqje dhe vendimmarrje. Autonomia e dhënë nga autoritetet shtetërore duhet të

arsyetohej me zbatimin në përpikëri të legjislacionit, pa dallime dhe pa ndikime politike,

- 3) Të kenë sistem të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë i cili mirëmbahet përmes politikave dhe strukturave të qarta brenda institucionit,
- 4) Që secili pjesëtar i komunitetit akademik në Kosovë të ndërgjegjësohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij që e bart brenda institucionit të arsimit të lartë. Ndërgjegjja individuale duhet të ngritet në ndërgjegje institucionale për arsimin e lartë cilësor dhe
- 5) Të mundësojnë krijimin e një kulture të cilësisë brenda institucionit dhe ky nocion të jetë i njohur dhe i materializuar nga gjithë komuniteti akademik brenda institucionit.

CHALLENGES OF QUALITY ASSURANCE IN HIGHER EDUCATION IN KOSOVO

Furtuna MEHMETI

AAB College
furtuna.mehmeti@aab-edu.net

Blerim REXHA

Faculty of Electrical and Computer Engineering,
University of Prishtina “Hasan Prishtina”
blerim.rexha@uni-pr.edu

Abstract

The liberalization of the higher education market and the growth of higher education service providers in the last two decades has demanded from such providers to demonstrate the quality of their activities. Research shows that universities were used to seeing excellence as a self-evident key indicator of quality in higher education, but now this self-evident indicator has been transformed into a control mechanism. In Kosovo, the concept of quality assurance through the Kosovo Accreditation Agency is relatively new, but this concept is becoming increasingly integral and important part of each higher education institution. Mechanisms for external and internal quality assurance have been established in the formal sense, the legal basis on which the quality assurance system is organized, i.e. the quality assurance requirements and standards, is well defined and applicable. This paper presents the challenges of quality assurance (external and internal), by comparing the fulfillment of these criteria over the years, then by comparing with the European quality assurance standards and guidelines as well as the good practices of some developed countries. The paper presents the conclusions, lessons learned during these years, and finally recommendations for higher education system actors to overcome these challenges.

Keywords: Higher education, quality assurance, accreditation, challenges, Kosovo.

Referencat

1. Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG). (2015). Brussels, Belgium.
2. http://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf
3. Lazar Vlasceanu, Laura Grunberg, and Dan Parlea, "Quality Assurance and Accreditation: A glossary of Basic Terms and Definitions" UNESCO, Bucharest, 2007.
4. <http://unesdoc.unesco.org/images/0013/001346/134621e.pdf>
5. Harvey, L., 2004-18, Analytic Quality Glossary, Quality Research International, <http://www.qualityresearchinternational.com/glossary/>
6. Page updated 24 January, 2018, © Lee Harvey 2004–2018.
7. Ferizi-Miftari, J. and Rexha, B. (2018) 'The teachers' impact on policy making for the improvement of the school performance (the case of Kosovo)', International Journal of Education Economics and Development, Vol. 9, No. 1, pp.80–104, 2018.
8. AQ Austria, Quality Audit in the European Higher Education Area: A comparison of approaches, Wien, 2014.
9. <https://www.aq.ac.at/de/internationales/dokumente-internationales/Quality-Audit-in-Europe-2013.pdf>
10. EUA, Quality Culture in European Universities: A Bottom –Up Approach, Report on the three rounds of the quality culture project, 2002 – 2006.
11. http://www.eua.be/eua/jsp/en/upload/Quality_Culture_2002_2003.1150459570109.pdf.
12. Nathalie Costes, Fiona Crozier, Peter Cullen, Josep Grifoll, Nick Harris, Emmi Helle, Achim Hopbach, Helka Kekäläinen, Bozana Knezevic, Tanel Sits, Kurt Sohm: Quality Procedures in the European Higher Education Area and Beyond – Second ENQA Survey, Helsinki, Finland, 2008.
13. <http://www.enqa.eu/indirme/papers-and-reports/occasionaln-papers/ENQA%20Occasional%20papers%2014.pdf>.
14. Raport i vlerësimit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, British Accreditation Council, Londër, 2008.
15. Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHT, Prishtinë, korrik 2016.

16. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf
17. Raport i vlerësimit i Planit strategjik të arsimit të Kosovës 2011 – 2016, MASHT, dhjetor, 2015.
18. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-shq-web.pdf>
19. Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037, shtator 2011.
20. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>
21. Komunikatë e përbashkët e ministrave evropian të arsimit – Komunikata e Londrës, Londër, 2007.
22. http://media.ehea.info/file/2007_London/69/7/2007_London_Communique_English_588697.pdf
23. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 nr. 06/L-020.
24. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>
25. Statistikat për arsim të lartë, Eurostats
26. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Tertiary_education_statistics
27. Komunikatë e përbashkët e ministrave evropian të arsimit – Komunikata e Pragës, Pragë, 2001.
28. http://media.ehea.info/file/2001_Prague/44/2/2001_Prague_Communique_English_553442.pdf
29. European Commission, From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Kosovo*, 2016
30. https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf
31. Të dhëna nga ueb faqja e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), 2017
32. <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/2015-09-16-11-39-57/2015-09-16-11-54-07>
33. UA për themelimin e AKA-së, MASHT 2004
34. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-aak-versioni-i-fundit.pdf>

ARSIMI DHE TREGU I PUNËS – PERSPEKTIVA E KOSOVËS

Drita KONXHELI¹

Përmbledhje

Arsimi konsiderohet si një prej fushave kyçe që ndikon direkt në zhvillimin ekonomik të një vendi, për arsye se falë një arsimimi të duhur përgatitet kapitali human për të plotësuar nevojat e tregut të punës. Në këtë kohë, kur procesi i globalizimit ka marrë hov të madh, imponohet kërkesa që në tregun e punës të kemi kuadro të afta, profesionale dhe kompetente. Nevojave të kërkesave të tregut të punës mund t'i përgjigjet vetëm një sistem i arsimit adekuat e bashkëkohor. Ky punim do të shpjegojë lidhjen që ka sistemi i arsimit me tregun e punës, me theks të veçantë do të diskutohet roli i arsimit në përbushjen e nevojave të tregut të punës, sidomos nga perspektiva e Kosovës. Sa i përbush arsimi i Kosovës nevojat e tregut të punës jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë? Cilat janë sferat në të cilat ka nevojë për avancim arsimi i Kosovës në mënyrë që t'i ofrojë tregut të punës kuadro të përgatitura? Përgjigjet në këto pyetje do të jepen duke bërë një krahasim të praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës.

Fjalët çelës: Arsimi, tregu i punës, Kosova, zhvillimi ekonomik, kapitali human.

Hyrje

Arsimi konsiderohet si një prej fushave kyçe që ndikon direkt në zhvillimin ekonomik të një vendi, sepse falë një arsimimi të duhur përgatitet kapitali human për të plotësuar nevojat e tregut të punës. Kur jemi te kapitali human, sipas Barro-s (2001), këtë element e përbëjnë shëndetësia, arsimi dhe aspektet tjera sociale. Tutje Barro (2001) sqaron se kapitali human (njerëzor) është përshkruar si determinues i rritjes ekonomike vetëm për faktin që në vete përfshinë elementin shumë me rëndësi siç është arsimi. Rëndësinë e kapitalit human e potencon edhe Ozturk (2001), duke thënë se asnjë vend nuk mund të ketë rritje të qëndrueshme ekonomike pa investime të vazhdueshme në kapitalin human. Ngjashëm me vështrimet e Barro-s

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
drita.koxheli@uni-pr.edu

(2001) dhe Ozturk-ut (2001) hasim shumë në literaturë. Autorë të shumtë që kanë studiuar kapitalin human e lidhin atë ngushtë me arsimin dhe zhvillimin ekonomik. Teles dhe Andrade (2008) potencojnë se është pikërisht investimi në kapitalin human pika që bën diferencën në rritjen ekonomike mes vendeve. Li dhe Liang (2010) në punimin e tyre përmendin ndikimin e madh të arsimit si pjesë qenësore e kapitalit human në zhvillim e hovshëm ekonomik të Azisë Lindore, ndërsa Azam e Ahmed (2015) rikonfirmojnë rolin e pazëvendësueshëm të zhvillimit të kapitalit human në rritjen ekonomike. Nga sa u tha më lart, mund të themi që në këtë kohë, kur procesi i globalizimit ka marrë hov të madh, imponohet kërkesa që në tregun e punës të kemi kuadro të afta, profesionale dhe kompetente dhe se nevojave të kërkesave të tregut të punës mund t'i përgjigjet vetëm një sistem i arsimit adekuat e bashkëkohor. Ky punim do të shtjellojë lidhjen që ka sistemi i arsimit me tregun e punës, me theks të veçantë do të diskutohet roli i arsimit në përmbushjen e nevojave të tregut të punës, sidomos nga perspektiva e Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ballkani Perëndimor gjatë viteve të 90-ta është përballë me konflikte të shumta që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në pothuajse të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe sistemin e arsimit. Pasojat e dëmeve në arsim i kanë përcjellë vendet e Ballkanit Perëndimor edhe pas konflikteve, gjë që ka pamundësuar që kjo fushë t'i shërbejë sa më mirë zhvillimit të vendit.

Kur flasim për Kosovën, arsimit në këtë vend gjatë tre dekadave të fundit është përballë gjithashtu me shumë sfida. Periudha e arsimit paralel e viteve të 90-ta, periudha e pasluftës nën administrimin e UNMIK-ut dhe periudha pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës paraqesin tri etapa që kanë kërkuar shumë reforma e transformime. Sa kanë arritur që këto reforma e transformime në arsim t'i plotësojnë nevojat e tregut të punës në Kosovë? Cilat janë sferat në të cilat ka nevojë për avancim arsimi i Kosovës në mënyrë që t'i ofrojë tregut të punës kuadro të përgatitura? Si qëndron arsimi i Kosovës në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor kur kemi të bëjmë me plotësimin e nevojave të tregut të punës? Raportet dhe publikimet në lidhje me këtë çështje tregojnë se sistemi i arsimit në Kosovë dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor kanë nevojë të ndërmarrin hapa e reforma të reja me qëllim të përgatitjes së kuadrove sa më profesionale për plotësimin e nevojave të tregut të punës. Punimi është i organizuar si në vijim: Pas pjesës së hyrjes do të prezantohet rishikimi i literaturës, pas

rishikimit të literaturës do të diskutohet periudha e arsimit në Kosovë prej viteve të 90-ta deri në shpalljen e Pavarësisë, më pastaj do të diskutohet periudha e arsimit pas Pavarësisë me fokus në objektivat për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe në fund do të jepen përfundimet.

Rishikimi i literaturës

Siç u potencua më lart, roli i arsimit në përmbushjen e nevojave të tregut të punës është temë gjithmonë aktuale dhe mjaft atraktive për studiuesit në botë. U tha më lart se Barro (2001) arsimin e sheh si element qenësor në kapitalin human për faktin që kapitali human është determinues i rritjes ekonomike. Furia et.al (2010) potencojnë se arsimi dhe aftësitë profesionale të fituara gjatë jetës janë padyshim faktorët kyç në arritjet e rezultateve të kënaqshme të krijimit të një tregu të punës të përshtatshëm për zhvillim ekonomik. Sipas Hanushek dhe Woessmann (2010) ekzistojnë tre mekanizma që e bëjnë arsimin një faktor determinues në zhvillimin ekonomik dhe njëri prej tyre është “zhvillimi i kapitalit human”. Autorët e sipërpërmendur potencojnë se zhvillimi i kapitalit human rrit tregun e punës e njëkohësisht rrit edhe produktivitetin e fuqisë punëtore. Por çështja qëndron në atë se cilat dimensionë të arsimit ndikojnë direkt në zhvillimin e kapitalit human? Autorët që kanë studiuar lidhjen mes arsimit dhe tregut të punës kanë vënë në pah nivelin e arsimit (Khorasgani, 2008), kualitetin e arsimit (Hanushek dhe Woessmann 2010) dhe sistemin arsimor (Furia et.al ,2010) si elemente që bëjnë diferencën. Kur flitet për arsimin dhe tregun e punës, një rëndësi në literaturë i jepet edhe “mospërputhjes”. “Mospërputhja” paraqet rastin kur tregu i punës dhe individët marrin “sinjale” të gabuara në lidhje me nevojën për punë/punësim (Furia et.al, 2010). Sipas Furia et.al (2010) mospërputhja krijon tri situata të ndryshme në tregun e punës:

- mbikualifikimin,
- nënkualifikimin,
- migrimin.

Pjesa e “mospërputhjes” në arsimin dhe tregun e punës është temë mjaft e gjerë, e cila do të shtjellohet në punime tjera, kurse në këtë punim do të përmendet vetëm si faktor me rëndësi në lidhjen në

mes arsimit dhe tregut të punës, ndërsa elementet tjera të sipërpërmendura do të shtjellohen më në detaje.

Khorasgani (2008) ka studiuar rolin e arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik të Iranit për vitet 1959-2000. Autori përmend arsimin e lartë si një shtyllë tejet të rëndësishme të zhvillimit të vendit, pasi që përgatit gjeneratat e reja të përballen me sfidat e një zhvillimi të qëndrueshëm. Khorasgani (2008) ka përdorur modelin e Lin (2004), një funksion prodhimi si funksion i punës, kapitalit fizik dhe kapitalit njerëzor. Autori i sipërpërmendur pas testimave ka përfunduar që arsimi i lartë në përgjithësi ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik në Iran për vitet 1959-2005. Nga qasja që i është bërë temës nga autori dhe përfundimet që ka dhënë autori, mund të konkludohet se në Iran arsimi i lartë përmbush kërkesat e tregut të punës. Nga punimi gjithashtu mund të shohim se autori i jep një rëndësi nivelit të arsimit. Khorasgani (2008) potencon se njëra prej arsyeve që ka bërë lidhjen e arsimit të lartë me zhvillimin ekonomik është se pikërisht arsimi i lartë përgatit kapitalin human për plotësimin e nevojave të tregut të punës.

Hanushek dhe Woessmann (2010) i japin një rëndësi qenësore kualitetit të arsimit. Si pikënisje e studimit të tyre është fakti që një vit shkollor nuk prodhon rezultate të njëjta në secilin vend. Autorët potencojnë se në këto rezultate ndikon shumë edhe shëndeti, rrethi, familja dhe mësimdhënësit. Për më tepër Hanushek dhe Woessmann (2010) argumentojnë se elementet e kualitetit të arsimit të përmendura nuk duhet injoruar, sepse pa këto elemente nuk mund të ketë një pasqyrë të vërtetë të lidhjes mes arsimit dhe zhvillimit ekonomik. Këta autorë theksojnë se zhvillimi ekonomik varet direkt nga aftësitë e punëtorëve dhe se “ajo çka dijnë njerëzit ka një rëndësi të madhe”. Autorët Hanushek e Woessmann (2010) kanë përfunduar, se kualiteti i arsimit ka fuqizuar efektet e zhvillimit ekonomik.

Furia et.al (2010) shtjellon sistemin e arsimit si një faktor me shumë rëndësi në zhvillimin ekonomik dhe plotësimin e nevojave të tregut të punës. Siç edhe është cekur më lart, autorët i japin një rëndësi edhe pjesës së trajnimeve si parakusht për një treg të mirë të punës. Studimi i Furia et.al (2010) sjell në fokus lidhjen midis sistemit arsimor dhe tregut të punës në 27 vendet e Bashkimit Evropian. Pas testeve të bëra, autorët kanë përfunduar se në Bashkimin Evropian ekziston një mospërputhje ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës. Sipas Furia et.al (2010), vendet që aplikojnë standarde më të larta të arsimit kanë edhe mundësi më të mëdha punësimi. Autorët në

fund sugjerojnë se vendet e Bashkimit Evropian për të plotësuar kërkesat e tregut të punës duhet të zbatojnë sistemin arsimor të ngjashëm me Finlandën, Holandën dhe Republikën Çeke.

Nëse shikojmë literaturën lidhur me arsimin dhe tregun e punës për vendet e Ballkanit Perëndimor, del se shumë autorë dhe institucione të këtyre vendeve dhe të Bashkimit Evropian kanë pasur interesim të madh për të. Shumë punime shkencore, raporte e përmbledhje të ndryshme kanë vënë në pah rëndësinë e zhvillimit të arsimit si faktor kyç në plotësimin e nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik.

Uvalic e Cvijanovic (2018) në punimin e tyre potencojnë se në vitet e 90-ta, vendet e Ballkanit Perëndimor janë përballur me shkurtime të mëdha në shpenzimet e qeverisë, që më së shumti kanë atakuar sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Më tej, këta autorë potencojnë se ky trend i mosinvestimit të madh në arsim ka vazhduar edhe pas viteve të 90-ta, duke bërë që këto vende të mos jenë në gjendje të përcjellin trendet e Evropës dhe shteteve të zhvilluara në fushën e arsimit dhe inovacionit. Uvalic e Cvijanovic (2018) kanë vënë në pah rëndësinë e investimeve në kapitalin human dhe kanë argumentuar se vendet e Ballkanit Perëndimor (Kroacia është përjashtuar) domosdoshmërisht duhet të kenë prioritet investimet në kapitalin human. Si përfundim këta autorë u rekomandojnë qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor që të hartojnë “politika më eficiente industriale”, të cilat do të ndikojnë direkt në zhvillimin ekonomik të vendeve të tyre. Si fushë me shumë prioritet, e cekur në punim, është edhe arsimi për shkak të rëndësisë që ka në krijimin e vendeve të punës.

Bartlett et.al (2016) nën mbështetjen e Komisionit Evropian kanë paraqitur një raport të detajuar të nevojave të tregut të punës në Ballkanin Perëndimor dhe ndikimin e arsimit të lartë në punësim. Autorët në fjalë potencojnë se në Ballkanin Perëndimor është shumë më lehtë të gjesh një punë me diplomë universitare se sa pa të, edhe nëse je i mbikualifikuar për pozitën e caktuar. Gjithashtu ceket se në vendet e Ballkanit Perëndimor shumë të diplomuar e kanë të pasigurt futjen në tregun e punës e edhe kur punësohen kalojnë një rrugë të gjatë derisa ta gjejnë një punëdhënës stabil. Në anën tjetër, raporti hedh në pah pakënaqësitë edhe të punëdhënësve me të punësuarit. Sipas deklaratave të punëdhënësve të prezantuara në këtë raport, theksohet se punëtorët e sapodiplomuar nuk janë të përgatitur mjaftueshëm për vendin e punës. Në raport ceket se vetëm gjysma e punëdhënësve mendojnë se punëtorët e diplomuar i sjellin më shumë

vlera kompanisë se punëtorët pa diplomë. Për ta përfunduar, Bartlett et.al (2016) theksojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë reforma të thella në sistemin e arsimit të lartë në mënyrë që të zhvillojnë kapitalin human, ta përgatisin atë për tregun e punës që të ketë zhvillim ekonomik më të madh. Këto reforma, sipas autorëve në fjalë, përfshijnë përmisimin e programeve të studimit, të mos ketë lehtësira për regjistrim në univerisitete, të zhvillohen programet e praktikës në mënyrë që studentët të kenë edhe njohuri praktike krahas asaj teorike etj. Bartlett et.al (2016) inkurajojnë një bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve arsimore dhe bizneseve në mënyrë që të ketë harmonizim të kërkesave në tregun e punës.

Pjesa e rishikimit të literaturës solli në pah dimensionet kyçe të arsimit të cilat ndikojnë në përmbushjen e nevojave të tregut të punës. Këto dimensione (niveli i arsimit, kualiteti i arsimit dhe sistemi i arsimit) janë të studiuar në detaje dhe janë pikërisht reformat në këto dimensione që bëjnë plotësimin e nevojave të tregut të punës në një vend. Pamë që këto reforma në këto dimensione janë rekomanduar edhe nga raportet për vendet e Ballkanit Perëndimor si të domosdoshme për një sistem efikas të arsimit. Më vonë te pjesa kur do të shqyrtohet arsimi në Kosovë, do të shohim që pjesë e strategjisë së arsimit në Kosovë dhe pjesë e reformave janë pikërisht edhe dimensionet e lartëpërmendura.

Arsimi në Kosovë prej viteve të 90-ta deri në shpalljen e Pavarësisë

Situata e tensionuar në Kosovë e fundviteve të 80-ta dhe e fillimviteve të 90-ta e gjeti Kosovën me shkolla të mbyllura. Mësimdhënësit ishin larguar nga puna dhe nxënësve e studentëve iu kishte mohuar e drejta për shkollim. Në atë kohë shqiptarët në Kosovë organizuan një lëvizje masive, duke krijuar sistemin paralel të arsimit i cili në disa vende mbahej në objektet ekzistuese shkollore, diku nëpër shtëpi, por edhe nëpër bodrume (Kuhn & Dragidella 2007). Financimi i arsimit në ato vite u bë nga kontributet e dhëna nga populli në formë tatimesh si dhe nga mërgata shqiptare (Kuhn & Dragidella 2007). Siç e potencojnë Kuhn dhe Dragidella (2007), arsimi i viteve të 90-ta ishte nevojë për mbijetesë e sistemit arsimor, e jo zhvillim i tij. Gjatë tërë kësaj periudhe mësimdhënësit nga Kosova nuk kanë mundur të zhvillohen profesionalisht aq sa duhet, nuk ka pasur trajnime e as zhvillime e reforma të duhura (Kuhn & Dragidella 2007). Roli më i madh i sistemit paralel të arsimit në Kosovë ishte

vetëdijësimi i popullit për rëndësinë e arsimit (Kuhn & Dragidella 2007). Pas luftës së vitit 1999, UNMIK dhe organizatat tjera ndërkombëtare nuk kanë pasur nevojë të promovojnë rëndësinë e arsimit, prioritet për ta ka qenë ndërtimi i infrastrukturës së arsimit të shkatërruar nga konflikti (Kuhn & Dragidella 2007).

Përkundër faktit që ky organizim i viteve të 90-ta ka një rëndësi të madhe, sepse ruajti arsimin shqip, nuk ndërpreu procesin e mësimi dhe vetëdijësoi popullatën për rëndësinë e arsimit, problemet në aspektin profesional ishin evidente. Pavarësisht problemeve të kësaj periudhe, arsimi në Kosovë për një periudhë jo shumë të gjatë ka kaluar nga një fazë emergjente pas luftës në një fazë zhvillimi (UNICEF, 2004). Në zhvillimin e arsimit kanë ndikuar shumë investime, transformime e strategji të përpiluara. Si strategji të para të përpiluara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ishin “Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015” dhe “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë (2007-2017)” (MASHT, 2015). Këto strategji paraqesin hapat e parë të institucioneve të atëhershme të Kosovës për të bërë reforma në sistemin arsimor. E përbashkët për këto dy strategji është se të dyja strategjitë, nëpërmjet objektivave të caktuara, synonin të zhvillonin arsimin në funksion të zhvillimit të qëndrueshem kulturor, shoqëror dhe ekonomik (MASHT, 2015). Fakti që MASHT në atë periudhë punoi me dy strategji të ndara në bazë të nivelit të arsimit (parauniversitar dhe universitar), tregon që ekspertët e asaj kohe, të cilët kanë kontribuar në përpilimin e strategjive, e kanë parë nivelin e arsimit si faktor determinues në zhvillimin ekonomik të vendit.

Arsimi në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë

Me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, rruga e nisur e reformave vetëm sa ka vazhduar edhe më tej (Konxheli & Kadriu, 2018). Edhe në sektorin e arsimit kjo rrugë ka vazhduar duke sjellur strategji dhe projekte të reja të financuara nga institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare. Strategjitë, reformat e transformimet që ndërmerreshin tashmë kishin realizimin e qëllimeve më bazike të sistemit të arsimit “përmbushjen e nevojave të tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik”. Njëri prej projekteve më të mëdha, me qëllim lidhjen e arsimit me tregun e punës për përmisimin e kushteve për punësim dhe zhvillimin ekonomik është projekti “Harmonizimi i arsimit me kërkesat e tregut të punës (Kosovë)”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia

Austriake për Zhvillim me bashkëfinancim të MASHT (MASHT,2015). Ky projekt u nënshkrua në vitin 2015 dhe fokusi i tij bazohej në promovimin e politikave që nxisin studentët të orientohen në fusha të rëndësishme dhe strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës si bujqësia, inxhinieria dhe mjekësia (MASHT,2015). MASHT në periudhën e dhjetëvjeçarit të fundit ka prezantuar dy plane strategjike të arsimit në Kosovë (PSAK): PSAK 2011-2016 dhe PSAK 2017-2021 (MASHT, 2015 & 2017). Të dyja këto strategji si një prej objektivave kryesore kanë krijimin e kushteve për zhvillimin e arsimit në atë formë që arsimit të përmbushë nevojat e tregut të punës (PSAK 2011-2016 & PSAK 2017-2021). Si një prej sfidave kryesore të arsimit të lartë, e potencuar në PSAK (2017-2021), është “shpërputhja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës”. Kjo sfidë në këtë strategji është paraparë të tejkalohet duke realizuar një studim për ndërlidhjen e programeve të arsimit të lartë me tregun e punës. Ky studim në PSAK (2017-2021) përmendet se duhet të jetë bazë për planin dhe profilizimin e universiteteve publike në Kosovë. Tjetër mundësi për tejkalimin e sfidës së sipërpërmendur sipas PSAK (2017-2021) është edhe bashkëpunimi me biznese, krijimin e një sistemi për analizë të tregut të punës etj.

Për sfidën e përmbushjes së nevojave të tregut të punës nga arsimit në Kosovë ka bërë studim edhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK). Në vitin 2017 OEK ka publikuar raportin “Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar – sfidë për bizneset”, ku sjell në pah mungesën e stafit të kualifikuar për bizneset kosovare. Në pyetjen “Sa është e vështirë të gjeni punëtorë të kualifikuar?”, del se bizneset kosovare kanë vështirësi të shumta në gjetjen e stafit.



Figura 1. Rezultatet e anketës të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës

Burimi: Oda Ekonomike e Kosovës (2017) – “Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar – sfida për bizneset”

Kjo gjetje është shqetësuese, por jo edhe e papritur marrë parasysh raportet edhe të institucioneve brenda dhe jashtë vendit jo vetëm për Kosovën, por edhe për shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Ky raport rikonfirmon edhe një herë nevojën për reforma më të thella në sistemin e arsimit në Kosovë. Është pozitiv fakti që OEK dhe MASHT ndajnë të njëjtat rekomandime për çështjen e rolit të arsimit në tregun e punës. Këto rekomandime vetëm se janë pjesë e PSAK (2017-2021).

Arsimi në Kosovë ka pësuar shumë për shkak të situatës së viteve të 90-ta, mirëpo edhe ka bërë hapa konkret që t’i ofrojë kuadro sa më profesionale tregut të punës në Kosovë. Kosova ka strategji konkrete për të realizuar këtë qëllim dhe aplikimi në disa fusha veçse ka filluar.

Përfundim

Ky punim shtjelloi rolin e arsimit në tregun e punës nga perspektiva e shtetit të Kosovës, duke bërë krahasime edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor. Sistemi i arsimit në vendet e Ballkanit Perëndimor ka kaluar shumë transformime vitet e fundit, sidomos pas viteve të 90-ta. Kur flasim për arsimin në Kosovë është më se evidente se tre dekadat e fundit kanë qenë periudha mjaft sfiduese, duke filluar nga aktiviteti paralel për ekzistencë e deri te transformimet dhe reformat e mëdha në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës me kuadro profesionale. Nga hulumtimet që ka bërë MASHT, OEK dhe organizatat tjera vendore dhe të huaja del se në Kosovë sistemi i arsimit ka nevojë për reforma shtesë në mënyrë që tregut të punës t’i ofrojë kuadro sa më profesionale. Përfundime të ngjashme jepen edhe për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë pjesë nuk mund të thuhet se Kosova qëndron më mirë apo më keq se vendet fqinje, pasi që të gjitha pa përjashtim kanë filluar reformat dhe kanë nevojë për reforma më të thella që të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Në fund ky punim edhe njëherë, ngjashëm me PSAK (2017-2021), raportin e OEK (2017) dhe Bartlett et.al (2016) rithekson se çelës për një zhvillim të arsimit në shërbim të tregut të punës është bashkëpunimi biznese - institucione të arsimit. Kosova dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë shumë në këtë drejtim që të kenë një sistem arsimor në shërbim të tregut të punës.

EDUCATION AND LABOR MARKET - KOSOVO'S PERSPECTIVE

Drita KONXHELI

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
drita.koxheli@uni-pr.edu

Abstract

Education is considered as one of the key areas that directly affect the economic development of a country, as an adequate education system prepares the human capital that meets the needs of the labor market. As of now, when the process of globalization has taken a big leap forward, there is a requirement to have skilled, competent staff in the labor market. The needs of the labor market can only be answered by an adequate and contemporary education system. This paper will elaborate on the relationship between the education system and the labor market, with particular emphasis on the role of education in fulfilling the needs of the labor market, especially from the perspective of Kosovo. How much does Kosovo's education meet the labor market needs, not only in Kosovo, but also beyond? What are the areas in which Kosovo's education system needs to be improved in order to provide skilled employees to the labor market? Answers to these questions will be given by comparing the practices of Balkan countries and Kosovo.

Keywords: Education, labor market, Kosovo, economic development, human capital.

Referencat

1. Azam,M & Ahmed, A.M. (2015). Role of human capital and foreign direct investment in promoting economic growth Evidence from Commonwealth of Independent States. *International Journal of Social Economics*. 42 (2), 98-111.
2. Bartlett,W, Uvalic,M, Durazzi,N, Monastiriotis,V, Sene,T (2016). *From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Western Balkans Synthesis Report*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
3. Barro, R. (2001). Education and Economic Growth. *OECD - Helliwell JF The Contribution of Human and Social Capital to Sustained Economic Growth and Well-Being*. 1-48.
4. Furia,D, Castagna,A, Mattoscio,N & Scamuffa, D. (2010). Education and labour market in the age of globalisation: some evidence for EU-27. *Procedia Social and Behavioral Sciences*. 9, 1140–1444
5. Hanushek, E.A & Woessman,L. (2010). Education and Economic Growth. *International Encyclopedia of Education*. 2, 245-252
6. Khorasgani, M.F. (2008). Higher education development and economic growth in Iran. *Education, Business and Society: Contemporary Middle Eastern Issues*. 1 (3), 1753-7983.
7. Konxheli, D & Kadriu,K (2018), Integrimi i tregut të energjisë së Kosovës me rajonin dhe Evropën. *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Tryezë Shkencore “Rruga e Kosovës drejt integritetit ekonomik evropian”*. 49-62.
http://www.ashak.org/repository/docs/Libri_Rruga_e_Kosoves_d_rejt_integritetit_ekonomik_evropian_SSHSH_908685.pdf
8. Li, H & Liang, H. (2010). Health, education, and economic growth in East Asia. *Journal of Chinese Economic and Foreign Trade Studies*. 3 (2), 110-131.
9. MASHT. (2015). *Lansohet projekti “Harmonizimi i arsimit me kërkesat e tregut të punës (Kosovë)”*. <https://masht.rks-gov.net/article/lansohet-projekti-harmonizimi-i-arsimit-me-kerkesat-e-tregut-te-punes-kosove>.
10. MASHT. (2015). *Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2011-2016)*. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/psak-2011-2016.pdf>.

11. MASHT. (2015). *Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015*.
<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ministria-e-arsimit-strategjia-e-al-fund.pdf>.
12. MASHT. (2015). *Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017*. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/strategjia-per-zhvillimin-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove.pdf>.
13. MASHT. (2015). *Strategjitë*. <https://masht.rks-gov.net/strategjite>.
14. MASHT. (2017). *Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2017-2021)*. https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf.
15. Oda Ekonomike e Kosovës. (2017). *Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar - sfidë për biznese*.
https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/January/26/Mungesa_e_fuqise_punetore_te_kualifikuar_-_sfide_per_bizneset1516952028.pdf
16. Ozturk, I. (2001). The role of education in economic development: A theoretical perspective. *Journal of Rural Development and Administration*. XXXIII (1), 39-47.
17. Teles, V.K & Andrade, J. (2008). Public investment in basic education and economic growth. *Journal of Economic Studies*. 35 (4), 392-364.
18. UNICEF. (2004). *Situtational Analysis of Education in Kosovo*. https://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo_media_publication00604.pdf.
19. Uvalic, M & Cvijanovic, V. (2018). *Towards A Sustainable Economic Growth and Development in the Western Balkans*.
http://www.fes-croatia.org/fileadmin/user_upload/180411_Economic_Growth_WEB.pdf.
20. Wolfgang Horner, Hans Dobert, Botho von Kopp, Wolfgang Mitter (editorë). (2007). *The Education Systems of Europe*. Springer Netherlands. (Pjesa e autorëve Kuhn & Dragidella) fq. 408-417.

Bibliografia

1. Aligning Education with Labour Market Needs - <http://www.alledkosovo.com/>
2. MASHT. (2015). Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2011-2016). <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/psak-2011-2016.pdf>.
3. MASHT. (2015). Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë (2005-2015). <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ministria-e-arsimit-strategjia-e-al-fund.pdf>.
4. MASHT. (2015). Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë (2007-2017). <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/strategjia-per-zhvillimin-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove.pdf>.
5. MASHT. (2015). Strategjitë. <https://masht.rks-gov.net/strategjite>.
6. MASHT. (2017). Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2017-2021). https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf
7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - <https://masht.rks-gov.net/>
8. Sommers, M & Buckland, P (2004). *Parallel Words, Rebuilding the education system in Kosovo*. Paris: UNESCO - International Institute for Educational Planning. 1-176.

POLITIKAT E TREGUT TË PUNËS DHE NDIKIMI I TYRE NË PUNËSIM - RASTI I MAQEDONISË

Rasim ZUFERI¹
Selajdin ABDUL²

Abstrakt

Punësimi, përkatësisht papunësia është një nga çështjet kryesore apo problemet me të cilat ballafaqohet shumica e vendeve, pavarësisht nëse janë të zhvilluara ose në zhvillim. Në shumë raste çështja e papunësisë mund t'i detyrojë njerëzit të emigrojnë brenda një vendi, por edhe në vende të tjera.

Republika e Maqedonisë bie në këtë kategori gjithashtu dhe është vendi që nga pavarësia ka pasur probleme të mëdha me punësimin, përkatësisht papunësinë. Në periudha të ndryshme kohore shkalla e papunësisë ka arritur nivelin prej 35% ose më shumë, me luhatje gjatë periudhës së mëvonshme që ishte rreth 30%. Çdo qeveri ka pasur vështirësi në trajtimin e kësaj çështjeje dhe nuk ka gjetur zgjidhje të përshtatshme për të. Por kohët e fundit po dëshmojmë një rënie të shkallës së papunësisë në Republikën e Maqedonisë, ku me përfundim të vitit 2017 norma e papunësisë arriti në 22.4%. Gjatë kësaj periudhe qeveria ka ndërmarrë një sërë reformash për të stimuluar punësimin, të cilat ishin kryesisht përmes politikave aktive për nxitjen e punësimit.

Në shikim të parë nëse përqendrohemi vetëm në shkallën e papunësisë, ne shohim se politikat aktive për nxitjen e punësimit që ka ndërmarrë qeveria kanë dhënë rezultate, por për të parë efektet reale dhe koston duhet analizuar shkallën e punësimit, efektivitetin e fondit të dedikuar për këto politika. Ne gjithashtu do të përqendrohemi në shkallën e punësimit dhe papunësisë të të rinjtë të cilat kanë më shumë gjasa të largohen nga vendi.

Fjalët çelës: *Punësimi, papunësia, politikat aktive.*

¹ Fakulteti i Biznesit dhe i Ekonomisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni. r.zuferi@seeu.edu.mk

² Fakulteti i Biznesit dhe i Ekonomisë, Universiteti i Evropës Juglindore. Tetovë, Maqedoni. s.abduli@seeu.edu.mk

Hyrje

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë, si rezultat i periudhës së gjatë të tranzicionit, iu nënshtrua ndryshimeve të mëdha strukturore dhe transformimeve të ndryshme. Këto ndryshime kanë çuar në rritje të madhe të numrit të të papunëve në Maqedoni, si dhe një shkallë shumë të ulët të punësimit në krahasim me vendet evropiane. Gjatë kësaj periudhe Republika e Maqedonisë u përball me shkallë të lartë të papunësisë, e cila arriti kulmin në vitin 2004, ku norma e papunësisë arriti një nivel alarmant prej 36.8% (Radvansky, Stefanik, Lichner, Weyerstrass, Domonkos dhe Haluska, 2013). Edhe pse vitet e fundit po shohim një rënie të shkallës së papunësisë, e cila është në një nivel më të pranueshëm prej 22.4% (në vitin 2017), ky është ende një nivel të lartë. Në vitet e fundit qeveria e Republikës së Maqedonisë ka ndërmarrë një sërë politikash dhe masash aktive dhe pasive të tregut të punës për të trajtuar shkallën e papunësisë.

Qëllimi i studimit është të analizojë politikat aktive dhe pasive, si dhe aktivitetet e punësimit në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë.


Pjesa tjetër e punimit është e organizuar si më poshtë: pjesa e dytë analizon tregun punës në Maqedoni që nga pavarësia e saj deri më sot; seksioni tre analizon politikat e tregut të punës në Maqedoni gjatë kësaj periudhe dhe seksioni katër jep konkluzione dhe rekomandime.

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë nga pavarësia e deri më sot

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë që nga pavarësia nuk ka qenë i balancuar dhe jo aq i rregulluar. Në këtë drejtim një nga faktorët ishte mungesa e përshtatjes së duhur ndaj sistemit të lirë të tregut ekonomik. Që nga fillimi vendi është përballur me shkallë të lartë të papunësisë, e cila në vitet e para të pavarësisë, në vitin 1991, ishte në nivelin 24.5% dhe vazhdoi të rritet në periudhën e ardhshme, e cila u karakterizua nga privatizimi i shumë ndërmarrjeve publik dhe çoi në një rritje të shkallës së papunësisë, duke arritur në 38% në vitin 1996. Pas kësaj pasoi një periudhë stabilizimi dhe një normë e cila shënonte rënieje e që arriti në 30-32% gjatë viteve 1997-2002. Që nga viti 2004 ka pasur një normë rritjeje papunësie që arrin një normë maksimale në

vitin 2005 prej 37.3%, pas së cilës kemi parë prirje rënëse nga viti në vit, duke arritur në nivelin 22.4% në përfundim të vitit 2017.

Figura 1. Norma e papunësisë në Maqedoni gjatë viteve 1991-2017




Burimi: Banka Popullore e Maqedonisë, Banka Botërore dhe Enti i Statistikave

Kjo përqindje e papunësisë në Republikën e Maqedonisë jo vetëm që trajtohet nga faktori i tranzicionit, por edhe vendi ka një shkallë relativisht të lartë të papunësisë nga pavarësia prej Jugosllavisë, ku në vitin 1991 vendi kishte një shkallë papunësie prej 22.1%. Por përveç shkallës së lartë të papunësisë, faktorë të tjerë si procesi i rishtrukturimit të ekonomisë së vendit pas pavarësisë, procesi i privatizimit të keqmenaxhuar dhe të ashtuquajturat masat makroekonomike të politikëbërësve në atë kohë ndikuan në këtë shkallë të lartë të papunësisë dhe në vazhdimin e kësaj norme edhe sot (Ананасовска-Новески & Трпески, 2016).

Por si qëndron puna me çështje të tjera që kanë të bëjnë me këtë aspekt, si p.sh. pjesëmarrja në tregun e punës të popullsisë, shkalla e punësimit dhe të ngjashmit? Kjo dëshmohej më së miri nga raportet vjetore të Entit Statistikor, i cili nga viti 2007 e tutje organizon çdo vit Anketat e forcave të punës. Prandaj ne do të përqendrohemi në analizën statistikore të këtyre parametrevë që lidhen direkt me tregun e punës.

Figura 2. Indikatorët e tregut të punës në Republikën e Maqedonisë



Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017

Figura 2 paraqet një pasqyrë të qartë të disa prej treguesve më të rëndësishëm të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2017. Nga ajo vihet re se shkalla popullore aktive ka qenë pothuajse lineare dhe me pak ndryshim gjatë periudhës së analizuar. Nëse në vitin 2007 shkalla e popullatës aktive ishte 55.7%, në vitin 2017 është në nivelin e 56.8%. Një trend pozitiv vërehet në shkallën e punësimit, i cili është rritur gjatë periudhës dhe në total është rritur me 6.9 për qind. Shkalla e punësimit në vitin 2007 ishte vetëm 36.2%, ndërsa në vitin 2017 arriti në 43.1%. Siç është shpjeguar më sipër, ka një tendencë pozitive edhe në shkallën e papunësisë, e cila ka rënë në periudhën e analizuar dhe kjo rënie është mbi 10 pikë për ind.

Nëse ndalemi të analizojmë punësimin, papunësinë dhe joaktivitetin te popullata në Maqedoni, arrijmë në konkluzë interesante. Tabela 1 ofron të dhëna të detajuara për periudhën 2007-2017, nga kur është filluar të bëhet “Anketa e fuqisë punëtore në Republikën e Maqedonisë”. Shikuar në aspekt të punësimit, në total do të vërejmë se për periudhën e analizuar kemi një rritje prej afër 25.4% (nga 590 mijë në 740 mijë). Kur shikohet më në detaje lidhur me nivelin e shkollimit, do të vërejmë ulje të punësimit në kategoritë pa shkollim dhe pa shkollë fillore të mbaruar. Me shkollë fillore të mbaruar norma e punësimit ka qenë deridiku e përafërt, por kemi ulje në kategorinë shkollë e mesme trevjeçare, ku si rëndom bëjnë pjesë

shkollat profesionale. Rritje më e heksuar e punësimit shënohet në kategorinë e personave me shkollë të mesme katërvjeçare, kur për periudhën në fjalë kemi rritje të punësimit për 39.8%. Po ashtu rritje e theksuar e punësimit shënohet edhe te personat me shkollim universitar të kryer, ku kemi rritje prej 94.8%, pra gati dyfishim. Në këtë drejtim rol të madh ka luajtur masivimi i shkollimit universitar në R.M. gjatë kësaj periudhe.

Në anën e papunësisë vërehet se kemi ulje të papunësisë përgjatë periudhës së analizuar, ku shënohet ulje e papunësisë 32.6%. Aty vërehet se gati të gjitha kategoritë kemi ulje të numri të personave të papunë, diku me përqindje më të lartë e diku më të ulët, përveç se në kategorinë shkollim universitar. Te kjo kategori kemi rritje të papunësisë për periudhën e analizuar. Nëse në vitin 2007 kishte vetëm 23.550 persona të papunë me studime universitare të kryera, në vitin 2017 kjo shifër ka arritur në 42.193 persona, që tregon një rritje prej 79.1% dhe kjo është një rritje e lartë. Përsëri, arsyet në këtë drejtim mund të gjenden te hapja e shumë universiteteve në vend, gjegjësisht disperzimi i universiteteve shtetërore, e që bëri të mundur rritjen e numrit të të diplomuarve pa mos pasur analizë për atë se sa i nevojshëm ishte ky disperzim dhe sa realisht ka nevojë tregu për profilet që do krijohen. Kjo me automatizëm ndikoi edhe në rritjen e papunësisë te kjo kategori.

E njëjta pasqyrë lart-poshtë shënohet te norma joaktive e popullatës. Në disa kategori (pa shkollim, shkollim fillor i pambaruar) shënohet rritje të pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës, por nga ana tjetër në kategorinë shkollim i mesëm 4-vjeçare dhe shkollimi universitar shënohet rënie në pjesëmarrje në tregun e punës, pra rritje të joaktivitetit të tyre. Ky është një tregues jo i mirë pasi që këto paraqesin kategorinë e popullatës që pritet të kontribuojë më shumë në rritjen e një vendi.

Tabela 1. Popullata e aftë për punë sipas aktivitetit ekonomik dhe shkollimit

	Pa shkollim	Shkollë fillore e pambaruar	Shkollë fillore	Shkollë e mesme trevjeçare	Shkollë e mesme katërvjeçare	Shkollë e lartë	Studime universitare	Gjithsej
Të punësuar								
2007	6,287	25,051	121,945	71,478	248,412	25,862	91,197	590,234
2008	4,014	26,243	136,100	74,991	256,349	24,630	86,688	609,015
2009	2,701	26,186	135,371	71,168	267,401	23,662	103,411	629,901
2010	3,764	24,490	130,115	74,959	267,477	24,656	112,395	637,855
2011	3,082	22,812	130,551	73,853	264,780	20,751	129,256	645,085
2012	3,044	21,088	120,579	72,661	276,297	19,903	136,982	650,554
2013	3,579	20,873	130,166	78,352	296,484	21,411	127,974	678,838
2014	2,800	17,470	140,296	63,043	313,005	19,471	134,103	690,188
2015	1,969	17,669	136,320	51,209	327,947	18,770	152,108	705,991
2016	3,266	14,076	121,990	65,097	329,168	16,853	173,099	723,550
2017	2,369	13,493	120,559	63,488	347,462	15,613	177,665	740,648
Të papunësuar								
2007	5,382	14,757	93,498	48,418	124,664	6,635	23,550	316,905
2008	4,572	14,172	97,650	41,500	122,206	6,233	24,077	310,409
2009	2,325	10,485	90,212	40,169	121,342	4,964	29,376	298,873
2010	3,074	10,366	87,193	39,458	122,212	5,163	32,973	300,439
2011	3,428	10,411	80,198	36,194	120,047	5,212	39,473	294,963
2012	2,844	10,287	74,581	35,727	123,686	3,763	41,614	292,502
2013	3,053	10,039	67,194	34,371	116,740	4,157	41,666	277,219
2014	3,347	8,455	64,277	25,836	122,388	4,117	40,389	268,809
2015	1,620	6,777	57,511	19,059	118,400	4,142	41,424	248,933
2016	1,974	4,177	50,907	19,549	102,851	2,497	43,092	225,049
2017	939	4,371	43,765	15,220	104,669	2,406	42,193	213,564
Joaktiv								
2007	44,782	122,113	301,801	40,719	175,780	14,039	22,262	721,496
2008	41,671	117,899	315,092	40,780	164,457	12,437	21,581	713,917
2009	33,377	111,665	314,075	43,497	170,514	14,665	22,301	710,094
2010	34,612	105,282	310,147	43,672	176,688	15,405	24,422	710,228
2011	30,609	99,515	309,477	46,050	184,769	14,906	30,840	716,166
2012	28,175	94,595	320,680	43,352	187,923	15,941	36,243	726,910
2013	25,268	86,250	315,444	52,547	186,702	17,441	32,751	716,403
2014	22,917	78,769	313,006	41,535	205,877	16,451	35,942	714,497
2015	30,451	72,055	318,190	33,080	215,738	18,242	34,030	721,735
2016	25,465	66,976	326,665	42,021	214,176	16,244	38,753	730,290
2017	22,037	62,917	317,246	44,043	224,940	16,411	38,131	725,723

Burimi: Anketa e fuqisë punëtore, Enti Shtetëror i Statistikave të R.M. (2007-2017)

Sipas të dhënave të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017, papunësia sipas profilit të personave me shkollim universtar tregon se më shumë të papunë janë juristët, ekonomistët, personat me studimet pedagogjike të kryera, profesorë të gjuhë shqipe dhe maqedone, punëtorë socialë të diplomuar, inxhinjerë të bujqësisë, maqinerisë e kështu me radhë.

Nga ata me shkollim të mesëm të kryer më shumë të papunë janë gjimnazistët, teknikë ekonomikë, teknikë maqinerie, teknikë bujqësorë, motër medicinale (teknikë medicinalë, teknikë konfeksioni, shitës, kuzhinjerë, kamarier e kështu me radhë.

Politikat e tregut të punës në Maqedoni

Vitet e fundit vërehet një interes më madh i qeverisë në nxitjen e punësimit nëpërmjet politikave aktive, pasive si dhe masave tjera në përgjithësi, ndërkohë që këto masa të ndërmara nga qeveria i dedikohen më së shumti të rinjve dhe kategorive tjera të rrezikuara. Nëpërmjet planeve operacionale, strategjive kombëtare të punësimit, planeve të veprimit qeveria është përpjekur të ndërhyjë në një segment që ka qenë në parametra shqetësues që nga pavarësia e Maqedonisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitet e fundit ka ndërmarrë disa hapa duke hartuar plane dhe strategji për të luftuar papunësinë, disa prej të cilave:

- Strategjia kombëtare e punësimit 2010,
- Strategjia kombëtare e punësimit 2015,
- Strategjia kombëtare e punësimit 2016-2020,
- Plani i veprimit për punësimin e të rinjve 2015,
- Plani i veprimit për punësimin e të rinjve 2016-2020,
- Planet operacionale për punësimin dhe masat dhe programet e tregut të punës.

Masat aktive dhe pasive të tregut të punës në R.M.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë gjatë kësaj peridhe ka zbatuar masa të ndryshme për trajtimin e papunësisë. Disa nga masat janë si më poshtë:

a) *Programet e vetëpunësimit.* - Qëllimi i programit të vetëpunësimit ishte zvogëlimi i papunësisë, duke financuar individët në fillimin e bizneseve personale dhe krijimin e vendeve të reja të

punës. Programi i vetëpunësimit është zbatuar përmes trajnimit të biznesit, përgatitjes së planeve të qëndrueshme të biznesit, ndihmës me çështjet administrative të regjistrimit të biznesit dhe mbështetjes financiare për fillimin e biznesit ose ndihmë biznesit ekzistues në shumën deri në 200.000 denarë (3.250 euro).

b) *Mbështetja financiare për personat juridikë* (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe zejtarët) për hapjen e vendeve të reja të punës. - Qëllimi i mbështetjes financiare për personat juridikë është zvogëlimi i papunësisë, hapja e vendeve të reja të punës dhe rritja e kërkesës për forcën e tregut të punës. Ofrimi i mbështetjes shtesë në formë të materialeve riprodhuese ose pajisjeve për hapjen e vendeve të reja të punës në vlerë prej 92.000,00 denarë ose (afër 1500 euro) për secilin vend të ri pune, por jo më shumë se pesë vende pune.

c) *Programi i subvencionimit të punësimit*. - Subvencionet për punësim ishin të synuara për personat e papunë të regjistruar, që e kanë të vështirë të përfshihen në tregun e punës dhe personat me aftësi të kufizuara. Sigurimi i mbështetjes financiare për punësimin e personave të papunë të cilët kanë vështirësi për t'u përfshirë në tregun e punës, me një shumë bruto prej 13.000 denarë për një periudhë gjashtëmujore ose 17.000 denarë për kategoritë e rrezikuara, me detyrimin që të mbahen në punë së paku 12 muaj, domethënë gjithsej 18 muaj.

ç) *Subvencionimi i punësimit të të rinjve deri në 29 vjet*. - Qëllimi i kësaj mase është të sigurojë kalimin më të shpejtë të të diplomuarve të rinj nga procesi i arsimit në punësim. Mbështetja u ofrohet personave të identifikuar si të papunë që kanë përfunduar arsimin e mesëm ose universitar deri në moshën 29 vjet për të arritur njohuri dhe aftësi praktike dhe për t'u bërë konkurrenues në tregun e punës.

d) *Programet e përgatitjes së punësimit*. - Qëllimi i këtij programi është të rrisë konkurrencën në tregun e punës, harmonizimin e ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore (sipas analizës së bërë për nevojat e aftësive të tregut të punës në RM), si dhe rritjen e punësimin e personave të identifikuar si të papunë.

Disa nga llojet e trajnimit që janë përfshirë në këto programe janë si në vijim:

- Trajnim në një punëdhënës të mirënjohur,
- Trajnim në një punëdhënës të njohur me subvencione,
- Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në treg,
- Trajnimi i aftësive IT dhe
- Internship si një përvojë pune fillestare drejt punësimit.

Korniza financiare e masave të tregut të punës

Me qëllim të realizimit të masave të parapara u ndanë fonde të veçanta nga buxheti qendror. Si bartës i këtyre proceseve ishte Agjencia për Punësim dhe pjesërisht Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Tabelat e mëposhtme paraqesin një pasqyrë të fondeve të alokuara nga buxheti qendror për të nxitur punësimin nëpërmjet Agjencisë së Punësimit dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, shumat e fondeve të alokuara nga buxheti i Agjencisë për Punësim paraqesin masat stimuluese për punësim për periudhën 2007-2017, mund të shohim se kemi një shpërndarje të ndryshme për këtë qëllim. Nëse në vitin 2007 vetëm rreth 1.5 milion euro ishin ndarë për masat e punësimit, në vitin 2009 kemi një rritje të madhe dhe shuma arrin në rreth 11.5 milion euro, d.m.th. një rritje prej 10 milion eurosh. Më pas kemi reduktim të shumës deri në rreth 5 milion euro (për 2010-2012), për t'u rritur përsëri në tre vitet e ardhshme, duke arritur në 10.1 milion euro në vitin 2015. Në vitin 2016 ka një rënie të fondeve të alokuara për këto mjete që janë pjesërisht për shkak të krizës politike që dominonte në vend. Në vitin 2017 përsëri kemi rritje në buxhetin e Agjencisë dedikuar ngritjes dhe promovimit të punësimit, që është rreth 12.5 milion euro.

Tabela 2. Fonde të alokuara nga Agjencia për Punësim e R.M.

Viti	Buxheti ministror (në MKD)	Buxheti ministror (në euro)	Mjete të ndara për masa aktive të tregut të punës (në MKD)	Mjete të ndara për masa aktive të tregut të punës (në euro)
2017	2,054,945,000.00	33,413,739.84	767,576,000 .00	12,480,910.57
2016	2,166,430,000.00	35,226,504.07	537,620,000.00	8,741,788.62
2015	2,214,162,000.00	36,002,634.15	625,000,000.00	10,162,601.63
2014	2,404,445,000.00	39,096,666.67	517,500,000.00	8,414,634.15
2013	2,693,800,000.00	43,801,626.02	523,900,000.00	8,518,699.19
2012	3,088,690,000.00	50,222,601.63	299,500,000.00	4,869,918.70
2011	3,027,309,000.00	49,224,536.59	304,835,000.00	4,956,666.67
2010	2,894,338,000.00	47,062,406.50	306,560,000.00	4,984,715.45
2009	4,587,599,000.00	74,595,105.69	705,465,000.00	11,470,975.61
2008	5,074,129,000.00	82,506,162.60	257,500,000.00	4,186,991.87
2007	5,183,600,000.00	84,286,178.86	88,950,000.00	1,446,341.46

Burimi: Buxhetet e Agjencisë për Punësim për periudhën 2007-2017

Në anën tjetër, përveç Agjencisë për Punësim, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale është përfshirë në vitet e fundit me masa të drejtpërdrejta për të stimuluar punësimin. Për qëllime të caktuara, Ministria ka ndarë buxhetin e fondeve nga 1.1 milion € në 2007, në € 9.7 milion në vitin 2009 dhe rreth 3 milion € në 2010-2015, që do të reduktohet në mënyrë të ndjeshme në 2016 dhe 2017. Prej këtu shihet tendenca e transferimit të fondeve për qëllime të punësimit te Agjencia për Punësim dhe forcimi i rolit të saj në luftën kundër papunësisë në vendi.

Tabela 2. Fondet e alokuara nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale

Viti	Buxheti ministrior (në MKD)	Buxheti ministrior (në euro)	Mjete të ndara për masa aktive të tregut të punës (në MKD)	Mjete të ndara për masa aktive të tregut të punës (në euro)
2017	41,157,473,000.00	669,227,203.25	12,513,000.00	203,463.41
2016	38,592,085,000.00	627,513,577.24	93,934,000.00	1,527,382.11
2015	33,826,071,000.00	550,017,414.63	235,527,000.00	3,829,707.32
2014	34,165,504,000.00	555,536,650.41	228,587,000.00	3,716,861.79
2013	32,094,800,000.00	521,866,666.67	228,500,000.00	3,715,447.15
2012	28,052,043,000.00	456,130,780.49	206,000,000.00	3,349,593.50
2011	24,963,277,000.00	405,906,943.09	200,060,000.00	3,253,008.13
2010	22,905,165,000.00	372,441,707.32	200,000,000.00	3,252,032.52
2009	823,480,000.00	13,389,918.70	598,000,000.00	9,723,577.24
2008	445,151,000.00	7,238,227.64	84,000,000.00	1,365,853.66
2007	248,813,000.00	4,045,739.84	69,000,000.00	1,121,951.22

Burimi: Buxheti qendror i Republikës së Maqedonisë 2007-2017

Tabela në vijim jep në detaje shumën e fondeve që u dedikohen programeve dhe masave specifike dhe numrit të personave të papunë që ishin të përfshirë në vitin 2016.

Tabela 3. Përmbledhje e mjeteve të kërkuara sipas llojit të programit dhe masës

Nr.	Programi dhe masa	Persona të përfshirë	Fonde (në denarë)	Fonde (në euro)
1	Programe vetëpunësimi	950	200.649.847,00	3.266.316,90
2	Mbështetje financiare për personat juridikë (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe zejtarët) për hapjen e vendeve të reja të punës	100	10.725.653,00	174.599,59
3	Programi i subvencionimit të punësimit	937	240.170.000,00	3.909.653,26
4	Programi i përgatitjes për punësim përmes trajnimit	6.976	59.250.900,00	964.527,10
5	Punë të dobishme në komunitet	100	3.600.000,00	58.603,28
6	Programi pilot - Inkubatorët për artizanët	10	696.000,00	11.329,96
7	Promovimi i programeve dhe masave nga plani operativ i vitit 2016		2.700.000,00	43.952,46

Efekti i masave të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë

Siç mund të shohim nga tabelat e mësipërme, është e qartë se qeveria në vitet e fundit është përpjekur të zbatojë programe dhe masa të ndryshme për të ulur papunësinë. Buxheti i Agjencisë së Punësimit është rritur shumë për qëllimin e zbatimit të këtyre masave. Nga ana tjetër, ne shohim se shkalla e papunësisë në përgjithësi ka rënë në këto vitet e fundit dhe shkalla e punësimit është rritur, prandaj mendimi i parë është se këto programe dhe masa kanë ndikuar në uljen e shkallës së papunësisë dhe në rritjen e shkallës së punësimit. Megjithatë, mund të shohim se buxheti i alokuar ende nuk është i mjaftueshëm në mënyrë që të mundë të kemi një ndikim më të madh.

Konkluzione

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë karakterizohet nga disa probleme me të cilat përballen një pjesë e mirë e vende në zhvillim. Në këtë drejtim janë marrë masa që duhet të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes së tregut të punës, që do të çojë në rritjen e nivelit të punësimit. Në kushtet aktuale vendi ka një papunësi realitivist të lartë dhe se shteti duhet të ndërhyjë duke vendosur taksa më të ulëta mbi punonjësit dhe punëdhënësit, për të financuar programet e sigurimeve shoqërore me qëllim të stimulimit të hapjes së vendeve të reja të punës, veçanërisht në sektorin privat.

Hapja e vendeve të punës më produktive dhe pagat më të larta janë elemente të rëndësishme për uljen e varfërisë dhe përmirësimin e standardit të jetesës në vend. Për këtë ne fuqimisht rekomandojmë të inkurajojmë dhe mbështesim përmirësimin e klimës së biznesit në kontekstin e rekomandimeve tatimore, sidomos për bizneset e vogla, si dhe zvogëlimin e shumës së kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor.

Në këtë drejtim rol të veçantë luan edhe sistemi edukativ apo shkollor. Aktualisht në Maqedoni ka shumë mospërputhje mes kërkesave të tregut të punës dhe asaj që prodhojnë institucionet e arsimit të lartë. Vërehet mungesë e madhe të programet teknike. Në këtë drejtim duhet bërë përforsimi i shkollimit profesional të mesëm, por edhe atij universitar, duke aplikuar programe që janë treguar të suksesshme në vendet e zhvilluara, siç është Gjermania dhe programi i saj i shkollimit dual.

Shteti si rregullator dhe përfaqësues i disa aspekteve të zhvillimit të shoqërisë dhe iniciativës së lirë duhet të stimulojë dhe rregullojë rritjen e shkollave profesionale, veçanërisht në fushat ku ato janë më të nevojshme. Për këtë çështje rekomandojmë që institucionet shtetërore të orientohen jo vetëm në kapacitetet dhe ofertat e tregut, por edhe nga trendet dhe drejtimet e zhvillimit të zonave rurale dhe në tregun e punës në përgjithësi.

LABOR MARKET POLICIES AND THEIR IMPACT ON EMPLOYMENT - THE CASE OF MACEDONIA

Rasim ZUFERI

Faculty of Business and Economics, South East European University
r.zuferi@seeu.edu.mk

Selajdin ABDULI

Faculty of Business and Economics, South East European University
s.abduli@seeu.edu.mk

Abstract

Employment and unemployment constitute one of the main issues or problems faced by most, whether they are developed or developing countries. In many cases, the issue of unemployment may force people to migrate within a country, but also to other countries.

The Republic of Macedonia falls into this category. Since its independence, the country has had major problems with employment/unemployment. At different time periods the unemployment rate has reached 35% or more, fluctuating during the later period at about 30%. Every government has had difficulties in dealing with this issue and has found no suitable solution for it. However, recently we are witnessing a decline in the unemployment rate in the Republic of Macedonia, where in the third quarter of 2016 the unemployment rate reached 23.4%. During this period, the government has undertaken a number of reforms to stimulate employment, mainly through active policies to promote employment.

At first glance, if we focus only on the unemployment rate, we see that the government's active employment promotion policies have yielded results, but to look at the real effects and costs we will analyze the employment rate, the effectiveness of the funding dedicated to these policies and we will also focus on the rate of employment and unemployment among young people who are most likely to leave the country.

Keywords: employment, unemployment, active policies.

Bibliografia

1. Corbanese, V. (2015) Assessment of delivery of employment services and programmes for youth by the Employment Service Agency of the FYR Macedonia. International Labour Organization.
2. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2008). *Report on the work of the Employment Agency of the Republic of Macedonia in 2007*. Skopje.
3. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2009). *Report on the work of the Employment Agency of the Republic of Macedonia*. Skopje.
4. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2011). *Report on the work of the Employment Agency of the Republic of Macedonia in 2010*. Skopje.
5. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2012). *Report on the work of the Employment Agency of the Republic of Macedonia in 2011*. Skopje.
6. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2013). *Annual report for 2012*. Skopje.
7. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2014). *Annual report for 2013*. Skopje.
8. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2015). *Annual report for 2014*. Skopje.
9. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2016). *Annual report for 2015*. Skopje.
10. Employment Service Agency of Republic of Macedonia. (2017). *Annual report for 2016*. Skopje.
11. Employment Service Agency of Republic of Macedonia.. (2017). *Programme for 2016*. Skopje.
12. Petreski, Blagica&Tumanoska, Despina. (2016). Active labour market policies: Challenge for the Macedonian labour market. Finance Think - Economic Research & Policy Institute. Skopje.
13. Radvansky, M., Stefanik, M., Lichner, I., Weyerstrass, K., Domonkos, T., & Haluska, J. (2013). *Labour market analysis and long-term forecast in Macedonia (FYROM) up to 2025*. Skopje: European Union.
14. State Statistical Office. (2008). *Labor Force Survey, 2007*. Skopje.

15. State Statistical Office. (2009). *Labor Force Survey, 2008*. Skopje.
16. State Statistical Office. (2010). *Labor Force Survey, 2009*. Skopje
17. State Statistical Office. (2011). *Labor Force Survey, 2010*. Skopje.
18. State Statistical Office. (2012). *Labor Force Survey, 2011*. Skopje.
19. State Statistical Office. (2013). *Labor Force Survey, 2012*. Skopje.
20. State Statistical Office. (2014). *Labor Force Survey, 2013*. Skopje.
21. State Statistical Office. (2015). *Labor Force Survey, 2014*. Skopje.
22. State Statistical Office. (2016). *Labor Force Survey, 2015*. Skopje.
23. State Statistical Office. (2017). *Labor Force Survey, 2016*. Skopje.
24. Атанасовска-Новески, В., & Трпески, П. (2016). Неусогласеност на (не)вработеноста на пазарот на труд во Македонија од аспект на знаења и вештини. *Четврти документ за политики во рамки на работата на експертската група за економски и социјални политики*. Friedrich Ebert Stiftung.

SFIDAT DHE PENGESAT E MENTORIMIT TË ARSIMTARËVE NË SHKOLLAT FILLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Lulzim MEHMEDI¹

Abstrakt

Në kuadër të proceseve të globalizimit, si dhe zhvillimit të hovshëm tekniko-shkencor, si të gjithë vendet tjera edhe Republika e Maqedonisë u kyç në procesin e përgatitjes së ndryshimeve ligjore me qëllim të plotësimit të standardeve për kompatibilitet, bashkëkohësim dhe efikasitet të procesit mësimor. Reformat arsimore të cilat ndërmerren në të gjitha vendet në botë, sidomos në dhjetë vitet e fundit, janë të fokusuara në zhvillimin e kuadrit arsimor. Për këtë arsye të gjithë arsimtarët gjenden në qendër të përpjekjeve shoqërore për përmirësimin e kualitetit të punës edukativo-arsimore.

Komisioni European në vitin 2017 në lidhje me zhvillimin e shkollës dhe mësimdhënien kualitative e thekson nevojën e sigurimit të mbështetjes specifike të arsimtarëve që në fazën fillestare të karrierës së tyre. Mentorimi i arsimtarëve ka komponenta të rëndësishme formative dhe mbështetëse, të cilat zakonisht përfshijnë trajnime, ndihmë personale dhe punë këshilldhënëse.

Punimi në fjalë do të japë pasqyrë mbi sfidat dhe pengesat që paraqiten gjatë procesit të mentorimit të arsimtarëve të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë. Do të analizohet Ligji për arsim fillor, Ligji i arsimtarëve si dhe Ligji për themelimin e Akademisë së Arsimtarëve, ku është paraparë edhe mentorimi i arsimtarëve. Gjithashtu do të analizohen të gjitha përpjekjet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të R. M, si dhe politikave dhe strategjive shkollore në drejtim të mentorimit të arsimtarëve të shkollave fillore, përfshirë edhe pengesat e shumta që paraqiten në këtë drejtim.

Fjalët çelës: Reformat në arsim, mentorimi i arsimtarëve, bashkëkohësimi i mësimin, politika arsimore.

¹ Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës. lulzim.mehmedi@unite.edu.mk

Sfidat dhe pengesat e mentorimit të arsimtarëve në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë

Në kuadër të proceseve të globalizimit, si dhe zhvillimit të hovshëm tekniko-shkencor, si të gjithë vendet tjera, edhe Republika e Maqedonisë u kyç në procesin e përgatitjes së ndryshimeve ligjore me qëllim të plotësimit të standardeve për kompatibilitet, bashkëkohësim dhe efikasitet të procesit mësimor. Reformat arsimore të cilat ndërmerren në të gjitha vendet në botë, sidomos në dhjetë vitet e fundit, janë të fokusuara në zhvillimin e kuadrit arsimor. Për këtë arsye të gjithë arsimtarët gjenden në qendër të përpjekjeve shoqërore për përmirësimin e kualitetit të punës edukativo-arsimore.

Përcaktimet e MASH-it të Republikës së Maqedonisë që të integrohet në proceset europiane dhe botërore u panë që në vitin 2004, me përgatitjen e Programit nacional për zhvillimin e arsimit në RM 2005-2015. Në këtë kontekst MASH e mori përgjegjësinë për realizim të qëllimeve, parimeve dhe rekomandimeve të cilat janë të hartuara në dokumentet ndërkombëtare për zhvillimin e arsimit në Europë dhe botë.

Në komunikatën e saj për zhvillim të shkollës, si dhe të realizimit të mësimdhënies cilësore, me qëllim të fillimit të mbarë të punës së mësimdhënësve praktikantë, Komisioni European e thekson rëndësinë e kuptimit të cilësisë nga ana e arsimtarëve, duke e potencuar rolin që mund ta luajë bashkëpunimi, përkryerja profesionale si dhe avancimi në tituj i arsimtarëve. Komisioni e thekson nevojën që përkryerja profesionale dhe avancimi në tituj i arsimtarëve të jenë të qasshme dhe relevante, si dhe e thekson efektin pozitiv të kyçjes së shkollave dhe arsimtarëve në definimin e politikave për përkryerje profesionale dhe avancim në tituj të arsimtarëve. Ai gjithashtu e thekson nevojën e sigurimit të përkrahjes së veçantë të arsimtarëve, posaçërisht në fazat fillestare të karrierës së tyre.²

Komisioni European përmes komunikatës thekson rëndësinë e sigurimit të përkrahjes specifike të arsimtarëve që në fazën fillestare të karrierës së tyre. Siç theksohet në Doracakun e Komisionit European për hartuesit e politikave të stazhit të praktikantit në profesionin e

² Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on school development and excellent teaching for a great start in life, COM/2017/165 final.

mësuesisë, “pika në të cilën arsimtarët e posadiploomuar kalojnë prej arsimimit inicial në jetën profesionale llogaritet si kyçe për përkushtimin dhe përkryerjen e tyre, si dhe në zvogëlimin e numrit të arsimtarëve të cilët e braktisin profesionin”.³

Stazhi i praktikantit, siç është kuptuar këtu, paraqet fazë të strukturuar të përkrahjes e cila parashihet për arsimtarët-praktikantë. Në këtë fazë ato tërësisht ose pjesërisht i realizojnë detyrat të cilat i realizojnë arsimtarët me përvojë dhe janë të shpërblyer për punën e tyre. Stazhi i praktikantit ka komponent të rëndësishëm formativ dhe përkrahës, e cila zakonisht përcillet me trajnime shtesë, ose me ndihmë personale dhe punë këshilldhënëse.

Statusi dhe kohëzgjatja e stazhit të praktikantit në shtetet europiane

Në shumë sisteme arsimore europiane arsimtarët e ardhshëm ose të sapopunësuarit kanë qasje te programet e stazhit të praktikantit. Në 26 shtete faza e strukturuar e stazhit të praktikantit është e obligueshme dhe realizohet përmes organeve rregullatore në nivelin më të lartë, ndërsa në Estoni, Slloveni dhe Finlandë stazhi i praktikantit është i rekomandueshëm.⁴

Programet e stazhit të praktikantit, atje ku realizohen, mund të organizohen në mënyra të ndryshme. Në disa sisteme arsimore stazhi i praktikantit është i siguruar për arsimtarët e rinj, ndërsa në disa shtete arsimtarët praktikantë llogaritet se janë tërësisht të kualifikuar vetëm pas përfundimit me sukses të stazhit pedagogjik. Stazhi i praktikantit në disa shkolla zakonisht organizohet pas nënshkrimit të kontratës, përderisa në disa shtete stazhi i praktikantit organizohet gjatë periudhës së realizimit të praktikës. Në Gjermani, Francë, Luksemburg dhe Austri stazhi i praktikantit realizohet në kuadër të arsimimit inicial të arsimtarëve. Nga shtatori i vitit 2019 stazhi i praktikantit do të jetë obligativ për të gjithë arsimtarët e arsimit fillor

³ European Commission, 2010. Developing Coherent and System-wide Induction Programmes for beginning Teachers. A Handbook for Policymakers. European Commission Staff Working Document. SEC(2010) 538 final. [pdf] Available at: http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/repository/education/policy/school/doc/handbook0410_en.pdf [marrë më 20.02.2018].

⁴ European Commission/EACEA/Eurydice, 2018. Teaching Careers in Europe: Access, Progression and Support. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

dhe të mesëm. Ai do të realizohet në fillim të punës, me nënshkrimin e kontratës së parë si arsimtarë i diplomuar.⁵

Mentorimi i arsimtarëve praktikantë

Mentorimi është element obligues i programeve të stazhit të praktikantit, gati se të gjithë sistemet arsimore e kanë të rregulluar këtë çështje. Mentorimi gjithashtu mund të jetë i qasshëm për arsimtarët praktikantë edhe në mungesë të stazhit të praktikantit, si dhe për të gjithë arsimtarët që kanë nevojë për të. Marrë në përgjithësi mentorimi i arsimtarëve të cilët fillojnë profesionin e tyre është obligativ në 28 sisteme arsimore, ndërsa rekomandohet edhe në pesë sisteme arsimore (Bullgari, Çeki, Qipro, Latvi dhe Norvegji).⁶

Mentorimi për arsimtarët tjerë nuk është shumë i zakonshëm në Europë. Edhe pse mentorimi në më tepër vende europiane është shumë rrallë i paraparë për arsimtarët tjerë, prapsepapë janë paraparë forma tjera të përkrahjes profesionale dhe personale. Vetëm në tetë sisteme arsimore nuk ka rekomandime oficiale si dhe akte për mentorim.⁷

Doracaku i Komisionit Evropian për kreatorët e politikave për mentorimin e arsimtarëve thekson rëndësinë e tre llojeve të përkrahjes: personale, sociale dhe profesionale. Programet e stazhit të praktikantëve përmbajnë elemente të ndryshme siç janë mentorimi, trajnimet profesionale, recenonet si dhe takimet e parapara konsultativo-këshilldhënëse me drejtorin e shkollës përmes të cilave sigurohet përrahje personale, sociale dhe profesionale.⁸ Mentorimi, i cili llogaritet si një ndër elementet kryesore të programeve për stazhin e praktikantit zakonisht i përfshin të trillojet e mbështetjeve. Sipas rregullores, mentorin është arsimtar me përvojë i emëruar për të ndërmarrë përgjegjësi për kolegët e rinj ose arsimtarët potencialë. Mentorin zakonisht është arsimtar më në

⁵ European Commission/EACEA/Eurydice, 2018. Teaching Careers in Europe: Access, Progression and Support. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

⁶ Ibid.

⁷ Ibid

⁸ European Commission, 2010. Developing Coherent and System-wide Induction Programmes for beginning Teachers. A Handbook for Policymakers. European Commission Staff Working Document. SEC(2010) 538 final. [pdf] Available at: http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/repository/education/policy/school/doc/handbook0410_en.pdf [marë më 20.02.2018].

moshë dhe me përvojë pune, i cili në fillim i njofton arsimtarët praktikantë me bashkësinë e shkollës dhe aktivet profesionale, duke u siguruar trajnime dhe punë këshilldhënëse në rastet kur kanë nevojë për të.⁹

Stazhi i praktikantit dhe mentorimi i arsimtarëve në Republikën e Maqedonisë

Stazhi i arsimtarit-praktikant në Republikën e Maqedonisë është rregulluar me Ligjin për arsim fillor të vitit 1995,¹⁰ ku theksohet se mësuesi, arsimtari, bashkëpunëtori profesional dhe edukatori i cili punësohet për herë të parë në shkollë fillore ka statusin e praktikantit. Ligji në fjalë përcakton edhe kohëzgjatjen e stazhit të praktikantit, e cila është periudha njëvjeçare gjatë së cilës arsimtari-praktikant aftësohet për punë të pavarur edukative-arsimore, gjegjësisht aftësohet që t'i nënshtrohet provimit profesional, për çka shkolla i përcakton mentor të cilin e zgjedh këshilli i arsimtarëve. Me Ligjin për arsim fillor të vitit 2008 stazhit të arsimtarit-praktikant i jepet rëndësi më e madhe përmes kapitullit të veçantë me numër 2 përshkruhet rregullativa ligjore për realizim të së njëjtës. Për dallim prej Ligjit për arsim fillor të vitit 1995, në Ligjin për arsim fillor të vitit 2008¹¹ parashihet që gjatë kohëzgjatjes së stazhit të praktikantit arsimtari-praktikant të marrë 80% të rrogës së arsimtarit, bashkëpunëtorit profesional ose edukatorit, ndërsa mentorit i përcaktohet që të marrë 10% nga rroga e arsimtarit praktikant. Por situata në terren e dëshmon të kundërtën e kësaj, për arsye se në shumë shkolla arsimtarët praktikantë marrin 100% të rrogës, që nënkupton se me këtë nuk motivohen arsimtarët-mentor dhe formalizohet procesi i mentorimit. Ligji më tej parasheh që arsimtarët të cilët realizojnë mentorimin e arsimtarit praktikant duhet të kenë tituj arsimtar-mentor ose arsimtar-këshilltar për arsye se me Ligjin për arsim fillor të vitit 2008 parashihet edhe avancimi në tituj i arsimtarëve, me ç'rast kemi arsimtarë-praktikantë, arsimtar, arsimtar-mentor dhe arsimtar-këshilltar. Sipas të njëjtit Ligj, mentori përgatit program të posaçëm për arsimtarin praktikant i cili përfshin përgatitje metodike, didaktike, pedagogjike, si dhe përgatitjen e nevojshme për aftësim të arsimtarit-praktikant për dhënien e provimit profesional. Në Ligj parashihet që mentori në fund

⁹ European Commission/EACEA/Eurydice, 2018. Teaching Careers in Europe: Access, Progression and Support. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

¹⁰ Ligji për arsim fillor, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 44/95, neni 72.

¹¹ Ligji për arsim fillor, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 103/2008, neni 85.

të përfundimit të stazhit të arsimtarit-praktikant të përgatisë raport me të cilin jep mendim pozitiv ose negativ për aftësimin e kandidatit dhe ky mendim është kusht për dhënien e provimit profesional.¹²

Në bazë të Ligjit për arsim fillor të vitit 1995, ministri i arsimit dhe i kulturës fizike të RM-së, më 5 qershor të vitit 1996 e solli Rregulloren për mënyrën e dhënies së provimit profesional për mësues, arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe edukatorë në shkollë fillore, e cila u publikua në Gazetën zyrtare të RM-së nr.27/96. Sipas rregullores në fjalë, provimit profesional arsimtari-praktikant i nënshtrohet pasi ta ketë kryer stazhin e praktikantit në kohëzgjatje prej një viti dhe të njëjtin duhet ta kalojë në afat prej gjashtë muajsh, ose më së voni një viti prej përfundimit të stazhit të praktikantit. Rregullorja parasheh që provimi profesional të realizohet në dy afate: afatin vjeshtor i cili fillon prej 1 tetori dhe zgjat deri më 30 nëntor, si dhe afatin pranveror i cili fillon prej 1 marsit dhe zgjat deri më 30 prill. Në lidhje me respektimin e këtyre afateve, praktika flet se afatet respektohen vetëm gjatë periudhës së paraqitjes së provimit profesional nga ana e arsimtarëve-praktikantë, ndërsa nuk respektohen afatet e realizimit të provimeve dhe ato anulohen edhe për afat njëvjeçar pa ndonjë arsyetim.¹³ Gjithashtu edhe informimi i kandidatëve për dhënien e provimit bëhet dy-tre ditë përpara mbajtjes, në disa raste edhe vetëm një ditë përpara, duke i pamundësuar që të përgatiten në kohë dhe të kenë orientim për shkollën ku do ta realizojnë orën praktike edhe pse në Rregullore parashihet që Komisioni i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ta njoftojë kandidatin si dhe shkollën fillore në të cilën është i punësuar më së paku 15 ditë para ditës së mbajtjes së provimit profesional.¹⁴ Me Rregullore parashihet që për dhënien e provimit profesional, arsimtari-praktikant përgatitet përmes Programit të posaçëm për dhënien e provimit profesional.¹⁵ Parashihet që arsimtari-praktikant për dhënien e provimit profesional të përgatitet me ndihmën e mentorit, të cilin e përcakton këshilli i arsimtarëve të shkollës fillore nga radhët e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve të dalluar, por parashihet edhe që mentorin të mund të caktohet edhe nga ndonjë shkollë tjetër fillore.

¹² Ligji për arsimin fillor, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.103/2008, neni 85.

¹³ Rregullore për mënyrën e dhënies së provimit profesional për mësues, arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe edukatorë në shkollën fillore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.27/1996, neni 72.

¹⁴ Ibid, neni 12.

¹⁵ Ibid, neni 16.

Rregullorja i kushton kujdes edhe planit të punës, si dhe evidencës për punë të arsimtarit-praktikant të cilën e udhëheq mentori dhe të njëjtën e dorëzon te drejtori i shkollës në të cilën është i punësuar praktikanti. Parashihet që gjatë vlerësimit të praktikantit në provimin profesional të shqyrtohet edhe mendimi i mentorit. Edhe pse kemi rregullativë ligjore, si dhe Rregullore për mënyrën e organizimit dhe dhënies së provimit profesional për mësues, arsimtar, bashkëpunëtor profesional dhe edukator në shkollë fillore, përsëri në lidhje me mentorimin e tyre, që është faktor kyç me ndikim në cilësinë e mësimdhënies, mund të themi se në mungesë të zbatimit të avancimit në tituj të arsimtarëve kemi mentorë formalë të cilët nuk kanë aspak ose posedojnë program joadekuat për mentorimin e arsimtarëve-praktikantë. Në të shumtën e rasteve arsimtarëve u caktohet mentor në periudhë kur arsimtari-praktikant duhet t'i nështrohet provimit profesional dhe mendimi i mentorit u nevojitet që të plotësojnë aspektin ligjor. Nga analiza e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillave të shkollave shumë lehtë mund të konstatohet kjo anomali, nëse shihet kontrata e parë e nënshkruar nga arsimtari-praktikant dhe periudha e caktimit të mentorit nga këshilli i arsimtarëve. Nga analiza e mendimit të mentorit për arsimtarin-praktikant, në shumicën e shkollave vërehet se mendimet e mentorëve janë identike në përmbajtje, që nënkupton se ata formalisht nënshkruhen nga ta.

Edhe pse në Rregullore është paraparë forma dhe mënyra e dhënies së provimit profesional, si dhe vlerësimet dhe rezultatet nga provimi profesional, të dhënat e marra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës flasin se kalueshmëria e arsimtarëve-praktikantë është shumë e lartë, gati 99%, që edhe më shumë e formalizon provimin profesional. Sa për ilustrim do të paraqesim të dhënat e marra nga MASH për vitin 2017, gjithsej të paraqitur në provim 267 kandidatë, kanë kaluar 264, ndërsa nuk kanë kaluar vetëm 3 kandidatë.

Praktikantit para dhënies së provimit profesional, i bëhet vlerësim i karakteristikave për përshtatshmëri me punë me fëmijë dhe adoleshentë në veprimtarinë edukative arsimore, të cilën e realizojnë persona të licencuar profesionalë të institucionit të pavarur të akredituar profesional.

Provimi profesional përbëhet nga pjesa praktike dhe teorike. Pjesa praktike e provimit parasheh hartimin e përgatitjes ditore dhe realizimin e orës mësimore me njësi konkrete, ndërsa në pjesën teorike kandidati arsyeton detyrën e shtëpisë dhe realizimin e detyrës praktike, si dhe përgjigjet në pyetjet e caktuara në lidhje me aspektet përmbajtësore dhe metodologjike të detyrave të realizuara. Në pjesën e dytë të provimit,

arsimtarit-praktikant i parashirohen pyetje për kontrollin e njohurive të përgjithshme në lidhje me rregullativën normativo-ligjore. Edhe pse në rregullore parashihet që komisioni i provimit të përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, si dhe numër të njëjtë të zëvendësve të tyre, të cilët emërohen nga persona të dalluar me përgatitje të lartë profesionale, edhe në këtë pjesë kemi shkelje të rregullores dhe emërim pa kritere të caktuara të anëtarëve të komisionit.

Me sjelljen e Ligjit për mësimdhënës në shkolla fillore dhe të mesme në RM, si dhe Ligjit për akademinë e arsimtarëve, të dy këto ligje të sjellura në vitin 2015, por deri më sot të prolonguar disa herë dhe akoma nuk janë në fuqi, vazhdon edhe më tej zvarritja e avancimit në tituj të arsimtarëve. Të dy këto ligje kanë sjellur huti dhe janë përcjellë me polemika të shumta nga qarqet akademike dhe nga vetë arsimtarët, prandaj edhe më tej nuk janë funksional. Kjo flet se në shtet akoma nuk kemi të përcaktuar strategji të mirëfilltë për zhvillimin e arsimit, e cila përmes realizimit të qëllimeve strategjike do na shpie drejt vizionit të dëshiruar.

Rekomandime:

- MASH dhe komunat përmes inspektorëve shtetërorë të arsimit si dhe inspektorëve të autorizuar komunalë për arsim të ndjekin punën e shkollave në lidhje me përzgjedhjen e mentorëve për arsimtarët-praktikantë.
- Të vendosen kritere për përzgjedhje të mentorëve të arsimtarëve-praktikantë deri në fillim të zbatimit të avancimit të karrierës së arsimtarëve.
- Të hartohet program për mentorim të arsimtarëve-praktikantë, si dhe të parashihen trajnime të obligueshme për mentorët.
- MASH përmes inspektoratit shtetëror të arsimit dhe byrosë për zhvillimin e arsimit të ndjekë punën e mentorëve në lidhje me realizimin e programit për mentorim të arsimtarëve-praktikantë.
- Të përgatiten ndryshime ligjore dhe të parashihet edhe mentorimi i arsimtarëve të cilët tregojnë rezultate të dobëta në punën e tyre me nxënësit.
- MASH dhe komuna të inspektojë planin financiar të shkollave në lidhje me pagesën e mentorëve në lartësinë e 10% të rrogës së praktikantit.
- Të konkretizohen dhe të respektohen kriteret për përzgjedhje të anëtarëve të komisionit dhe zëvendësve të tyre për dhënien e provimit profesional.

CHALLENGES AND OBSTACLES TO THE MENTORING OF TEACHERS IN PRIMARY SCHOOLS OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Lulzim MEHMEDI

Faculty of Pedagogy, University of Tetova
lulzim.mehmedi@unite.edu.mk

Abstract

Within the process of globalization and advanced technical-scientific development, like all other countries, the Republic of Macedonia was also involved in the process of preparing legal changes in order to meet the standards for compatibility, contemporaneity and efficiency of the teaching process. Educational reforms that are undertaken in all countries around the world, especially in the last ten years, are focused on the development of the education cadre. For this reason, all teachers are at the center of social efforts to improve the quality of educational work.

In 2017, with regard to school development and quality teaching the European Commission emphasized the need to provide specific support to teachers at the initial stage of their careers. The mentoring of teachers has important formative and support components that typically involve training, personal assistance, and counseling work.

This paper will provide an overview of the challenges and obstacles faced during the mentoring process of elementary school teachers in the Republic of Macedonia. The Law on Primary Education, the Law on Teachers and the Law on the Establishment of the Teachers' Academy, which provide for the mentoring of teachers, will be analyzed. It will also analyze all the efforts of the Ministry of Education and Science of RM, as well as policies and school strategies in terms of the mentoring of elementary school teachers, including the many obstacles faced in this regard.

Keywords: education reforms, teacher mentoring, contemporaneity of education, education policy.

Literatura e shfrytëzuar

1. Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on school development and excellent teaching for a great start in life, COM/2017/165 final.
2. European Commission, 2010. Developing Coherent and System-wide Induction Programmes for beginning Teachers. A Handbook for Policymakers. European Commission Staff Working Document. SEC(2010) 538 final. [pdf] Available at: http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/repository/education/policy/school/doc/handbook0410_en.pdf [marrë më 20.02.2018].
3. European Commission/EACEA/Eurydice, 2018. Teaching Careers in Europe: Access, Progression and Support. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
4. Ligji për akademinë e arsimtarëve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.10/2015.
5. Ligji për arsim fillor, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.103/2008.
6. Ligji për arsim fillor, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.44/95.
7. Ligji për mësimdhënës në shkolla fillore dhe të mesme, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.10/2015.
8. Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumentet shoqëruese programore, (2006), Shkup, MASH.

SHKOLLA SHQIPE DHE REFORIMI I SISTEMIT ARSIMOR NË MAQEDONI

Fatmir SULEJMANI¹

Përmbledhje

Studimi im është përpjekje që synon të hedhë dritë mbi pozitën e arsimit shqip në Republikën e Maqedonisë, mbi tendencat për reformimin e sistemit arsimor të këtij vendi, që kanë nisur që nga viti 1996 dhe mbi rezultatet konkrete të përpjekjeve në fjalë.

Studimi sjell dëshmi mbi sprovat e dështuara të reformimit të sistemit arsimor mbi harxhimin e kotë të mjeteve financiare të donatorëve të jashtëm, trajnimet e vazhdueshme, por të paefektshme të arsimtarëve të shkollave fillore (të të dy cikleve) dhe të mesme dhe mbi shkaqet e dështimit të mbi 60 projekteve, që i sollën (në veçanti arsimit shqip) më shumë dëme se sa dobi.

Studimi është ndër të parit e këtij lloji, ndaj si i tillë shpresoj të zgjojë interesimin e duhur të botës akademike e intelektuale.

Përpjekjet për reformimin e sistemit arsimor në Maqedoni kanë nisur në vitet e '90-ta. Gjer më tani kanë rrjedhur shumë projekte, janë mbajtur shumë seminare, janë shpenzuar shumë para, por e gjitha ka rezultuar me rezultate modeste. Dëshmi për këtë janë projektet: *“Bazat e demokracisë”*, *“Parandalimi i dhunës nëpër shkolla”*, *“Integrimi ndëretnik”*, *“Forcimi i bashkëpunimit ndëretnik”*..., efektet e të cilëve shihen në protestat ulëritëse të albanofobëve maqedonas kundër qenies dhe gjuhës sonë në të cilat, mjerisht, marrin pjesë edhe profesorë universitarë, studentë dhe nxënës.

Koha e humbur në kërkim të modeleve bashkëkohore të mësimdhënies dhe përgatitjes së kuadrove për jetën dinamike të së sotmes ka krijuar vakume të dukshme. Shumëçka nuk është në përputhshmëri me nevojat e nxënësve të epokës dixhitale, kur gjërat vjetrohen sa çel e mbyll sytë. Kjo është e kushtueshme për brezat e mbetur peng vorbullash të krijuara prej insititucioneve të thirrura për të ndryshuar gjendjen ekzistuese në arsim.

¹ Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tetovës. fatmir.sulejmani@unite.edu.mk

Shi për këtë, Maqedonia ka ngecur prapa të tjerëve në proceset e reformimit dhe sot është disa hapa pas Shqipërisë, ndoshta edhe pas Kosovës, që, përkundër vonesave për shkaqe të njohura, e synon më seriozisht shkollën e shek. XXI.

Në vijim po sjellim disa prej shkaqeve të ngecjes në fjalë:

- 28 vitet e fundit, që kur u bë shtet i mëvetësishëm, Maqedonia nuk e ka pasur kurrë prioritet çështjen e arsimit në asnjë nivel të shkollimit. Po ta kishte pasur do të kishte ndërtuar shkolla moderne në vend të luanëve me pamje të egërsuar, priftërinjve mesjetarë ortodoksë që ruajnë urën e lashtë të kryeqytetit multietnik e multikonfesional, anijeve anakronike në Vardarin e shndërruar në shtonë, luftëtarëve me armë dhe me hanxharë të nxjerrë këllëfesh, që, si për t'na e bërë me dije sa bie sahati, u bëjnë karshillëk lagjeve shqiptare, duke pozuar domethënshëm para gjykatave, bibliotekave, universiteteve, televizioneve publike, shtëpive operistike, teatrove, muzeve të holokaustit..., të cilat kudo dhe kurdo simbolizojnë paqen, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërmjet njërëzish, kulturash, etnish...

- Gjatë kësaj periudhe kanë rrjedhur mbi 60 projekte² me synim reformimi të sistemit arsimor në nivel të shkollimit fillor dhe të mesëm (gjimnazeve dhe shkollave profesionale), por gjithçka është braktisur në momentin kur janë harxhuar donacionet e jashtme³, të

² Ja disa prej projekteve të realizuara me para donatorësh të huaj dhe të braktisura pa asnjë arsytim në fazat kur pritej zbatimi i risive në praktikë: Hap pas hapi, Bazat e demokracisë, Mësimi aktiv - të mësuarit interaktiv, Planifikimi i punës edukativo-arsimore, Notimi me shkrim, Përparimi i mësimin në matematikë dhe në shkencat natyrore, Arsimi për shkathtësitë jetësore, Tolkid-aouftver për mësimin klasor, E-scool, Shkrimi dhe leximi gjuhësor, Mendo matematikisht, Koncepti për edukimin dhe arsimin fillor nëntëvjeçar, Teknologjia informatike kompjuterike, Paketa e gjelbër (edukimi ekologjik), Standardet për vlerësim, Zbatimi i programeve të reja mësimore në arsimin nëntëvjeçar, PHARE, Planifikimi procesual zhvillimor në shkollat fillore dhe të mesme sipas programeve të reja mësimore, Parandalimi i dhunës nëpër shkolla, integrimi ndëretnik në arsim, Avancimi i mësimdhënies për lëndët matematikë dhe shkencat e natyrës, TIK në arsim, Programet mësimore për lëndën kimi - planifikimi tematik procesual, Programet e reja mësimore për lëndët e shkencave natyrore teknike (kl. VI), Zbatimi i maturës shtetërore, Zbatimi i standardeve për notim (notimi formativ dhe sumativ), Afarizmi dhe ndërmarrësia, Mësimi aktiv interaktiv, Leximi dhe shkrimi me të mënduarit kritik, Forcimi i bashkëpunimit ndëretnik...

³ Autori i kësaj kumtese ka qënë i kyçur që nga fillimi në projektin PHARE, që në lëndët e gjuhëve amtare rezultoi me ndryshimin e programeve mesimore, duke inkuadruar dhe fuqizuar në programe fushën e rëndësishme programore të komunikimit, që kishte për qëllim të përmirësojë aftësitë komunikuese të

dhuruara me dedikim konkret, jo për të përfunduar në xhepa hajdutësh.

- Dështuan dhe seminarët e pafundme, me përfshirje të gjerë të arsimtarëve të shkollave fillore dhe të mesme, sepse askush nuk u interesua të vjelë informacionin kthyes nga terreni, për të parë sa dhe si zbatohen në praktikë risitë; askush nuk u lodh për pasojat e informacionit rrëmujë të hedhur në veshët e arsimtarit të zbritur në statusin e shkopit të lypsarit, që jeton për të edukuar me dashuri fëmijët e të tjerëve dhe vdes në këste të përditshme nga pamundësia e shkollimit cilësor të fëmijëve të vet.

- Asnjë institucion nuk i analizoi seriozisht modelet më të përshtatshme evropiane që mund të gjejnë zbatim te ne⁴, askush nuk e pati parasysh të dhënë se jo gjithçka e dëshmuar gjetiu mund të jep rezultate në kushtet dhe rrethanat tona.

- *Fiasko* që dhe projekti qeveritar për kompjuterizimin e tërësishëm të shkollave fillore dhe të mesme, i njohur si “*Kompjuter për çdo nxënës*”, që në fakt ishte monitor për çdo nxënës, por që bëri rrush e kumbulla shuma milionëshe me të cilat mund të ishte përparuar arsimi.

nxënësve. Për çudi, atëherë kur pritej që të hartoheshin tekste të veçanta mësimore për lëndët në fjalë (në lëndën Gjuhë dhe letersi shqipe akoma sot nuk ka tekste të veçanta për shkollat e mesme profesionale 4, 3 dhe 2-vjeçare, të përgatitura në përputhje me programet përkatëse mësimore...), dikujt iu tek t'i pezullojë programet mësimore të përgatitura enkas për shkollat në fjalë, duke e kthyer sërish gjendjen e para 10 viteve me aktin e heqjes nga programet të fushës programore të komunikimit. Pa dashur të asbuzojmë me këtë gjest aspak arsimor, e tëra duket se u bë shkaku i një tregu më të madh për shitje librash të ndonjë botuesi a autori tekstesh shkollore me ndikim politik jo vetëm në gjimnaze, por edhe në shkollat e mesme profesionale. Me këtë rast askush nuk u lodh me faktin se fondi i orëve të gjuhës dhe letërsisë në gjimnaze dhe ai i shkollave profesionale është i ndryshëm; se janë të ndryshme dhe kërkesat etj., etj. Po të mos ishte diçka e tillë, përse do të kërkohej që në mënyrë gati tinëzare të adaptohen programet mësimore të shkollave të mesme profesionale dhe të afrohen sa më shumë që është e mundur me programet e lëndëve të gjuhës në gjimnazet e reformuara?

⁴ Në kohën e realizimit të trajnimeve të arsimtarëve për përvetësimin e të rejave të projektit amerikan Hap pas hapi (1998 -2000), në shumëçka të ngjashëm me projektin Mësimi interaktiv..., doli në shesh e vërteta se ai ishte në fazën më eksperimentale të tij, duke qenë se kishte lindur vetëm para 5-6 vitesh në kokën e disa metodistëve të njërit prej 50 shteteve amerikane. Si i tillë, natyrisht, ai nuk kishte arritur të imponohet akoma as në shkollat amerikane të rajonit ku kishte lindur...

- Si për të kompensuar projektin e dështuar të monitorëve të shnderruar në havele elektronike, që pamundësojnë pamjen e fytyrave të nxënësve nga ana e arsimtarit të trajnuar me vite për realizimin e mësimdhënies interaktive, u shpik “*Ditari elektronik*”, që, natyrisht, nuk e largoi nga skena ditarin e rëndomtë, por ia doli ta shndërrojë arsimtarin në punëtor administrativ, të cilin më shumë e sikletos qëndrueshmëria e rrjetit të internetit nëpërmjet të cilit duhet të dërgojë titujt e njësive mësimore në labirintet e sistemit të drejtuar prej analfabetësh se sa procesi fisnik i mësimdhënies...

- Kanë dështuar gjithanshëm testimet eksterne të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, veçmas në shkollat me mësim në gjuhën shqipe për shkak të mungesës së teksteve kualitative, mungesës së këshilltarëve pedagogjikë⁵ në shumë lëndë mësimore dhe mungesës së lektorëve shqiptarë, që do t’i bënin tekstet të kuptueshme për nxënësit. Në kësi shtate, testet eksterne në shqip dalin të shfityruara dhe me gabime teknike, gjuhësore e materiale, që do të detyronin çdo shtet normal t’i anulojë në vend rezultatet diskutabile, jo të degradojë mësimdhënësit me zbritje pagash edhe ashtu mizerje...

- Të pasuksesshme janë edhe testet e maturës, sepse nuk paraqesin kurrfarë filtrash për seleksionimin e drejtë të nxënësve në pajtim me prirjet dhe afinitetet e tyre...

- Dështim janë dhe tekstet mësimore të të gjitha lëndëve në gjuhën shqipe, të përpiluara 90% prej autorësh maqedonas dhe të mbushura me leshime të qëllimshme përmbajtësore, me të cilët fyhen e poshtërohen shqiptarët, shpallen ardhacakë e qiraxhinj në trojet e tyre stërgjyshore etj...

Nga e sipërthëna (pa minimizuar edhe ndonjë të mirë të disa projekteve...) kuptohet lehtë se me çfarë serioziteti iu fut Maqedonia reformimit të sistemit të saj arsimor, që duhet t’i përgjigjej jetës dinamike të kohës aktuale.

⁵ Numri i këshilltarëve pedagogjikë shqiptarë nuk përputhet me numrin e shkollave, mësimdhënësve dhe nxënësve shqiptarë. Diskriminimi vërehet në veçanti në mungesën e një këshilltari të gjuhës dhe letërsisë shqipe, që është lëndë mësimore dhe gjuhë mësimi në shkollat me nxënës shqiptarë. Mungesa e një kuadri kaq të rëndësishëm dhe të domosdoshëm zgjat nga viti 2010. Rëndësia e këshilltarit pedagogjik për gjuhën amtare kuptohet më së miri me faktin se për vëllim të njëjtë punësh maqedonasit kanë punësuar 7-8 këshilltarë të gjuhës dhe letërsisë maqedonase dhe vetëm 1 këshilltar të gjuhës dhe letërsisë shqipe (për Shkup e Kumanovë), aq sa ka edhe për gjuhën dhe letërsinë turke?!

Dështimi i projekteve në fjalë dhe kujdesi me të cilin shtetet normale i përgatisin gjeneratat e reja për jetën e shek. XXI kuptohet nga analizat e vazhdueshme krahasimtare të suksesit të nxënësve, të verifikuara nga institucionet kredibile, si TIMSS - *Trends in International Mathematics and Science Study*, ku rezultatet e aftësive dhe shkathtësive konkrete të nxënësve të Maqedonisë janë tejet të dobëta dhe përherë ndër vendet e fundit në botë, aty ku janë dhe shtetet si: Jordani, Libani, Irani, Maroko, Tunisi, Gana...⁶

Nga e gjithë kjo më keq e ka pësuar shkolla shqipe, ndaj së cilës, për shkaqe të mirënjohura..., Maqedonia është dashur të bëjë diskriminim pozitiv, për aq kohë sa të arrijë nivelin e infrastrukturës dhe pajisjeve të shkollave maqedonase dhe të fitojë autonominë e plotë për përgatitjen e programeve dhe teksteve unike mësimore për gjithë shqiptarët, veçmas ato të lëndëve me aromë etnie, duke nisur që nga abetarja...

Mjerisht, ende nuk ndërmerret asgjë për ta përmirësuar substancialisht pozitën e arsimit shqip në Maqedoni. Prandaj në vendbanimet rurale të Velesit, Prilepit, Krushevës... ka shkolla ku nxënësit shqiptarë diskriminohen në mënyrën më të ulët, duke u detyruar të ndjekin procesin mësimor në gjuhën maqedonase. Deri vonë një shkollë e tillë ishte ajo e fshatit Mallçisht të Velesit me emrin “*Draga Stojanova*”, në të cilën me shumë vështirësi u arrit që nxënësit shqiptarë të nisin të mësojnë në gjuhën shqipe. Por ka plot të tjera ku e drejta elementare e nxënësve shqiptarë për të mësuar në gjuhën e tyre amtare mohohet nga ana e pushtetarëve maqedonas dhe heshtet nga politikbërësit e korruptuar e të hipotekuar shqiptarë (respekt përjashtimeve të rralla!). I tillë është rasti i shkollës fillore të Banjicës së Velesit, ku, për paradoks, shqiptarët vazhdojnë të trajtohen si robër, si rajë, si gjynah... në një shekull kur bota e qytetëruar drejt së cilës marshojmë me tam-tame shurdhuese, pandeh se aparthejdi ka vdekur në Afrikën e Jugut⁷. Së këndejmi, me të drejtë shtrohet pyetja: Si është e mundur që në shekullin XXI nxënësve shqiptarë t’u

⁶ Grup autorësh, Të arriturat e nxënësve nga gjuha shqipe dhe nga matematika, Biroja për zhvillimin e arsimit, Shkup, 2006, f. 23, 26, 29, 32, 35, 47, 51, 55, 59, 63, 67...

⁷ Se në çfarë shkalle është diskriminimi në fjalë kuptohet që nga mbiemrat e shqiptarëve që akoma sot përfundojnë me prapashtesën sllave “ski”: Bakioski, Dautovski, Asanovski... Tamam si para 100 e ca vitesh – në kohën e Serbit e Bullgarit, kur të gjithë mbiemrat tanë përfundonin me “ski” ose me “ov”...

mohohet shkollimi në gjuhën e shenjtë të nënës – t’u mohohet abetarja dhe alfabeti i njomur me gjak i shqipes?! Si është e mundur që në shekullin e teknologjisë dixhitale, në epokën e emancipimit të lirë gjithandej botës, fëmijët tanë detyrohen të udhëtojnë gjer në shkollat e fshatrave maqedonase jo për të marrë dije, po për t’u dresuar si shtazë, për të harruar si i thonë nënës, bukës, ujit dhe diellit shqip?!

*

Po ndalemi tani në gjërat që duhet bërë për të marrë të mbarën arsimit, veçmas arsimit shqip, që është përballur dhe vazhdon të përballët me padrejtësi të shumëllojshme.

Si e para, arsimit duhet:

Të depolitizohet në të gjitha nivelet:

- të ndërpritet diskriminimi financiar i arsimit shqip;
- të sigurohen kushte për arsimimin e njëjtë të të gjithëve, pa asnjë përjashtim (të mos ketë më mungesa shkollash, shkolla pa hapësira të mjaftueshme, shkolla ku nxënësit shqiptarë mësojnë maqedonisht, tekste me të meta të patolerueshme gjuhësore e përmbajtësore, përpilues tekstesh mësimore pa kompetencë profesionale...);
- të hapen më shumë shkolla profesionale në gjuhën shqipe dhe të përgatitet kuadri i nëvojshëm mësimdhënës për to;
- të kenë kontinuitet ndryshimet pozitive dhe të mos varen prej nderrimit të ministrave;
- drejtuesit e institucioneve arsimore të jenë apolitikë dhe profesionistë të dëshmuar të fushës së arsimit, me vizione të qarta, të jenë menaxhues të aftë, ta kenë ndjeshmërinë e duhur për sektorët që drejtojnë dhe për të cilët sjellin vendime të rëndësishme...

Të kthehet dinjiteti i arsimtarit:

- arsimtari të mos jetë objekt i papërfillshëm, por subjekt i rëndësishëm i sistemit arsimor;
- të mos varfërohet e katandiset edhe më tej, të mos mendojë më për ekzistencë fizike...;
- të mos shndërrohet në punëtor administrativ...;
- të mos çorientohet me trajnime të pafundme, efektin e të cilave e mbykëqyrin kuadrot që nuk kanë asnjë lidhje me arsimin...;
- të mos lihet i vetëm në veprimtarinë e tij fisnike për shkak se numri i profesionistëve të cilët duhet t’i ketë krahë ndihme

(këshilltarët pedagogjikë, pedagogët, sociologët, psikologët...) është simbolik...

Të bëhet reformimi serioz i sistemit arsimor me strategji të mirëmenduar nacionale:

- të sigurohen mjetet financiare për reformim;
- të studiohet fillimisht gjendja aktuale e arsimit dhe të hidhen elementet që nuk i përgjigjen kohës;
- të zgjedhet pastaj modeli më i përshtatshëm risitë e të cilit do të gjejnë zbatim praktik dhe do të japin rezultate në kushtet tona;
- asimitarët të trajnohen nga profesionistë të dëshmuar, që më pas do të kujdesen edhe për zbatimin e risive në terren...

Të fillojë ngritja e shkollave të shek. XXI:

- të pajisen shkollat me laboratore, kabinete teknologjike, mjete bashkëkohore pune...;
- të kenë prioritet në punësim mësimdhënësit që kanë *kompetencë profesionale* (njohuri të përgjithshme, aftësi për të planifikuar dhe për kryerje efektive detyrash...); *kompetencë pedagogjike – didaktike e metodike*, që nënkupton: (respektimin e procedurave shkollore, përgatitjen e njësive mësimore, aftësinë për zgjidhjen e problemeve...) dhe *kompetencë në punë – njohuri praktike*, (aftësi për bashkëpunim, parime pune, ndjenjë përgjegjësie, njohje të teknologjisë...);
- të stimulohen mësuesit që do ta lidhin punën e shkollës me bizneset dhe prodhimin;
- ta nxisin punën kreative dhe ekipore të nxënësve;
- t'i pajisin ata me vetëdije kulturore dhe me kompetenca shoqërore, qytetare, teknologjike e dixhitale;
- t'i aftësojnë të komunikojë në gjuhën amtare dhe të huaj;
- t'i bëjnë të aftë për mësim praktik dhe përdorim të teknologjisë në sferën e robotikës, animacionit, kodimit, programimit, energjisë solare...

Të faktorizohet BZHA si institucion që do t'u prijë reformave:

- Biroja për zhvillimin e arsimit⁸ ta ketë statusin e institutit, që krijon politika arsimore në bazë të hulumtimeve empirike;
- këshilltarët pedagogjikë të trajtohen si ekspertë, jo si punonjës të thjeshtë administrate⁹;
- të kompletohet kuadri shqiptar¹⁰ me këshilltarë për gjithë lëndët mesimore të shkollës fillore dhe të mesme, në pajtim me standardet...;

⁸ Byroja për zhvillimin e arsimit (BZHA) është institucion që vepron nën kulmin e Ministrisë së Arsimit. Në të janë të punësuar këshilltarët pedagogjikë, të cilët i kryejnë detyrat më të rëndësishme të lidhura për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Këshilltarët pedagogjikë janë profesionistë të fushave përkatëse, që mbulojnë lëndët mësimore të shkollës fillore, gjimnazeve dhe shkollave të mesme profesionale me kohëzgjatje 4, 3 dhe 2-vjeçare. Selia e BZHA është në Shkup, por, me qëllim të funksionimit më të mirë të punës ekzistojnë edhe njësitë ndërkomunale (rajonale) të saj. Në mesin e tyre është Njësia Ndërkomunale e BZHA për Tetovë, Gostivar dhe Dibër veprimtaria e së cilës kontrollohet nga qendra në Shkup. Kjo do të thotë se mbarëvajtja e punëve në njësitë ndërkomunale varet nga mbarëvajtja e punëve në gjithë BZHA-në...

⁹ Detyrat bazë të këshilltarëve pedagogjikë janë: përgatitja e programeve mësimore; dhënia e mendimeve profesionale për cilësinë e teksteve shkollore; dhënia e mendimeve profesionale për cilësinë e revistave shkollore dhe teksteve e burimeve plotësuese; organizimi i seminareve dhe trajnimit të mësimit; vëzhgimi i orëve mësimore dhe përgatitja e raporteve mbi cilësinë e tyre (ofrimi i ndihmës profesionale për mësuesin, me qëllim të tejkalimit të problemeve me të cilat ballafaqohen gjatë procesit të punës); kontrollimi i mbarëvajtjes së gjithë veprimtarisë edukative-arsimore në shkollat fillore dhe të mesme; ofrimi i ndihmës për funksionimin e mirë të aktiveve profesionale nëpër shkolla, nëpërmjet konsultimeve, këshillimeve dhe orientimeve të vazhdueshme; ofrimi i ndihmës profesionale lidhur me përpilimin e programeve për punën e shkollave fillore dhe të mesme; përgatitja e testeve eksterne për nxënësit e fillores dhe ato të shkollave të mesme, përfshirë këtu edhe kyçjen në punën rreth testeve të maturës (që përgatiten në institucion të veçantë..., po që është i lidhur ngushtë me BZHA) etj.

¹⁰ Po sjell në vijim të dhanat për numrin e këshilltarëve pedagogjikë në Njësinë Ndërkomunale/Rajonale të BZHA - Tetovë, Gostivar dhe Dibër, qytete këto ku për nga numri i popullatës shqiptarët dominojnë me mbi 80%. Kështu, në Tetovë ka 4 këshilltarë shqiptarë, 4 maqedonas dhe 1 turk; në Gostivar ka 1 këshilltar shqiptar, 2 maqedonas dhe 2 turq, kurse në Dibër nuk ka asnjë këshilltar pedagogjik. Siç mund të vërehet nga tabelat e mësipërme, numri i këshilltarëve pedagogjikë shqiptarë nuk përputhet me numrin e shkollave, mësuesve dhe nxënësve shqiptarë. Me një fjalë, numri i pamjaftueshëm i këshilltarëve pedagogjikë shqiptarë për mësimin lëndor, veçmas i këshilltarëve të gjuhës dhe letërsisë shqipe krijon probleme të pazgjidhshme dhe ndikon në rënien e cilësisë së arsimit të fëmijëve tanë, sepse shkollat shqipe dhe mësuesit shqiptarë kanë nevojë të përhershme për ndihmë profesionale, të cilën gjithsesi nuk mund

- të punësohen përkthyes dhe lektorë në njësitë ndërkomunale të Byrosë, që në disa segmente duhet të gëzojnë autonomi veprimi;
- nga Ministria e arsimit të përfillen mendimet profesionale të këshilltarëve mbi cilësinë e teksteve shkollore...

Të përgatiten programe dhe tekste të reja mësimore nga ekipe profesionistësh të lëndëve të caktuara dhe brenda afateve të arsyeshme për projekte të rëndësisë së veçantë:

- në veçanti meritojnë kujdes programet dhe tekstet për shkollat profesionale, që duhet të jenë në pajtim me tregun vendor dhe global të punës, të shkarkuara prej informacioneve të parëndësishme për nxënësit...;

- programet e lëndëve me aromë etnie (*Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Kulturë muzikore...*) t'i përgatisin kuadrot shqiptarë etj., etj.

*

Tani më kur është humbur mundësia e prapakhimit dhe e përmirësimit të gjërave që kanë ndodhur në të shkuarën, mund vetëm të ndiejmë keqardhje për efektet dhe përfitimet e pakta të arsimit në nivel shteti, që nuk përputhen as përafërsisht me paratë e harxhuara dhe mundin e dhënë të trajnuesve, shkollave dhe mësimdhënësve të përfshirë me vite të tëra në trajnimet e realizuara gjithandej. U tha edhe më lart se nga e tërë kjo ka një lloj përmirësimi në punë të ndryshimit të qasjes së arsimtarëve ndaj planifikimit të punës edukativo-arsimore (planeve të tyre të punës...), ndaj trajtimit të nxënësve si subjekt gjatë orëve mësimore, ndaj metodave dhe teknikave të shfrytëzuara të punës, ndaj vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive (aftësive) konkrete të tyre..., po kjo është minimale në raport me pritjet dhe vijnë si pasojë e mungesës së kontrollit të së tërës gjatë fazës së implementimit praktik të gjërave.

Kyçja e shkollave dhe mësimdhënësve në projekte të shumta brenda një periudhe të shkurtë kohore, në njërën anë, dhe mungesa e përkrahjes morale e profesionale në momentin e zbatimit të risive të mësuara nëpër trajnime, në anën tjetër, solli zhgënjimin dhe humbjen e besimit në gjithçka që propagohej e imponohej si ndryshim pozitiv në sferën e arsimit. Arsimtarët më mirë se kushdo tjetër e kuptuan se njerëzit më kompetentë të arsimit u qasen gjërave me papërgjegjësi

t'ua japin kuadro të tjera, si puna e inspektorëve të arsimit, të cilët me profesionin e tyre prej juristësh, ekonomistësh... nuk kanë asnjë mundësi të ndihmojnë në këtë aspekt.

dhe nuk mërzhiten aspak për efektet e arritura të përpjekjeve reformuese, sepse posa përfundonin mjetet financiare të një projekti përqafohet një projekt tjetër dhe humbet interesimi për projektet paraprake. Për pasojë, nuk egziston asnjë projekt i vetëm që është realizuar në tërësi dhe që sot jep fryte konkrete.

Megjithatë, rrugdalje ka dhe këtë duhet kërkuar prej ministrave të arsimit të vendit, duke insistuar fillimisht në rritjen e buxhetit të shtetit për sferën e arsimit; në zhvillimin e infrastrukturës shkollore dhe pajisjen me mjetet moderne pune; në përgatitjen dhe botimin e domosdoshëm të teksteve mësimore për shkollat e mesme profesionale, që mungojnë me dekada...; në ndërprerjen e përnjëhershme e traditës së përgatitjes së programeve dhe teksteve mësimore për afate tejet të shkurta; në punësimin e kuadrove përkatëse në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - institucionin përgjegjës për çështjet kyçe të arsimit dhe në përmirësimin e të ardhurave të mësimdhënësve të vendit, sepse vetëm arsimtarët që nuk mendojnë për ekzistencë fizike mund të jenë të dobishëm për edukimin e mirëfilltë të brezave që vijnë.

Hapin më serioz për ndryshimin e situatës në arsim duhet ta bëjë lidërshipi shqiptar në Maqedoni. Ai duhet të hapë rrugën e natyrshme të bashkëpunimit me institucionet arsimore të shtetit amë - Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, duke kërkuar një status më të denjë të shkollës dhe të gjuhës shqipe në Maqedoni, një koordinim e bashkëveprim të përhershëm ndërmjet institucioneve e njerëzish kompetentë të arsimit, ashtu siç vepron Maqedonia kur bëhet fjalë për maqedonasit e 7-8 fshatrave të Gollobërdës me vetëm 3-4 mijë frymë... Kjo duhet të nisë me tryshinë që duhet të bëhet për pranimin e ABETARES gjithkombëtare që refuzohet nga pushtetarët maqedonas, thua ti se bëhet fjalë për shpërndarje narkotikësh, jo librash më të mirë për fëmijët tanë, që do të jenë ardhmëria e këtij vendi.

Kur të ndodhin këto ndryshime dhe kur të eliminohen pengesat aktuale me të cilat përballen arsimtarët dhe nxënësit tanë, kur të kuptohet seriozisht rëndësia e reformimit të sistemit arsimor të vendit përmes projektesh e hapash të mirëmenduar që do të pasojnë pas analizave të gjithanshme të bëra nga ana e ekspertëve dhe njohësve të mirëfilltë të çështjeve arsimore, mund të shpresojmë se do të ecim drejt standardeve të aspiruara dhe të domosdoshme për kyçjen e vendit në bashkësinë e shteteve të përparuara. Ndryshe nuk do t'arrijmë kurrë të jemi të barabartë mes të barabartëve.

ALBANIAN SCHOOLING AND REFORM OF THE EDUCATION SYSTEM IN MACEDONIA

Fatmir SULEJMANI

Faculty of Philology, University of Tetova
fatmir.sulejmani@unite.edu.mk

Abstract

My paper is an attempt to shed light on the position of Albanian education in the Republic of Macedonia, on the trends for reforming the education system of this country that have started since 1996 and on the concrete results of the efforts in question.

The study provides evidence on the failed trials of reforming the education system, on the useless waste of external donors' financial resources, the ongoing but ineffective primary and secondary school teacher trainings, and the causes of failure of over 60 projects that caused more damages (in particular to Albanian education) than benefits.

The paper is among the first of its kind, so as such I hope to awaken the proper interest of the academic and intellectual world.

Bibliografia

1. ANKICA, A.: “Raport për të arriturat e nxënësve të Republikës së Maqedonisë në matematikë, fizikë, kimi, gjeografi, biologji”, BZHA, Shkup 2007 (TIMSS - Trends in International Mathematics and Science Study).
2. Grup autorësh: “Të arriturat e nxënësve nga gjuha shqipe dhe nga matematika”, BZHA, Shkup 2006.
3. NASE, K.: “Prirucnik za opisno ocenuvanie na ucenicite...”, BZHA, Shkup 2004.
4. VIOLETA, P. Beshka & KIRO P.: “Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve”, Akademia për Zhvillimin e Arsimit (AED), Shkup.

MOSPËRPUTHJET ARSIMORE DHE PROFESIONALE NË TREGUN E PUNËS DHE NDIKIMI NË PAPUNËSINË NË KOSOVË

Iliriana MIFTARI¹
Drita KAÇANDOLL²
Vlora PRENAJ³
Mujë GJONBALAJ⁴

Përmbledhje

Ky punim është një përpjekje për të studiuar papunësinë në dimensionin e mospërputhjes të ofertës dhe kërkesës në tregun e punës në Kosovë. Njëra nga arsyt kryesore për papunësinë e lartë të rinjve të diplomuar është mospërputhja e aftësive të fituara me arsimim profesional. Kjo është për shkak të përshtatjes së ngadalshme të nivelit arsimor dhe profesional me trendët dinamike në tregun e punës. Pyetja kryesore hulumtuese në këtë studim është se deri në çfarë mase papunësia në Kosovë i atribuohet mospërputhjes profesionale (horizontale) dhe arsimore (vertikale)? Të dhënat janë mbledhur përmes anketimit të përfaqësuesve të ndërmarrjeve me mbi 4 të punësuar në Kosovë. Hulumtimi është shtrirë në 202 mostra në shtatë rajonet e Kosovës. Më pas është krijuar baza e të dhënave e cila është përdorur për të analizuar treguesit themelorë të mospërputhjes horizontale dhe vertikale të të punësuarit e diplomuarit në Kosovë. Statistikat kryesore të përdorura për të shprehur këtë mospërputhje janë frekuencat, treguesit e tendencës mesatare, devijimi standard dhe statistikatat inferenciale. Për të përcaktuar marrëdhënien midis mospërputhjes profesionale është përdorur analiza e regresionit dhe korrelacionit. Gjetjet kryesore të hulumtimit tregojnë një lidhje të ngushtë arsimore dhe profesionale të të diplomuarve dhe shkallës së punësimit. Rezultatet e hulumtimit provojnë se në një ekonomi tregu çelësi kryesor për zvogëlimin e papunësisë në Kosovë është përmirësimi i kompetencave arsimore dhe profesionale të diplomuarit e rinj. Nuk ka dyshim se kompetencat arsimore dhe profesionale të diplomuarve të rinj janë ndër përcaktuesit më të rëndësishëm të pozitës së individit në tregun e punës dhe kështu edhe parakusht kyç të punësimit dhe perspektivës së punësimit.

Fjalët çelës: *Mospërputhja arsimore dhe profesionale, tregu i punës, papunësia, Kosova.*

¹ Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
iliriana.miftari@uni-pr.edu

² dritakgj@hotmail.com

³ Fakulteti i Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
vlora.prenaj@uni-pr.edu

⁴ Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
mujë.gjonbalaj@uni-pr.edu

Hyrje

Kosova është një vend i vogël, me rreth 1.8 milion banor, me standard më të ulët të jetesës në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë në përgjithësi, me një GDP për banor prej 2,560 €, që është vetëm 63 për qind e mesatares prej 4,059 € për pjesën tjetër të rajonit të Ballkanit Perëndimor⁵. Kosova ka shkallë më të lartë të papunësisë në Evropë prej 32,9% (Komisioni Evropian, 2015)/6. Ndryshimet strukturore në ekonominë e Kosovës nuk janë përcjell me përshtatje të strukturës së aftësive të fuqisë punëtore dhe rënien e shkallës së papunësimi në Kosovë. Zhvillimi ekonomik ishte i pamjaftueshëm që t'i kompensojë humbjet e vendeve të punës në procesin e privatizimit dhe për arsye të humbjes së tregjeve të produkteve dhe shërbimeve. Kjo situatë zinxhirore vit pas viti ka sjell deri te thellimi i papunësisë dhe i varfërisë në Kosovë. Papunësia dhe varfëria janë shqetësimet më të mëdha të qytetarëve të Kosovës (UNDP, 2017). Zhvillimi i ngadalësuar ekonomik ka ngulfatur tregun e punës, duke vështirësuar ruajtjen e vendeve të tanishme të punës dhe në shumë ndërmarrje krijimin e vendeve të reja të punës. Kosova ka popullsinë më të re nga të gjitha vendet tjera në Ballkanin Perëndimor (28 për qind e popullsisë është nën 15 vjet). Kërkesa për regjistrim në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës është në rritje, por tregu aktual i punës nuk arrin t'i absorbojë të diplomuarit e rinj. Zhvillimi ekonomik i përshpejtuar është përgjigje më e mirë për shtimin e vazhdueshëm të kërkesës për punë. Kjo kërkon në të njëjtën kohë një edukim cilësor, për t'iu përgjigjur kërkesave të ekonomisë dhe biznesit.

Numër i madh i studimeve i janë dedikuar natyrës dhe pasojave si dhe përkufizimit të formave të mospërputhjes mes karakteristikave të punësuarve dhe aftësive të tyre të punës. Vështirësitë me të cilat përballën sot vendet nuk është vetëm për të përmirësuar nivelet e aftësive, por për t'i përshtatur aftësitë e tyre të duhura për punët e

⁵ Data for DGP per capita in Kosovo are taken from the World Bank Economic Development Indicators, and data for the EU-28 are taken from Eurostat. Kosovo's GDP per capita is just 63% of GDP per capita in the rest of the Western Balkan region.

⁶ European Commission (2015) "2015 Economic Reform Programme (Part I) of Albania, The former Yugoslav Republic of Macedonia, Montenegro, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*" The Commission's overview and country assessments", Occasional Papers 229, Brussels: Directorate-General for Economic and Financial Affairs.

duhura. Në kushtet kur zhvillimi ekonomik dhe teknologjik po bëhet më dinamik, punët më të ndërlikuara dhe kërkesa për njerëz të aftë gjithnjë më e madhe, bëhet më e vështirë gjetja e njerëzve të duhur për punët e duhura. Gjithnjë e më shpesh vendet e reja të punës që ekonomia evropiane pritet të krijojë gjatë dekadës së ardhshme do të kërkojë kualifikime të larta. Vlerësohet se në vitin 2020, 31.5% e të gjitha vendeve të punës do të kenë nevojë për kualifikime të larta (Quintini, 2011a).

Mospërputhja e punës është një koncept i ri në tregun e punës dhe që manifeston gjendjen e përgjithshme të ekonomisë së një vendi. Fillimisht, koncepti i mospërputhjes së punës është kuptuar si mungesë e ekuilibrit mes punësisë dhe papunësisë. Që nga vitet 1970, ky koncept është njohur në literaturë si "mospërputhje strukturore", për të shpjeguar normat e larta të papunësisë, pavarësisht ekzistencës së shumë vendeve të punës. Kjo mospërputhje është cilësuar një kërcënim serioz për rritjen dhe zhvillimin ekonomik (Bartlett et. al. 2016). Referuar këtij studimi niveli i mospërputhjes së aftësive të të diplomuarve të rinj me detyrat e punës që i ushtrojnë është e ndryshme. Referuar të dhënave të këtij studimi, drejtimi i Biznesit, Administratës dhe Juridikut ka mospërputhjen më të madhe. Në vitin 2016 kishte 9066 të diplomuar në këtë drejtim jashtë tregut të punës, për shkak se nuk kishte kërkesë për një numër të tillë. Ndërkohë që kishte mungesë të profileve të të diplomuarve në shkencat e natyrës - Matematikë dhe Statistikë, ku tregu i punës ishte në mungesë për 3176 kuadro të këtyre profileve. Këto shifra flasin më së miri për shkallën e mospërputhjes dhe dëmin që i shkaktohet ekonomisë për shkak të përdorimit joefektiv të kapitalit njerëzor në Republikën e Kosovës. Secili që kryen një universitet synim kryesor ka të gjejë një vend pune që përshtatet me kualifikimin dhe profesionit për të cilin është diplomuar. Secili ka një shpresë që me forcat e tyre ose me ndonjë ndihmë të jashtme të arrijë synimet e tij në karrierë dhe të përmbushë pritshmërinë e tij/saj dhe të familjeve të tyre që kanë ndihmuar financiarisht edukimin e tyre. Sikur tregojnë rezultatet e këtij hulumtimi, të qenit me kualifikim të lartë zvogëlon mundësinë e mbetjes papunë me pothuajse përgjysmë në lidhje me grupet më pak të arsimuara. Sidoqoftë, përqindja e të diplomuarve të AL është më shumë se tri herë më e ulët sesa është në vendet e EU-28. Në Kosovë përqindja e papunësisë së të diplomuarve të rinj ishte 19% (ASK, 2016). Nëse vazhdojnë trendet e së kaluarës, mund të pritet rritje më e shpejtë e punësimit të të diplomuarve të rinj në aktivitete profesionale,

shkencore dhe teknike, duke përfshirë arkitekturën, inxhinierinë, ndërtimtarinë, tregtinë me pakicë dhe shumicë, punët shëndetësore etj. Disa sektorë, si aktivitetet financiare dhe të sigurimeve dhe aktivitetet prodhuese pritet të shënojnë trend të rënies së punësimit të të diplomuarve (Will Bartlett, 2016). Referuar të dhënave të këtij studimi, mospërputhja vertikale është e përhapur në Kosovë vetëm 47 për qind e të diplomuarve të arsimit të lartë janë mirë të përputhur me kërkesat e punës që mbajnë, 53 për qind e të diplomuarve nuk përputhen me aftësitë e kërkuara në vendet e tyre të punës, prej të cilëve 42% janë të mbikualifikuar dhe 11% janë të nënkualifikuar. Po ashtu anketa tregon se 28 për qind e të diplomuarve sipas profesionit nuk janë në përputhje me kërkesat e vendeve të punës që i ushtrojnë. Ky proporcion i mospërputhjes është i lartë edhe në vendet e BE-së ku, sipas vërtetimit të OECD, niveli më i lartë i mospërputhjes është në Itali me 34%. Edhe në rastin e hulumtimit në Kosovë është treguar se niveli i kualifikimit dhe lloji i aftësive të fituara ndikon në mundësinë e gjetjes së një pune të përputhur mirë. Është treguar po ashtu se të diplomuarit që kishin ndonjë përvojë pune përmes praktikës ose ndonjë forme tjetër të përvojës kishin më shumë gjasa të përfundonin në një punë të mirëfilltë në krahasim me të tjerët. Kjo thekson rëndësinë e përvojës së punës të fituar përmes një praktike në lehtësimin e kalimit të të diplomuarve në tregun e punës. Fusha e studimit në IAL ndikon gjithashtu në përputhjen ose jo vertikale: 27% e atyre që thanë se kishin shumë vështirësi në gjetjen e një pune për shkak të fushës së studimit ishin të punësuar në një punë për të nënkualifikuar, që tregon për një përputhje shumë të dobët. Kjo tregon se sistemi i arsimit në Kosovë prodhon më shumë të diplomuar në krahasim me nevojat e tregut të punës, duke çuar në një shkallë të lartë të papunësisë së të diplomuarve. Kjo është sidomos më e shprehur në arte dhe shkencat humane, shkencat sociale, gazetari, biznes, administratë dhe shkencat juridike. Në Kosovë e kemi edhe fenomenin e braktisjes së studimeve, që çojnë në një shkallë të ulët të përfundimit. Shumë nga ata që diplomojnë përballen për kohë të gjatë me papunësinë. Nga ata që gjejnë punë, shumë prej tyre nuk përputhen me fushën e tyre të studimit ose nivelin e kualifikimit. shëndetësisë dhe mirëqenies dhe arsim, ndoshta edhe për shkak të numrit të vogël të vendeve të punës dhe numrit relativisht më të lartë të studentëve të regjistruar. Sipas kësaj ankete, nga çdo njëqind studentë të rinj mund të pritet që vetëm gjashtë të diplomohen përfundimisht nga sistemi dhe të gjejnë një punë të përshtatshme.

Që sistemi i arsimit të lartë në Kosovë të jetë në shërbim të ndërtimit të kapitalit njerëzor, konkurrencës dhe rritjes ekonomike nevojiten reforma gjithëpërfshirëse të sistemit të arsimit të lartë, duke inkurajuar një bashkëpunim më të mirë ndërmjet punëdhënësve dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Ky problem nuk është trajtuar sa duhet nga komuniteti i gjerë akademik, rajonal, evropian madje edhe global. Kjo çështje është bërë objekt i analizës nga institucionet shtetërore, shkencëtarët dhe bizneset nën presionin e krizës ekonomike globale nga viti 2008 (Milivoje Radovic & Jovan Djuraskovic, 2016). Rritja e konkurrenca kërkonte përdorim efektiv të resurseve të punës dhe përshtatje, përshtatje më e mirë e aftësive të tyre me kërkesat në vendet e punës. Mospërputhja mesatare në tregun evropian të punës vlerësohej të ishte 29 për qind e të punësuarve në vitin 2014 (Descy & Tessaring, 2001).

Ky hulumtim empirik është ndër përpjekjet e para në Kosovë lidhur me problemin dhe pasojat nga mospërputhja në tregun e punës. Punimi ka për qëllim për t'i dhënë përgjigje pyetjes kryesore, deri në çfarë mase papunësia në Kosovë i atribuohet mospërputhjes së nivelit dhe llojit të arsimit në tregun e punës? Matja e nivelit të mospërputhjes në këtë punim është bazuar në të dhënat e grumbulluara me intervista të punonjësve dhe punëdhënësve të tyre. Përmes krahasimit të nivelit arsimor të të punësuarve me arsimimin që kërkohej në vendin e punës konstatohet nëse nevojitej arsim më i lartë, më i ulët ose i njëjtë. Mospërputhjet e nivelit ose vertikale dhe llojit të kualifikimit ose horizontale të punonjësve me kërkesat e tregut të punës më se shpeshti ndodhin për shkak të përshtatjes së ngadalshme të aftësive të tyre, ndryshimeve më të shpejta strukturore të ekonomisë në vend etj. Kjo ndodh edhe për shkak se institucionet e arsimit të lartë nuk disponojnë informacion për nevojat e tregut të punës ose pse ato i neglizhojnë këto kërkesa.

Përkundër interesit të lartë që kanë ofruesit e arsimit të lartë në Kosovë që t'i përshtatin nivelin e aftësive të diplomuarve të rinj me kërkesat e tregut, ato vazhdojnë të kenë probleme të theksuara. Ky fenomen është më pak prezent në vendet e zhvilluara, të cilat kanë investuar shumë në dekadat e fundit për përgatitjen e të diplomuarve të rinj me shkathtësi të nevojshme, duke parë te ata faktorin kryesor për rritjen e produktivitetit, rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Kosova si një shtet i ri në formim duhet të vendosë përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kompetencën e të diplomuarve të rinj si prioritet të politikave të qeverisë, duke e përafrua me kërkesat e tregut të punës.

Për këtë qëllim përgjegjësit e arsimit të lartë në Kosovë në fokus duhet të kenë përmirësimin e kapaciteteve mësimdhënëse dhe të demonstrimit praktik të njohurive të fituara nga të diplomuarit e rinj. Është provuar në shumë vende dhe ekonomi se fuqia punëtore e arsimuar dhe profesionale, e aftë për aplikim praktik të njohurive, është promotor i rritjes dhe i zhvillimit ekonomik dhe i mirëqenies së qytetarëve të saj. Njerëzit e aftë kanë tendencë të jenë më të suksesshëm në punën e tyre, duke u bërë faktorë tërheqës për më shumë investime dhe investitor vendor dhe të huaj, kur vendosin se ku duhet të investojnë. Fuqia punëtore e arsimuar dhe profesionale është shumë e rëndësishme për rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës në nivel biznesi dhe të ekonomisë kombëtare. Kjo kërkon një përshtatje shumë më të mirë të profilit të programeve të studimeve në institucionet e arsimit të lartë me nevojat e biznesit dhe ekonomisë sipas standardeve evropiane. Lidhja e ngushtë e institucioneve të arsimit të lartë me nevojat e tregut të punës mund të ndikojë në përshtatjen më të mirë të kompetencës së të diplomuarve të rinj me nevojat e ekonomisë, që do të përkthehet në rritje të vendeve të reja të punës dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.

Objektivat e punimit

Objekti kryesor i punimit është të hedhë më shumë dritë mbi gjendjen aktuale në tregun e punës në vend. Gjithashtu, objektivi tjetër është të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë në mospërputhjen vertikale dhe horizontale në kontekstin aktual në Republikën e Kosovës.

Hipoteza kryesore është se pjesa e konsiderueshme e papunësisë në Kosovë është strukturore, prej nga rrjedh pyetja kryesore e këtij hulumtimi se deri në çfarë mase niveli ekzistues i papunësisë i atribuohet mospërputhjes horizontale ose profesionale si dhe vertikale ose të aftësive. Ky punim promovon rëndësinë e tejkalimit të këtyre mospërputhjeve, si çështje jetike për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës. Punimi përfundon me formulimin e rekomandimeve dhe zgjidhjeve konkrete për të cilat do të duhej angazhuar qeveria dhe institucionet tjera vendimmarrëse në Republikën e Kosovës.

Rishikimi i literaturës së fushës

Mospërputhja e të punësuarve është një term që përfshin të gjitha llojet e pabarazive ndërmjet aftësive që i disponojnë dhe nevojave në tregun e punës. Aftësitë dhe kompetencat nuk mund të maten në mënyrë statistikore veçanërisht në vendet me nivele shumë të ulëta të arsimimit, (Sparreboom dhe Nübler, 2013). Kjo është arsyeja pse përdoren tregues indirekt për matjen e aftësive, të ashtuquajtura proxy tregues ose variabël të tilla si kualifikimet dhe vitet e arsimit në anën e ofertës dhe profesionet në anën e kërkesës. Mospërputhja në kontekstin individual më së shpeshti shprehet si i nënarsimuar ose i mbiarsimuar. Në mungesë të të dhënave për përcaktimin e qartë të aftësive shpesh shfrytëzohen sondazhet e punonjësve dhe të punëdhënësve (më shumë për këtë mund të lexoni: Johansen dhe Gatelli (2012), Quintini (2011), Sparreboom dhe Powell (2009), Wilson et al. (2014). Këtë formë të hulumtimit e kemi zbatuar në punimin tonë. Format apo llojet e mospërputhjes së aftësive me kërkesat e punës janë të ndryshme. Në vazhdim janë dhënë sqarime përkufizuese për format kryesore të mospërputhjeve (Tabela 1).

Tabela 1. Llojet më të shpeshta të mospërputhjes së aftësive

Mungesa e aftësive (suficit)	Kërkesa (furnizimi) për një lloj të veçantë aftësie tejkalon furnizimin (kërkesën) e njerëzve me atë aftësi
Hendeku i aftësive	Lloji ose shkalla e aftësive është e ndryshme nga ajo që kërkohet për të kryer punën në mënyrë adekuate
Mospërputhja vertikale	Niveli i arsimit ose kualifikimit është më i vogël ose më i madh se sa kërkohet
Mospërputhja horizontale	Lloji - fusha e arsimit ose shkathtësive është e papërshtatshme për punën
Mbiedukimi (nënedukimi)	Punëtorët kanë më shumë (pak) vite të arsimimit sesa kërkohet nga puna
Mbikualifikimi (nënkualifikimi)	Punëtorët mbajnë një kualifikim më të lartë (më të ulët) se sa kërkon puna
Shkathtësitë e vjetërsimit	Aftësitë e përdorura më parë në një punë nuk kërkohen më ose aftësitë janë përkeqësuar me kalimin e kohës

Burimi: ILO (2013).

Në vazhdim është shqyrtuar literatura empirike që shtjellon dy llojet më të shpeshta të mospërputhjes në tregun e punës: mospërputhja në nivelin e arsimit, ose vertikale, dhe i llojit të arsimit ose horizontale.

Mospërputhja vertikale ose arsimore mund të jetë në rastet kur niveli i kualifikimit të punonjësit është i papërshtatshëm për të ushtruar një profesion të caktuar, për shkak se është i mbikualifikuar ose i nënkualifikuar për punën që ai e ushtron. Një shembull tipik do të ishte rasti i një personi të kualifikuar si arkitekt, që punon si recepcionist, i cili është padyshim i mbikualifikuar, por megjithatë mund të mos ketë aftësi të komunikimit që janë të domosdoshme në këtë punë dhe prandaj mund të jetë gjithashtu i nënkualifikuar.

Ndërsa mospërputhja mund të jetë horizontale në rastet kur niveli i kualifikimit të punonjësit është i nivelit të duhur për punën e caktuar, por lloji i kualifikimit nuk është i tillë. Një shembull tipik është rasti kur një person me një diplomë në inxhinieri punon në një punë që nuk kërkon fare njohuri të inxhinierit. Këto dy koncepte, mospërputhja e nivelit dhe e llojit të kualifikimit, janë të lidhura ngushtë, por nuk janë identike (Velciu, 2017).

Mospërputhja mund të jetë edhe horizontale dhe vertikale, kur dikush mund të ketë kualifikim të nivelit të gabuar dhe të llojit të gabuar për punën në të cilën ata janë të punësuar (Stephane et. al. 2015).

Përputhja arsimore nënkupton pajtimin e numrit të personave me kualifikime të caktuara me numrin e vendeve të lira për ato kualifikime. Mungesë shfaqet kur numri i njerëzve me kualifikime të caktuara është më i ulët se numri i vendeve të lira të punës në dispozicion për ato kualifikime. Dhe e kundërta, tepërisht shfaqet kur ka më shumë njerëz me kualifikime të caktuara se sa numri i vendeve të lira për këto kualifikime (Bejaković & Mrnjavac, 2014). Kjo mospërputhje në tregun e punës konsiderohet një kërcënim serioz për rritjen dhe zhvillimin ekonomik (Chigunta, 2002) dhe përdorimin adekuat të resurseve njerëzore si faktor më i rëndësishëm i prodhimit. Pabarazitë mes kërkesës dhe ofertës në tregun e punës ndikohen nga kualiteti i kurrikulës, lloji i kurseve që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë, bashkëpunimi i universitetit me tregun e punës dhe fusha e studimit (Proasca, 2016; Robst, 2007; Verhaest et al. 2015).

Sipas Darkwa-it dhe Adu-Gyamfit (2013) boshllëku që ekziston mes aftësive të fituara në institucionet e arsimit të lartë dhe shkathtësive që kërkohen për detyrat e caktuara të punës, ndodhin pjesërisht në mungesë të komunikimit të informacionit midis

institucionit të arsimit të lartë dhe tregut të punës. Shkëmbimi i rregullt i informacionit midis tyre është i rëndësishëm për ata që kërkojnë punë, por edhe për institucionet e arsimit të lartë si dhe krijuesit e politikave (Shah & Burke, 2001). Mospërputhjet e të diplomuarve të rinj me detyrën e punës që i ushtrojnë nuk është zgjedhje vullnetare e tyre, por janë të shtyrë nga rrethana të ndryshme, sepse nuk gjejnë punë në fushën e tyre ose sepse shpërblehen më mirë në tjera profesione.

Një shpjegim tjetër për mospërputhjen midis nivelit të arsimimit dhe shkallës së punësimit ndodh për shkak të regjistrimit të numrit të madh të të rinjve në një fushë të veçantë të studimit, ku tregu për atë profil është i ngopur (Montt, 2015). Kjo prodhon pasoja negative për individin, firmën dhe shoqërinë në tërësi (Senarath dhe Patabedige, 2014). Për shembull, në nivel të firmës mospërputhja në nivelin dhe llojin e arsimit çon në një nivel të ulët të produktivitetit dhe në numër të vogël të vendeve të reja të punës. Nga ana tjetër, rekrutimi dhe trajnimi i punonjësve të rinj në mënyrë të përsëritur shkakton shpenzime shtesë për biznesin (Van dhe Velden, 2000). Kështu, individët që punojnë në një profesion që nuk përputhet me fushën e tyre të arsimimit pritet të pësojnë humbje të konsiderueshme në nivel të pagave dhe statusit të punës (Robst, 2007).

Robst (2008) sugjeroi katër hipoteza në lidhje me mospërputhjeje në tregun e punës:

E para, efekti i pagave është më e madhe kur të punësuarit nuk përputhen njëkohësisht sipas llojit, profesionit si dhe nivelit të arsimimit;

E dyta, efekti i pagave për shkak të mospërputhjes midis të punësuarve sipas nivelit dhe llojit të arsimit varet nga shkathhtësitë dhe lloji i diplomës;

E treta, efekti i pagave ka gjasë të jetë më i madh për shkak të diskriminimit mbi baza racore, shkallës së paaftësisë, përkatësisë gjinore dhe sociale;

E katërta, efekti i pagave nga mospërputhjet ka të ngjarë të jetë më i madh te punëtorët ku zgjidhja është diktuar nga oferta e jo nga kërkesa e tyre.

Prindërit që kanë investuar në financimin e edukimit të fëmijëve të tyre shpesh janë të zhgënjyer kur ata përfundojnë në punët që nuk kërkojnë arsimimin që e kanë fituar (Prisca, 2016).

Studimet e fundit kanë treguar se midis 15 dhe 35 për qind e punëve në vendet evropiane janë të nënarsimuara ose të mbiarsimuara, ku mungesa e arsimit është rast më i shpeshtë sesa arsimi i tepërt. Shkallë më e lartë e mospërputhjes është regjistruar në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit (Morgado et. al. 2016).

Mospërputhja arsimore vertikale mund të zvogëlohet kur institucionet e arsimit të lartë i ndihmojnë të diplomuarit që të përshtaten në tregun e punës (Will B et al. 2016).

Nëse i referohemi statistikave, në Kosovë 28 për qind e të diplomuarve kanë mospërputhje horizontale në punën e tyre aktuale në krahasim me fushën e tyre të studimit. Kjo është si rezultat i numrit të madh të të diplomuarve të profileve të caktuara që nuk janë të nevojshëm në tregun e punës, kështu që në mungesë të një pune detyrohen të punojnë një punë që nuk iu përshtatet profileve të tyre. Ky fenomen në Kosovë ka marrë përmasa shqetësuese, me pasojë për individin dhe ekonominë si tërësi.

Mospërputhja horizontale dhe vertikale ka ndërlidhje dhe janë të përafërta në të gjithë sektorët e aktivitetit ekonomik. Përfundimisht bëjnë "bujqësia, pylltaria dhe peshkimi", ku mospërputhja horizontale është mjaft e vogël, ndërsa për transportin dhe magazinimin për profesionet teknike dhe akademike e arteve është shumë më e lartë se mospërputhja vertikale (Lopes dhe Dewan. 2014).

Menaxhimi i sfidës së mospërputhjes së aftësive duhet të jetë një shqetësim i përbashkët i punëdhënësve, i ofruesve të arsimit të lartë dhe i shtetit. Kështu, punëdhënësit janë përgjegjës për ofrimin e trajnimeve, ndërsa ofruesit e arsimit të lartë janë përgjegjës për përgatitjen e të rinjve të përgatitur mirë, të aftë që njohurit teorike t'i praktikojnë në punën e tyre. Roli i shtetit është të sigurojë një sistem efektiv arsimor, ku aftësitë dhe kompetencat që i fitojnë të diplomuarit e rinj të jenë në përputhje me kërkesën (Velciu, 2017). Përputhja më e mirë horizontale e të diplomuarve të rinj lehtëson tranzicionin e suksesshme të tyre në punë, përdorimin më të mirë të kapitalit njerëzor dhe produktivitet më të lartë në punë. Më shumë gjasë për të gjetur një punë të përputhshme horizontalisht kanë të diplomuarit me përvojë të krijuar gjatë studimit. Praktika mund t'i ofrojë një të riu të diplomuar një mundësi që të kuptojë më mirë kushtet e punës dhe përgjithësisht të gjendet më lehtë në tregun e punës.

Mospërputhja vertikale mendohet të jetë më e lartë në vendet në zhvillim sesa në vendet e zhvilluara, ku më të arsimuarit e kanë më lehtë të gjejnë një punë të përshtatshme. Analizat empirike tregojnë se

të diplomuarit të cilët janë përshtatur mirë kanë fitime fillestare më të larta se ata që nuk kanë një përshtatje.

Metodologjia dhe metodat e hulumtimit

Punim është bazuar në shfrytëzimin e dy burimeve të të dhënave - të dhënat sekondare nga anketa e fuqisë punëtore (AFP) dhe disa publikime dhe punime të publikuara, si dhe në burimet primare nga të dhënat e grumbulluara me pyetësor. Anketa e fuqisë punëtore është zhvilluar në nivel të familjeve, sipas metodologjisë së Eurostatit, që zbatohet nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) nga viti 2014. Kjo qasje ka siguruar një krahasim ndërkombëtar të gjendjes në tregun e punës të Republikës së Kosovës me të vendeve të tjera.

Pyetëtori hulumtues i zhvilluar përbëhet nga pyetjet lidhur me perceptimet e punonjësve dhe punëdhënësve për mospërputhjen mes aftësive të të diplomuarve të rinj të punësuar dhe kërkesave në vendin e punës. Anketa përbënte gjithsej 27 pyetje, kryesisht të mbyllura me zgjedhje të shumëfishta. Të dhënat janë mbledhur gjatë dhjetorit të vitit 2017 dhe janarit, shkurtit e marsit të vitit 2018. Hulumtimi është administruar nga autorët e punimit, në përkrahje të studentëve të nivelit master. Paraprakisht janë kontaktuar përfaqësuesit e ndërmarrjeve dhe pasi që janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit dhe është siguruar leja janë realizuar 202 anketa drejtpërdrejt me përfaqësues të ndërmarrjeve me mbi 4 të punësuar, si dhe me të diplomuarit e rinj të punësuar në ato ndërmarrje. Përzgjedhja e të punësuarëve është bërë në mënyrë të rastësishme. Secili intervistues paraprakisht është njoftuar me një letër udhëzimi me shpjegime të nevojshme të pyetësit. Më pas është krijuar baza e të dhënave. Është përdorur programi statistikorë SPSS për të analizuar të dhënat e grumbulluara.

Përgjigjet e të anketuarve lidhur me variablat/faktorët e përfshirë në pyetësorë ishin të përqendruara në:

- (1) Vlerësimin e kualifikimit se sa ai i përgjigjet pozitës që e ushtrojnë të punësuarit në vendin e tyre të punës,
- (2) Vlerësimin e profesionit që e ushtrojnë, sa ai i përgjigjet punës që e ushtrojnë.

Pyetjet ishin të ndara në katër grupeve kryesore:
1. Karakteristikat e respondentit me 15 pyetje - çështje të përgjithshme si: (1) Statusi i respondentit; (2) Forma e ndërmarrjes; (3) Emri i

ndërmarrjes/institucionit; (4) Komuna, (6) Regjioni; (6) Gjinia; (7) Mosha; (8) Vitet e arsimimit; (9) Niveli arsimor; (10) Pozita që ushtroni; (11) Pozicioni në ndërmarrje; (12) Numri i viteve të përvojës në këtë pozitë; (13) Dëshironi t'i vazhdoni studimet; (14) Veprimtaria juaj që ushtroni dhe (15) Profesionin juaj që ushtroni.

2. Të dhënat për mospërputhjen vertikale dhe horizontale nga këndvështrimi i punëtorëve me 5 grupe të pyetjeve të strukturuar.

3. Të dhënat për mospërputhjen vertikale dhe horizontale nga këndvështrimi i punëdhënësve me 6 grupe të pyetjeve të strukturuar.

Më shumë për këtë shih: Pyetësin.

Me qëllim të identifikimit të mospërputhjeve në tregun e punës në Republikën e Kosovës, të gjithë të punësuarit janë ndarë sipas 8 grupeve profesionale:

1. Ekonomistë me tre profile: Ndërmarrës/menaxher, financier, kontabilist dhe marketing,

2. Jurist/ administrator,

3. Informatikë/komunikim/teknologji,

4. Inxhinieri me katër profile: Elektro, ndërtimtari, arkitekturë dhe energjetikë,

5. Bujqësi,

6. Shëndetësi,

7. Edukim/gjuhësi/ art, etj dhe

8. Matematikë/fizikë/ kimi etj.

Mospërputhja e aftësive zakonisht shqyrtohet nëpërmjet grupeve arsimore (Dur, 1999). Për shkak të mungesës së të dhënave për vendet e lira dhe numrin e punonjësve është analizuar papunësia nga mospërputhja profesionale. Në kontekstin specifik të tregut të punës në Kosovë, ne besojmë se mospërputhja profesionale/horizontale mund të ofrojë informata më të plota sesa ajo arsimore/vertikale.

Kufizimet e punimit dhe sugjerimet për hulumtimet e ardhshme

Gjithsesi, burimi më i rëndësishëm i statistikave të tregut të punës është regjistrimi i fundit i popullsisë në Republikën e Kosovës në vitin 2014. Burimi i rregullt i statistikave të punës janë po ashtu: Anketa e fuqisë punëtore (AFP) e cila kryhet çdo vit nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) dhe të dhënat nga regjistrimi i

Shërbimeve Publike të Punësimit. Duhet theksuar se AFP ka mangësitë e veta. Së pari, mostra e realizuar është e vogël, më pak se dy për qind e masës statistikore. Së dyti, anketa zakonisht realizohet në tremujorin e fundit të çdo viti dhe ka gjasë të mos arrijë të përfshijë një pjesë të punësimit sezonal. Së treti, kërkesës për punë të papunëve shpesh ju bashkohen kategoritë e njerëzve që nuk janë pjesë aktive në tregun e punës, që punojnë në tregun informal ose ka shumë të papunë që nuk janë të përfshirë në Anketë. Është shumë me rëndësi që ASK t'i adresojë këto probleme të natyrës metodologjike, që të barasvlerësojë të dhënat nga shumë burime dhe të nxjerrë tregues real në tregun e punës në nivel vendi. Vetëm në këtë mënyrë mund të monitorohen dhe ndërtohen politika aktive në tregun e punës.

Nga ana tjetër, hulumtimet si ky të fokusuar në një mostër të rastit dhe të kufizuar nuk kalojnë pa vështirësi dhe kufizime të caktuara. Në vazhdim janë pasqyruar disa nga kufizimet kryesore me të cilat jemi ndeshur gjatë realizimit të hulumtimit.

Si çdo studim i cili mbështetet kryesisht në të dhëna primare, rezultatet varen shumë nga natyra dhe cilësia e të dhënave. Duke qenë se te dhënat paraqesin perceptimet e punonjësve dhe te punëdhënësve të tyre, jemi të vetëdijshëm se të dhënat mund të mos kenë qenë të plota, ngase ka raste kur disa përfaqësues të ndërmarrjeve ose edhe ndonjë i punësuar nuk kanë treguar gatishmëri për arsye të ndryshme të japin informacion më të plotë.

Fakti se analiza sasiore ishte kryesore në këtë hulumtim, që ishte bazuar në një mostër të caktuar, ku janë intervistuar zyrtarë të lartë të ndërmarrjeve a kompanive si dhe të punësuarit në ato ndërmarrje, sado gjithëpërfshirëse të ketë qenë mostra është e mundur që në përfundimet e nxjerra të jenë bërë lëshime dhe gabime të vogla. Përgjigjet nga intervistat mund të kenë qenë në raste të caktuara të mbivlerësuara për përputhshmërinë ose mospërputhshmërinë, ku pikëpamjet e tyre për çështje të njëjta mund të dallojnë dhe të jenë nënshtruar gjykimeve subjektive profesionale.

Konsiderojmë se gabimet e mundshme mund të konsiderohen të pranueshme dhe nuk i cenojnë përfundimet e analizës. Në këtë kuptim, rezultatet sasiore të fituara me modele ekonometrie nuk duhet të shihen si shumë të sakta, por të përafërta që nxjerrin në pah se si duhet të lëvizet drejt krijimit të modelit i cili lehtëson matjen më objektive të mospërputhjeve në tregun e punës (vertikale dhe horizontale) në Republikën e Kosovës.

Këto kufizime i kemi marrë në konsideratë gjatë analizës dhe interpretimit të rezultateve dhe dhënies së përfundimeve e rekomandimeve përfundimtare.

Analiza dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimit

Në studim janë realizuar gjithsej 202 intervista të strukturuar, nga të cilat 60 janë realizuar me punëdhënës dhe 142 me punëtorë. Në kuadër të intervistave të realizuara me punëdhënës 40.6% të mostrës e përbëjnë ndërmarrjet private, 24.3% institucionet publike, rreth 11% bizneset familjare, 7.4% ndërmarrjet publike dhe 4% organizatat jofitimprurëse. Numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara është e shpërndarë në të gjitha rajonet e Kosovës, me koncentrim më të madh në rajonin e Prishtinës. Figura në vijim prezanton shpërndarjen gjinore ndërmjet punëdhënësve dhe të punësuarve.




Figura 6. Shpërndarja gjinore e intervistave të realizuara me punëdhënës dhe punëtorë

Nga rezultatet e këtij studimi shihet se shpërndarja gjinore është më e drejtë te intervistat e realizuara me punëtorë krahasuar me shpërndarjen gjinore te punëdhënësit. Ky rezultat tregon se femrat në Kosovë ende vazhdojnë të kenë mundësi të kufizuara sa i përket pronësisë ose udhëheqjes me biznese. Mosha mesatare e punëdhënësve nuk dallon shumë nga mosha mesatare e punëtorëve, ndërsa sa i përket shkollimit të dy grupet kanë shkollim të barabartë në mesatare.

Gjithashtu, niveli arsimor bachelor, master dhe me doktoratë nuk ka dallim të rëndësishëm statistikorë ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve, vlera e Hi-katrorit ishte 0.934, me shkallë të lirisë 2.

Tabela 3. Statistikat përshkruese të moshës dhe shkollimit për respondentët e intervistuar

Variabla	Njësi	Mesatarja	Devijimi i standardit
Mosha (punëdhënës)	Vite	40.73	11.10
Mosha (punëtorë)	Vite	34.08	10.44
Arsimimi (punëdhënës)	Vite	15.14	4.20
Arsimimi (punëtorë)	Vite	15.41	4.38

Nga totali i të intervistuarëve afër 32% deklaruan se pozita që ushtron kërkon shkollë të mesme, mbi 40% nivelin e studimeve bachelor dhe afër 22% studime master. Shumica e punëdhënësve janë pronarë të bizneseve dhe në të njëjtën kohë ushtrojnë edhe detyrën e menaxherit apo drejtorit të biznesit. Mbi 40% e punëtorëve të intervistuar deklarojnë se pozita që ushtrojnë në vendin e punës kërkon nivelin bachelor të studimeve dhe te mbi 20% e punëtorëve kërkohet niveli i studimeve master. Krahastuar me punëtorët e intervistuar, përqindja e punëdhënësve që shprehen se në pozitën që ushtrojnë mjafton shkolla e mesme është më e lartë 42%. Interesimi për të vazhduar studimet është më i lartë në grupin e punëtorëve, ku 70% e punëtorëve theksojnë se kanë dëshirë të vazhdojnë studimet më tutje. Krahastuar me grupin e punëtorëve të intervistuar, interesimi i punëdhënësve për të vazhduar studimet është dukshëm më i ulët. Vetëm 35% e punëdhënësve deklarojnë se ekziston dëshira për të vazhduar studimet tutje. Llojet e veprimtarisë që ushtrojnë punëdhënësit janë të ndryshme, por përqindje më e lartë është në shëndetësi (27%) dhe në tregti me shumicë-pakicë (17%).

Sa i përket profesionit që ushtrojnë punëtorët, nga totali i të intervistuarëve afër 29% ushtrojnë profesionin e ekonomistit, 22% të punëtorit shëndetësor, 15% të juristit, afër 14% të mësimdhënësit, 10% të inxhinierit dhe afër 10% të profesioneve të tjera. Profesioni më i shpeshtë në grupin e punëdhënësve ishte i ekonomistit ku 50% e

punëdhënësve deklarojnë se kanë këtë profesion, duke pasuar me atë të shëndetësisë me 27% dhe të inxhinierit me 12%.

Lidhur me rëndësinë e faktorëve që kanë ndikuar në punësim, afër 50% e punëtorëve të intervistuar e konsiderojnë përgatitjen në universitet si shumë të rëndësishëm. Përqindje afërsisht e njëjtë me përgatitjen në universitet qëndron edhe për rëndësinë e përvojës në punë (50%) në punësim. Ndërsa përqindje më e vogël, 20% konsiderojnë lidhjet familjare dhe miqësitë si faktorë shumë të rëndësishëm për punësim. Afër 60% e punëtorëve të intervistuar e konsiderojnë faktorë të parëndësishëm qendrën e karrierës së IAL-së në punësim dhe afërsisht e njëjta përqindje (56%) qëndron edhe për shërbimet publike të punësimit.




Figura 7. Rëndësia e ndikimit të faktorëve në punësim

Vetëm 27% e punëtorëve vlerësojnë si shumë të rëndësishme arsyen e ndërrimit të vendit të punës, pasi nuk përputhet me profesionin që kanë. Përqindje e vogël e punëtorëve (17%) e konsiderojnë si arsye shumë të rëndësishme ndërrimin e vendit të punës për shkak të mungësës së kolegjialitetit në vendin e punës. Gjithashtu e parëndësishme është edhe arsyeja e menaxhmentit jo të përshtatshëm në ndërrimin e vendit të punës. Si arsye shumë e rëndësishme në ndërrimin e vendit të punës duket të jetë avancimi në karrierë, pasi 51% e punëtorëve të intervistuar e konsiderojnë avancimin në karrierë shtytës shumë të rëndësishëm në ndërrimin e

vendit të punës. Fleksibiliteti në orarin e punës nuk duket të jetë arsye shumë e rëndësishme në nxitjen e punëtorëve për të ndërruar vendin aktual të punës. Për ndryshim nga kjo, ofrimi i pagës më të lartë shihet se është faktor shumë i rëndësishëm në nxitjen e punëtorëve për të ndërruar vendin e punës, ku afër 65% e punëtorëve deklarojnë se do të ndërrojnë vendin e punës për një pagë më të mirë në një vend pune tjetër. Shumica e punëtorëve të intervistuar deklarojnë se përshtatja me kualifikimin që kanë është njëri nga faktorët më të rëndësishëm që ka ndikuar të aplikojnë për këtë vend pune.




Figura 8. Rëndësia e faktorëve që kanë ndikuar në aplikim për një vend pune

Shumica e punëtorëve (57%) deklarojnë se puna që ushtrojnë përshtatet me kualifikimin që kanë. Afër 20% e punëtorëve të intervistuar mbajnë pozitën jashtë kualifikimit për shkak të mospranimit në vend pune ku përputhet me kualifikimin që kanë. Ndërsa 11% e punëtorëve heqin dorë nga mundësia për të punuar në nivel kualifikimi që kanë në këmbim të një page më të mirë në një pozitë tjetër.




Figura 9. Përputhshmëria e vendit të punës me kualifikimin

Shumica e punëtorëve të intervistuar duket të jenë të kënaqur me profesionin që kanë zgjedhur, pasi 63% e tyre deklaruan se nuk do ta ndryshonin profesionin sikur tashmë të kishin mundësinë të ripërcaktoheshin. Për ata të cilët deklaruan se do ta ndërronin profesionin po të kishin këtë mundësi, profesioni me frekuencë më të lartë që do të zgjedhej nga punëtorët është teknologji informative.




Figura 10. Përshtatja e profesionit me vendin e punës

Afër 70% e punëtorëve mendojnë se një bashkëpunim më i mirë i IAL-së me punëdhënësit kishte për ta lehtësuar dhe rritur punësimin. Pothuaj se të gjithë (96%) deklaruan se një praktikë në punë do të shtonte gjasat për gjetjen e një vendi pune. Gjithashtu shumica e punëtorëve të intervistuar (80%) vlerësojnë se përmirësimi i mësimdhënies në IAL do të lehtësonte gjetjen e një vendi pune.

Shumica e punëdhënësve (58%) i konsiderojnë shpalljet si mënyrë shumë të rëndësishme për plotësimin e vendeve të reja të punës. Përqindje më e vogël (37%) e punëdhënësve e vlerësojnë si shumë të rëndësishme plotësimin e vendeve të reja të punës përmes institucioneve të shkollimit/aftësimi. Vlerësim i njëjtë është dhënë edhe për mënyrën e plotësimit të vendeve të reja të punës përmes shërbimeve publike të punësimit. Vetëm 27% e punëdhënësve bëjnë plotësimin e vendeve të reja të punës përmes të afërmeve apo miqve. Afër 48% e punëdhënësve e konsiderojnë si mënyrë shumë të rëndësishme të plotësimit të vendeve të punës përmes avancimit të punësimit në ndërmarrje.




Figura 11. Mënyrat e plotësimit të vendeve të reja të punës nga punëdhënësit

Shumica (51%) e punëdhënësve deklarojnë se të diplomuarit ballafaqohen me vështirësi në punësim për shkak të mungesës së përvojës në punë. Përveç kësaj, arsye tjetër shumë e rëndësishme që të diplomuarit ballafaqohen gjatë punësimit është mospërshtatja me fushën e studimit. Afër 44% e punëdhënësve deklarojnë se të diplomuarit ballafaqohen me vështirësi për t'u punësuar për arsye të mospërshtatjes së nivelit të kualifikimit me vendin e punës.




Figura 12. Veshtirësitë me të cilat ballafaqohen të diplomuarit në punësim

Punëdhënësit e vlerësojnë përvojën e të diplomuarëve si një nga faktorët më të rëndësishëm që rritë gjasat për punësim. Si shumë e rëndësishme në rritjen e gjasave për punësim konsiderohet edhe ofrimi i trajnimeve shtesë në ndërmarrje dhe jashtë ndërmarrjes. Shumica e punëdhënësve të intervistuar (80%) do të punësonin një të sapodiplomuar nëse pagën mujore për një periudhë kohore e paguan një donator. Përqindje pak më e vogël (67%) e punëdhënësve do të punësonin një të sapodiplomuar nëse paga mujore do të bashkëfinancohej nga punëdhënësi me një donator.

Përfundim

Për të punësuarit përgatitja në universitet dhe përvoja në punë konsiderohen si dy faktorët më të rëndësishëm dhe përcaktues për punësim. Qëndrim i kundërt ishte për shërbimet publike të punësimit dhe qendra e karrierës së IAL.

Ekziston shpërputhje e konsiderueshme sa i përket kualifikimit me pozitën që ushtrojnë (shpërputhje vertikale), shpërputhja është e lartë edhe në atë horizontale.

Për punëdhënësit: Bashkëpunimi i IAL me punëdhënësin konsiderohet e rëndësishme në ofrimin e mundësisë që të diplomuarit të punësohen. Zhvillimi i shkathtësive të të diplomuarëve përmes modernizimit të metodave të mësimdhënies konsiderohet e rëndësishme në ofrimin e mundësisë që të diplomuarit të punësohen. Të diplomuarit me një përvojë pune kanë më shumë gjasa të gjejnë punë. Trajnime shtesë jashtë ndërmarrjes konsiderohen si shumë të rëndësishme në ofrimin e mundësisë që të diplomuarit të punësohen. Punëdhënësit e konsiderojnë si shumë të rëndësishme punësimin e një të sapodiplomuari nëse paga mujore për një periudhë kohore financohet ose bashkëfinancohet nga një donatorë.

EDUCATIONAL AND PROFESSIONAL DISCREPANCIES IN THE LABOR MARKET AND IMPACT ON UNEMPLOYMENT IN KOSOVO

Iliriana MIFTARI

Faculty of Agriculture and Veterinary, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
iliriana.miftari@uni-pr.edu

Drita KAÇANDOLLI-GJONBALAJ

dritakgj@hotmail.com

Vlora PRENAJ

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
vlora.prenaj@uni-pr.edu

Mujë GJONBALAJ

Faculty of Agriculture and Veterinary, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
mujë.gjonbalaj@uni-pr.edu

Abstract

This paper is an attempt to study unemployment in the dimension of discrepancies in supply and demand in the labor market in Kosovo. One of the main reasons for the high unemployment of young graduates is the lack of matching skills acquired through vocational education. This is due to the slow adaptation of the educational and professional level to the dynamic trends in the labor market. The main research question in this study is to what extent unemployment in Kosovo is attributed to professional (horizontal) and educational (vertical) discrepancies. The data were collected through the survey of representatives of enterprises with more than 4 employees in Kosovo. The research was extended to 202 samples in seven regions of Kosovo. Then a database was created which was used to analyze the basic indicators of horizontal and vertical discrepancies of graduate employees in Kosovo. The main statistics used to express this discrepancy are frequencies, average tendency indicators, standard deviation and inferential statistics. To determine the relationship between professional discrepancies, the regression and correlation analysis was used. The main findings of the research show a close relationship between the graduates' educational and professional competences and their degree of employability. Research results prove that in a market economy the key to reducing unemployment in Kosovo is to improve the educational and professional competencies of young graduates. There is no doubt that the educational and professional competences of young graduates are among the most important determinants of the individual's position in the labor market and thus a key prerequisite of employability and employment prospects.

Keywords: Educational and professional discrepancies, labor market, unemployment, Kosovo.

Literatura

1. Bartlett, W., Uvalić, M., Durazzi, N., Monastiriotis, V., & Sene, T. (2016). From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Western Balkans Synthesis Report. European Commission, Directorate-General for Education and Culture.
2. Bejaković, P., & Mrnjavac, Ž. (2014). Skill mismatches and anticipation of the future labour market need: Case of Croatia. *Zagreb international review of economics & business*, 17(1), 47-68.
3. Dur, R. A. J. (1999). Mismatch between unemployment and vacancies in the Dutch labour market. *Applied Economics*, 31, 237-244.
4. Chigunta, F. J. (2002). Youth entrepreneurship: Meeting the key policy challenges (pp. 1-34). Education Development Center.
5. Descy, P., & Tessaring, M. (2001). Training and Learning for Competence: Second Report on Vocational Training Research in Europe. Executive Summary. CEDEFOP Reference Series. CEDEFOP, PO Box 22427, Thessaloniki, GR-55102 Greece.
6. Johansen, J.; Gatelli, D. 2012. Measuring mismatch in ETF partner countries: A methodological note, European Training Foundation (Turin).
7. Lopes, A., & Dewan, I. (2014). Precarious pedagogies? The impact of casual and zero-hour contracts in higher education. *Journal of Feminist Scholarship*, 7(8), 28-42.
8. Morgado, A., Sequeira, T. N., Santos, M., Ferreira-Lopes, A., & Reis, A. B. (2016). Measuring labour mismatch in Europe. *Social Indicators Research*, 129(1), 161-179.
9. Montenegrin Employers Federation (MEF) & Milivoje Radovic & Dr Jovan Djuraskovic. (2016). MISMATCH BETWEEN EDUCATION AND LABOUR MARKET NEEDS . Podgorica, : Montenegrin Employers Federation (MEF) .
10. Prisca, N. (2016). Education-job mismatch among university graduates in Cameroon- The perspectives of graduates in the field of humanities. Oslo: University of Oslo.]
11. Prisca, N. (2016). Education-job mismatch among university graduates in Cameroon- The perspectives of graduates in the field of humanities. Oslo: University of Oslo.

12. Robst, J. (2007). Education and job match: The relatedness of college major and work. *Economics of Education Review*, 26(4), 397-407.
13. Senarath, S. A. C. L., & Patabendige, S. S. J. (2014). Job-education mismatch among the graduates: A Sri Lankan Perspective. *Ruhuna Journal of Management and Finance*, 1(2), 1-16.
14. Shah, C., & Burke, G. (2001). Occupational replacement demand in Australia. *International Journal of Manpower*, 22, 648–663.
15. Stephane Mahuteau, Kostas Mavromaras, Peter Sloane & Zhang Wei. (2015). Horizontal and Vertical Educational Mismatch and Wages. National Institute of Labour Studies, Flinders University, Adelaide, South Australia.
16. Sparreboom, T., & Nübler, J. (2013). Productive transformation, employment and education in Tanzania.
17. Sparreboom, T.; Powell, M. 2009. 'Labour Market Information and Analysis for Skills Development', ILO Employment Working Paper, No. 27, 2009 (Geneva).
18. Quintini G (2011a) Over-qualified or under-skilled: a review of existing literature. Social, OECD, Employment and Migration Working Papers 121, OECD Publishing, Paris.
19. Quintini, G. 2011. 'Over-Qualified or Under-Skilled: A Review of Existing Literature', OECD Social, Employment and Migration Working Papers, No. 121 (Paris).
20. Velciu, M. (2017). Job matching as a new challenge for work performance. In *Balkan Region Conference on Engineering and Business Education* (Vol. 3, No. 1, pp. 14-19). De Gruyter Open.
21. Verhaest, D., Schattelman, T., & Van Trier, W. (2015). Over education in the early career of secondary education graduates: An analysis using sequence techniques. *Young*, 23(4), 336-356.
22. Van Smoorenburg, M. and van der Velden, R. . (2000). The training of school-leavers. *Economics of Education Review*.
23. Wilson, R.A.; Tarjáni, H.; Rihova, H. 2014. A Practical Guide on Anticipation and Matching of Skills at Sector Level, Cedefop, European Training Foundation, Warwick Institute for Employment Research and International Labor Office, forthcoming.
24. www.mzv.cz/file/584501/Kosovo_Debate_on_European_Issues.pdf · PDF file

PROCESI I PËRSHTATJES DHE RISTRUKTURIMIT TË SHKOLLËS PËRKRAH ZHVILLIMIT SHOQËROR, EKONOMIK DHE POLITIK NË KOSOVËN E PAS LUFTËS – VËSHTRIM KRITIK

Jehona FERIZI-MIFTARI¹
Blerim REXHA²

Përmbledhje

Çdo gjë që ndodh në shoqëri bartet dhe reflektohet në mënyrë të tërthortë në shkollë. Sistemi i arsimit në Kosovë pas luftës pësoi ndryshime rrënjësore, ashtu që lëvizjet për reformim dhe përshtatje ndaj kushteve të reja prekën të gjitha hallkat e sistemit arsimor. Statusi politik, social dhe ekonomik në të cilin ndodhej Kosova pas lufte, si dhe forca e pamjaftueshme kadrovike për jetësimin e reformës arsimore, paraqesin sfida serioze në procesin e jetësimit praktik të reformës arsimore. Në tranzicione të tilla tentohet të barten përvojat e sistemeve arsimore më të avancuara të shteteve perëndimore. Aplikimi i këtyre reformave solli shumë pakënaqësi, vërejtje e dilema. Në këtë punim përveç vështrimit kritik kronologjik për ndryshimet që pësoi sistemi i arsimit në Kosovë, krahasohen edhe përvojat pozitive të vendeve fqinje si Shqipëria, Maqedonia, Serbia e Kroacia dhe të vendeve gjermanfolëse si Gjermania dhe Austria, gjegjësisht praktikatat që këto vende i kanë ndjekur për të tejkaluar sfidat që dalin në procesin e reformimit të shkollës. Në kontekstin kosovar, nisur nga hapat që u ndërmorën në secilën fazë të procesit, konkludojmë se inicimi i ndryshimeve në sistemin arsimor kosovar filloi duke lënë anash edhe kontekstin në të cilin funksionon shkolla. Në fund të punimit jepen edhe rekomandime për akterët e sistemit arsimor me qëllim të përbushjes së kërkesave gjithnjë e më të shtuara të shoqërisë.

Fjalët çelës: Kosovë, shkollë, reformë, tranzicion, zhvillim.

¹ Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu

² Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". blerim.rexha@uni-pr.edu.

Hyrje

Natyrisht, reformat arsimore janë pjesë e pandashme e politikave shkollore edhe të sistemeve më të avancuara të arsimit. Ngritja e cilësisë në arsim, përkatësisht ngritja e cilësisë së mësimdhënies, sot në Europë dhe Kosovë vlerësohet të jetë një proces i komplikuar. Jemi dëshmitarë të një realiteti të ri, se sot punën në shkollë e kanë përshkuar reforma të shumta. Politikat për reformimin e strukturës dhe përmbytjes së sistemit arsimor ishin nevojë imediate për t'iu përgjigjur ndryshimeve në vend. Domosdoshmëria për reformimin e punës në shkollë lidhet edhe me nevojën për t'i përgatitur nxënësit për kërkesat e reja të tregut të punës për jetën në një shoqëri moderne, demokratike. Procesi i përmirësimit të punës së shkollës kërkon bashkërendim të të gjithë faktorëve për të arritur deri te thelbi i ndryshimit. Në procesin e përmirësimit të një shkolle janë një mori faktorësh të rëndësishëm që mund ndikojnë e të cilët vlerësohen të jenë *jashtë shkollë, në shkollë e edhe në nivel individ* (Oterkiil & Ertesvåg, 2012; Berry& Eckert, 2012). Sa herë bëhet fjalë për ndryshime në arsim gjithnjë duhet të merren në konsideratë specifikat e mjedisit, përkatësisht lëvizjet e reja të sferës ekonomike dhe sociale të shoqërisë. (Edwards, 2011). Po aq me ndikim llogaritet të jetë edhe konteksti historik qoftë në nivel individual, qoftë në nivel organizativ të shkollës (Spillane J. P. et al, 2002). Si çdokund tjetër, edhe ndryshimi i sistemit arsimor kosovar ishte i nevojshëm, por edhe i domosdoshëm në rrethanat e reja shoqërore, politike në Kosovën e pas luftës. Periudha e gjatë e pushtimit, tensionet politike dhe lufta ndikuan fuqishëm edhe në mbarëvajtjen dhe cilësinë e arsimit në Kosovë. Të dhënat për periudhën para Luftës së Dytë Botërore dëshmojnë ekzistencën e 252 shkollave në Kosovë, por që në to mësimi nuk zhvillohej në gjuhën shqipe, e në vitin 1945 pati 392 shkolla, ku prej tyre 292 shkolla zhvillonin mësimdhënien edhe në gjuhën shqipe nga 300 mësimdhënës shqiptarë, 50 prej të cilëve vinin nga Shqipëria në mungesë kuadri. Rrjedha e punës së shkollës shqipe u pengua edhe gjatë periudhës kohore 1991-1999. Sistemi arsimor në Kosovë midis viteve 1992-1999 njihet si një sistem arsimit "*paralel*", apo "*në hije*", i vetëfinancuar, "*që kishte dhe akoma ka një forcë të madhe simbolike*" (Crighton et.al. , 2001, fq.8), meqë shkollat ishin shndërruar në qendra të rezistencës kundrejt asimilimit të kombit shqiptar, në frymën e patriotizmit mësimdhënësit kosovarë punonin me pak apo edhe pa pagesë (Goddard, 2007).

Situata politike në Kosovë në vitet e 90-ta, suprimimi i autonomisë së Kosovës, raportet jo të mira ndëretnike bënë që të funksionojnë dy sisteme paralele - ai shqiptar dhe serb. Acarimi i raporteve ndëretnike dita-ditës, shkelja e të drejtave të njeriut dhe kushtet jo të mira ekonomike preken edhe rrjedhën e procesit mësimor dhe cilësinë e punës. Mësimdhënia dhe të nxëniti në këtë periudhë karakterizohen si "*sistem tradicional didaktik*" në të cilin nxënësi është "*dëgjues pasiv, memorizues dhe vrojtues i ngjarjeve*". Mësimdhënësit kosovarë e kishin të vështirë zhvillimin profesional në këto rrethana, kështu që mësimnxënia ishte jo tërheqëse, monotone, jointerese, meqë përdorshin metoda dhe qasje të vjetruara të mësimdhënies (Hyseni, Salihaj, Shatri, et al., 2000, fq. 202). Në këtë periudhë kohore të represionit dhe frikës nuk mund të flitet për cilësi në mësimdhënie e nxënie dhe pikërisht kjo periudhë kohore përfshinë vite "*të humbura për Kosovën*", të cilësuar si vitet e "*izolimit nga reformat në fushën arsimore*" (Crighton et.al. , 2001, fq.16). Pikërisht për shkak të situatës së rëndë politike në Kosovë risitë arsimore të kohës nuk depërtuan (Mula et. al. 2006) dhe kjo bëri që Kosova të mbetet mbrapa me jetësim të ndryshimeve në drejtim të përmirësimit të cilësisë në raport me vendet e OECD-së apo edhe të atyre vendeve ish-komuniste në Evropën Qendrore si: Hungari, Poloni, Republikë Çeke, Slloveni, Rumani (Crighton et.al. , 2001). Nga një analizë e bërë zhvillimeve në arsimin e Kosovës theksohet se në këto kohë shkollës kosovare i është vënë epiteti "*shkollë e sëmurë apo patologjike*", meqë në shkollën kosovare nuk kishte natyrshmëri të kalimit nga njëri nivel i shkollimit në tjetrin, duke dhënë kështu shumë stres të nxënësit dhe mundësi për të krijuar shprehje, vese jo të mira, gjendje emocionale jo të mirë etj. Dhe se rrethanat në të cilat ndodhej shoqëria kosovare e bënë të qëndrueshëm togfjalëshin: "*shoqëria e shëndoshë - shkolla e shëndoshë dhe anasjelltas*" (Hyseni, Salihaj, Shatri, et al., 2000, fq. 202).

Ndryshimi i vërtetë ndodh vetëm atëherë kur ndryshohen shprehjet dhe traditat, praktikat dhe procedurat, rregullat dhe rolet. Kur flitet për shkallën e pajtueshmërisë minimale për shtrirje të ndryshimit në raport me sistemet e vlerave të atyre që janë bartës të ndryshimeve, gjetjet tregojnë se "*udhëheqësit dhe hartuesit e politikave shkollore nuk munden që në mënyrë të drejtpërdrejtë të "rikulturojnë" apo të ndryshojnë besimet dhe vlerat e njerëzve, por që ekziston mundësia "për të punuar mbi bazën e disa shkallëve të*

pajtueshmërisë minimale”, me ç’rast vihet në dukje një ndjenjë e "orkestrimit" në këtë proces të ndryshimit (Fertig, 2004, fq. 5).

Në procesin e jetësimit të ndryshimeve dhe të qenit e tyre të qëndrueshme në kohë, sipas Schlechty (1997, fq. 83) nevojiten tri lloje kapacitetesh: (i) kapaciteti për të krijuar dhe ruajtur një fokus në të ardhmen; (ii) kapaciteti për të mbajtur një drejtim të vazhdueshëm dhe (iii) kapaciteti për të vepruar në mënyrë strategjike. Studimet empirike tregojnë se menaxhimi i ndryshimeve arsimore komplekse kërkon paraprakisht të kuptuarit e përgjithshëm të natyrës së ndryshimit, ofrimi i kushteve kontekstuale që favorizojnë ndryshimin të ndodhë, delegim të qartë të përgjegjësi si dhe monitorim i vazhdueshëm i progresit bazuar në kriteret e performancës ashtu që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të korrigjuar ose përshtatur, për të qenë “*në rrugën e duhur në procesin e ndryshimit*”, meqë vërehet *tendenca e shkollave që në procesin e jetësimit të ndryshimeve të ndryshojnë drejtimin e edhe të bëjnë lëvizje në mënyrë të çrregullt* (Schlechty 1997; Fertig, 2004). Sipas Hinde (2003, fq. 2) shkollat shpesh shihen ose si “*shkak për problemet e shoqërisë, ose kurë për to*” dhe se “*shkollat janë një reflektim i shoqërisë*”. Jetësimi i politikave reformuese në mjedisin politik e sociokulturor i Kosovës ishte edhe një sfidë tjetër. Përpyekjet intensive për ristrukturimin e sistemit arsimor në Kosovë nisën me sanimin e pasojave të luftës dhe me përpjekjen për avancim të cilësisë së mësimdhënies e të nxëniet në shkolla, ku MASHT në bashkëpunim me OJQ (Organizata Joqeveritare) dhe OQ-të (Organizatat Qeveritare), partnerë zhvillimorë synon reformimin e sistemit arsimor në përputhje me zhvillimet evropiane të arsimit. Fillimisht përpjekjet për sanim u përqendruan në infrastrukturën shkollore dhe ndërtim të godinave shkollore për të rinisë punën shkollat, meqë në fillim të muajit prill 1998-99 shkollat ndërprejnë punën. Të dhënat për këtë periudhë (Crighton et.al., 2001) flasin për largim të 95.000 fëmijëve nga shkollat, një pjesë e të cilëve vijuan ca orë mësimi në kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe të luftës llogaritet se u shkatërruan plotësisht 290 shkolla (37%) dhe 800 shkolla të tjera ishin dëmtuar rëndë.

Procesi i rimëkëmbjes së sistemit arsimor në Kosovën e pas luftës (Sommers, 2004) shoqërohet me shumë sfida, të cilat kërkojnë planifikim, angazhim dhe financa. Në dy dekadat e fundit në sistemin e arsimit në Kosovë s’kanë të reshtur përpjekjet për të ngritur cilësinë e arsimit në vend. Fillimisht ishin përpjekjet për sanimin e pasojave të

luftës në Kosovë, vitet '99 kur ndërhyjnë forcat paqeruajtëse ndërkombëtare të NATO-s me qëllim të vendosjes së paqes. Kjo periudhë kohore cilësohet si kohë e zhvillimeve të mëdha në fushën e arsimit. Tani Kosova si një vend i dalur nga lufta gëzon mundësi të shumta, duke përfituar nga projekte, donacione ndërkombëtare, që ofruan organizatat e mëdha botërore (Ferizi-Mftari & Rexha, 2018). Në Kosovë vendoset Administrata e Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Investimet nuk munguan në asnjë sferë të fushëveprimtarisë jetësore. E edhe në fushëveprimtarinë arsimore u ndërmorën hapa të shumtë për përmirësimin e gjendjes që mbizotëronte. U ndërtuan e u rindërtuan shkolla të shumta. Përveç nismave për përmirësim të infrastrukturës fizike, nisi edhe krijimi i infrastrukturës ligjore. Me këtë rast vëreheshin përpjekjet për decentralizim të sistemit arsimor dhe monitorim të implementimit të politikave arsimore në rrafshin komunal. Në këto rrethana del në pah nevoja për trajnimin e mësimitdhënësve kosovarë, drejtuesve të shkollave, me qëllim të përmirësimit të praktikave të mësimitdhënies dhe drejtimit të shkollës, duke iu përshtatur risive të kohës. Në këtë periudhë krahas ndryshimeve kurrikulare nisi edhe trajnimi i mësimitdhënësve dhe drejtuesve të shkollave. Programet e trajnimit ishin të shumta dhe ato ofroheshin nga ekspertë, organizata ndërkombëtare si KEDP (Projekti Kanadez për Aftësimin e Mësimitdhënës Kosovarë), UNICEF, FSDEK, SAVE THE CHILDREN etj. Gjithashtu nuk munguan nismat për ndryshimin, përmirësimin e planeve dhe programeve mësimore, teksteve mësimore etj.

Ndërtimi i një sistemi të arsimit bazik sa më cilësor (Mula et. al., 2006) gjithëpërfshirës ishte synimi kryesor në Kosovën e pas luftës. Nga analiza dhe vlerësimi i procesit të ndryshimeve në sistemin e arsimit në Kosovë, vërejtje bëhen edhe rreth shpejtësisë së reformimit dhe influencës së saj në tërë sistemin e arsimit, me ç'rast rekomandohet të krijohet një ekuilibër në këtë drejtim (Crighton et.al., 2001). Megjithë përpjekjet e ndërmarra në drejtim të reformimit me qëllim të avancimit të cilësisë në sistemin arsimor, edhe në Kosovën e pas luftës, si në shumë sisteme tranzicioni është *"reforma pa vizion"*, si dhe vërehet mungesa e *"strategjive të qarta në nivel operativ"* (Crighton et.al., 2001, fq. 28).

Vendimmarrja në shkolla

Në procesin e përpilimit të politikave arsimore në Kosovë vazhdon të mbetet sfida vendimmarrja e cila nuk bazohet në informata

nga terreni. Në këtë drejtim pikërisht si rrjedhojë e paqartësive në prioritete dhe mosnjohje e mospranim të tyre, rezultojnë (Crighton et.al., 2001, fq. 42) të jetë *"copëzimi dhe mbingarkesa në reformën arsimore"*, dhe nevoja për të *"caktuar prioritete të qarta dhe të pranueshme nga të gjithë për të përcaktuar se çfarë duhet reformuar dhe si duhet bërë reforma"*. Në këtë drejtim munguan përpjekjet për të mbledhur dhe nxjerrë sugjerime nga të gjitha palët me rëndësi në procesin e ndryshimit, duke lënë anash kështu edhe kontekstin në të cilin funksionon shkolla. Shkolla dhe mësimdhënësit kosovarë nuk ishin në pozicion të reagimit, vetëm se merrnin përsipër detyra dhe përgjegjësi të reja (Fullan, 2001). Me këtë rast nuk u organizuan tryeza diskutimi në të cilat do të jehonte fuqishëm edhe zëri i mësimdhënësve kosovarë. Natyrisht, në vorbullën e gjithë këtyre ndryshimeve do të duhej kaheerë të hapej edhe një debat i hapur publik për të vlerësuar reformën shkollare, rrjedhën e proceseve implementuese dhe rezultatet nga faza e zbatimit të risive të parapara. Ofrimi i mundësive për një spektër të gjerë konsultimi në komunitetin e arsimit dhe mbledhje të informative kthyes nga terreni shihen si të nevojshme dhe të domosdoshme në procesin e përmirësimit të punës në shkolla. Problemet që dolën në sipërfaqe me iniciativën për reformim-ndryshime radikale në organizim dhe përmbajtje të punës në shkollë ishin të shumta e komplekse dhe se ishte i nevojshëm përkushtim i veçantë i të gjithë akterëve që i preknin ndryshimet në fjalë. Në procesin e shqyrtimit të efektivitetit të punës në shkollë, shtrohet çështja e ndikimit të faktorëve të jashtëm, në veçanti influencën e shkollës si faktor në vete. (Botha, 2010). Prej një vështrimi kronologjik të zhvillimeve në jetën shkollare, sipas OECD-së, (2013, fq. 50), prej viteve 1980 e këtej vërehen tendencat për një autonomi të shtuar të shkollës në fushën kurrikulare, menaxhimin e resurseve financiare, duke vlerësuar që shkollat janë ato që kanë dijeni më së shumti për nevojat e veta. Që nga viti 1990, shkollat vlerësohen të jenë *"institucionet e vetëpërmirësimit"* (Mincu, 2013). Sipas rezultateve të PISA-s 2012, shkollat të cilat kishin autonomi në qeverisje, sistem funksional të llogaridhënies, bashkëpunim ndërmjet mësimdhënësve dhe drejtorit në procesin e drejtimit të shkollës ishin shkolla që i karakterizonin edhe rezultatet pozitive të nxënësve në testet e PISA-s. Sipas Fullan-it (2011, fq.3) motivimi i brendshëm, përkushtimi i vazhdueshëm për përmirësim të mësimdhënësisë, puna në ekip - fryma kolektive në shkollë, janë faktorë me rëndësi jetike në procesin e reformimit dhe njëherësh shihen si *"sëmundje"* nga e cila lëngojnë sistemet e arsimit. Në sajë të analizës së zhvillimeve në

fushën e arsimit në Kosovë, cilësia e sistemit arsimor është përmirësuar, por jo siç ishin pritshmëritë. Nga një analizë e funksionimit të sistemit të arsimit në Kosovë, vlerësohet se në shkollën kosovare dukshëm mbizotëron një klimë jo shumë e mirë e bashkëpunimit ndërkolegial, mungon mbështetja profesionale për mësimdhënësit (Anastoska-Jankulovska & Skikos, 2013).

Vlerësojmë se reformimi i sistemit të arsimit në Kosovë nisi jo mirë, meqë nuk ishin llogaritur resurset humane që do të jetësonin rritje të parapara arsimore. Një armatë e tërë e mësimdhënësve kosovarë në shërbim kishin nevojën për një parapërgatitje profesionale për jetësim të risive arsimore dhe njëherësh edhe institucioni që ishte në përgatitje të mësimdhënësve të ardhshëm kishte nevojë për ndryshime të thella në strukturë dhe përmbajtje. Mësimdhënësit kosovarë nuk ishin të përfshirë sa duhej në proceset e përpilimit dhe vendimmarrjes së politikave shkollore dhe kërkimet për të prezantuar opinionin, qëndrimet e mësimdhënësve për reformën në arsim ishin të zbehta.

Performanca e shkollës

Për disa vite rresht në Europë dhe në mbarë botën janë iniciuar shumë reforma në sistemin arsimor, kjo edhe për shkak të problemeve sociale si rritja e papunësisë, rritja e dhunës dhe e pabarazisë sociale të cilat e kanë goditur shoqërinë (Backman & Trafford, 2007) dhe në një mënyrë kanë prekur edhe punën në shkollë. Përgjatë një dekade në sistemin e arsimit parauniversitar të Kosovës u bënë përpjekje të vazhdueshme për reformim në drejtim të përmirësimit të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Procesi i reformimit të sistemit arsimor në Kosovë nisi me shkollimin fillor dhe të mesëm, duke riorganizuar strukturën e sistemit të vjetër të arsimit 4 + 4 në 5 + 4 dhe moshën e hyrjes së fëmijëve në klasë të parë nga 7-vjeçare, tani në moshën 6-vjeçare, pastaj të mësuarit e gjuhëve të huaja qysh në shkollën fillore, përpilimi dhe pilotimi i kurrikulumit me nxënësin në qendër e të bazuar në kompetenca (Anastoska-Jankulovska & Skikos, 2013). Sistemi i arsimit në Kosovë tani ndahet në 6 nivele formale të arsimit dhe është në përputhje me nivelet e ISCED (AKA, 2013). Në arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës hyjnë këto nivele të arsimit: shkolla fillore (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (klasa 6-9) dhe shkolla e mesme e lartë (klasa 10-12/13).

Nivelet (SNKA)	Shkollat	Shkallet kryesore te kurrikulës	Klasat	Mosha me vjet
0	Parashkolla (Edukimi në fëmijërinë e hershme)			0–5 vjeç
	Kl. parafillore	Shkalla kryesore 1 (Përvetësim themelor)	Parafillor	5
I	Shkolla Fillore		I	6
			II	7
		III	8	
		IV	9	
		V	10	
II	Shkolla e Mesme e Ulët	Shkalla kryesore 3 (Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim)	VI	11
			VII	12
		Shkalla kryesore 4 (Përforsim dhe orientim)	VIII	13
			IX	14
III	Shkolla e Mesme e Lartë	Shkalla kryesore 5 (Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional)	X	15
			XI	16
		Shkalla kryesore 6	XII	17

Tabela 1. Organizimi i arsimit parauniversitar në Kosovë

Në përpjekjet për krijimin e një sistemi të mirëfilltë të edukimit në përputhje edhe me zhvillimet globale, sistemi arsimor në Kosovë vazhdon të përballë me shumë sfida. Në drejtim të përmirësimit të politikave shkollare në Kosovë, cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie vërehet një kujdes i shtuar në drejtim të jetësimit të gjithëpërfshirje në arsim (KEC, 2012) dhe respektim të të drejtave të njeriut, me shtimin e pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara si: komunitetet, fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me gjendje ekonomike jo të mirë. Edhe në vendet gjermanfolëse ekzistojnë përpjekje për të reformuar sistemin arsimor disa dekada rresht. Gjermania njihet për sistemin shkollor me tre nivele, ku në moshën dhjetëvjeçare të gjithë nxënësit kanë mundësinë të ndjekin një nga opsionet e shkollës së mesme: Gjimnazin, Realschule ose Hauptschule. Kjo praktikë e ndarjes në sistemin gjerman kishte krijuar kufizim të mundësive dhe me këtë rast edhe pabarazi. Rezultatet e Gjermanisë të PISA-s në vitin 2000, përveçse më të ulëta se mesatarja e OECD-së për lexim, njëherësh konfirmuan një korrelacion më të lartë midis statusit socioekonomik familjar dhe arritjeve të nxënësve. Kjo e dhënë e njohur si "goditja PISA" si dhe lëvizja globale drejt arsimit gjithëpërfshirës dhe procesi i Bolonjës (Tulowitzki et. al, 2018) nxitën debatin kombëtar mbi mënyrën më të mirë për të reformuar sistemin arsimor të Gjermanisë. Përvoja tregon se procesi i

përmirësimit të performancës së shkollës është i lidhur ngushtë me procesin e përmirësimit të performancës së mësimeve (Darling, 2000; Hattie, 2003; Hanushek & Rivkin, 2006; Buddin & Zamarro, 2008). Me këtë rast vihen re përpjekjet e para për ndryshimin e moduleve të trajnimit të mësimeve gjermanë, duke i freskuar e pasuruar ato me qëllim të ngritjes së cilësisë, ashtu që mësuesit të jenë sa më të përgatitur për t'i kryer me sukses detyrat e reja të mësimit si rezultat i reformës arsimore. Në bazë të një studimi krahasues (Zgaga, 2006, fq. 21), në vendet e rajonit një numër i madh i mësimeve përgatitjen profesionale të tyre para shërbimit e vlerësojnë si të pamjaftueshme dhe shprehin nevojën për “përmirësim”, dhe ky grupi i ashtuquajtur “grupi për përmirësim” është më i madh në Austri, Serbi, Shqipëri, Kroaci. Me fillimin e nismave për implementimin e reformës arsimore, para mësimeve kosovare dalin detyra të tjera profesionale, sfida këto që domosdoshmërisht i obligojnë mësuesit të ndjekin më tej trajnime, punëtori për t'u aftësuar për të dhënë mësim. Në sajë të të dhënave lidhur me përmbytjet në punëtoritë, trajnimet profesionale që kanë ndjekur mësuesit kosovarë (Mula et. al., 2006), del se ato kryesisht kishin funksionin të përmirësimit të praktikave të mësimit, nuk ofrohej një ekuilibër ndërmjet ofertës së trajnimeve dhe nevojave të shkollës. Me këtë rast munguan mekanizmat që do të kontrollonin cilësinë e programeve të trajnimit të mësimeve në shërbim. Mungesa e monitorimit dhe vlerësimit të programeve të trajnimit bëri që mësuesit të ndjekin tematika të përsëritura brenda programeve të ndryshme të trajnimit, madje nganjëherë edhe nga trajnerë jo të përgatitur sa duhet (Ferizi-Miftari, 2014). Procesin e hartimit të kurrikulave të reja në përgatitjen e mësuesve “në nivel ndërkufitar, rajonal dhe panevropian” në shumë vende të rajonit e përcjellën vështirësi të shumta, e që kryesisht ishin përkrahja financiare jo e mirë, infrastruktura fizike jo e përshtatshme, legjisllacioni kombëtar, por edhe mungesa e burimeve njerëzore (Zgaga, 2006, fq. 32). Formimi profesional dhe praktik i mësimeve në shërbim paraqet pikën kritike në procesin e ngritjes së cilësisë së punës në shkollë në shumë shtete të rajonit. Edhe programet e formimit fillestar të mësimeve, në varësi nga konteksti i secilit vend, i gjejmë në modalitete të shumta. *Bashkëpunimi ndërmjet fakulteteve për përgatitje të mësimeve dhe shkollës*, me ç'rast studentët mësues shkojnë në shkollë për të bërë punën praktike cilësohet të jetë për shumë prej vendeve në rajon si “mënyra më e përhapur dhe tradicionale e bashkëpunimit”. Në

saje të rezultateve të një hulumtimi për rajonin (Zgaga, 2006, fq. 25) gatishmëria kolegjiale e mësimdhënësve mentorë, njohur ndryshe si Grupi “kolegjial” më i madhi është në Serbi, ndërsa më i vogli në Austri. Kurse mospërkrahja e mësimdhënësve mentorë, në hulumtim njohur ndryshe si grupi “egoist” më i madhi është në Austri dhe pastaj në Kosovë (42.9%), ndjekur pas nga Sllovenia.

Cilësia në shkollë

Cilësia në mësimdhënie dhe në drejtimin e shkollës janë faktorë më të rëndësishëm dhe natyrshëm iniciativat për përmirësim orientohen drejt tyre. Nga përvoja e vendeve që karakterizohen me sisteme të suksesshme arsimore, që kishin nis reformat arsimore me synim të përmirësimit të cilësisë në arsim është pikërisht Gjermania që kishte përmirësim të shpejtë të sistemit arsimor (OECD, 2011), përpjekjet për përmirësimin e cilësisë i kishin nisur me përmirësimin e politikave për përgatitjen e mësimdhënësve, përkatësisht me hartimin e politikave për përgatitjen e mësimdhënësve, si dhe me rritjen e pagave të mësimdhënësve, meqë si Austrinë edhe Gjermaninë e karakterizon fuqia punëtore mësimore e plakur. Me këtë rast shohim pikërisht me qëllim të përmirësimit të situatës në shkollë në vitin 2013 u krijua Pakti i cilësisë për mësimdhënien (Qualitätspakt Lehre, 2010). Në këto vende iu dha autonomi më e madhe shkollave, drejtori është në rolin e atij që e mbështet punën e mësimdhënësit në shkollë, si dhe u përmirësuan kushtet e punës (Klump et al., 2014). Drejtorët e shkollave në Kosovë në mënyrën e reagimit ndaj mësimdhënësve kishin rolin *tradicional të hierarkisë, ku mësimdhënësit* "shihen si vartës dhe strukturat e komandimit e të kontrollimit do të jenë më të rëndësishme", e në fakt pritej që drejtorët e shkollave në Kosovë, nën presionin e reformës shkollore "të lëvizin prej qasjes tradicionale të monitorimit e të inspektimit të mësimdhënësve në marrëdhënie të ndihmës e të përkrahjes" (MASHT 2012a, fq. 15). Sipas Hargreaves (2003, fq.192) "*të njëjtat strategji të përmirësimit nuk iu përshtaten të gjitha shkollave*", përkatësisht në shkollat e vogla roli dhe fuqia ndikuese e drejtorit të shkollës është shumë më e madhe me mundësinë e ndikimit të drejtpërdrejtë në procesin, duke vizituar klasat, duke inkurajuar mësimdhënësit me përfshirjen e tyre në trajnimet, përderisa në një shkollë të madhe fuqia ndikuese e drejtorit mund të jetë indirekte. Edhe David Hopkins (cituar në Hargreaves, 2003, fq.192), i njohur me punë e tij në fushën e strategjive për

përmirësimin e punës në shkollë, thekson problemet e standardizimit, duke vënë në pah faktin që përveç llojit të shkollës duhet të merret parasysh edhe fakti që shkollat mund të jenë nëpër nivele të ndryshme të efektivitetit dhe përmirësimit të performancës së tyre, me ç'rast janë edhe strategjitë si ato për shkollën e dështuar, atë me arritje të ulët -- mesatarisht efektive dhe shkollën efektive. Nga përvojat e vendeve me synimin për të përmirësuar cilësinë e arsimit, fushat e tjera ku u përqëndrua vëmendja drejt reformimit ishte edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, me ç'rast Austria paraqiti një vlerësim të centralizuar (Zentralmatura) për certifikatën e shkollimit të mesëm të lartë, megjithatë pati reagime që shprehin nevojën për ndryshime për të përmirësuar organizimin e vlerësimit si dhe përmbajtjen e tij. Përqafimi i vlerave perëndimore, filozofive, strategjive të ndryshme mësimore, metodologjive të mësimdhënies dhe vlerësimit pa përfillur kontekstin vendor, rrethanat specifike në të cilat ndodhej shoqëria kosovare, duke mos përfillur kështu as traditën arsimore në vend (Koliqi, 2004) ishin arsytet që mbjellnin dyshime në çështjen e jetësimit të suksesshëm të reformës arsimore. *Ne vlerësojmë se po kështu në Kosovë të njëjtat strategji të përmirësimit nuk iu përshtaten të gjitha shkollave kosovare*, meqë ato ndjeknin modele standarde perëndimore të përmirësimit për shkollën, duke lënë anash kushtet në të cilat ishin shkollat në Kosovë. Me mbarim të shkollës së mesme, nxënësit kanë për t'iu nënshtruar provimit të maturës, për të fituar të drejtën për të vazhduar më tej në arsimin e lartë. Në sistemin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë, me përfundimin e klasës V, IX dhe XII, përmes vlerësimit të standardizuar (Testit të arritshmërisë, Provimit të maturës) matet niveli i arritshmërisë së nxënësve. (Anastoska-Jankulovska & Skikos, 2013). Austria nga viti 2015 futi edhe punimin e diplomës si pjesë e vlerësimit të arritshmërisë së nxënësve, të cilët kryesisht kanë synim shkollimin e mëtutjeshme universitar.

Konkluzione dhe rekomandime

Sipas Creemers (2007) në procesin e përmirësimit janë disa faza në të cilat kalon shkolla, fillimisht bëhet vlerësimi i nevojave për përmirësim, diagnostifikimi i nevojave për përmirësim dhe vendosja e qëllimeve specifike, pastaj planifikimi i aktiviteteve të përmirësimit, zbatimi në praktikë dhe në fund të këtij procesi vjen edhe vlerësimi dhe reflektimi. Shkollë e mirë është ajo shkollë ku udhëheqja është

efektive, sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së punës është funksional.

Duke pasur parasysh faktet dhe analizën e argumenteve të shtjelluara në punim, si dhe gjendjen aktuale të arsimit në Kosovë, ofrohen këto rekomandime për institucionet relevante shtetërore të fushës së arsimit:

- Në procesin e zhvillimit profesional mësimdhënësve duhet t'u ofrohet një laramani e ofertave trajnuese, këshilluese e informuese dhe të bëhet përzgjedhja e tyre varësisht nga nevojat për zhvillim profesional të mësimdhënësve në bazë shkolle.
- Ndryshmi i pozicionit të drejtorëve të shkollave në procesin e përmirësimit të performancës së shkollës, me ç'rast drejtorët ishin shumë pak të përgatitur në drejtim të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe se përqendrimi i tyre më shumë ishte në domenin administrativ të punëve të mësimdhënësit dhe shkollës në përgjithësi.
- Institucionet e formimit fillestar të mësimdhënësve të kenë përgjegjësi edhe trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve, meqë përmes kësaj sigurohet një koordinim më i mirë, me mundësi bashkëpunimi midis mësimdhënësve para shërbimit me ata që tashmë janë në shërbim.
- Të jetësohen nismat për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, meqë informacioni kthyes do të ndikojë fuqishëm në motivimin e mësimdhënësve drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies e edhe të punës në shkollë, njëherit do të krijoheshin politikat dhe kushtet për të përkrahur dhe mbështetur zhvillimin profesional të tyre.
- Me qellim të përgatitjes sa më të mirë të nxënësve për karrierë akademike të rikthehet punimi i temës së diplomës në shkollën e mesme, që përgatisin nxënësit për universitet.

THE PROCESS OF SCHOOL ADAPTATION AND RESTRUCTURING SUPPORTS SOCIAL, ECONOMIC AND POLITICAL DEVELOPMENTS IN POST-WAR KOSOVO - CRITICAL REVIEW

Jehona FERIZI-MIFTARI

Faculty of Electrical and Computer Engineering,
University of Prishtina “Hasan Prishtina”
jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu

Blerim REXHA

Faculty of Electrical and Computer Engineering, University of
Prishtina “Hasan Prishtina”
blerim.rexha@uni-pr.edu

Abstract

Everything that happens in a society is transmitted and reflected indirectly in its schools. The education system in post-war Kosovo underwent radical changes, and the reform and adaptation movements affected all the links of the education system. The political, social and economic status of post-war Kosovo, as well as insufficient staffing capabilities for implementing educational reform, represent a serious challenge in the process of practical implementation of educational reform. In such transitions there are drives to transfer the experiences of the most advanced educational systems of western countries. The application of these reforms brought much disappointments, objections and dilemmas. This paper, apart from the chronological critical review of the changes the education system in Kosovo went through, compares the positive experiences of neighboring countries such as Albania, Macedonia, Serbia and Croatia, and German-speaking countries such as Germany and Austria, i.e. practices that these countries have followed to overcome the challenges that arise in education reforms. In the Kosovo context, based on the steps taken at each stage of the process, we conclude that the initiation of changes in the Kosovo education system started in disregard of the context in which these schools operate. In conclusion, the paper provides recommendations for stakeholders in the education system in order to meet the increasing demands of the society.

Keywords: Kosovo, school, reform, transition, development.

Literatura

1. Anastoska-Jankulovska, M. and Skikos, H. (2013) Teacher Education and Training in the Western Balkans: Report on Kosovo, Publications Office of the European Union, Luxembourg. <http://bookshop.europa.eu/mt/teacher-education-and-training-in-the-western-balkanspbN C0113481/downloads/NC-01-13-481> (22 December, 2017).
2. Berry, B. and Eckert, J. (2012) Creating Teacher Incentives for School Excellence and Equity, National Education Policy Center, Boulder, CO, <http://nepc.colorado.edu/publication/creatingteacher-incentives> (22 December, 2017).
3. Botha, R.J. (2010) 'School effectiveness: conceptualising divergent assessment approaches', South African Journal of Education, Vol. 30, No. 4, pp.605–620.
4. Buddin, R., & Zamarro, G. (2008). Teacher quality, teacher licensure tests, and student achievement. Santa Monica, CA: RAND.
5. Creemers, Bert PM, Louise Stoll, and Gerry Reezigt. (2007). "Effective school improvement—Ingredients for success: The results of an international comparative study of best practice case studies." *International handbook of school effectiveness and improvement*. Springer Netherlands. 825-838.
6. Crighton, J., Bakker, S., Beijlsmit, L., Crisan, A., Hunt, E., Gribben, A., Ramsey, G., Roberts-Schëitzer, E., Sahlberg, P., Stromberger, C. and Ëhitman, I. (2001) Thematic review of national policies for education—Kosovo, Organisation for Economic Cooperation and Development.
7. Darling, L. (2000). How teacher education matters. Journal of Teacher Education, Vol. 51, No. 3, May/June 2000 166-173. The American Association of Colleges for Teacher Education)
8. Deissinger, T. (2004). Germany's system of vocational education and training: challenges and modernisation issues. *International Journal of Training Research*, 2(1), 76-99.
9. Dohmen, D. (2006). Germany's Education System in an International Perspective—An Analysis in Relation to

- Innovation. In *National Systems of Innovation in Comparison* (pp. 245-262). Springer, Dordrecht.
10. Edëards, G. (2011). The past and future inside the present: Dialectical thinking and the transformation of teaching. *Journal for Critical Education Policy Studies*, 9(2), 43-59.
11. Ferizi-Miftari, J., & Rexha, B. (2018). The teachers' impact on policy making for the improvement of the school performance (the case of Kosovo). *International Journal of Education Economics and Development*, 9(1), 80-104.
12. Fertig, M. and Wallace, M. (2004) 'Modelling complex educational change: a preliminary literature review', British Educational Research Association (BERA) Annual Conference, pp.2004–2009.
13. Fullan, M. (2011) Choosing the Wrong Drivers for Whole System Reform, Centre for Strategic Education.
14. Goddard, J. T. (2007). The professional development needs of educational leaders in post-conflict Kosovo. In *The Educational Forum* (Vol. 71, No. 3, pp. 200-210). Taylor & Francis Group.
15. Hanushek, E. A., & Rivkin, S. G. (2006). Teacher quality. *Handbook of the Economics of Education*, 2, 1051-1078.
16. Hargreaves, A. (2003) Teaching in the Knowledge Society: Education in the Age of Insecurity, Teachers College Press.
17. Hattie, J. (2003). Teachers make a difference: what is the research evidence?(p. 4). Melbourne: Australian Council for Educational Research.
18. Hinde, E. (2003) 'Reflections on reform: a former teacher looks at school change and the factors that shape it', *Teachers College Record*, Vol. 8, No. 3, p.03.
19. Hopkins, D., Stringfield, S., Harris, A., Stoll, L. and Mackay, T. (2014) 'School and system improvement: a narrative state-of-the-art review', *School Effectiveness and School Improvement*, Vol. 25, No. 2, pp.257–281, <http://digital.library.louisville.edu/utls/getfile/collection/etd/id/1964/filename/4761.pdf> (18 November, 2017).
20. Hyseni et al. (2003). Qeverisja dhe udhëheqja në arsim. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).
21. Jacob, M., & Solga, H. (2015). Germany's vocational education and training system in transformation: Changes in

- the participation of low- and high-achieving youth over time. *European Sociological Review*, 31(2), 161-171.
22. Klumpp, L., Pont, B., Figueroa, D. T., Albiser, E., Eitzenberg, D., Zapata, J., & Fraccola, S. (2014). Education Policy Outlook: Germany. *OECD Publishing*.
23. Koliqi, H. (2004) Education System in Kosovo, LibriShkollor, Pristina. Kosovo Parents' Council (2014) <http://36283.activeboard.com/forum.spark?forumID=36283&p=3&topicID=12892943> (Accessed 12 January, 2018).
24. Lamza-Maronić, M., Glavaš, J., & Vukašinović, A. (2011). Primary school education system in Croatia—improvements through a strategic management model (case study). *International Journal of Knowledge and Learning*, 7(1-2), 39-50.
25. Loëther, J. (2004). The quality of Croatia's formal education system. *The competitiveness of Croatia's human resources*, 13-25.
26. MASH.T.(2012a). Udhëzim Administrativ nr. 02/2012: Standardet e praktikës profesionale për drejtorët e shkollës http://www.masht.gov.net/advCms/documents/udhezim_administrativ_04_2012_shqip.pdf
27. Miftari - Ferizi, J. (2014). The school reform effects and challenges in teachers professional development (the teacher's voice). SGEM2014 Conference Proceedings, ISBN 978-619-7105-24-7/ ISSN 2367-5659 Vol. 3,
28. Mincu, M. (2013) Teacher Quality and School Improvement: What is the Role of Research?. Research and Teacher Education: The BERA-RSA Inquiry, BERA, London.
29. Mula M. (2006) Qualitative Basic Education in the Context of Human Development, Research Report, KEC, Pristina. National Qualification Authority (2011) National Qualification Framework, Retrieved from: http://akk-ks.net/uploads/national_qualifications_framework.pdf (Accessed 22 December, 2017).
30. OECD (2003) Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe, Vol. 1, Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Kosovo, Publishing. OECD (2013) PISA 2012 Results: What Makes Schools Successful? Resources, Policies and Practices, Vol. IV, OECD Publishing, PISA.

- Oterkiil, C. and Ertesvåg, K.S. (2012) 'Schools' readiness and capacity to improve matter', *Education Inquiry*, Vol. 3, No. 1, pp.71–92.
31. Schlechty, C.P. (1997) *Inventing Better Schools: An Action Plan for Educational Reform*, JosseyBass Publishers, San Francisco.
32. Schleicher, A. (2011), *Building a High-Quality Teaching Profession: Lessons from around the World*, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264113046-en>
33. Schreier, G. (1991). Reforming teacher training and the school system. *World Affairs*, 154(1), 36-40.
34. Sommers, M. and Buckland, P. (2004) *Parallel Worlds: Rebuilding the Education System in Kosovo*, International Institute for Educational Planning, Paris.
35. Tuloëitzki P., Krüger M., Roller M. (2018) Education Policies, the Teaching Profession and Teacher Training in Germany—The Ever-Evolving 16-Piece Mosaic. In: Normand R., Liu M., Carvalho L., Oliveira D., LeVasseur L. (eds) *Education Policies and the Restructuring of the Educational Profession. Perspectives on Rethinking and Reforming Education*. Springer, Singapore.
36. Wolter, A., & Kerst, C. (2015). The 'academization' of the German qualification system: Recent developments in the relationships between vocational training and higher education in Germany. *Research in Comparative and International Education*, 10(4), 510-524.
37. Zgaga, P. (2006). Perspektiva mbi përgatitjen dhe trajnimin e mësuesve në Europën Juglindore, Vështrim i përgjithshëm rajonal. Rrjeti i Bashkëpunimit Arsimor të Europës Juglindore (SEE ECN, South-east European Education Cooperation Network).

SFIDAT DHE MUNDËSITË NË TREGUN E PUNËS NË KOSOVË PËRMES ZHVILLIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT TË AVANCUAR NË FUSHËN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (EE) DHE BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË (BRE)

Violeta NUSHI¹
Mehmet QELAJ²

Përmbledhje

Një prej sfidave më me rëndësi në zhvillimin ekonomik në Kosovë është sistemi i avancuar në arsimin e lartë dhe profesional në eficiency të energjisë (EE) dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE). Ekzistojnë shumë lëmenj shkencor dhe profesional që përmes sistemeve të avancuara mund të bëhen kërkime shkencore në fusha të caktuara. Një ndër fushat më me perspektivë në Kosovë është ngritja e sistemit të avancuar në arsimin e lartë në fushën e EE dhe BRE-ve, meqë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë ka mungesë të stafit akademik, arsimor dhe profesional në këtë fushë. Sfidë kryesore në këtë drejtim është ngritja e kapaciteteve me kuadër të ri shkencor dhe profesional si në arsimin e lartë, ashtu edhe në atë të mesëm. Kjo arrihet përmes studimit, hulumtimit dhe zhvillimit shkencor dhe profesional në Kosovë, e cila sot ka një përmasë të gjerë hulumtuese dhe implementuese, duke marrë për bazë studimin e eficiency së energjisë për objektet publike-universitare nëpër Kosovë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Me një avancim më të gjerë të kurrikulave dhe me reformim të disa indikatorëve në arsimin e lartë dhe profesional në Kosovë do të mundësohet krijimi i vendeve të reja të punës në këtë fushë.

Fjalët çelës: Arsimi i lartë, eficiency e energjisë (EE), burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), zgjuarsia, qëndrueshmëria.

¹ Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. violeta.nushi@uni-pr.edu

² Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë, Kosovë. mehmet.qelaj@gmail.com

Hyrje

Energjia dhe burimet e mjaftueshme të energjisë përbëjnë një nga sfidat më të mëdha të civilizimit njerëzor sot e sidomos të vendeve në zhvillim. Mungesa e burimeve të mjaftueshme të energjisë dhe potencialit ekonomik për t'i identifikuar dhe shfrytëzuar ato ka ngritur nevojën për shfrytëzim sa më efikas dhe më eficient të sasisë ekzistuese të energjisë. Këto shqetësime shtohen edhe me problemet që rrjedhin nga rritja e sasisë së dioksidit të karbonit (CO₂) të emetuar në atmosferë, një problem ky i identifikuar në nivelin ndërkombëtar.

Në vitin 2015 Marrëveshja e Parisit propozoi një objektiv global të temperaturës (UNFCCC, 2015) jo më shumë se 1.5 - 2.0 C. Shumë studime të ndryshme në nivelin ndërkombëtar analizojnë dhe identifikojnë kërkesën e energjisë dhe emetimet e CO₂ në vendet e tyre për të parë rritjen e përgjithshme të nivelit të CO₂ në nivelin global (LI J.-F. et al., 2018). Rrjedhimisht, strategjitë e prodhimit dhe konsumimit të energjisë janë të varura dhe nga konceptet dhe metodologjitë lidhur me një kontekst të relacionit gjeografik të kërkesës për energji, si: praktikave sociale, vendeve të punës, mjedisit, etj. (Hui, A., Walker, G., 2018).

Reflektimet e sfidave të tilla pa dyshim ngjallin kërshërinë për studime të trendeve të reja në edukimin e lartë, me qëllim që të analizohen dhe propozohen masat e shtimit të profesionistëve dhe akademikëve të pajisur me dije të nevojshme për të kuptuar fushën e energjisë në kuptimin e gjerë, ose sektorin e energjisë së ripërtëritshme në kuptimin e ngushtë (Friman, 2017).

Këto sfida shfaqen e ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në janar 2016 Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë kombëtare të zhvillimit 2016-2021 (SKZH, 2016), ku, ndër tjera, janë parashikuar katër masa me prioritet për zhvillimin e sektorit të energjisë: 1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe energjia e qëndrueshme; 2. Krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike; 3. Ulja e konsumit të energjisë përmes masave eficiente dhe 4. Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Secila prej objektivave për sektorin e energjisë shoqërohet me masa konkrete veprimi. SKZH ka shërbyer si bazë referuese për hartimin e Strategjisë së energjisë të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka hartuar Strategjinë e energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 (SERK, 2017) me qëllim të që orientojë objektivat themelore të qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, furnizimin e sigurt dhe cilësor të konsumatorëve, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtëritshme, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit natyror dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

Sektori i energjisë zë një vend të rëndësishëm edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA, 2016) që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Sipas MSA Kosova obligohet të përmbush detyrimet që lidhen me integrimin në tregun e përbashkët rajonal që përfshinë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Zbatimi i kësaj marrëveshje lidhur me energjinë përfshinë: konkurrencën në tregun e energjisë; ruajtjen e mjedisit; eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë, detyrime këto të cilësuar si mjaft serioze e që duhet të përmbushen nga Republika e Kosovës për sektorin e energjisë në periudhë të caktuar kohore. Strategjia e energjisë për vitet 2017-2026 i adreson këto sfida. Ndër të tjera, e bazuar në analizën e hollësishme të sektorit të energjisë, SERK ka përcaktuar pesë objektiva strategjike: 1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike; 2. Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë; 3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja; 4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; 5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në eficiencë të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Në këtë drejtim ka shumë shembuj të studimeve, si të autorëve (Ott, A., et. al. 2018), që kanë për qëllim që të gjejnë mënyra për të përmirësuar përvojat e studimit tradicional të edukimin për energjinë diellore, duke integruar edhe ndikimet e aspekteve sociale, sociologjike dhe pedagogjike në mënyrën e të menduarit dhe të edukimit. Autorët në këtë kërkim diskutojnë zhvillimin e kurrikulave dhe mjeteve pedagogjike për mësimdhënie dhe mësimnxënie në fushën e arsimit të energjisë së ripërtëritshme me qëllim të një qasjeje paraprake për të përfshirë arsimin për energjinë diellore në kuadrin e versionit të përmirësuar të teorisë sociokulturore për mësim, me synimin për të lidhur këtë fushë arsimore e edukative me arsimin

bashkëkohor dhe me hulumtimin bashkëkohor të krijimtarisë inovative, përkatësisht me qëllim që të lidhë këtë fushë arsimore me neuroshkencën arsimore dhe me hulumtimet bashkëkohore të krijimtarisë.

Në diskutimet e mëtutjeshme duhet të marrim parasysh edhe një sërë sfidash për traditën tonë bashkëkohore në lidhje me arsimin. Këto sfida mund të ndikojnë dhe të kërcënojnë "zonën tonë të rehatshme" subjektive dhe mendore. Kur u përgjigjemi këtyre sfidave, ne duhet ta gjejmë të frytshëm arritjen mendore, ta lëmë këtë zonë "të kufizuar" për të hyrë në "zonën e pakufizuar" të mësimnxënies të ashtuquajtur zonë e zhvillimit *proksimal*³ (*zone of proximal development, ZPD*).

Sipas mendimeve dhe diskutimeve të autorit (Matusov, 2015), roli i edukimit dhe i ndryshimeve cilësore të proceseve njohëse ose kognitive gjatë fazave të zhvillimit është t'u japë fëmijëve përvojat që janë brenda zonave të tyre të zhvillimit proksimal për të inkurajuar dhe avancuar mësimin e tyre individual, siç janë aftësitë dhe strategjitë, e që mund të bëhen koncepte gjithnjë e më të rëndësishme në kontekstin e edukimit për EE dhe BRE. Meqë asnjë parim i vetëm nuk mund të llogarisë zhvillimin individual pa iu referuar kontekstit social dhe kulturor brenda të cilit është ngulitur. Proceset më të larta mendore në individë kanë origjinën e tyre në proceset shoqërore. Veçanërisht është i rëndësishëm procesi mendor i ashtuquajtur ndryshim i mendjes, siç tregohet nga neuroshkencëtarja Susann Greenfield në librin e saj *Mind Change* (Greenfield, 2014). Ajo argumenton se ndryshimi i mendjes, sipas pikëpamjes së saj, është shkaktuar edhe nga teknologjitë bashkëkohore dixhitale dhe është kërcënuese për ndotjen e mendjes së gjeneratave të ardhshme mu sikur realiteti i ndryshimeve klimatike që shkaktohet nga ndotja e atmosferës sonë.

Sipas autorëve (Brown, et.al., 2009) lidhur me ndryshimin e mendjes nga dizajni, apo si dizajnimi i mendimit transformon teoritë arsimore dhe inspiron inovacionin, citojmë: "dizajni ka fuqinë për të pasuruar jetën tonë duke ndryshuar emocionet tona përmes imazheve, formës, strukturës, tingullit të ngjyrave dhe erërave. Natyra thelbësore

³ Zhvillimi proksimal, shpesh i shkurtuar si ZPD, është dallimi ndërmjet asaj që një nxënës/studentë mund të bëjë apo se çfarë nuk mund të bëjë pa ndihmën e mësimdhënësit. Koncepti është i prezantuar, por jo i zhvilluar plotësisht nga psikologu Lev Vygotsky (1896–1934) në të cilin thuhet se një fëmijë ndjek shembullin e një të rrituri dhe zhvillon gradualisht aftësinë për të kryer detyra të caktuara pa ndihmën e tutorit.

e njeriut në qendër të mendimit të dizajnit tregon hapin e ardhshëm: mund të përdorim ndjeshmërinë dhe mirëkuptimin e njerëzve për të dizajnuar përvoja që krijojnë mundësi për angazhim dhe pjesëmarrjen aktive”, mund të aplikohet si një ndër teoritë edhe në arsimin gjithëpërfshirës në fushën e EE dhe BRE-së.

Plani strategjik për zhvillimin e arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021, i hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka për qëllim të përcaktojë kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit në periudhën 2017-2021, në mënyrë që arsimi të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Por mbetet për t’u parë se si t’i adresojmë sfidat në drejtim të ngritjes së kapaciteteve - kapitalit njerëzor, shkencor dhe profesional në arsimin e mesëm e të lartë në fushën EE dhe BRE, në kuadër të detajuar dhe të mbarështuar si nënobjektivë e PSAK-ut. Ndonëse në PSAK është menduar për edukimi gjithëpërfshirës si një ndër shtatë fushat tematike që mbulojnë të gjitha segmentet relevante të arsimit në Kosovë, si: pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja, menaxhimi i sistemit arsimor; sigurimi i cilësisë, zhvillimi i mësimdhënësve, mësimdhënia dhe të nxënësve, arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve, si dhe arsimi i lartë.

Për sa i përket dimensionit ndërkombëtar, PSAK përpaket të merr parasysh politikat dhe strategjitë përkatëse të realizuara në kontekstin e katër objektivave të përbashkëta të BE-së për të trajtuar sfidat në sistemet e arsimit dhe aftësimin deri në vitin 2020, të detajuara në Arsimi dhe aftësimi 2020 (ET 2020), si: 1. Bërja realitet e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit; 2. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe aftësimin; 3. Promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive; 4. Shtimi i kreativitetit dhe inovacionit, duke përfshirë ndërmarrësinë në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin, përfshirë këtu edhe arsimin dhe edukimin në EE dhe BRE.

Mbetet që ky qëllim të ketë vijimësinë e proceseve të deritanishme drejt zhvillimit të vazhdueshëm në studimet, hulumtimet dhe zhvillimit shkencor e profesional në fushën e EE-së dhe BRE-së, me strukturë të mjaftueshme të kuadrove, që mund të përcjellë procesin dhe sistemin arsimor, por që njëkohësisht ka potencialin e mjaftueshëm intelektual e praktik për të bërë zhvillimin dhe aplikimin e të arriturave bashkëkohore në fushën EE-së dhe BRE-së. Rrjedhimisht, avancimi i kurrikulave dhe reformimi i disa indikatorëve në arsimin e lartë dhe profesional në Kosovë do të mundësonte ngritjen dhe krijimin e vendeve të reja të punës në këtë fushë.

Pyetja hulumtuese – metoda dhe konteksti

Për sa u tha më sipër, pyetja hipotetike është sa dijmë për *zgjuarsinë*⁴ në kontekst të arsimit të lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të shkencës dhe të teknologjisë në fushën EE dhe BRE në Kosovë. Ndonëse kjo pyetje është ‘po aq e thjeshtë’ aq sa është i ndërlikuar raporti ndërmjet ciklit jetësor të materies/njerëzimit me çështjet si: burimet e natyrës, gjendja shoqërore, ekonomike dhe kulturore; përgjigjet që duhet vërtetuar në vijimësi janë ato që mbeten të argumentojnë vlerat kualitative dhe kuantitative të po atyre çështjeve, si: *Kur mbesim pa burime të mjaftueshme nga natyra? Nëse na mungon mirëqenia ekonomike apo nëse mbesim të paedukuar e të paarsimuar?* Ndërveprimi dhe ekuilibrimi i përdorimit të *zgjuar* të burimeve natyrore, të ekonomisë së *zgjuar* dhe komunitetit të *zgjuar* kërkon lëvizjen në të gjitha drejtimet, veçanërisht në atë qarkore dhe me inicim drejt përparimit dhe inovacionit për të ngritur kualitetin e jetës. Një mënyrë për të matur masën e një mostre të *kualitetit të jetës* është të kuantifikohet, përkatësisht të përcaktohet sasia e inercisë së po asaj mostre, që është e ‘detyrueshme’ të lëvizë shprehimisht si në fig. 1.




Figura 1. Ndërveprimi i zgjuarsisë për kualitetin e jetës

⁴ Zgjuarsi-a – ndjeshmëria e individit ndaj çështjeve problematike, kuptimi i lehtë i tyre dhe mendjemprehtësia e perceptimit të lehtë mendor të raporteve parësore e dytësore, si dhe shpejtësi e të gjeturit të rrugëve dhe të mjeteve që kontribuojnë në zgjidhjen e tyre. Zgjuarsia si tipar i personalitetit me anën e të cilit njeriu gjen lehtë dhe shpejtë rrugëdalje në situata problematike, i organizon lehtë dhe shpejtë sjelljet për arritjen dhe zotërimin e një qëllimi të parashikuar, kur para tij dalin pengesa e vështirësi të mëdha, duke ruajtur qëndrueshmërinë emocionale dhe motorike të tij (Nushi, 2014).

Metodat

Efikasiteti i energjisë dhe burimet e ripërtritëshme të energjisë janë fusha multidisiplinare, të nivelit të lartë dhe të ndërlikuar të indikatorëve dhe asnjë nga disiplinat si e vetme nuk ofron një garanci për qasjen e arritjes së potencialit të plotë të kursimeve të energjisë, ndonëse problemet e energjisë me të cilat ballafaqohet shoqëria shqyrtohen nëpër disa disiplina akademike. Sipas autorëve (Hoover & Harder 2015), nëse duam të lëvizim drejt transformimit real për qëndrueshmërinë, duke praktikuar atë që e predikojmë, atëherë duhet të sjellim në dritë dhe t'u drejtohem me hapur pjesëmarrësve, studentëve e profesionistëve gjatë sesioneve, leksioneve e trajnimeve. Programet e arsimit dhe trajnimit efektiv për EE nuk kanë të bëjnë vetëm me mësimdhënien dhe mësimnxënien, por edhe me të komunikuarit të përvojave në mënyrë efektive, veçanërisht e mësimëve të nxjerra nga praktikuesit të cilët realisht realizuan projekte inxhinierie në një mjedis të vërtetë industrial.

Hulumtimi kuantitativ dhe kualitativ i tri pyetjeve për çështjet se çfarë është, përse është i tillë dhe si u zhvillua arsimit i lartë për EE dhe BRE në Kosovë është bërë me rishikimin e literaturës dhe të dhënave vendore e ndërkombëtare, sikurse edhe me sondazhin në institucionet e EE-së dhe BRE-së në Kosovë, përkatësisht përfundimet e dala nga qasja sasiore, të plotësuara dhe të bashkërenduara me përfundimet nga qasja cilësore e çështjeve të hulumtuara. Ndonëse, nga rishikimi gjithëpërfshirës i një numri të konsiderueshëm të literaturës është vënë re se ka shumë iniciativa që janë të lidhura me hulumtimet kuantifikuese-sasiore të arsimit të lartë në fushën e EE-së dhe BRE-së.

Megjithatë, sa i përket matjes së rezultateve të të nxënies, ende ekzistojnë shumë hulumtime që duhet të bëhen për të funksionalizuar kompetencat dhe për zhvilluar instrumentet matëse që bëjnë vlerësimin dhe monitorimin e zhvillimit të kompetencave (Adomßent, et al., 2013). Në këtë drejtim *metaetnografia*⁵ e trajtuar nga autorët (Noblit & Hare, 1988) mbetet si metodë ndihmëse ndaj pamjaftueshmërisë për të perceptuar rishikimin e literaturës dhe metodologjinë e analizës sistematike për të sintetizuar në mënyrë kuptimplote të dhënat nga hulumtimi empirik i pyetësorit. Kjo metodë

⁵ Metaetnografi-a – Është metodë që bën sintetizimin dhe interpretimin e hulumtimeve kualitative e cila e ka zanafillën e saj në fushën e mjekësisë.

përfshin një proces të 'rikapitulimit' të pjesëve të veçanta të hulumtimit kualitativ, duke i analizuar dhe sintetizuar ato në kontekstin e studimeve të tjera të ndërlidhura, perspektivat dhe kuptimet nga studimet e ndryshme të kombinuara dhe interpretuara për të krijuar kuptime të reja. Ndonëse u zhvillua fillimisht në hulumtimin e arsimit, më tutje është përdorur gjerësisht në studimet e shëndetit dhe sëmundjes, në rastin e këtij hulumtimi, për të dhënat lidhur me arsimin e lartë në EE dhe BRE në Kosovë është përdorur si metodë për të bërë një pasqyrë të sintetizuar të zhvillimit të arsimit të lartë dhe institucioneve për EE-në dhe BRE-në.

Kjo metodë është në kontrast me metodat e tjera të sintezës cilësore, siç janë sinteza tematike ose sinteza e kornizës - kufijve, meqë kjo metodë mund të vihet në përdorim më të mirë nga ekipet hulumtuese shumëdisiplinare, duke përfshirë hulumtimet kualitative në fushën e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, makinerisë, elektrike, IT-së, etj., që lidhen dhe adaptohen me vlerësimin e arsimit të lartë të institucioneve në Kosovë për EE dhe BRE, duke respektuar shtatë shkallët e metaetnografisë si: të filluarit, përcaktimi se çka është relevante për interesin fillestar, të lexuarit e studimeve, përcaktimin se si janë të ndërlidhura, përkthimin e studimeve në njëri-tjetrin, sintetizimin e përkthimeve dhe interpretimin e sintezës.

Burimi i të dhënave - përzgjedhja dhe analiza

Revistat dhe artikujt shkencorë, të identifikuar për të shprehur iniciativat për çështjen hulumtuese, janë në gjuhën angleze dhe të gjetura përmes mekanizmit të kërkimit akademik IT në bazën e të dhënave: *ISI Web of Knowledge*, *Science Direct*, *Elsevier online*, *Google Scholar*, por vetëm për revistat *Open Access*. Temat e përfshira dhe të kërkuara ishin: 'arsimi i lartë', 'efiçienca e energjisë', 'burimet e ripërtitëshme të energjisë' dhe 'qëndrueshmëria'. Përmbledhja e sintetizuar e literaturës së hulumtuar është bërë përmes mekanizmit të kërkimit shtesë apo *follow-up*, duke përdorur tiparet e artikujve tjerë të lidhur aty ku është e mundur, apo duke shfletuar nëpër revista kryesore të fushës së hulumtimit, si: *Journal of Cleaner Production*; *International Journal of Sustainability in Higher Education*; *Environmental Education Research and International*; dhe *Journal of Education for Sustainable Development*.

Disa nga të dhënat kuantitative lidhur me fjalët kyçe të hulumtimit në Evropë janë të analizuar nga të dhënat në raportet e platformës *EuroStat* (Key Data on Education in Europe, 2012) dhe (Key Figures on Europe, 2017). Duke u nisur nga sasia e madhe e të dhënave në dispozicion në *Eurostat*, në këto raporte gjendet një përzgjedhje e rëndësishme dhe interesante e statistikave. Veçanërisht analiza që bëhet kur merren parasysh rekomandimet për peizazhin e arsimit në të gjithë Evropën, i cili po ndryshon shumë shpejtë. Në samitin e Goteborgut, 2017, liderët e BE-së përshkruan një vizion për arsimin dhe kulturën dhe në Konkluzionet e dhjetorit të vitit 2017 Këshilli Evropian u bëri thirrje Shteteve Anëtare, Këshillit dhe Komisionit të ndërmarrin një sërë nismash, duke përfshirë "... forcimin e partneriteteve strategjike në të gjithë BE-në midis institucioneve të arsimit të lartë dhe nxitjes së krijimit të 20 universiteteve, të përbërë nga rrjetet e poshtme të universiteteve në të gjithë BE-në, të cilat do t'u mundësojnë studentëve të marrin një diplomë duke kombinuar studimet në disa vende të BE-së për të kontribuar në konkurrencën ndërkombëtare të universiteteve evropiane.

Iniciativa e universiteteve evropiane i përgjigjet kësaj thirrjeje dhe në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë organizatat studentore, shtetet anëtare dhe Komisionit BE është një nga iniciativat kryesore të ambicieve të BE-së për të ndërtuar një hapësirë arsimore evropiane e cila do të ndihmonte të tejkalohen sfidat e shumta që kanë të bëjnë me modele të ndryshme bashkëpunimi. Ky bashkëpunim parashikohet të jetë i bazuar në këto parime: një aleancë e partnerëve të zgjedhur nga të gjitha llojet e institucioneve të arsimit të lartë që mbulojnë një fushë të gjerë gjeografike evropiane; një strategji të parashikuar afatgjate e të fokusuar në qëndrueshmërinë, përsosmërinë dhe vlerat evropiane; një ofrim i kurrikulave të përqendruara në studentë të shpërndarë bashkërisht në një kampus ndëruniversitar, ku një organizim i ndryshëm i studentëve mund të ndërtojë programe të tyre dhe të përjetojë lëvizshmërinë në të gjitha nivelet e studimit; një qasje të bazuar në sfida ku studentët, akademikët dhe partnerët e jashtëm mund të bashkëpunojnë në ekipe ndërdisiplinore për të trajtuar çështjet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Evropa sot.

Kufizimet dhe të gjeturat

Siç u tha më sipër, me theks të veçuar empirik për këtë hulumtim janë përzgjedhur informacionet që kanë të bëjë me arsimin

dhe trajnim, si: në BE kishte 19.6 milion studentë të arsimit të lartë në vitin 2016, nga të cilat 61% ishin duke studiuar për gradën bachelor - arsimi terciar që është niveli i arsimit pas shkollimit të mesëm; në vitin 2016, 54% e studentëve të nivelit të lartë në BE ishin të gjinisë femërore; shumica e studentëve për studime të doktoraturës ishin të gjinisë mashkullore; pothuajse një e treta e studentëve të arsimit të lartë në BE në vitin 2016 po studionin shkencat shoqërore, gazetarinë, informacionin, biznesin, administratën ose ligjin (si në figurën 2); në vitet e ardhshme shumë komentues parashikojnë se do të ketë një kërkesë në rritje për njerëz me aftësi të larta, meqë mangësitë e aftësive tashmë ekzistojnë në disa shtete anëtare të BE-së; të shtyrë nga teknologjia digjitale, vendet e punës po bëhen më fleksibile dhe komplekse që rezultojnë me një numër në rritje të punëdhënësve që kërkojnë staf me kapacitet të nevojshëm për të menaxhuar informacione komplekse, që mendojnë në mënyrë autonome, që të jenë krijues dhe inventiv, që të përdorin burimet në mënyrë të zgjuar dhe efikase si dhe që të komunikojnë në mënyrë efektive.





Figura 2. Shpërndarja e studentëve të arsimit terciar (bachelor) sipas fushës dhe gjinisë

Nga raportet e Eurostat-it është përzgjedhur si e rëndësishme e dhëna lidhur me trendin në rënie të shkëputjes së të rinjve të moshës 8-24 nga arsimi dhe trajnimi. Tendencia e strategjisë së arsimit në BE 2020 është që mos të jetë nën numrin e 10% të braktisjes a shkëputjes së studentëve të përgjithshëm, figura 3.

Early leavers from education and training, EU-28, 2002-2017

(% of the population aged 18-24)




Note: Breaks in time series in 2003, 2006 and 2014.

Source: Eurostat (online data code: t2020_40)

*Figura 3. Të braktisurit e hershëm nga arsimi dhe trajnimi, grupmosha 18-24 vjet***Primary energy consumption and final energy consumption, EU-28, 2000-2016**

(Million tonnes of oil equivalent (Mtoe))




Source: Eurostat (online data codes: sdg_07_10 and sdg_07_11)

eurostat

a.

Final energy consumption in households per capita, EU-28, 2000-2016

(kg of oil equivalent)



Note: Breaks in time series in 2001, 2008, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 and 2015; 2012-2016 data are (provisional) estimates.

Source: Eurostat (online data code: sdg_07_20)

eurostat

b.

Figura 4. a) konsumi primar dhe final i energjisë dhe b. konsumi final i energjisë në familje për kokë banori

Po ashtu, në drejtim të fjalëve kyçe të punimit janë të përzgjedhura të dhënat për EE dhe BRE në raportet e *Eurostat-it*. Nga aty, figura 3, vërejmë se BE ka bërë progres substancial drejt caktit të efikasitetit energjetik, por ka nevojë ende për përmirësime. Përderisa konsumi i energjisë primare dhe asaj finale është drejt kontrollit të mirë, konsumi final i energjisë në familje për kokë banori është sërish në rritje. Indikatorët e tillë si dhe ata të papunësisë, figura 4, mund ta harmonizojnë nevojën për zgjerimin e nevojave të arsimit dhe trajnimit të kuadrove të cilët kontribuojnë në zbutjen e papunësisë dhe zhvillimin e programeve që mbështesin ndërlidhjen efektive të arsimit me tregun e punës.

Qëllimi i punës së mëtejme empirike është bërë përmes pyetësorit me institucionet, OJQ-të, shoqatat tregtare, praktikuesit dhe mësimmësuesit për të kuptuar dhe vërtetuar mendimin se përfitimi i shumëfishtë i kuadrit akademik dhe profesionistëve të fushës për EE dhe BRE mund të përdoret në avokimin e jetës reale me politikanët, shërbyesit civilë dhe vendimmarrësit e tjerë, përkatësisht të kuptojmë se a ka programe të akredituara dhe cilit nivel të arsimit i takojnë, a ka staf të mjaftueshëm akademik e profesional për t'i udhëhequr ato programe, a janë të kënaqur me stafin profesional që punojnë në programet e tyre dhe cilat janë specifikat e fushës EE ose BRE në programet e akredituara? Në fund, si e mendojnë zhvillimin e arsimit të lartë në të ardhmen e afërt në Kosovë. Janë anketuar 22 pjesëmarrës nga 7 institucione të përzgjedhur përmes rrjeteve profesionale, bazuar në reputacionin e krijuar të secilës organizatë dhe përvojën e të intervistuarit në përdorimin e qasjes së përfitimeve të shumëfishta me vendimmarrësit e lartë. Pyetësorët u realizuan me garanci anonimiteti, prandaj u përdorën shkronja në vend të emrave të individëve ose të organizatave, industrisë, pushtetit ose të akademisë si në tabelën 1.

Tabela 1. Pasqyra e organizatave të anketuara

Kodi	Përshkrimi i Organizatës
A	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 4 pjesëmarrës
B	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit, 2 pjesëmarrës
C	GIZ, 2 pjesëmarrës
D	Universiteti i Prishtinës, 5 pjesëmarrës
E	Universiteti UBT, 2 pjesëmarrës
F	Profesionistë të pavarur, 5 pjesëmarrës
G	Firma projektuese – NGO, 2 pjesëmarrës

Anketimi ka rezultuar i suksesshëm dhe rezultati i përmbledhur është: vetëm në 2 institucione është i akredituar programi për EE dhe BRE; niveli i arsimit aty është bachelor dhe master profesional; programet janë të akredituara nga MASHT-i; ka mungesë të programeve profesionale në arsimin e mesëm; ka staf që është mjaftueshëm i arsimuar në fushën EE; stafi profesional për EE është i certifikuar nga universiteti; 30% kanë studiuar për EE dhe 28% janë të kënaqur me studimet dhe 30% e sheh zhvillimin e arsimit për EE dhe BRE në nivelin bachelor, 20% në nivel master, 10% në nivelin PhD; përderisa 16% nuk i janë përgjigjur fare anketimit.

Përfundime dhe rekomandime

Ekziston interes në rritje për konceptin se efikasiteti i energjisë ka ndikime ekonomike, mjedisore dhe sociale përtej kursimit të energjisë dhe kostos - një perspektivë me 'përfitime të shumta'. Megjithatë, vendimmarrja e BE-së mbi efikasitetin e energjisë bazohet në vlerësimin e një game shumë të ngushtë të kostove dhe të përfitimeve. Edhe në Kosovë, institucionet e arsimit të lartë për EE dhe BRE luajnë një rol të rëndësishëm në tranzicionin drejt një shoqërie më të zgjuar dhe më të qëndrueshme, rrjedhimisht përfituese. Në këtë kontekst ka pak institucione që kanë hyrë në një udhëtim drejt përmbushjes së nevojave të tregut të Kosovës, meqenëse deri më tani ka pasur kërkime jo të mjaftueshme që janë të ndërlidhura me proceset organizative dhe programore. Janë të identifikuar disa dëshmi se faktori shoqëror (njerëzor) ka detyra të rëndësishme në procesin e ndryshimeve në fushën e EE dhe BRE.

Sipas analizës së literaturës, anketimit dhe gërshetimit të hulumtimit kualitativ me kuantitativë, është parë një identifikim i një numri të panjohurash dhe kontradiktash që i karakterizojë proceset e tilla. Sfidat dhe mundësitë në tregun e punës në Kosovë përmes zhvillimit të sistemit të arsimit të avancuar në fushën e EE-së dhe BRE-së ndikohen nga perceptimi se kush ka fuqi për të ndikuar në ndryshimet, rrjetat dhe strukturat institucionale dhe vendimmarrëse.

Diskutimet duhet të bëhen lidhur me avancimin e hulumtimit dhe praktikës për të zbutur tensionet dhe kontradiktat ekzistuese përmes praktikës reflektive dhe dialogut të singertë, si dhe zhvillimit të strukturave fleksibile ndërmjet akademisë dhe tregut të punës apo dhe lëvizjes drejt të mësuarit "të dyfishtë" brenda institucioneve. Rezultati

përfundimtar i trajnimit praktik është një studim paraprak i veçantë i kompanisë që merret me pikat e dobëta të energjisë dhe masat e efijencës së energjisë që kanë një potencial të lartë zbatimi.

Bazuar në përvojën e fituar gjatë 4 viteve të fundit të zbatimit të programit të arsimit dhe trajnimit në Kosovë, mund të përfundojmë se ekspertët e energjisë e vlerësuan me të vërtetë arsimimin dhe trajnimin e tyre praktik, sikurse trajnerët profesional. Sfidat e ardhshme të programit të arsimit dhe trajnimit duhet të jenë të lidhura me aktivitetet pasuese, zhvillimin e mjeteve interaktive dhe përshtatjen e kurrikulës për të plotësuar nevojat në vazhdimësi në rritje të ekspertëve të energjisë nga industria.

Kurrikula e programit për arsimin dhe trajnimin duhet të ofrojë një bazë solide për rritjen e njohurive dhe aftësive të profesionistëve për EE dhe BRE, me theks në përvojat praktike në lidhje me vendosjen, demonstrimin, matjen dhe verifikimin e zgjidhjeve efikase për efijencë të energjisë në industri dhe ndërtesa, me trajnim të vazhdueshëm. Nga anketimi që përfshiu pjesëmarrësit të cilët kanë trajnime të shtuara profesionale kuptuam se është stimuluar ekonomia, përkatësisht janë bërë kurse të konsiderueshme të energjisë në kompanitë e tyre e edhe në objektet që janë trajtuar mbi bazën e auditimit të përgjithshëm.

Të gjithë të anketuarit kanë argumente për shumë përfitime nga përvoja e tyre. Këto argumente janë më bindëse kur lidhen me vlerat dhe prioritetet e vendimmarrësve dhe politikanëve, shumica e të cilëve nuk e vlerësojnë efikasitetin e energjisë si përfitim në vetvete. Kontekste të ndryshme dhe përfitime të ndryshme janë pak a shumë të spikatura për palët e ndryshme të interesit. Si i tillë, kërkohet të ketë më shumë prova sesa një përqendrim i thjeshtë në kursimet e energjisë dhe lloje të ndryshme provash të cilat mund të lidhen me një sërë vendimmarrësish. Rëndësia e njohjes së konteksteve, aktorëve, vlerave, prioriteteve të ndryshme ka çuar në zhvillimin e një vizualizimi alternativ të përfitimeve të shumëfishta, që e bënë të qëndrueshme fushën e EE-së dhe BRE-së.

Përkundër disa përparimeve në zhvillimin e praktikës së mbledhjes së të dhënave të tregut të punës dhe hartimit të Strategjisë për arsim dhe këshillim në karrierë 2015-2019, mungesa e orientimit dhe qendrave të këshillimit të karrierës në shkollë në nivel komunal dhe në nivel kombëtar, si dhe mungesa e informatave nga tregu i punës mbeten sfida të rëndësishme. Në mënyrë të ngjashme, përkundër punës së mirë të MASHT-it në Strategjinë për praktikën

profesionale 2013-2020 dhe zhvillimin e dy udhëzuesve për ndërmarrjet dhe shkollat profesionale me qëllim që të ofrohen mundësi për bashkëpunim më të madh, deri më tani ende nuk ka ndonjë marrëveshje ndërministrORE për të lehtësuar këtë bashkëpunim dhe për të mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale të nxënësve.

Çështjet tjera të cilat kanë nevojë për vëmendje në arsimin e lartë në EE dhe BRE përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të stafit mësimdhënës, sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe ndërmarrjeve, rishikimin e standardeve ekzistuese të profesionit dhe zbatimin e standardeve që mungojnë. Sfidat e tjera janë zhvillimi i kurrikulit bërthamë për EE dhe BRE, korniza për profilet profesionale, modularizimi i kurrikulave ekzistuese të EE-së dhe BRE-së dhe zhvillimi i kurrikulës së re modulare të bazuar në kompetenca sipas standardeve profesionale, cilësia e mësimit praktik dhe trajnimi në shkollat profesionale dhe mbështetja për mësimdhënësit e EE-së dhe BRE-së nga programet e zhvillimit profesional.

Falënderime

Jemi mirënjohës për kooperimin e kolegëve të institucioneve pjesëmarrëse në anketimin si dhe GIZ-it - Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit për krijimin e kushteve të anketimit, i cili u realizua gjatë procesit të trajnimit të trajnerëve për auditim energjetik në Kosovë, proces certifikues që u organizua dhe u mbështet nga GIZ-i dhe u mbajt nga EIHP & FIRE, Republika e Kroacisë. Ky punim nuk merret me ndonjë të dhënë të re të prodhuar si pjesë e këtij procesi certifikues, prandaj e gjitha literatura sekondare është referuar plotësisht.

CHALLENGES AND OPPORTUNITIES IN THE LABOR MARKET IN KOSOVO THROUGH THE DEVELOPMENT OF AN ADVANCED EDUCATION SYSTEM IN THE FIELD OF ENERGY EFFICIENCY (EE) AND RENEWABLE ENERGY RESOURCES (RES)

Violeta NUSHI

Faculty of Civil Engineering and Architecture,
University of Prishtina “Hasan Prishtina”
violeta.nushi@uni-pr.edu

Mehmet QELAJ

Ministry of Economic Development, Kosova
mehmet.qelaj@gmail.com

Abstract

One of the most important challenges in economic development in Kosovo is the advancement of the system of higher education and vocational education in energy efficiency (EE) and renewable energy sources (RES). There are many scientific and professional areas in which scientific research can be made through the advanced system. One of the most promising areas in Kosovo is the establishment of an advanced system of higher education in the field of EEs and RESs, since the higher education system in Kosovo lacks sufficient academic, educational and professional staff in this field. The main challenge in this regard is capacity building with new scientific and professional cadres in both higher and secondary education levels. This is achieved through academic work, research and scientific and professional development in Kosovo, which today has a wide research and application dimension, based on the study of energy efficiency for public/university facilities throughout Kosovo for a sustainable economic development. With a broader curriculum advancement and reforming some indicators in higher and vocational education in Kosovo, it will be possible to create new jobs in this field of the economy.

Keywords: Advanced education, curriculum, Energy Efficiency, Renewable Energy Sources.

Bibliografia

1. Adomßent, M., Fischer, D., Godemann, J., Herzig, C., Otte, I., Rieckmann, M., Timm, J., 2013. Emerging areas in research on higher education for sustainable development- management education, sustainable consumption and perspectives from central and eastern Europe. *Journal of Cleanar Production* 62, 1-7.
2. Brown, T, et.al., 2009. *Change by Design, How Design Thinking Transforms Educational Theories and Inspires Innovation*. Harper Collins, New York.
3. EACEA; Eurydice; Eurostat. 2012. *Key Data on Education in Europe*. Education, Audiovisual and Culture Executive Agency, 67-97
4. Eurostat Products Statistical Books. 2017. *Key Figures on Europe*. Luxemburg, 53-65.
5. Friman, H., 2017. New Trends in the Higher Education: Renewable Energy at the Faculty of Electrical Engineering. *Energy Procedia* 115, 18–28
6. Greenfield, S., 2014. *Mind Change, How digital technologies are leaving their mark on our brains*. Random House, Berlin.
7. Hoover, E., Harder, M.K., 2015. What lies beneath the surface? The hidden complexities of organizational change for sustainability in higher education. *Journal of Cleanar Production* 106, 175-188.
8. Hui, A., Walker, G., 2018. Concepts and methodologies for a new relational geography of energydemand: Social practices, doing-places and settings. *WalkerEnergy Research & Social Science* 36, 21–29.
9. LI, J.-F. et al., 2018. Analysis on energy demand and CO2emissions in China following the Energy Production and Consumption Revolution Strategy and ChinaDream target. *Advances in Climate Change Research* 9, 16-26.
10. Matusov, E. 2015. Vygotsky's Theory of Human Development and New Approaches to Education. *International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences (Second Edition)*, 316-321.
11. Noblit, G.W., Hare, R.D., 1988. *Meta-ethnography: Synthesising Qualitative Studies*. Sage, Newbury Park, CA. 17-25.
12. Nushi, P., 2014. *Leksikon i psikologjisë, Vëllimi 1 dhe II*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1017-1018.
13. Ott, A., Broman, L., Blum, K., 2018. A pedagogical approach to solar energy education. *Solar Energy, Elsevier*, 740-743.
14. Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2016. *Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021(PSAK)*. 6-10.
15. Republika e Kosovës, Ministria e Integritimit Evropian. 2015. *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, (MSA)*, 83-84.
16. Republika e Kosovës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik. 2017. *Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026 (SERK)*, 10-14.
17. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit. 2016. *Plan për zhvillim të qëndrueshëm – Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH)*, 42-45.
18. UNFCCC, 2015. *The Paris Agreement. United Nations Framework Convention on Climate Change, Paris, France*.

SI T'I IDENTIFIKOJMË DHE T'U SHMANGEMI BOTIMEVE NË REVISTA FIKTIVE

Albana BERISHA-QEHAJA¹

Përmbledhje

Studiuesit dhe hulumtuesit shkencorë kanë nevojë t'i botojnë rezultatet e punës së tyre. Po ashtu, akademikëve u kërkohet botimi i punimeve shkencore në mënyrë që ta dëshmojnë punën e tyre shkencore për arritje të titujve të caktuar akademikë nëpër institucionet e arsimit të lartë. Sigurisht, në nivel botëror ka një mori publikuesish dhe revistash të cilat ofrojnë mundësi për botim, bashkëpunim dhe recensione të ndryshme. Kohëve të fundit një nga temat aktuale në qarqet tona akademike është edhe numri i shtuar i ftesave për botime me procedura të përsheptuara, pa kaluar fare nëpër procedura të rregullta të rishikimit të punimeve. Çdo ditë e më shumë integriteti i botimeve akademike është duke u kërcënuar nga publikuesit dhe revistat e tilla, të cilat kanë për qëllim përfitimet materiale e assesit të kontribuarit në zhvillimin shkencor. Në përgjithësi vërehet një hendek në dije të hulumtuesit shkencorë në vendin tonë në aspektin e përzgjedhjes së publikuesve dhe revistave për botim. Pa dashje, një pjesë e tyre vazhdojnë të botojnë në revista të tilla si pasojë e mosdijes dhe mosinformimit të duhur për to. Rrjedhimisht, qëllimi parësor i këtij studimi është rritja e vetëdijes, paralajmërimi dhe udhëzimi i hulumtuesve shkencorë, sidomos hulumtuesve të rinj, si t'i identifikojnë këto revista dhe si t'i shmangen dorëzimit të punimeve të tyre dhe bashkëpunimit me to, andaj ky studim kontribuon në ofrimin e informatave se si t'i identifikojnë dhe t'i shmangen botimeve në revista fiktive. Për t'u arritur ky qëllim është konsultuar literatura relevante e kohës së fundit, praktikatat e vendeve të tjera dhe vendit tonë.

Fjalët çelës: Revista fiktive, publikues fiktiv, modeli i qasjes së hapur, punime shkencore, lista të zeza.

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
albana.berisha@uni-pr.edu.

“Ka miliona studiues anembanë botës që dëshirojnë të publikojnë dhe publikuesit fiktivë janë të etur t’i kenë ata si konsumatorë”.

(Beall, 2013)

Hyrje

Përparimi në shkencën bashkëkohore varet nga shpërndarja e punimeve shkencore të vlefshme dhe të besueshme. Industria e revistave akademike mbështetet në një sistem ku akademikët e kualifikuar recensojnë vullnetarisht dorëshkrimet e të tjerëve. Ky proces i korrigjimit, i quajtur edhe recension i kolegëve (ang. *peer review*), qet në pah studimet jocilësore dhe joetike. Nga ky proces zakonisht përfitojnë autorët, sepse recensentët japin rekomandime të cilat e përmirësojnë cilësinë e dorëshkrimeve (Umlauf & Mochizuki, 2018).

Koncepti i botuesit grabitqar (ang. *predatory*) është bërë i njohur gjerësisht qysh nga prezantimi i tij vite më parë (Xia, 2015) nga bibliotekisti Jeffrey Beall. Përveç emrit “*revista grabitqare*” (ang. *predatory journals*) që e ka përdorur Beall (2010), këto revista janë të njohura edhe si “*revista të kapura*” (ang. *hijacked journals*) (Jalalian, 2012; cituar nga Jalalian & Dadkhah, 2015), “*ana e errët e botimit*” (ang. *dark side of publishing*) (Butler, 2013), “*revista fantazmë*” (ang. *ghost journals*) (Memon, 2015). Po ashtu, për to përdoren edhe emrat “*revista të rrejshme*”, “*revista mashtruese*” dhe “*pseudorevista*” (ang. *fake journals*, *sham journals* dhe *pseudojournals*) (Berger, 2017). Pavarësisht nga emërtimi i tyre, revistat e tilla nuk aplikojnë proces të recensionimit të dorëshkrimeve e që është shenjë dalluese e botimeve shkencore tradicionale (Laine & Winker, 2017). Meqë te ne njihen kryesisht si publikues dhe revista fiktive, tash e tutje kryesisht do t’iu referohemi si të tilla.

Revistat akademike janë shumë shpejt viteve të fundit, veçanërisht ato me qasje të hapur (ang. *open access*). Në mesin e këtyre revistave të reja është rritur edhe numri i revistave fiktive të cilat shfaqin tendenca të pandershme, mungesë të rigorozitetit shkencor dhe funksionojnë kryesisht për përfitime financiare (Kurt, 2018). Kjo skemë përfituese anashkalon procesin e korrigjimit të dorëshkrimeve dhe premton botim të shpejtë, por vetëm pasi autori paguan çmimin e caktuar. Kur një dorëshkrim është shkruar dobët ose aspekti shkencor

është dizajnuar keq, marrëveshja është ideale. Në anën tjetër, autorët e ndershëm që kanë gabuar dhe e zbulojnë gabimin e tyre nuk mund t'i tërheqin dorëshkrimet e tyre (Umlauf & Mochizuki, 2018).

Revistat fiktive janë lloji më i përhapur i pseudorevistave dhe janë rritur shumë shpejt (Laine & Winker, 2017). Gjithsej 8000 revista aktive fiktive botuan rreth 420.000 artikuj në vitin 2014, pas një rritjeje relativisht lineare nga 53.000 në vitin 2010 (Shen & Björk, 2015). Sipas Frandsen (2017) shpjegimet e mundshme për rritjen e shpejtë të tyre janë masat matëse mashtruese, titujt e revistave të ngjashme me titujt e revistave të respektuara dhe “prania” e akademikëve - shkencëtarëve nga universitetet dhe organizatat kryesore hulumtuese.

Berger (2017) e përshkruan publikimin fiktiv si botim akademik me cilësi të ulët, amator dhe shpesh joetik, e që zakonisht funksionon si model i qasjes së hapur. Ndërsa Umlauf dhe Mochizuki (2018) theksojnë se pasojat e të botuarit në revista fiktive për studiuesit e ndershëm janë: humbja e kohës, përdorimi i të dhënave kot, paratë e çuara dëm dhe dorëshkrimet që përfundojnë pa u indeksuar ose arkivuar në bazat e duhura të të dhënave. Andaj identifikimi i revistave të tilla është shumë i rëndësishëm për autorët, hulumtuesit shkencorë, recensentët dhe redaktorët, sepse puna shkencore e cila nuk kalon nëpër procesin e duhur recensues nuk do të duhej të përfshihej në regjistrin e të dhënave shkencore (Laine & Winker, 2017).

Prjedhimisht, qëllimi parësor i këtij studimi është rritja e vetëdijes, paralajmërimi dhe udhëzimi i hulumtuesve shkencorë në Republikën e Kosovës, sidomos hulumtuesve të rinj se si t'i identifikojnë këto revista dhe si t'i shmangen dorëzimit të punimeve të tyre dhe bashkëpunimit me to. Në përputhshmëri me këtë janë përcaktuar detyrat e mëposhtme hulumtuese:

- rishikimi i literaturës mbi publikuesit dhe revistat fiktive,
- prezantimi dhe diskutimi i rezultateve,
- përmbledhja e listave/veglave/metodave më të përdorura për identifikimin e publikuesve dhe revistave fiktive dhe
- zhvillimi i një kornize udhëzuese për vlerësimin e publikuesve dhe revistave.

Punimi është i organizuar në tri seksione kryesore. Seksioni i parë ofron një përmbledhje të shkurtër të literaturës mbi publikuesit dhe revistat fiktive, karakteristikat e tyre, qasjen e hapur, pagesat për procesim të artikujve si dhe eskperimentin e Bohannon-it. Më tutje vazhdon me seksionin e dytë ku përshkruhet shkurtimisht metodologjia e punës. Në seksionin e tretë prezantohen gjetjet kryesore dhe diskutohen

ato, për të vazhduar me prezantimin e kornizës udhëzuese për vlerësimin e publikuesve dhe revistave. Në fund fare, është bërë një përmbledhje përfunduese dhe janë paraqitur kufizimet e punimit, njëkohësisht edhe sugjerimet për punimet e ardhshme.

Rishikim i literaturës

Gjatë dekadës së kaluar, një grup i revistave shkencore është përhapur shumë shpejt dhe është bërë i njohur si grup i “revistave grabitqare” të botuara nga “publikues grabitqarë” (Laine & Winker, 2017). Rrjedhimisht, komuniteti hulumtues ka rënë viktimë e krimit kibernetik - anës së errët të shkruarit shkencor. Kjo “*njolloosje akademike*” ka shënjestruar shumë shkencëtarë pas shfaqjes së revistave grabitqare dhe të kapura (Memon, 2016).

Ka shumë pak studiues të cilët nuk kanë marrë postë elektronike mashtroese nga revistat me qasje të hapur dhe konferencat e reja, të cilat tentojnë të rekrutojnë artikuj, respektivisht pjesëmarrje. Ata mund të kenë pranuar edhe posta elektronike që përmbajnë ftesa për të marrë pjesë në redaksinë e revistës ose për t’u anëtarësuar në ekipin redaktues të revistës përkatëse (Xia *et al.*, 2015). Autorët që me dashje zgjedhin të dërgojnë dorëshkrimet e tyre në revista të dyshimta, veçanërisht ato në vendet në zhvillim, me gjasë kërkojnë mundësi më të mira për punësim, promovim, zotërim ose grante hulumtuese (Greco, 2016; cituar nga Umlauf & Mochizuki, 2018).

Lëvizja e qasjes së hapur dhe pagesa për procesim të artikullit

Berger (2017) mendon se publikimi fiktiv u mundësua nga dy kushte: disponueshmëria e platformave botuese të revistave dhe të ardhurat potenciale nga pagesat e procesimit të artikujve (*ang.* APC - **Article Processing Charge**) për qasje të hapur.

Qasja e hapur është më e përshtatshme se ajo tradicionale e botimit të mbyllur për nevojat dhe pjesëmarrjen në një komunitet gjithnjë e më të madh kërkimor-shkencor. Po ashtu, recensionin e hulumtuesve shkencorë nga një komunitet më i gjerë shpesh mund të jetë më rigoroz, duke iu përgjigjur natyrës gjithnjë e më ndërdisiplinare të hulumtimeve moderne (Bolick *et al.*, 2017). Prandaj koncepti i qasjes së hapur është që të mundësojë që hulumtimet të jenë në dispozicion pa pagesë për këdo *online*. Edhe pse qasja e hapur

është një nismë qëllimshme, megjithatë natyra e burimit të saj të hapur ka rënduar disa probleme, duke lehtësuar imitimin e revistave të ligjshme nga revistat fiktive (Kurt, 2018).

Ekzistojnë disa modele të ndryshme të pagesave për procesimin e artikullit: Së pari, modeli “*i artë*” i qasjes së hapur (ang. “*gold*” OA) kërkon që autori të paguajë deri në disa mijëra euro për të ruajtur të drejtën autoriale për artikull, të sigurojë që artikulli është i tëri dhe falas në internet dhe mund të shpërndahet te të gjithë. Së dyti, modeli “*i gjelbër*” i qasjes së hapur (ang. “*green*” OA) kufizon të drejtën e autorit për shpërndarje, ku ai ose ajo mund të shpërndajë vetëm artikujt e vet nëpërmjet uebfaqes personale ose faqeve të arkivimit të palëve të treta. Janë krijuar edhe modele të tjera, duke përfshirë qasjen hibride, ku autorët mund të paguajnë për qasje të hapur në një revistë me bazë abonimi. Megjithatë, përkundër revistave me bazë abonimi të cilat vënë taksa të ulëta pas pranimit të artikullit, autorët që i dërgojnë dorëshkrimet e tyre në revistat me qasje të hapur duhet të paguajnë një shumë të konsiderueshme për publikim, e cila njihet si pagesa e procesimit të artikullit (Richtig *et al.*, 2018).

Realisht, modeli i publikuesve fiktiv është ndërtuar mbi bazën e pagesës për procesimin e artikujve (Berger, 2017). Deri në vitin 2010 pjesa më e madhe e artikujve ishte në revista më të vjetra të shtypura, të cilat kishin filluar të ofronin versionin e tyre elektronik falas. Por duke filluar nga viti 2011, revistat *online* që kërkonin pagesë për procesimin e artikujve u bënë grupi dominues. Po ashtu me shpejtësi të madhe ishte rritur edhe pjesëmarrja e artikujve në revistat me bazë vetëm në internet pa pagesë të procesimit të artikullit (Björk, 2017).

Sot dorëshkrimet dhe revistat mund të publikohen në formate *online* ose hibride. Në vitin 2015 publikuesit e ligjshëm në internet krijuan 335 milion dollarë të ardhura totale. Në të njëjtin vit publikuesit e paligjshëm krijuan 75 milion dollarë, duke botuar 500.000 dorëshkrime të dyshimta në 8000 revista të dyshimta (Teixeira da Silva; 2015, cituar nga Umlauf & Mochizuki, 2018).

Në nivel global me gjasë janë më shumë se 20.000 revista me qasje të hapur që pretendojnë se janë shkencore dhe posedojnë proces të recensionimit. Rreth 9000 revista të tilla janë të indeksuara në Directory of Open Access Journals (DOAJ). Por shumë prej tyre, e veçanërisht ato të voglat që publikohen jashtë Amerikës së Veriut dhe Evropës Perëndimore e që shpesh botohen në gjuhë të tjera e jo në anglisht, nuk janë pjesë e saj (Björk, 2017).

Sipas Shen dhe Björk (2015) ekzistojnë rreth 10.000 revista me cilësi të dyshimtë që botohen nga të ashtuquajturit publikues fiktiv. Këto revista tashmë janë larguar nga lista e DOAJ-së. Ndërkaq, Kozak dhe Hartley (2013) kanë studiuar mbi 9000 revista me qasje të hapur të përfshira në DOAJ dhe sipas tyre vetëm 28% kanë kërkuar pagesë të procesimit të artikujve për publikim në revistat e tyre. Ndryshe nga këta, Xia (2015) shqyrtoi politikat e pagesave të revistave fiktive me qasje të hapur, atëherë në dispozicion në *scholarlyoa.com*. Ai analizoi 298 revista fiktive dhe krahasoi numrin e revistave që kërkonin pagesë (214) me përqindjen e atyre të listuara në DOAJ. Ai gjeti lidhje midis praktikave të revistave fiktive dhe pagesës së procesimit të artikujve. Ky studim qiti në pah se rreth 72% e revistave fiktive kërkojnë pagesë për procesimin e artikujve. Kjo e gjetur është më e larta krahasuar me të gjitha gjetjet e mëparshme.

Bohannon (2013) gjeti se nga gjithsej 255 artikuj që i ishin nënshtruar procesit të recensionimit për pranim ose refuzim, rreth 60% e vendimeve përfundimtare ndodhën pa asnjë shenjë të këtij procesi. Sipas Kurt-it (2018: 144), përveç kostove dhe procesit të recensionimit, ka edhe pika të tjera që zakonisht i dallojnë revistat e ligjshme me qasje të hapur nga revistat fiktive me qasje të hapur, e ato janë: a) revistat e ligjshme me qasje të hapur janë zakonisht (jo gjithmonë) të lidhura me një shoqëri të njohur akademike ose institucion akademik; b) kanë redaktorë, staf redaktues dhe recensentë të përkushtuar të cilët janë gjithashtu ekspertë në fushat e tyre (edhe pse recensentët mund të mos jenë në uebfaqet e tyre me qëllim të ruajtjes së anonimitetit); c) japin informata për tarifat e tyre të botimit dhe shpjegojnë se si këto tarifa përdoren për të mbështetur revistën; ç) zakonisht janë të indeksuara në shumë baza shkencore të të dhënave dhe d) në uebfaqen e tyre përshkruajë fushën e botimit për autorët potencialë, në mënyrë që të informohen nëse punimi i tyre përshtatet dhe i plotëson kërkesat përkatëse për publikim.

Karakteristikat e publikuesve dhe revistave fiktive

Me rritjen e tregut të publikimeve dhe përmirësimeve në fushën e hulumtimit, ky komunitet është viktimizuar nga krimi kibernetik nëpërmjet revistave fantazma, publikuesve të rremë dhe masave magjike të ndikimit (Memon, 2016). Mjaft autorë kanë shkruar rreth karakteristikave të revistave fiktive. Në vijim kemi përmbledhur karakteristikat e detajuara të

tyre sipas Berger-it (2017: 209-210) dhe Shamseer *et al.* (2017) (Tabela 1). Berger (2017) thekson se ndër karakteristikat kryesore të revistave fiktive janë: emailat mashtrues dërguar te adresat me mbaresën .edu, për të tërhequr autorë të mundshëm për revista dhe konferenca; premtimet për recension dhe publikim të shpejtë; mungesë e fokusit në lëmenj të caktuar apo lëmenj shumë të gjerë; mungesë e transparencës lidhur me tarifat e autorit; kontradiktat dhe mospërputhjet; redaktorët nuk janë redaktorë të vërtetë; emra imitues me ose pa uebfaqe imituese; informata mbi vendndodhjen e tyre është kontradiktore ose mungon; bibliometrikë false dhe të rreme; pretendime të rreme dhe të papërshtatshme të indeksimit dhe përfshirjes në bazë të të dhënave; uebfaqe amatoreske etj.

Ndërsa Shamseer *et al.* (2017) analizuan 93 revista fiktive, 99 revista me qasje të hapur dhe 100 revista me bazë abonimi. Ata identifikuan 13 karakteristika të dëshmuara me anë të të cilave revistat fiktive mund të dallohen potencialisht nga revistat e ligjshme të supozuara. Këto karakteristika janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 1. Karakteristikat dalluese të revistave të mundshme fiktive

1. Fusha e interesit përfshin lëndë jobiomjekësore së bashku me tema biomjekësore.²
2. Uebfaqja përmban gabime drejtshkrimore dhe gramatikore.
3. Imazhet janë të shtrembëruara - të pa qarta, që synojnë të duken si diçka që nuk janë ose janë të paautorizuara.
4. Gjuha e përdorur në uebfaqe i ka cak autorët.
5. Vlera e indekstit të Kopernikut (ang. *The Index Copernicus*) promovohet në uebfaqen e tyre.
6. Mungon përshkrimi i procesit të trajtimit të dorëshkrimeve.
7. Dorëshkrimet kërkohet të dorëzohen përmes postës elektronike.
8. Premtohet publikim i shpejtë.
9. Nuk ka politika të tërheqjes së dorëshkrimit.
10. Mungojnë informatat nëse do të ruhet dhe si do të ruhet përmbajtja elektronike e revistës.
11. Çmimi i procedimit - publikimit të artikullit është shumë i ulët (p.sh. < 150\$).
12. Revistat që pretendojnë që kanë qasje të hapur ose e mbajnë të drejtën autoriale për punimet e publikuara ose nuk e përmendin fare atë.
13. Adresa kontaktuese elektronike është joprofesionale dhe nuk lidhet me revistën (p.sh. @gmail.com ose @yahoo.com)

² Autorët kanë hulumtuar kryesisht revistat me qasje të hapur të fushës mjekësore.

Burimi: Shamseer *et al.* (2017). Potential predatory and legitimate biomedical journals: can you tell the difference? A cross-sectional comparison. *BMC Medicine*, 15(1), 28-42, fq. 39.

Po ashtu, duke u bazuar në karakteristikat dalluese të revistave prestigjioze dhe atyre fiktive Rele, Kennedy dhe Blas (2017) kanë zhvilluar një vegël vlerësuese të revistave. Kjo vegël ofron një udhëzues për secilën karakteristike të listuar dhe po ashtu ju udhëzon se si të merrni në konsideratë kriteret specifike gjatë vlerësimit të revistës përkatëse. Çdo kriter vlerësohet me pikë dhe në fund pikët totale e definojnë nëse revista është një zgjedhje e duhur ose jo për publikimin e punimit tuaj. Vlen të theksohet se kjo vegël është lehtë e qasshme dhe e përdorshme.³

Eksperimenti i Bohannon-it

Një gazetar i quajtur John Bohannon kreu një operacion “sulmues” me 304 publikues me qasje të hapur: 167 nga baza e të dhënave DOAJ, 121 nga lista e Beall-it dhe 16 nga të dyjat. Ai e dërgoi një punim të rremë mjekësor i cili u pranua nga 157 revista dhe u refuzua nga 98 sosh. Nga 49 revistat e mbetura, 29 dukej se ishin braktisur (uebfaqet e braktisura nga krijuesit e tyre). Redaktorët nga 20 revistat tjera kishin korresponduar nëpërmjet autorëve fiktivë përmes postës elektronike duke deklaruar se punimi ishte ende në proces të recensionimit.

Bohannon (2013) theksoi se lokacioni i botuesit, redaktori dhe llogaria bankare shpesh ishin në kontinente të ndryshme. Ata kishin një rregull të thjeshtë, pranimin e jo refuzimin. Gjendja ishte rënduar edhe më tej kur punimi u pranua nga revistat e titanëve të industrisë si Sage dhe Elsevier. Po ashtu punimi u pranua nga revistat e publikuara nga institucionet prestigjioze akademike si Universiteti Kobe në Japoni. Ishte pranuar nga revistat e shoqërisë akademike. Ishte pranuar edhe nga revistat për të cilat tema e trajtuar ishte krejtësisht e papërshtatshme. Bohannon (2013) ishte shumë i shqetësuar që 45% e publikuesve të listuar në DOAJ e që e kishin kryer procesin e recensionit të punimit, e pranuan punimin si të tillë!

³ Kjo vegël mund të shkarkohet nga vegza në vijim: https://digitalcommons.lmu.edu/librarian_pubs/40/.

Në dhjetor të vitit 2013, si përgjigje ndaj operacionit “sulumues”, Shoqata e Publikuesve Akademikë me Qasje të Hapur (*ang.* OASPA - **O**pen **A**ccess **S**cholarly **P**ublishers **A**ssociation) zhvilloi “Parimet e transparencës dhe praktikës më të mirë për publikimet akademike” në partneritet me aktorë të tjerë kryesorë që mbështetin praktikat më të mira duke përfshirë DOAJ-nin, Komisionin e etikës së publikimit (*ang.* COPE - **T**he **C**ommittee **o**n **P**ublication **E**thics) dhe Shoqatën Botërore të Redaktorëve Mjekësorë. Këto organizata, së bashku me Koalicionin Shkencor dhe të Resurseve Akademike (*ang.* SPARC - **S**cholarly **P**ublishing and **A**cademic **R**esources **C**oalition) dhe bashkëpunëtorët e saj vazhdojnë të ofrojnë udhëzime dhe burime të nevojshme në mënyrë kritike (Berger, 2017).

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë punim bazohet kryesisht në rishikim të literaturës. Sipas Fink (2013), rishikimi i literaturës është dizajnuar për të siguruar një pasqyrë të burimeve që analizohen gjatë hulumtimit të një teme të caktuar. Më konkretisht, si metodë kryesore e rishikimit është përdorur rishikimi integruar. Whittemore dhe Knafl (2005) e definojnë rishikimin integruar si qasje më gjithëpërfshirëse metodologjike të rishikimeve e cila lejon përfshirjen e studimeve eksperimentale dhe joeksperimentale për të kuptuar plotësisht fenomenin që studiohet. Gjithashtu, kjo metodë kombinon të dhëna nga literatura teorike dhe empirike dhe ka një gamë të gjerë të qëllimeve të tilla si përkufizimi i koncepteve, rishikimi i teorive dhe dëshmimeve dhe analiza e problemeve metodologjike të një teme të veçantë.

Ky rishikim përfshin 24 artikuj shkencorë mbi publikuesit dhe revistat fiktive. Punimet i kemi kërkuar në bazat akademike DOAJ dhe Google Scholar me termat *publikues fiktivë* dhe *revista fiktive*. Punimet e përzgjedhura për analizë i takojnë periudhës 2013-2018. Pra, për t'i hulumtuar mënyrat e identifikimit të revistave fiktive dhe shmangies së dorëzimit të punimeve në to, kemi hulumtuar literaturën përkatëse të botuar kryesisht kohëve të fundit. Duke u bazuar në të, tek rezultatet kemi prezantuar të gjeturat kryesore në formë listash, metodash dhe veglash, të cilat janë të vlefshme në botën akademike dhe lehtë të përdorshme edhe për hulumtuesit e rinj. Po ashtu kemi zhvilluar një kornizë udhëzuese për vlerësimin e publikuesve dhe revistave.

Rezultatet dhe diskutimi

Shumë akademikë që punojnë në vende jashtë shteteve kryesore industriale përballen me një dilemë të vështirë në zgjedhjen e revistave për të botuar. Shpesh janë në pozitë të pafavorshme sa i përket pranimi të dorëshkrimeve të tyre nga revistat kryesore botërore kryesisht për shkak të aspekteve të ndryshme gjuhësore, përmbajtjeve që shpesh i referohen çështjeve lokale etj. Në të njëjtën kohë në praktikën e vlerësimit akademik në shumë vende ekziston një presion i madh për të botuar në “revista ndërkombëtare”. Në të vërtetë ky presion ka krijuar fenomenin e kohëve të fundit të publikuesve fiktivë me qasje të hapur, të revistave që përpiqen të krijojnë përshtypje që janë revista shkencore ndërkombëtare, të cilave kryesisht u mungon procesi i recensionimit. Revistat e tilla gjithnjë kërkojnë nga autorët pagesë për publikim (Björk, 2017). Rrjedhimisht, Kurt (2018) thekson se ka shumë nevojë për ngritje të vetëdijes mbi rëndësinë e përzgjedhjes së revistave, sidomos të hulumtuesit në krijim e sipër të karrierës së hershme akademike në vendet në zhvillim.

Jalalian dhe Dadkhah (2015: 82) mendojnë se “zhvillimi i një liste të “revistave të mira” është mënyrë shumë më efektive dhe më e mirë për të arritur këtë qëllim sesa publikimi i listave të “revistave të këqija” (kjo i referohet revistave të dyshimta), “revistave të kapura” (i referohet revistave legjitime që identiteti i tyre në internet është vjedhur nga kriminelët kibernetikë) dhe “publikuesit e rremë” (u referohet publikuesve të revistave që nuk janë regjistruar zyrtarisht nga personat ose kompanit e vërteta)”.

Ekzistojnë disa lista, metoda dhe vegla për të identifikuar publikuesit dhe revistat legjitime si dhe anasjelltas. Në vazhdim do të shqyrtojmë dhe diskutojmë listat kryesore të zeza dhe të bardha, duke vazhduar më tutje me metodat e tjera.

Listat e zeza

Lista e Beall-it

Me lindjen e qasjes së hapur dhe lëvizjes për të botuar artikujt vetëm në internet, numri i publikuesve dhe revistave që shfrytëzojnë modelin e qasjes së hapur u rrit (Richtig *et al.*, 2018). Këtë rritje

drastike e vërejtë edhe Jeffrey Beall, një bibliotekist dhe hulumtues në Universitetin e Kolorados në Denver. Në vitin 2008 ai filloi të vërejë një vërshim të postës elektronike nga revistat e reja, duke kërkuar nga ai të dërgojë artikuj ose t'iu bashkohet bordeve të tyre redaktuese (Butler, 2013). Si reagim ndaj këtij fenomeni, ai vendosi të përkushtohet kundër këtyre fantazmave dhe pas një periudhe të përpjekjes dhe punës krijoi listën e publikuesve dhe revistave fiktive, e që sot njihet si lista e Beall-it.

Quek dhe Teo (2018) në artikullin e tyre "*Publikimi fiktiv; presionet, promovimet dhe rreziqet*" përmendin që në vitin 2010 Beall publikoi listën e tij të parë të "publikuesve potencialë dhe të mundshëm fiktivë me qasje të hapur". Dy vjet më vonë ai botoi kriteret e tij për vlerësimin e revistave. Në ndërkohë ai botoi edhe disa punime tjera lidhur me këtë temë. Ndërkaq, në janar të vitit 2017 për shkak të presionit ligjor (Umlauf & Mochizuki, 2018) Beall hoqi listën e publikuesve të mundshme fiktive nga blogu i tij.

Artikujt e Beall-it janë kritikuar mjaft shumë, duke përfshirë kriteret e paragjykit të vlerësimit dhe mungesën e kontaktit të drejtpërdrejtë me publikuesit për t'i kuptuar më mirë proceset e tyre para se t'i fuste në listë të zezë (Quek & Teo, 2018). Megjithatë, sot ekziston një version i arkivuar i listës së Beall-it në faqen e internetit: <https://beallslist.weebly.com/>. Kjo listë përmban 1162 publikues fiktivë dhe 1.310 revista fiktive. Lista e kriterëve të Beall-it që u përmend më lart përfshin pesë çështje kryesore: redaktorin dhe stafin, menaxhimin e biznesit, integritetin, standardet - praktikatat e dobëta të revistës dhe të tjera.

Pavarësisht kritikave, lista e Beall-it mbetet listë e zezë më e njohur dhe gjithashtu më e përdorur dhe e diskutuar mes akademikëve (Butler, 2013; Bohannon, 2013; Shen & Björk, 2015; Xia, 2015; Xia *et al.*, 2015; Wallance & Perri, 2016; Memon, 2016; Danevska *et al.*, 2016; Frandsen, 2017; Björk, 2017; Berger, 2017; Bagues, Sylos-Labini & Zinovyeva, 2017; Laine & Winker, 2017; Quek & Teo, 2018; Ritching *et al.*, 2018; Kurt, 2018; Strielkowski, 2018; Umlauf & Mochizuki, 2018).

Duhet theksuar se kriteret e Beall-it për plotësimin e këtyre listave nuk ishin të bazuara në hulumtime, ato bazoheshin në standardet e shkencës bibliotekare (Beall, 2012, cituar nga Umlauf & Mochizuki, 2018).

Bagues *et al.* (2017) hulumtuan shkallën e publikimit të autorëve italianë në revista "fiktive". Ata gjetën se në vitin e fundit të mostrës së

tyre (2012), rreth 5% e të gjithë artikujve të ekonomistëve italianë dhe akademikëve të menaxhmentit në revistat në gjuhën angleze ishin botuar në njërën nga këto revista (6000 nga 1.8 milion publikime). Gjithashtu, Wallace dhe Perri (2016) hulumtuan shkallën e publikimit në revistat fiktive në ekonomi. Ata analizuan punimet nga të dhënat e përzgjedhura për autorët e nëntëdhjetë vendeve të ndryshme, megjithëse rezultoi se vetëm tetë vende përbënin rreth 50% të punimeve dhe autorëve (Irani, SHBA-ja, Nigeria, Turqia dhe Malajzia). Ata përdorën listat e Beall-it për të identifikuar publikuesit dhe revistat fiktive të përfshira në RePEc (*ang. Research Papers in Economics archives*). Gjetën që një numër mjaft i madh i autorëve që janë në 5% e parë të RePEc-ut kanë botuar në revista fiktive në vitin 2015.

Duhet theksuar se rezultatet e Bohannon-it (2013) tregojnë se Beall është treguar i suksesshëm në identifikimin e publikuesve me kontroll të cilësisë së dobët, meqë nga publikuesit në listën e tij që e përfunduan procesin e recensionimit, 82% e tyre e pranuan punimin e rremë.

Lista e Cabell-it

Lista e zezë e Cabell-it doli në pah në vitin 2017, kur blogu i Beall-it u mbyll. Kjo listë e zezë u prezantua nga kompania analitike akademike e Cabell-it, nga Beaumont i Teksasit si "lista e vetme e zezë e revistave akademike mashtruese dhe fiktive". Sot kjo listë përmban më shumë se 4000 revista (dhe shumë tjera nën shqyrtim) (Strielkowski, 2018).

Lista e Beall-it ishte në dispozicion pa pagesë dhe të gjithë mund ta kontrollonin atë në çdo kohë, ndërsa Cabell kërkon pagesa të majme për alternativën e tyre të listës së zezë. Sipas Cabell-it, abonimi 1-vjeçar në listën e tyre të zezë mund të blihet për një kosto shtesë prej 1.500 \$ me blerjen e të paktën një disipline më shumë në listën e bardhë (duke filluar nga 1.000 – 3.600 \$ për një set). Për fat të keq Cabell nuk u ofron përdoruesve mundësinë të paktën të kontrollojnë profilin e autorit falas në të njëjtën mënyrë si Scopusi, një bazë e respektuar akademike në pronësi të Elsevier-it (Strielkowski, 2018).

Sipas Beall-it (2013) një listë e zezë është më e lehtë të përpilohet dhe të mirëmbahet sesa një listë e bardhë dhe nga natyra e saj përmban informata më të përditësuara sesa një listë e bardhë.

Listat e bardha

Si një alternativë logjike ndaj listës së zezë, akademikët kanë kërkuar një listë të bardhë të besueshme për të identifikuar revistat legjitime akademike (Umlauf & Mochizuki, 2018). Realisht, listat e bardha kanë ekzistuar shumë më herët se listat e zeza. Listat më të njohura të bardha janë në dispozicion në bazat e të dhënave të Web of Science dhe Scopus-it. Po ashtu ekzistojnë edhe disa baza tjera të të dhënave që konsiderohen relativisht të besueshme si DOAJ, EBSCOhost, WorldCat etj. Ka baza të tjera që arkivojnë punimet akademike nga revista të ndryshme mbarbotërore. Prej tyre, disa janë të lidhura ngushtë me një fushë të caktuar shkencore. Në vijim do t'i trajtojmë veçantë disa prej tyre që konsiderohen me kredibilitet dhe me besueshmëri të lartë në botën akademike.

Web of Science⁴ është baza akademike kryesore e citimit në botë, me informata multidisiplinare nga më shumë se 33.000 revista, prej tyre 18.000 me ndikim të lartë, mbi 180.000 përmbledhje punimesh nga konferencat dhe mbi 80.000 libra nga mbarë bota. Daton nga viti 1900 dhe ka më shumë se një miliard referenca të cituara (marrë nga uebfaqja zyrtare). Kjo bazë akademike menaxhohet nga kompania Clarivate Analytics.

Përveç shumë produkteve tjera në dispozicion, Web of Science ofron falas listën ku përfshihen të gjithë titujt e revistave (ang. *Master Journal List*)⁵ të indeksuara në baza të ndryshme të të dhënave që janë nën ombrellën e Web of Science, e cila përditësohet çdo dy muaj, pra gjashtë herë në vit.

Kjo listë konsiderohet listë e bardhë, andaj do të duhej të ishte lista e parë e bardhë që merret në konsideratë nga akademikët për të përzgjedhur revistat për publikim. Vlen të theksohet se përveç mundësisë së shkarkimit të saj, ekziston edhe mundësia e kërkimit *online* për të parë nëse një revistë e caktuar është e indeksuar apo jo në Web of Science. Ky kërkim mund të bëhet duke shkruar emrin e plotë të revistës (pa gabime) ose numrin e ISSN-së.

Scopus⁶ konsiderohet baza e dytë e të dhënave në nivel botëror, pra pas Web of Science. Edhe pse në uebfaqen zyrtare të tyre prezantohet si “databaza më e madhe e abstrakteve dhe e citimit të literaturës së

⁴ <https://clarivate.com/products/web-of-science/>

⁵ <http://mjl.clarivate.com/>

⁶ <https://www.elsevier.com/solutions/scopus>

recensionuar: revista shkencore, libra dhe përmbledhje punimesh nga konferencat”. Është markë e regjistruar tregtare e kompanisë Elsevier dhe daton nga viti 1970. Numron mbi 5000 publikues, 22.800 tituj revistash dhe 150.000 libra dhe ka rreth 1.4 miliard referenca të cituara që nga fillimi i saj (marrë nga uebfaqja zyrtare).

Edhe Scopusi e ka databazën ku përfshihen titujt e revistave të indeksuara në të, por që t’i qasësh lehtë asaj duhet të jesh i regjistruar në Scopus. Përveç kësaj mënyre, Elsevier ofron mundësinë e qasjes në listën e përditësuar në uebfaqen zyrtare e që është një libër pune i Excel-it, por zakonisht nuk bie në sy pa hulumtuar për të. Në këtë listë mund të qaseni nëpërmjet vegzës së vendosur në fusnotë⁷. Scopusi çdo herë e përditëson edhe listën me titujt e revistave që janë larguar nga databaza e saj për arsye të ndryshme dhe kjo listë mund të gjendet në të njëjtin vend.

Ne e kemi analizuar listën e dytë, pra atë me titujt e larguar me qëllim të gjetjes së arsyes pse janë larguar titujt e tillë. Kjo listë aktualisht përmban 424 tituj. Prej tyre 289 (rreth 68%) janë larguar për shkak të shqetësimeve rreth publikimit të tyre e që u referohet se janë të dyshimta, 114 (rreth 27%) janë larguar për shkak se nuk kanë plotësuar ndonjë nga kriteret e Scopus-it dhe pjesa e mbetur prej 21 sosh (rreth 5%) janë identifikuar nga vegla e ashtuquajtur “radar”, e që nënkupton se kanë pësuar ndryshime të shpejta të pashpjegueshme.

Që nga rritja e numrit të revistave fiktive, Scopusi ka marrë masa rigorozë dhe vazhdimisht është duke bërë rivlerësimin e titujve të listuar, andaj edhe sugjerojnë që përveç listës së tyre të bardhë të kontrollohet edhe lista me titujt e larguar.

The Directory of Open Access Journals (DOAJ)⁸ u krijua 10 vjet më parë nga Lars Bjørnshauge, një shkencëtar i bibliotekës në Universitetin e Lundit në Suedi (Bohannon, 2013) dhe vazhdon të jetë një nga listat e bardha më të rëndësishme (Berger, 2017). DOAJ filloi me 300 revista me qasje të hapur dhe sot përmban 12.152 revista me qasje të hapur për të gjitha fushat shkencore si teknologji, mjekësi, shkenca shoqërore dhe humane nga 128 vende të botës (marrë nga uebfaqja zyrtare).

Megjithatë, DOAJ nuk është një listë gjithëpërfshirëse e të gjitha revistave të ligjshme me qasje të hapur. Nëse një revistë nuk është e

⁷ <https://www.elsevier.com/solutions/scopus/how-scopus-works/content>

⁸ Kërkimi i revistave në bazën e të dhënave DOAJ mund të bëhet në vegzën në vijim: <https://doaj.org/>.

listuar në të nuk duhet të supozohet se është jolegjitime ose fiktive. Mund të jetë një revistë që nuk ka bërë kërkesë të përfshihet në DOAJ ose nuk ka financime të mjaftueshme për të përmbushur disa nga kërkesat e saj. Anasjelltas, përfshirja në DOAJ nuk garanton cilësi të lartë - DOAJ ka një mekanizëm rutinor për përdoruesit e saj, kërkon ta njoftojnë nëse gjejnë një revistë me praktika të dyshimta në listën e saj (Laine & Winker, 2017).

Sipas Berger-it (2017), rezultati më i rëndësishëm i operacionit “sulmues” të Bohannon-it ishte se DOAJ kërkoi nga të gjitha revistat e listuara në databazën e saj të riaplikojnë duke përdorur një sistem më rigoroz të verifikimit. Që nga dhjetori i vitit 2016 DOAJ “pranoi 3700 revista, refuzoi 6500 aplikacione, ...largoj 1450 revista dhe hoqi nga lista 2850 revista që nuk kishin riaplikuar për të mbetur të indeksuara”.

Memon (2016) thekson se artikujt e botuar në revista fiktive janë njësoj të shfaqur në ResearchGate si ato të revistave prestigjioze. Sipas tij, ResearchGate me gjasë nuk kontrollon ose filtron përmbajtjen e ngarkuar. Me gjasë kjo është arsyeja që shpesh hasim në revista fiktive dhe artikuj të tillë në platformën e rrjetëzimit – ResearchGate.

Qasja “Think. Check. Submit”

Gjatë dy dekadave të fundit shumë hulumtues kanë analizuar procesin e vendimmarrjes dhe kanë ardhur në përfundim se ai është një koleksion i ndërlikuar i kriterëve konkurruese, duke përfshirë midis faktorëve të tjerë edhe kohën nga dorëzimi në publikim, normën e pranimit/refuzimit, audiencën potenciale, pagesat, faktorin e ndikimit dhe përceptimet e prestigjit (Mabe & Amin, 2002; Rowland & Nicholas, 2005; Bjork & Holmstrom, 2006; Bjork & Oorni, 2009; Mabe, 2009; Coonin & Younce, 2010; Mabe & Mulligan, 2011; Tenopir *et al.*, 2011; Jamali *et al.*, 2014; Tenopir *et al.*, 2016; siç citojnë Forrester, Björk & Tenopir, 2017).

Në anën tjetër, përkundër të gjitha debateve dhe diskutimeve në qarqet akademike ka mjaft dëshmi që tregojnë se publikimi fiktiv ekziston dhe është një biznes në lulëzim e sipër në botën akademike, prandaj para se të ngazëllehemi tej mase për ftesën që kemi pranuar për të dorëzuar një artikull, duhet t’ia hedhim një sy të dytë burimit të ftesës (Quek & Teo, 2018). Edhe presioni për të publikuar i bën hulumtuesit të ndjeshëm ndaj praktikave të përdorura të marketingut nga këto revista

fiktive dhe hulumtuesit nuk i kushtojnë shpesh kohë hetimit të revistës para se t'i dërgojnë dorëshkrimet e tyre për publikim (Kurt, 2018).

Sipas uebfaqes zyrtare, **“Think. Check. Submit.”** është një fushatë për të ndihmuar hulumtuesit të identifikojnë revista të besuara për punën e tyre. Është një listë e thjeshtë kontrolluese të cilën hulumtuesit mund ta përdorin për të vlerësuar kredencialet e një reviste ose publikuesi.⁹ Fushata është inicuar me mbështetjen e një koalicioni të përbërë nga komunitetet shkencore,¹⁰ si përgjigje ndaj diskutimeve për publikimet fiktive.

Në uebfaqe ofrohet një videoudhëzuese, një listë e ngjashme me veglën vlerësuese të revistave dhe përgjithësisht shumë këshilla të mira për të kontrolluar kredibilitetin e revistës përkatëse.


Pyetjet kyçe të kësaj qasjeje përfshijnë:

- THINK** A po e dorëzoni hulumtimin tuaj në një revistë të besuar?
A është revista e duhur për punën tuaj?
- CHECK** Referoju kësaj liste për revistën tuaj të zgjedhur për të parë nëse është e besuar apo jo (ka disa pyetje, vizito uebfaqen në vijim: <http://thinkchecksubmit.org/check/>)
- SUBMIT** Nëse mund t'i përgjigjeni me “po” shumicës ose të gjitha pyetjeve në listën kontrolluese.

Shoqata Botërore e Redaktorëve Mjekësorë (*ang.* WAME - World Association of Medical Editors) zhvilloi kornizën e ilustruar në figurën e mëposhtme. Kjo kornizë fillon me vlerësimin nëse revista ka ndonjë nga karakteristikat që Bealli i ka listuar si potencialisht problematike, prania e saj në DOAJ dhe prania e karakteristikave të qasjes “Think. Check. Submit.”, duke u përcjellur me hetime të mëtutjeshme të udhëhequra nga këta tregues fillestarë (Laine & Winker, 2017).

⁹ Ngjashëm me këtë, ekziston edhe qasja “Think. Check. Attend.” e cila është një iniciativë që udhëzon hulumtuesit dhe akademikët të vendosin për të marrë pjesë ose jo në një konferencë të caktuar (<http://thinkchecksubmit.org/think-check-attend/>).

¹⁰ Association of Learned & Professional Society Publishers (ALPSP), BioMed Central, Committee on Publication Ethics (COPE), Directory of Open Access Journals (DOAJ), ISSN International Centre, Ligue des Bibliothèques Européennes de Recherche – Association of European Research Libraries (LIBER), Open Access Scholarly Publishers Association (OASPA), Springer Nature, International Association of STM Publishers (STM), Ubiquity Press dhe UKSG.

Figura 1. Korniza vlerësuese e revistave

Burimi: Laine, C., & Winker, M. A. (2017). Identifying predatory or pseudo-journals. *Biochemia Medica*, 27(2), 285-291, fq. 290.

Karakteristikat që Beall i ka listuar si potencialisht problematike mund t'i gjeni në vegzën në vijim


<https://bealllist.weebly.com/uploads/3/0/9/5/30958339/criteria-2015.pdf>

Kriteret e pranimit në DOAJ mund t'i gjeni në vegzën në vijim: <https://doaj.org/publishers#seal>.

Përveç burimeve tjera, për t'i analizuar karakteristikat dalluese të revistave të mundshme fiktive mund t'i përdorni përmbledhjet e detajuara sipas Berger-it (2017) dhe Shamseer *et al.* (2017) (shih: Rishikim i literaturës, pjesa 1.2, faqe 5).

Përveç kornizës vlerësuese të prezantuar më lart, ne kemi zhvilluar një kornizë udhëzuese për vlerësimin e publikuesve dhe revistave bazuar në praktikën akademike vendore (përfshirë edhe Udhëzimin administrativ nr. 1/2018¹¹ për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension).

¹¹ Nxjerr nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës.

Figura 2. Kornizë udhëzuese për vlerësimin e publikuesve dhe revistave

*Me databaza tjera kuptojmë të gjitha bazat akademike që pranohen sipas Udhëzimit administrativ nr. 1/2018.

**Siç e pamë më lart, Scopusi kohëve të fundit ka marrë masa rigorozë dhe vazhdimisht është duke bërë rivlerësimin e titujve të listuar. Ka larguar nga databaza gjithsej 424 tituj revistash, kryesisht për shkak të dyshimeve ndaj tyre. Andaj, nëse një revistë është në listë të Beall-it dhe e njëjta është edhe në Scopus, sugjerohet të mos dërgohet punimi, meqë revista e tillë në të ardhmen e afërt ka gjasa të mos jetë më pjesë e Scopus-it.

***Nëse një revistë nuk është në Scopus e as në bazat tjera akademike sipas Udhëzimit administrativ nr. 1/2018 sugjerohet të mos dërgohet punimi, meqë me gjasë nuk do të merret parasysh për avancim akademik.

Përfundim

Revistat fiktive janë kërcënim për shkencën dhe duhet bërë diçka për t'i kufizuar këto botime joetike (Clark, 2018). Numri i tyre është përshkallëzuar në pesë vitet e fundit, megjithatë, është e vështirë për t'u matur. Disa studime konfirmojnë se shpërndarja rajonale e vendit të publikimit dhe autorësisë është shumë e pjerrtësuar dhe e dominuar nga autorë aziatikë dhe afrikanë (Frandsen, 2017). Ndërsa Kurt (2018) argumenton se shumë hulumtues nga vendet në zhvillim mendojnë se revistat perëndimore do t'i refuzojnë ata, kështu që kërkojnë revista alternative për publikim.

Siç kemi kuptuar më lart, "*njollojja akademike*" ka prekur një numër të institucioneve prestigjioze. Edhe pse numrat janë të vegjël - 9 artikuj nga Universiteti i Harvardit, 11 nga Klinika Mayo tregojnë se si janë ndikuar institucionet më prestigjioze (Clark, 2018). Po ashtu Bohannon (2013) gjeti që 45% e publikuesve në DOAJ, që përfunduan procesin e recensionimit, e pranuan punimin e rremë. Fatmirësisht, rezultatet e operacionit "sulmues" të Bohannon-it rezultuan në disa ndryshime të rëndësishme (Berger, 2017). Edhe Wallace dhe Perri (2016) gjetën se një numër i madh i autorëve që janë në 5% e parë në RePEc kanë publikuar gjithashtu në revista fiktive në vitin 2015.

Fokusi fillestar i Beall-it ishte në revistat shkencore, të njëjtat strategji të përdorura nga publikuesit fiktivë që tashmë përdoren gjerësisht për organizimin e konferencave të rreme, për të kryer mashtrime identiteti për akademikët, për të rrëmbyer uebfaqet e revistave profesionale, për të prodhuar shkencë të pavlerë dhe për t'iu dhënë hapësirë autorëve joetikë. Kështu, kriminelët kibernetikë po shfrytëzojnë nevojën e akademikëve dhe hulumtuesve për të publikuar punën e tyre. Në fund të fundit ata po pasurohen dhe autorët joetikë janë të gatshëm të paguajnë për të botuar dorëshkrime të rëndomta me qëllim të avancimit profesional (Umlauf & Mochizuki, 2018).

Edhe pse lista e Beall-it ka mangësi të caktuara, ajo përfaqëson një vegël të vlefshme që hulumtuesit mund ta përdorin për të vlerësuar revistat në bazë të kredibilitetit të tyre. Gjithashtu, kjo listë e ngriti vetëdijen dhe ndërgjegjësimin për këtë çështje të rëndësishme dhe ofroi udhëzime për institucionet e tjera se si t'i krijojnë listat e tyre të zeza (Silver, 2017; cituar nga Richtig *et al.*, 2018).

Akademikët e përfshirë në procesin e avancimit të stafit dhe fakultetit duhet të paralajmërojnë dhe këshillojnë hulumtuesit e rinj se ku t'i dorëzojnë punimet e tyre për publikim. Edhe komisionet recensuese të promovimit duhet të përgatiten për të kryer vlerësim serioz të artikujve të botuar në revista fiktive ose të kapura (Danevska *et al.* 2016). Po ashtu databizat bibliografike duhet të luajnë një rol aktiv në forcimin e kontrollit të cilësisë së artikujve dhe revistave të indeksuara (Frandsen, 2017).

Identifikimi i revistave të tilla është shumë i rëndësishëm për autorët, hulumtuesit shkencorë, recensentët dhe redaktorët, sepse puna shkencore e cila nuk kalon nëpër procesin e duhur vlerësues nuk do të duhej të përfshihej në regjistrin e të dhënave shkencore (Laine & Winker, 2017). Richtig *et al.* (2018) propozojnë që duhet të zbatohet një sistem i ri për të identifikuar revistat fiktive dhe të gjithë artikujt e botuar në revista të tilla.

Me të drejtë Strielkowski (2018) ngrit shqetësimin se nuk ka asnjë rekomandim të qartë lidhur me atë se çfarë duhet bërë me revistat që Bealli dyshonte se kanë praktika mashtruese, e që janë të indeksuara në databaza të respektuara si Web of Science dhe Scopus. A duhet që hulumtuesit të vazhdojnë të publikojnë në to apo duhet të kërkojnë lista të tjera të zeza dhe udhëzime të komisioneve etike për publikim? Nëse po, kush do t'i emërojë këto komisione ose kush do të vendosë se cilat janë revista të mira dhe cilat janë të këqija?

Edhe ResearchGate si një platformë e rrjetëzimit ka qenë e butë në politikat e saj dhe ka krijuar hapësirë për revistat fiktive që janë aty. Disa nga revistat që shfaqin faktorë të rremë ndikues në uebfaqet e tyre janë në dispozicion në ResearchGate me faktorë ndikimi si pikë ç'orientuese për shkencëtarët që i besojnë dhe bazohen në ResearchGate. Rrjedhimisht, komuniteti shkencor dhe platformat e rrjetëzimit si ResearchGate duhet të marrin vërejtje serioze për hapësirën dhe mundësinë që u kanë dhënë revistave fantazmë dhe vendosjes së tyre në një vend me revistat e besueshme dhe cilësore. Kjo gjë në të ardhmen mund të krijojë situatë alarmante. Kjo anë e errët e shkrimit akademik duhet të pengohet para se të gjejë më shumë hapësirë dhe të dominojë, pasi që do të ndikonte jo vetëm te shkencëtarët, por edhe te komuniteti në tërësi (Memon, 2016).

Në vijim i kemi përmbledhur politikat e ndryshimit të propozuara nga Beall-i (2016: 326):

- Universitetet dhe kolegjet duhet të ndalojnë përdorimin e sasisë së artikujve të botuar si një masë matëse e performancës akademike;

- Hulumtuesit dhe revistat e respektuara nuk duhet të citojnë artikuj nga revistat fiktive dhe databazat e bibliotekave akademike duhet të përjashtojnë meta të dhënat për publikimet e tilla;

- Kompanitë që ofrojnë shërbime për publikuesit, duke përfshirë ato që licencojnë softuerin e revistës ose japin identifikues standard, duhet të refuzojnë të punojnë me publikuesit fiktivë;

- Bazat e të dhënave shkencore si Scopus dhe Thomson Reuters (Web of Science) duhet ta rrisin pragun e pranueshmërisë, duke eliminuar revistat dhe publikuesit që përdorin praktika mashtruese të recensionimit.

Përveç këtyre politikave që do të duhej të aplikoheshin në nivel botëror, do të ishte mirë që edhe Universiteti i Prishtinës si lider i arsimit të lartë në Kosovë të ofrojë listat e revistave legjitime, duke i klasifikuar ato në kategori sipas nivelit të ndikimit të tyre akademik. Ky do të ishte një lehtësim për akademikët e sidomos për hulumtuesit e rinj në rrugëtimin e tyre të krijimit të karrierës akademike.

Po ashtu do të ishte më lehtë të orientoheshin në një listë revistash legjitime sesa të përdorin lloj-lloj kombinimesh e algoritmesh për identifikimin e publikuesve dhe revistave fiktive. Praktika ka dëshmuar se edhe përkundër orvatjeve për të mos rënë në kurth të ngritura nga këta publikues dhe këto revista fiktive, shpesh hulumtuesit e rinj pa dashje e kanë gjetur veten pjesë të tyre.

Ekziston një numër fushash të tjera potenciale për hulumtimet e ardhshme që mund të ofrojnë vlerë të shtuar shkencore, prandaj rekomandohet që kufizimet e mëposhtme të merren parasysh në hulumtimet e ardhshme.

Ky punim bazohet kryesisht në rishikim të literaturës, përvojat e vendeve tjera dhe vendit tonë. Në të ardhmen do të ishte mirë që punimet tjera të përfshijnë edhe aspektin empirik. Pra, të hulumtohet shkalla e publikimeve në revista fiktive në Republikën e Kosovës. Pastaj, përveç tjerash, të hulumtohen edhe arsytet dhe motivet e publikimit në këto revista.

HOW TO IDENTIFY AND AVOID PUBLISHING IN FICTITIOUS JOURNALS

Albana BERISHA-QEHAJA

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
albana.berisha@uni-pr.edu

Abstract

Researchers and academics are constantly looking for scientific journals to publish their research work, in their constant effort to overcome themselves and meet the rigorous academic expectations and requirements of the institutions they belong to. Obviously, on the global level there are a number of publishers and magazines that provide opportunities for publishing, collaboration and various reviews. Recently, one of the current topics in our academic circles is the increased number of invitations for publications with expedited procedures without going through regular peer review procedures.

Increasingly and by the day the integrity of academic publications is being threatened by such publishers and journals, whose sole purpose is for material benefits and not to contribute to scientific development. In general, there is a lack of deep knowledge by many scholars in our country in terms of selection of publishers and journals. Some of them inadvertently continue to publish in such journals as a result of lack of knowledge and lack of proper information about them. Therefore, this study contributes in providing information on how to identify and avoid publishing in fictitious journals. Consequently, the primary purpose of this study is to increase the awareness and brief scientific researcher, especially young researchers, on how to identify these journals and how to avoid submitting their papers and collaborating with them.

To achieve this goal, the relevant literature of recent times, practices of other countries, as well as personal and peer experiences have been consulted.

Keywords: Fictitious journals, fictitious publishers, open access models, scientific papers, editorial boards.

Referencat

1. Bagues, M., Sylos-Labini, M., & Zinovyeva, N. (2017). A walk on the wild side: 'Predatory' journals and information asymmetries in scientific evaluations. IZA Discussion Papers, No. 11041, Institute of Labor Economics (IZA), Bonn. <http://hdl.handle.net/10419/171025>.
2. Beall, J. (2013). Predatory publishing is just one of the consequences of gold open access. *Learned Publishing*, 26(2), 79-84. <https://doi.org/10.1087/20130203>.
3. Beall, J. (2015). Criteria for determining predatory open-access publishers. <https://beallslist.weebly.com/uploads/3/0/9/5/30958339/criteria-2015.pdf>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-20).
4. Beall, J. (2016). Ban predators from the scientific record. *Nature*, 534(7607), 326-327. <https://doi.org/10.1038/534326a>
5. Berger, M. (2017). Everything you ever wanted to know about predatory publishing but were afraid to ask. In ACRL 2017 Conference, Baltimore, Maryland, March 22 - 25, 2017.
6. Björk, B. C. (2017). Journal portals—an important infrastructure for non-commercial scholarly open access publishing. *Online Information Review*, 41(5), 643-654. <https://doi.org/10.1108/OIR-03-2016-0088>
7. Bohannon, J. (2013). Who's afraid of peer review? *Science*, 342, 60-65. <https://doi.org/10.1126/science.342.6154.60>
8. Bolick, J., Emmett, A., Greenberg, M. L., Rosenblum, B., & Peterson, A. T. (2017). How open access is crucial to the future of science. *The Journal of Wildlife Management*, 81(4), 564-566. <https://doi.org/10.1002/jwmg.21216>
9. Butler, D. (2013). The dark side of publishing. *Nature*, 495(7442), 433-435. <https://doi.org/10.1038/495433a>.
10. Clark, J. (2018). Letter to the editor-predatory journals: Bad for all but especially authors from low and middle income countries. *Acta Medica Portuguesa*, 31(3), 184-185. <https://doi.org/10.20344/amp.10489>.
11. Danevska, L., Spiroski, M., Donev, D., Pop-Jordanova, N., & Polenakovic, M. (2016). How to recognize and avoid potential,

- possible, or probable predatory open-access publishers, standalone, and hijacked journals. *Prilozi*, 37(2-3), 5-13.
12. Fink, A. (2013). *Conducting research literature reviews: From the Internet to paper*. Sage Publications.
 13. Forrester, A., Björk, B. C., & Tenopir, C. (2017). New web services that help authors choose journals. *Learned Publishing*, 30(4), 281-287. <https://doi.org/10.1002/leap.1112>.
 14. Frandsen, T. F. (2017). Are predatory journals undermining the credibility of science? A bibliometric analysis of citers. *Scientometrics*, 113(3), 1513-1528. <https://doi.org/10.1007/s11192-017-2520-x>.
 15. Jalalian, M., & Dadkhah, M. (2015). The full story of 90 hijacked journals from August 2011 to June 2015. *Geographica Pannonica*, 19(2), 73-87. <https://doi.org/10.18421/GP19.02-06>.
 16. Kozak, M., & Hartley, J. (2013). Publication fees for open access journals: Different disciplines-different methods. *Journal of the American Society for Information Science and Technology*, 64(12), 2591-2594. <http://dx.doi.org/10.1002/asi.22972>.
 17. Kurt, S. (2018). Why do authors publish in predatory journals?. *Learned Publishing*, 31(2), 141-147. <https://doi.org/10.1002/leap.1150>.
 18. Laine, C., & Winker, M. A. (2017). Identifying predatory or pseudo-journals. *Biochemia Medica*, 27(2), 285-291. <https://doi.org/10.11613/BM.2017.031>.
 19. Memon, A. R. (2016). ResearchGate is no longer reliable: leniency towards ghost journals may decrease its impact on the scientific community. *Journal of Pakistan Medical Association*, 66(12), 1643-1647.
 20. Quek, H. C., & Teo, E. K. (2018). Predatory publishing; pressures, promotions and perils. *Proceedings of Singapore Healthcare*, 27(1) 3-5. <https://doi.org/10.1177/2010105817749602>.
 21. Rele, Sh., Kennedy, M., & Blas, N. (2017). *Journal Evaluation Tool*. LMU Librarian Publications & Presentations. 40. http://digitalcommons.lmu.edu/librarian_pubs/40.
 22. Richtig, G., Berger, M., Lange-Asschenfeldt, B., Aberer, W., & Richtig, E. (2018). Problems and challenges of predatory journals. *Journal of the European Academy of Dermatology and Venereology*. 1-9. <https://doi.org/10.1111/jdv.15039>.
 23. Scopus. <https://www.scopus.com/>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-27).

24. Shamseer, L., Moher, D., Maduekwe, O., Turner, L., Barbour, V., Burch, R., ... & Shea, B. J. (2017). Potential predatory and legitimate biomedical journals: can you tell the difference? A cross-sectional comparison. *BMC Medicine*, 15(1), 28-42. <https://doi.org/10.1186/s12916-017-0785-9>.
25. Shen, C., & Björk, B. C. (2015). 'Predatory' open access: a longitudinal study of article volumes and market characteristics. *BMC Medicine*, 13(1), 230, 1-15. <https://doi.org/10.1186/s12916-015-0469-2>.
26. Strielkowski, W. (2018). Setting new publishing standards after the Beall's list. *The International Journal of Occupational and Environmental Medicine*, 9(2), 108-110.
27. The Directory of Open Access Journals. <https://doaj.org>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-24).
28. "Think. Check. Submit". <http://thinkchecksubmit.org/>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-23).
29. Umlauf, M. G., & Mochizuki, Y. (2018). Predatory publishing and cybercrime targeting academics. *International Journal of Nursing Practice*, 24(S1), 1-7. <https://doi.org/10.1111/ijn.12656>
30. Udhëzimi Administrativ nr. 01-2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-29).
31. Wallace, F. H., & Perri, T. J. (2018). Economists behaving badly: publications in predatory journals. *Scientometrics*, 115(2), 749-766. <https://doi.org/10.1007/s11192-018-2690-1>.
32. Web of Science. <https://clarivate.com/products/web-of-science/>, (qasur për herë të fundit më 2018-09-27).
33. Whittemore, R., & Knafl, K. (2005). The integrative review: Updated methodology. *Journal of Advanced Nursing*, 52(5), 546-553. <https://doi.org/10.1111/j.1365-2648.2005.03621.x>.
34. Xia, J. (2015). Predatory journals and their article publishing charges. *Learned Publishing*, 28(1), 69-74. <https://doi.org/10.1087/20150111>.
35. Xia, J., Harmon, J. L., Connolly, K. G., Donnelly, R. M., Anderson, M. R., & Howard, H. A. (2015). Who publishes in "predatory" journals?. *Journal of the Association for Information Science and Technology*, 66(7), 1406-1417. <http://doi.org/10.1002/asi.23265>.

EFEKTI I TATIMIT LINEAR KUNDREJT TATIMIT PROGRESIV NË RRITJEN EKONOMIKE

Skender AHMETI¹
Alban ELSHANI²

Përmbledhje

Sot në botë ekziston një debat i madh si politik, ashtu edhe akademik se cilin lloj të tatimit duhet aplikuar, tatimin linear apo atë progresiv. Në këtë punim do të tregojmë se cilat shtete kanë rritje më të madhe të GDP-së për kokë banori, shtetet që aplikojnë tatimin linear apo ato që aplikojnë tatimin progresiv. Në studim janë marrë gjithsej 35 shtete evropiane. Në njëërën anë janë përfshirë 20 shtete evropiane, anëtare të OECD-së që aplikojnë tatimin progresiv dhe, në anën tjetër, janë përfshirë 15 shtete evropiane që aplikojnë tatimin linear. Për studim janë marrë 13 vite, nga viti 2002 (viti kur është futur në fuqi monedha e përbashkët euro) e deri në vitin 2014. Gjithsej kemi 456 observime. Të dhënat janë marrë nga databaza e Bankës Botërore, databaza e OECD-së dhe enti i statistikave të vendeve përkatëse. Të dhënat e variablave tjera janë paraqitur në % të brutoproduktit vendor. Në fund të punimit do të tregojmë se rritje më të madhe të GDP-së për kokë banori kanë shtetet që aplikojnë tatimin linear dhe atë me 3.13% në krahasim me shtetet që aplikojnë tatimin progresiv.

Fjalët çelës: *Rritja ekonomike, tatimi linear, tatimi progresiv, GDP per capita*

Hyrje

Arti i tatimit konsiston në përcaktimin e nivelit të tillë të tatimeve, në mënyrë që të sigurojë të ardhura sa më të mëdha të mundshme, me minimumin e reagimit të tatimpaguesve. (Jean Baptist Colbert- shek. XIV, Francë). (Becker & Mulligan, 2003).

Koncepti “Tatimi linear” zakonisht asocion me punimin shkencor të Hall-it dhe Rabushka-s (1983) të cilët e konsiderojnë aplikimin e

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
skender.ahmeti@uni-pr.edu

² Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
alban.elshani@uni-pr.edu

tatimit linear në të dyja llojet e tatimeve: Tatimit në të ardhurat e korporatave dhe tatimin në të ardhurat personale. Aplikimi i tatimit progresiv nënkupton që ky lloj i tatimit aplikohet së paku në tatimin në të ardhurat personale. Personi i parë i cili e përkrahu dhe tha që duhet të aplikohet tatimi linear ka qenë ekonomisti i njohur Adam Smith, i cili nuk e ka quajtur si tatimi linear, por në bazë të teorive të tij lë të kuptohet se ka menduar për këtë sistem. Mbi 20 shtete në botë, duke përfshirë edhe shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore (disa prej tyre edhe shtete anëtare të Bashkimit Evropian e disa tjera kandidate potenciale për të hyrë në Bashkimin Evropian) e aplikojnë tatimin linear në tatimin në të ardhurat personale dhe tatimin në të ardhurat e korporatave. Duke u bazuar në literaturën akademike, del se argumenti kryesor i aplikimit të tatimit linear bazohet në thjeshtësinë e saj. Si karakteristika përmenden: transparenca, zvogëlimi i kostove administrative dhe zvogëlimi i komplikimeve. Veçanërisht aplikimi i tatimit linear në tatimin në të ardhura personale dhe tatimin në të ardhura të korporatave japin stimulim për të punuar dhe investuar.

Termi “tatimi progresiv” në kuptimin e njëjtë është përdorur së pari nga Joseph Garnier (Sigot, 2010). Për të aplikuar tatimin progresiv duhet një numër shumë i madh i personave që marrin pjesë në mbledhjen e tatimeve. Aplikimi i tatimeve progresive kërkon një administratë tatimore më të madhe, më të shkolluar, por edhe më të paguar. Kjo nënkupton rritjen e shpenzimeve në administratën tatimore, andaj, si i tillë, ky lloj i tatimit mund të aplikohet vetëm në shtetet e zhvilluara. Për t’u kategorizuar si shtet që aplikon tatimin progresiv nuk është e thënë që në dy llojet e tatimeve (Tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në të ardhurat e korporatave) të aplikojnë progresivitetin. Nëse vetëm njëri nga tatimet (zakonisht tatimi në të ardhurat personale) ka progresivitet, atëherë mund të thuhet se ai shtet aplikon tatimin progresiv.

Rishikimi i literaturës

Tatimi linear

Paguhej me përqindje të njëjtë nga shuma e fituar. Ithtarët (mbrojtësit) e aplikimit të tatimit linear kundrejt atij progresiv kanë fituar poena në rastin e Rusisë. Rusia në vitin 2001 aplikoi tatimin linear, i cili u tregua mjaft i suksesshëm në rritjen ekonomike.

Aplikimi i tatimit linear ka kosto më të ulët administrative sesa aplikimi i tatimit progresiv. Nëse aplikohen norma të ulëta tatimore, atëherë tendencat për t'iu ikur tatimeve ulen. Edhe personat të cilët nuk merren me tatime e kanë shumë më të lehtë aplikimin e këtij lloji të tatimit kundrejt atij progresiv i cili është më i komplikuar. Aplikimi i këtij lloj tatimi mund të jetë politikë e mirë, por nuk do të thotë që është një sistem optimal tatimor.

Sipas autorëve Hall dhe Rabushka (1995) thuhet se nëse aplikohet tatimi linear, paga minimale duhet të përjashtohet nga tatimi. Sipas autorëve Rosen (2004) dhe Auerbach, Aaron dhe Hall (1983) aplikimi i tatimit linear ndikon pozitivisht në mirëqenien sociale, në formimin e kapitalit dhe në rritjen ekonomike tek pas shtatë viteve. Aplikimi i tatimit linear është një burim i përmirësimit të barazisë horizontale dhe eficiencës sikurse edhe e thjeshtësisë (Keen, 2007). Konkurrenca globale sjell rritjen ekonomike – me këtë lloj të aplikimit të tatimit vihet te një konkurrencë globale e mirëfilltë, e cila çon te rritja ekonomike e vendit. (Mitchell, Poterba, Warshawsky, & Brown, 1999).

Vendet që kanë aplikuar kohët e fundit tatimin linear e kanë bërë këtë në masë të madhe në shpresën e nxitjes së rritjes ekonomike. Vendet baltike si Estonia (viti 1994), Letonia (1995) dhe Lituania (1994) kanë pasur tatime lineare prej 24%, 25% dhe 33%, përkatësisht një sasi të tatimeve të liruara që nga mesi i viteve 1990. Më 1 janar 2001 një tatim linear prej 13% e aplikoi edhe Rusia. Ukraina ndjeku shembullin e Rusisë me një tatim linear 13% në 2003, e cila më vonë është rritur në 15% në vitin 2007. Në vitin 2004 Sllovakia futi një tatim linear prej 19% mbi shumicën e tatimeve (tatimi në të ardhurat personale, tatimin në të ardhurat e korporatave, TVSH, etj). Rumania aplikoi një tatim linear prej 16% mbi të ardhurat personale dhe tatimit në të ardhurat e korporatave më 1 janar 2005. Maqedonia aplikoi një tatim linear prej 12% mbi të ardhurat personale dhe të ardhurat e korporatave në 1 janar 2007 dhe premtoi për të ulur atë në 10% në 2008. Shqipëria ka aplikuar një tatim linear prej 10% nga viti 2008 deri në vitin 2014. Bullgaria aplikoi tatimin linear prej 10% për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe tatimit mbi të ardhurat personale që nga viti 2008.

Në vijim do të paraqesim të dhënat nga shtetet që aplikojnë tatimin linear nga viti 2002 deri në vitin 2014 (mesatarja).

Tabela 1. Shtetet që aplikojnë tatimin linear (mesatarja e viteve 2002-2014) në % të GDP-së

Shteti	Të hyrat totale	Të hyrat tatimore	Tatimet direkte (TAP dhe TAK)	Tatimet indirekte (TVSH, doganë dhe akcizë)	Të hyrat tjera tatimore	Të hyrat jotatimore
ALB	25.45	22.84	3.45	12.26	7.13	2.62
BH	46.04	37.26	3.48	19.71	14.07	8.78
BG	31.40	29.82	4.49	13.52	11.81	1.59
EST	37.47	31.73	7.27	12.87	11.60	5.74
CZ	39.34	33.76	6.77	10.77	16.22	5.58
HUN	44.38	37.92	8.44	15.44	14.04	6.46
LTU	32.79	29.05	5.47	14.07	9.50	3.74
LET	34.50	28.30	3.70	12.81	11.79	6.20
SVK	36.17	30.07	5.98	10.92	13.17	6.10
ROM	31.14	27.98	6.57	13.11	8.30	3.16
SRB	41.80	37.37	6.26	18.08	13.02	4.44
MKD	31.90	28.14	3.38	13.60	11.16	3.76
RUS	37.69	28.51	8.41	7.66	12.43	9.18
GEO	25.88	20.79	6.93	11.98	1.88	5.09
UKR	44.26	25.90	9.40	12.16	4.34	18.35

Burimi: World Bank Indicators, OECD, enti i statistikave të vendeve përkatëse, IMF, të përpunuara nga autori

Është për t'u theksuar se në këto vite rritjen më të madhe ekonomike e ka pasur Gjeorgjia në vitin 2007 prej 12.34% rritje të GDP-së, respektivisht 13.83% rritje të GDP-së për kokë banori. Pas Gjeorgjisë kanë pasuar këto shtete: Ukraina në vitin 2004 ka pasur rritje të GDP-së prej 12.10%, respektivisht 12.95% rritje në GDP për kokë banori. Letonia në vitin 2006 ka pasur një rritje të GDP-së prej 11.90%, respektivisht 12.93% rritje në GDP për kokë banori. Lituania në vitin 2007 ka pasur një rritje të GDP-së prej 11.09% dhe 12.41% rritje në GDP për kokë banori. Estonia në vitin 2006 ka pasur një rritje të GDP-së prej 10.27% dhe 10.92% rritje në GDP për kokë banori.

Shtetet që kanë pasur rënie të GDP-së për kokë banori në këto vite kanë qenë: Letonia, Lituania, Estonia dhe Ukraina. Është për t'u cekur se të gjitha këto vende kanë pasur rënie të GDP-së pikërisht në kohë krize, në vitin 2009. Letonia në këtë vit ka pasur rënie të GDP-së

prej 14.35%, respektivisht 12.92% rënie në GDP për kokë banori. Lituania ka pasur rënie të GDP-së prej 14.81%, respektivisht 13.86% rënie në GDP për kokë banori. Estonia ka pasur rënie prej 14.72% në GDP, respektivisht 14.56% në GDP për kokë banori. Ukraina ka pasur rënie prej 14.80% në GDP, respektivisht 14.42% rënie në GDP për kokë banori. Në vijim do të paraqesim rritjen ekonomike ndër vite (mesatarja) të shteteve që aplikojnë tatimin linear.


Tabela nr. 2. GDP për kokë banori

GDP për kokë banori	
Viti	Shtetet që aplikojnë tatimin linear
2002	5.65
2003	6.76
2004	7.28
2005	7.18
2006	7.80
2007	8.15
2008	3.85
2009	(6.36)
2010	2.61
2011	4.10
2012	1.88
2013	2.33
2014	2.22

Burimi: World Bank Indicators

Në tabelën e mësipërme është paraqitur rritja ekonomike e shteteve që aplikojnë tatimin linear ndër vite. Në vitin 2002 rritja mesatare e GDP-së për kokë banori për gjithsej 15 shtete që janë marrë në studim ka qenë 5.65%. Në këtë vit rritjen më të madhe e ka pasur Letonia me 8.36% rritje të GDP-së për kokë banori, e përcjellur nga Bullgaria me 8.06% rritje dhe Lituania me 7.62% rritje. Ndërsa rritjen më të ulët e ka pasur Maqedonia me 1.14%, e ndjekur nga Çekia me 1.84% rritje të GDP-së për kokë banori.

Grafiku 1. Rritja e brutoproduktit vendor në shtetet që aplikojnë tatimin linear 2002-2014



Burimi: World Bank Indicators, të përpunuara nga autori

Rritjen më të madhe ekonomike shtetet që aplikojnë tatimin linear e kanë pasur në vitin 2007 me mesatare 8.15% rritje të GDP-së për kokë banori. Në këtë vit rritjen më të madhe të GDP-së për kokë banori e ka pasur Gjeorgjia me 13.83%, e ndjekur nga Lituania me 12.41% dhe Letonia me 10.86%. Rritjen më të vogël të GDP-së për kokë banori e ka pasur Hungaria me 0.58%, e ndjekur nga Çekia me 4.92%.

Në kohë krize, respektivisht në vitin 2009, shtetet që kanë aplikuar tatimin linear kanë pasur një rënie të GDP-së për kokë banori prej -6.36%. Në këtë vit shtetet që më së shumti e kanë ndier krizën janë Estonia me 14.56% ulje të GDP-së për kokë banori, e përcjellur nga Ukraina me 14.42% ulje, Lituania me 12.92% ulje dhe Letonia me 12.92% ulje. Ndërsa shteti që e ka ndier më pak krizen financiare të vitit 2009 ka qenë Shqipëria me një rritje të GDP-së për kokë banori prej 4.05%.

Tatimi progresiv

Shumë autorë të ndryshëm kanë dhënë mendime të ndryshme, disa *për* e disa *kundër* tatimit progresiv. Së pari lind pyetja: Tatimi progresiv a iu përmbahet parimeve të barazisë? Tatimi progresiv i bën të gjithë qytetarët të sakrifikojnë në mënyrë të barabartë (Mill, 1848).

Tatimi progresiv shkel parimin e barazisë para ligjit, meqë individët janë të barabartë para ligjit (Dorn, 1996).

Tatimi progresiv rrit të ardhurat e buxhetit duke përmirësuar borxhin publik dhe përmirëson pabarazinë pa pasur ndikim negativ mbi rritjen ekonomike (Fieldhouse, 2013). Sipas autorit, të dhënat statistikore dhe teoria ekonomike tregojnë se sistemi optimal është ai progresiv.

Tatimi progresiv supozon se të pasurit duhet të paguajnë më shumë se të varfërit. Kjo do të thotë se kush fiton më shumë duhet të paguajë një normë më të madhe të tatimit (Klinghoffer & Elkis, 1992). Nga kjo thënie mund të vijmë në përfundim se personat që kanë të ardhura më të mëdha duhet të paguajnë më shumë, sepse më shumë i shfrytëzojnë të mirat e atij shteti. Tatimi progresiv i detyron padrejtësisht të pasurit që të paguajnë tatim më shumë. Në parim, amerikanët e pasur këtë nuk e meritojnë (Downes, 1999). Të pasurit nuk përfitojnë diçka më shumë nga sistemi tatimor (Downes, 1999). Të pasurit paguajnë pjesën më të madhe të tatimeve, sepse ata përfitojnë më shumë nga të ardhurat kombëtare (Shapiro, 1996). Nga tatimi progresiv përfiton publiku (populli), nga publiku (populli) përfitojnë të pasurit. (Lakoff, 2007). Tatimi regresiv në shitje (sales tax) e bën të domosdoshëm aplikimin e tatimit progresiv (Jacobs, 2010). Aplikimi i tatimit progresiv nuk ndikon në çështje etike. (Shapiro, 1996). Shumë autorë morën në studim ndikimin e tatimeve në punësim. Sipas autorëve Koskela dhe Fuest (1996) thuhet se tatimi progresiv ka ndikim në rritjen e punësimit. Tatimi progresiv ndikon në rritjen e normës së punësimit (Koskela, 1996). Tatimi progresiv nuk është domosdoshmërisht i mirë për punësim. (Fuest, 2000).

Në vijim do të paraqesim të dhënat nga shtetet që aplikojnë tatimin progresiv nga viti 2002 deri në vitin 2014 (mesatarja).

Tabela 3. Shtetet që aplikojnë tatimin progresiv (mesatarja e viteve 2002-2014) në % të GDP-së

Shteti	Të hyrat totale	Të hyrat tatimore	Tatimet direkte (TAP dhe TAK)	Tatimet indirekte (TVSH, doganë dhe akcizë)	Të hyrat tjera tatimore	Të hyrat jotatimore
AUT	49.03	41.53	11.52	14.24	15.22	7.50
BEL	49.77	43.25	15.59	13.13	11.61	6.52
DNK	54.76	46.45	27.36	19.32	2.81	8.31
FIN	52.77	42.20	15.67	17.51	7.90	10.57
FRA	4.06	3.25	1.21	1.35	0.61	0.81
DEU	43.56	35.18	10.37	12.93	11.03	8.38
GRC	41.84	32.19	7.39	14.19	8.82	9.65
ISL	42.66	36.12	14.92	16.21	2.64	6.53
IRL	34.23	28.73	11.57	12.86	2.37	5.51
ITA	45.33	41.48	13.82	13.54	11.80	3.85
LUX	43.87	37.79	13.34	14.55	6.96	6.08
NLD	42.83	35.88	9.56	13.10	11.68	6.95
NOR	56.61	41.65	19.59	14.24	6.68	14.96
POL	39.44	32.74	6.63	16.29	8.40	6.70
PRT	41.67	31.81	8.86	17.00	4.80	9.87
ESP	38.02	33.24	9.62	11.04	10.19	4.78
SWE	52.16	44.29	16.12	14.79	12.19	7.87
SUI	33.19	26.74	11.20	7.14	6.40	6.45
GBR	37.92	33.31	12.51	13.54	3.24	4.61
SVN	3.48	36.99	7.50	17.62	11.26	6.49

Burimi: World Bank Indicators, OECD

Për dallim nga shtetet që aplikojnë tatimin linear, në shtetet që aplikojnë tatimin progresiv rritja e GDP-së për kokë banori është më e vogël, mirëpo ka një rritje konstante. Prej vitit 2002 deri në vitin 2014 rritjen më të madhe të GDP-së për kokë banori e ka pasur Islanda në vitin 2004 me 7.27%, e pasuar nga Polonia në vitin 2007 me 7.26%. Ndërsa rënien më të madhe të GDP-së për kokë banori e ka pasur Greqia në vitin 2011 me 9.00%, pasuar nga Finlanda në vitin 2009 me 8.71% rënie të GDP-së për kokë banori.

Në formë tabelare do ta paraqesim rritjen ekonomike ndër vite të shteteve që aplikojnë tatimin progresiv


GDP për kokë banori	
Viti	Shtetet që aplikojnë tatimin progresiv
2002	1.22
2003	1.11
2004	2.92
2005	2.04
2006	3.13
2007	3.35
2008	(0.15)
2009	(4.72)
2010	1.15
2011	0.67
2012	(1.07)
2013	(0.20)
2014	1.25

Burimi: World Bank Indicators

Nga tabela e mësipërme vërehet se shtetet që kanë aplikuar tatimin progresiv nuk kanë pasur rritje të madhe ekonomike.

Në vijim në grafik do të paraqesim rritjen e GDP-së për kokë banori prej vitit 2002 deri në vitin 2014 (mesatarja)

Grafiku 2. Rritja e GDP-së për kokë banori në shtetet që aplikojnë tatimin progresiv



Burimi: World Bank Indicators

Në shtetet që aplikojnë tatimin progresiv, viti 2007 ka qenë viti më i mirë me një rritje mesatare të GDP-së për kokë banori prej 3.35%. Në këtë vit rritjen më të madhe të GDP-së për kokë banori e ka pasur Polonia me 7.26%, e pasuar nga Islanda me 6.76% dhe Luksemburgu me 6.73% rritje të GDP-së për kokë banori. Viti që ka pasur rënie të GDP-së për kokë banori është viti 2009 (kriza e madhe financiare) me një mesatare të rënies së GDP-së për kokë banori prej 4.72%. Në këtë vit rënien më të madhe të GDP-së për kokë banori e ka pasur Finlanda me 8.71%, e pasuar nga Sllovenia me 8.63% dhe Luksemburgu me 7.11% rënie. I vetmi shtet i cili nuk ka pasur rënie ekonomike gjatë viteve 2002-2014 ka qenë Polonia.

Metodologjia

Në tërë rishikimin e literaturës që lidhet me temën tonë është vërejtur se shumica e autorëve kanë përdorur modelin panel, i cili është edhe modeli më i mirë kur kemi të bëjmë me shumë shtete për shumë vite. Përdorimi i të dhënave panel bën të mundur vlerësimin e ndryshimeve në kohë, por edhe ndryshimeve midis shteteve. Marrja e të dhënave në formë paneli bën të mundur të kemi më shumë të dhëna dhe si rezultat i kësaj jemi më të saktë. Përmes aplikimit të modelit panel është e mundur të kontrollohen variablat, që në realitet është

shumë e vështirë të maten, kjo vlenë sidomos në rastin tonë (Rregullat dhe ligjet janë të njëjta për çdo shtet, por norma tatimore e tyre mund të ndryshojë nga viti në vit). Të dhënat tona panel janë të balancuara. Me këtë nënkuptojmë se kemi të dhëna për të gjitha shtetet për një periudhë të njejtë kohore. Për të përcaktuar se cilat shtete kanë pasur rritje më të mëdhe të GDP-së për kokë banori, e kemi përdorur modelin Panel Random Effects me Dummy Variabla, ku me D1 kemi shënuar shtetet që aplikojnë tatimin progresiv, ndërsa me D0 kemi shënuar shtetet që aplikojnë tatimin linear.

Shtetet janë ndarë në dy grupime. Në grupimin e parë janë marrë gjithsej 15 shtete evropiane (të gjitha shtetet) që aplikojnë tatimin linear apo në periudha të ndryshme e kanë ndryshuar llojin e tatimit si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Estonia, Letonia, Lituania, Bullgaria, Serbia, Maqedonia, Rusia, Ukraina, Gjeorgjia, Rumania, Sllovakia, Hungaria dhe Çekia.

Në grupimin e dytë bëjnë pjesë shtetet evropiane, anëtare të OECD-së, të cilat aplikojnë tatimin progresiv si: Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Islanda, Republika e Irlandës, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Spanja, Suedia, Zvicra, Britania e Madhe dhe Sllovenia.

Periudha kohore e cila është marrë për analizë është nga viti 2002 deri në vitin 2014. Numri total i observimeve është gjithsej 456 observime me të dhëna të plota.

Si variabla janë marrë rritja e GDP-së për kokë banori, tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në të ardhurat e korporatave, tatimi mbi vlerën e shtuar së bashku me të hyrat nga doganat dhe akciza, të hyrat tjera tatimore dhe të hyrat jotatimore. Të dhënat janë marrë nga databaza e Bankës Botërore. Këto variabla i kanë përdorur edhe shumica e autorëve të cilët e kanë shtjelluar këtë problematikë si: (Martinez-Vazquez, 2011) (Canavire-Bacarreza & Martinez-Vazquez, 2013), (Kneller, 1999), (Padovano, 2001) (Widmalm, 2001), (Schwellnus, 2008), (Arnold, 2011), (Romer, 2010), (Lee & Gordon, 2005), (Mendoza, Milesi-Ferrett, & Patrick, 1997) etj.

Si variabël e varur është marrë rritja e brutoproduktit vendor për kokë banori (Growth of GDP per capita). Kjo variabël është marrë si e tillë duke u bazuar në autorët e mëparshëm që janë marrë me efektin e tatimeve në rritjen ekonomike. Të dhënat për rritjen e brutoproduktit vendor për kokë banori janë marrë nga databaza e Bankës Botërore (World Bank Databaze – World Development Indicators), ndërsa si variabla të pavarura janë marrë tatimet direkte (Tatimi në të ardhurat

personale së bashku me tatimin në të ardhurat e korporatave), tatimet indirekte (Tatimi mbi vlerën e shtuar së bashku me të hyrat nga dogana dhe akciza) dh të hyrat tjera tatimore e jotatimore. Këto të dhëna janë mbledh nga databaza e OECD-së, FMN-së dhe enteve të statistikave të vendeve përkatëse.

Gjetjet

Në vijim do të paraqesim rezultatet e fituara përmes aplikimit të modelit ekonometrik PANEL data, Random Effects me dummy variabla, ku me D0 kemi shënuar shtetet që aplikojnë tatimin linear dhe D1 kemi shënuar shtetet që aplikojnë tatimin progresiv.

Random-effects GLS regression				Number of obs		=	456
Group variable: id				Number of groups		=	35
R-sq:				Obs per group:			
within = 0.0823				min		=	13
between = 0.7130				avg		=	13.0
overall = 0.1858				max		=	14
corr(u_i, X) = 0 (assumed)				Wald chi2(5)		=	92.48
				Prob> chi2		=	0.0000

GDP per cap.		Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	

progresiv		-3.128352	.4951588	-6.32	0.000	-4.098845	-2.157859
dir.tax		.0001834	.0511514	0.00	0.997	-.1000714	.1004383
ind.tax.		-.0400993	.0631083	-0.64	0.525	-.1637894	.0835907
other taxes.		-.1286093	.0468216	-2.75	0.006	-.2203781	-.0368406
nontax		-.2148071	.0603174	-3.56	0.000	-.3330271	-.096587
_cons		7.231472	1.119266	6.46	0.000	5.037751	9.425194

sigma_u		.38191939					
sigma_e		3.6115574					
rho		.01105922	(fraction of variance due to u_i)				

Nga kjo që shihet më lart vijmë në përfundim se shtetet që aplikojnë tatimin progresiv kanë rritje më të vogël të GDP-së për kokë banori kundrejt shteteve që aplikojnë tatimin linear. Thënë ndryshe, shtetet që aplikojnë tatimin linear kanë rritje më të madhe të GDP-së për kokë banori me 3.13% më shumë sesa shtetet që aplikojnë tatimin progresiv.

Në vijim do të paraqesim rritjen e GDP-së për kokë banori në shtetet që aplikojnë tatimin linear dhe në shtetet që aplikojnë tatimin progresiv. Njëherësh do të mundohemi të tregojmë se në cilat shtete ka pasur rritje më të madhe të GDP-së për kokë banori.

Tabela 4. Rritja e GDP-së për kokë banori në % (mesatarja)


GDP për kokë banori		
Viti	Shtetet që aplikojnë tatimin progresiv	Shtetet që aplikojnë tatimin linear
2002	1.22	5.65
2003	1.11	6.76
2004	2.92	7.28
2005	2.04	7.18
2006	3.13	7.80
2007	3.35	8.15
2008	(0.15)	3.85
2009	(4.72)	(6.36)
2010	1.15	2.61
2011	0.67	4.10
2012	(1.07)	1.88
2013	(0.20)	2.33
2014	1.25	2.22

Burimi: World Bank Indicators

Në tabelë është paraqitur rritja e GDP-së për kokë banori për secilin vit. Në njërin anë është paraqitur mesatarja e rritjes së GDP-së për kokë banori te shtetet që aplikojnë tatimin progresiv (mesatarja), ndërsa në anën tjetër është paraqitur mesatarja e rritjes së GDP-së për kokë banori te shtetet që aplikojnë tatimin linear. Trendi i rritjes së GDP-së për kokë banori është më i theksuar te shtetet që aplikojnë tatimin linear.

Trendi i rritjes së GDP-së për kokë banori i shteteve që aplikojnë tatimin linear kundrejt atyre që aplikojnë tatimin progresiv më mirë mund të shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 3. GDP për kokë banori - tatimi linear, vs tatimi progresiv



Burimi: World Bank Indicators

Në periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2008 trendi i rritjes së GDP-së për kokë banori ka qenë më i theksuar te shtetet që aplikojnë tatimin linear. Mirëpo në kohë krize (2009) rënie më të madhe të GDP-së për kokë banori kanë pasur shtetet që aplikojnë tatimin progresiv. Pas kalimit të krizës financiare të vitit 2009, prapë trendi i rritjes ka qenë më i theksuar te shtetet që aplikojnë tatimin linear.

Përfundimi

Shtetet që aplikojnë tatimin linear kanë rritje më të madhe ekonomike sesa shtetet që aplikojnë tatimin progresiv. Shtetet që aplikojnë tatimin linear kanë rritje më të madhe të GDP-së për kokë banori me 3.13% më shumë sesa shtetet që aplikojnë tatimin progresiv. Nga kjo mund të themi se aplikimi i tatimit linear është më i qëlluar sesa aplikimi i tatimit progresiv.

Shtetet që aplikojnë tatimin linear njohin një rritje të menjëhershme ekonomike. Shtetet e Evropës Lindore dhe Juglindore zakonisht e aplikojnë tatimin linear. Aplikimi i tatimit linear ka kosto më të ulët administrative sesa aplikimi i tatimit progresiv. Argument i fortë për aplikimin e tatimit linear mund të jetë rritja e investimeve,

rritja e punësimit dhe rritja e prodhimit. Argumenti kryesor i aplikimit të tatimit linear bazohet në thjeshtësinë e saj. Si karakteristika janë: transparenca, zvogëlimi i kostove administrative dhe zvogëlimi i komplikimeve. Aplikimi i tatimit linear nganjëherë ndikon në reduktimin e shtrembërimeve tatimore dhe si e tillë ndikon në rritjen e eficiencës ekonomike.

Për të aplikuar tatimin progresiv duhet një numër shumë i madh i personave që marrin pjesë në mbledhjen e tatimeve. Aplikimi i tatimeve progresive kërkon një administratë tatimore më të madhe, më të shkolluar por edhe më të paguar. Kjo nënkupton rritjen e shpenzimeve në administratën tatimore, andaj, si e tillë, ky lloj i tatimit mund të aplikohet vetëm në shtetet e zhvilluara.

THE EFFECT OF LINEAR TAX VERSUS PROGRESSIVE TAX ON ECONOMIC GROWTH

Skender AHMETI

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
skender.ahmeti@uni-pr.edu

Alban ELSHANI

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
alban.elshani@uni-pr.edu

Abstract

Today, the world is gripped in a great political and academic debate as to which type of taxation should be applied, linear or progressive taxation. In this paper we will show which countries have higher GDP growth per capita, those applying linear taxation or those applying progressive taxation. A total of 35 European countries have been surveyed. On one hand there are 20 European countries, OECD members applying progressive taxation, and on the other 15 European countries applying linear taxation. For the paper we used data for 13 years, from 2002 (the year when the Euro was introduced) until 2014. In total, we have 456 observations. The data are obtained from the World Bank database, the OECD database and the countries' statistics agencies. Other variables' data are presented in % of Gross Domestic Product. At the end of the paper, we will show that countries applying the linear tax achieve higher GDP growth per capita, by 3.13%, compared to the countries applying the progressive tax.

Keywords: economic growth, linear taxation, progressive taxation, GDP per capita

Literatura

1. Arnold, J. M. (2011). Tax policy for economic recovery and growth. *The Economic Journal* , 59-80.
2. Auerbach, A. J., Aaron, H. J., & Hall, R. E. (1983). Corporate taxation in the United States. *Brookings Papers on Economic Activity* no. 2 , 451-513.
3. Becker, G. S., & Mulligan, C. B. (2003). Deadweight costs and the size of government. *The Journal of Law and Economics* 46, no. 2 , 293-340.
4. Canavire-Bacarreza, G., & Martinez-Vazquez, J. a. (2013). *Taxation and economic growth in Latin America*. Washington D.C.: Inter-American Development Bank.
5. Dorn, J. A. (1996). Ending Tax Socialism: Progressive taxation is unfair and unsafe. *Freeman New York Foundation for Economic Education* , 747-748.
6. Downes, T. A. (1999). Do tax and expenditure limits provide a free lunch? Evidence on the link between limits and public sector service quality. *National Tax Journal* , 113-128.
7. Fieldhouse, A. (2013). *A review of the economic research on the effects of raising ordinary income tax rates*. New York: Economic Policy Institute.
8. Fuest, C. a. (2000). Is tax progression really good for employment? A model with endogenous hours of work. *Labour Economics* , 79-93.
9. Hall, R. E., & Rabushka, A. (1983.). *Low tax, simple tax, flat tax*. McGraw-Hill Companies .
10. Hall, R. E., & Rabushka, A. (1995). *The flat tax*. Stanford: Hoover Institution Press, Stanford University, Vol. 423.
11. Jacobs, B. a. (2010). Human capital and optimal positive taxation of capital income. *International Tax and Public Finance* , 451-478.
12. Keen, S. (2007). *Empathy and the Novel*. Oxford: Oxford University Press on Demand.
13. Klinghoffer, J. A., & Elkins, L. (1992). "The Petticoat Electors": Women's Suffrage in New Jersey, 1776-1807. *Journal of the Early Republic* , 12 (2), 159-193.
14. Kneller, R. M. (1999). Fiscal policy and growth: evidence from OECD countries. *Journal of Public Economics* , 171-190.

15. Koskela, E. a. (1996). Tax progression is good for employment in popular models of trade union behaviour. *Labour Economics* , 65-80.
16. Lakoff, G. a. (2007). *Progressive Taxation: Some Hidden Truths*. Kansas City: The Huffington Post.
17. Lee, Y., & Gordon, R. H. (2005). Tax structure and economic growth. *Journal of public economics* , 1027-1043.
18. Martinez-Vazquez, J. V. (2011). Direct versus indirect taxation: Trends, theory and economic significance. *The Elgar Guide to Tax Systems, Edward Elgar Publishing* , 37-92.
19. Mendoza, E. G., Milesi-Ferrett, i. G., & Patrick, A. (1997). On the ineffectiveness of tax policy in altering long-run growth: Harberger's superneutrality conjecture. *Journal of Public Economics* , 99-126.
20. Mill, J. S. (1848). *Principles of Political Economy; With Some of Their Applications to Social Philosophy* (Vol. 2). London: John W. Parker.
21. Mitchell, O., Poterba, J., Warshawsky, M., & Brown, J. (1999). New evidence on the money's worth of individual annuities. *American Economic Review.* , 1299-1318.
22. Padovano, F. a. (2001). Tax rates and economic growth in the OECD countries. *Economic Inquiry* , 44-57.
23. Romer, C. D. (2010). The macroeconomic effects of tax changes: estimates based on a new measure of fiscal shocks. *The American Economic Review* , 763-801.
24. Rosen, H. S. (2004, May 20). The Case for Making the TaxCuts Permanent. *'Remarks for the National Tax Association Spring Symposium*.
25. Schwellnus, C. a. (2008). Do Corporate Taxes Reduce Productivity and Investment at the Firm Level? Cross-country Evidence from the Amadeus Dataset. *OECD Economics Department* , forthcoming.
26. Shapiro, R. J. (1996). *Why Fairness Matters*:. Washington, D.C: Progressive Foundation.
27. Sigot, N. (2010). Utility and Justice: French Liberal Economists in the 19th Century. *European Journal of the History of Economic Thought*, Taylor & Francis (Routledge), 17 (4) , 759-792.
28. Widmalm, F. (2001). Tax structure and growth: Are some taxes better than others? *Public Choice* , 199-219.

NDIKIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE NË ARSIM NË RITJEN EKONOMIKE

Lekë PULA¹

Përmbledhje

Në këtë punim shkencor do të trajtojmë ndikimin e shpenzimeve publike në arsim në rritjen ekonomike në Kosovë. Të dhënat e serive kohore përfshijnë periudhën prej vitit 2002 deri në vitin 2016. Metodologjia e përdorur në këtë punim për vlerësimin dhe krahasimin ndërmjet ndikimit të shpenzimeve publike në arsim dhe rritjen ekonomike do të jetë regresioni i shumëfishtë linear (OLS). Vlerësimi i këtij modeli të regresit OLS do të kryhet vetëm pasi që kemi aplikuar testin e Augmented Dickey-Fuller (ADF) për të vlerësuar të dhënat e serive kohore, nëse janë stacionare. Pastaj pas vlerësimit të modelit janë kryer testet statistikore për të siguruar që ky studim do të fitojë rezultatet dhe konkluzionet më të mira për sa i takon ndikimit të shpenzimeve publike në rritjen ekonomike. Modeli i ka plotësuar të gjitha supozimet e testeve statistikore, siç janë: Mbetjet e termit të gabimit kanë shpërndarje normale (*testi Jarque – Bera*), nuk ka autokorrelacion ndërmjet variablave (*testi Breusch-Godfrey*), variantat e gabimit janë konstante, pra që njihen si parim i homoskedasticitetit (*testi Breusch-Pagan-Godfrey*).

Të dhënat për brutoproduktin vendor si variabël i varur janë marrë nga databaza e Bankës Qendrore, Ministria e Financave dhe Enti i Statistikave i Kosovës. Ndërsa si variabla ekzigjene janë marrë shpenzimet publike në arsim (*Shpnz. A*), investimet private (*INV*), eksportet (*EXP*) dhe të ardhurat totale buxhetore (*TRtax*). Pas analizimit të të dhënave kemi gjetur se shpenzimet publike në arsim kanë ndikim negativ dhe plotësisht sinjifikant në rritjen ekonomike. Eksportët gjithashtu kanë ndikim pozitiv, ndërsa të ardhurat e përgjithshme buxhetore kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, por nuk janë statistikisht sinjifikante.

Fjalët çelës: Brutoprodukti, shpenzimet publike, rritja ekonomike, arsimi.

Hyrje

Shpenzimet në Arsim në Kosovë si kategori e shpenzimeve kanë mision për hartimin dhe realizimin e një sistemi arsimor në pajtim me standardet evropiane. Në këtë kategori të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional hyjnë shpenzimet për arsimin parashkollor, primar, arsimin dytësor dhe tretësor dhe shërbimet shtesë të arsimit.

¹ Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
leke.pula@uni-pr.edu

Ministritë dhe organizatat buxhetore që përbëjnë sektorin e arsimit janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Universiteti i Prishtinës; Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Pejës etj. Shumë vende të zhvilluara dhe ato në zhvillim i kushtojnë mjaft rëndësi sektorit të arsimit, sepse kjo kategori e shpenzimeve funksionale është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit


Shpenzimet në sektorin e Arsimit sipas literaturës ekonomike janë një përcaktues shumë i rëndësishëm i produktivitetit të punës, zhvillimit teknologjik, zvogëlimit të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik. Ekzistojnë shumë punime empirike që tregojnë se shpenzimet në arsim kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike (Gylfason, 2001), (Hanushek, Schwerdt, Woessman, & Zhang, 2017), (Jakobowski, 2011). Ndërsa Sala-i-Martin (1992) në punimin e tij thekson se nga tërësia e shpenzimeve publike, shpenzimet në fushën e arsimit janë komponenti më i rëndësishëm në rritjen ekonomike. Kjo është arsyeja pse në vendet e zhvilluara ekonomike shpenzimet publike në arsim janë në nivele të larta, sepse është sektor prioritar i ekonomisë. Sipas Bankës Botërore shpenzimet në sektorin e arsimit duhet të konsiderohen si investime në kapitalin njerëzor, sepse një punëtor i shkolluar dhe i aftësuar mirë do të rrisë buxhetin e shtetit përmes pagesës në tatimin e të ardhurave personale dhe kontributeve sociale.

Ndër të tjera, siç vihet re edhe nga tabela 1, niveli i shpenzimeve publike në sektorin e arsimit është rritur kohën e fundit dhe po arrin mesataren e vendeve të rajonit. Kosova gjatë kësaj periudhe ka shpenzuar në sektorin e arsimit një mesatare rreth 15% nga totali i shpenzimeve të përgjithshme publike, ndërsa në raport me BPV ka arritur një mesatare rreth 4.1%. Përderisa në vitin 2004 shpenzimet në sektorin e arsimit ishin 3.7 për qind të BPV-së, në vitin 2011 arriti në 4%, ndërsa në vitin 2014 shpenzimet në këtë sektor arritën në 4.2 për qind të BPV-së. Pavarësisht rritjes së shpenzimeve publike gjatë kësaj periudhe, Kosova shpenzon sa mesatarja e vendeve të rajonit, mirëpo krahasuar me vendet e Bashkimit Europian (BE-11)² është nën nivelin e tyre. Sipas Bankës Botërore të vitit 2010 Kosova shpenzoi në sektorin e arsimit më shumë sesa Shqipëria (3.3%) dhe IRJ e Maqedonisë (3.5%), por më pak krahasuar me Kroacinë (4.4%) dhe

² BE-11 përbëhet nga Polonia, Sllovenia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Lituania, Letonia, Estonia, Bullgaria, Rumania, dhe Kroacia.


Serbin (4.7%). Grafikët e mëposhtëm 1 dhe 2 tregojnë shpenzimet në arsim në % të BPV-së krahasuar me vendet e rajonit.

Grafiku 1 Shpenzimet publike në arsim, %PBBsë.(2012)



Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN-ja)

Grafiku 2 Shpenzimet e tërësishme publike dhe shpenzimet publike në arsim, %PBBsë(2012)



Burimi: Banka Botërore (2014)

Pavarësisht rritjes së nivelit të shpenzimeve publike në këtë sektor, kostoja mesatare për nxënës mbetet prapa vendeve të rajonit. Ky rezultat vjen për shkak të proporcionit të lartë të nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit në Kosovë. Në këtë kontekst, raporti i Bankës Botërore (2010) vlerësoi se kostoja mesatare operative për nxënës në Kosovë është 377 euro për një vit shkollor, ekuivalent me 14% të BPV-së për kokë banori dhe krahasuar me vendet e tjera të rajonit është e ulët. P.sh. Bullgaria dhe Kroacia përafërsisht kanë kosto mesatare për nxënës rreth 23%, Sllovakia rreth 15%, ndërsa Hungaria ka një kosto mesatare për nxënës rreth 25%.

Nga ana tjetër, sistemi i arsimit në nivelin publik që lidhet me raportin mësues-nxënës është në raport të mirë në krahasim me vendet e rajonit. Sipas Bankës Botërore (2014), në vitin 2011 ky raport kishte rënë nga 18.1 në 16.4 për arsimin fillor, ndërsa për arsimimin e mesëm gjithashtu kishte rënë nga 19.7 në 15.6 krahasuar me vendet me të ardhura të larta të mesme, ku raporti nxënës-mësues për arsimin fillor është 18.5, ndërsa për arsim bazik është 15.4. Në bazë të tabelës së mëposhtme vërehet se niveli i arsimit në raportin mësues-nxënës është në nivel të kënaqshëm. Statistikat e arsimit në Kosovë (2013/2014)

Tabela 1. Treguesit e arsimit sipas raportit nxënës-mësues, viti 2014/2015


Niveli i arsimit	Treguesit	Vlera
Arsimi parashkollor	Numri i nxënësve	5,119
	Raporti gjinor F/M	0.92
	% e femrave	48.0
	Raporti nxënës-mësimdhënës	9.7
Arsimi parafillor	Numri i nxënësve	20.809
	Raporti gjinor F/M	0.94
	% e femrave	48.5
	Raporti nxënës-mësimdhënës	23.6
Arsimi fillor i mesëm i ulët	Numri i nxënësve	273649
	Raporti gjinor F/M	0.94
	% e femrave	48.4
	Raporti nxënës-mësimdhënës	16.4
Arsimi i mesëm i lartë	Numri i nxënësve	83.743
	Raporti gjinor F/M	0.89
	% e femrave	47.0
	Raporti nxënës-mësimdhënës	15.6

Burimi: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), 2014/2015

Përpos kësaj, vlen të theksohet se rritja e nivelit të shpenzimeve publike në sektorin e arsimit ishte kryesisht si rezultat i rritjes së pagave të mësimdhënësve, për shembull rritja e pagave në vitin 2011 ndikoi që shpenzimet në arsim të rriteshin nga 3.6 në 4.1 për qind të BPV-së. Siç vërehet edhe nga grafiku i mëposhtëm, kategoria e shpenzimeve në paga dhe mëditje akumulon nivelin më të lartë në totalin e shpenzimeve në arsim. Pra, pjesa më e madhe e shpenzimeve të alokuara për sektorin e arsimit kanë qenë të drejtuara në rritjen e pagave e shumë pak të drejtuara për të rritur cilësinë në arsim. Ndërsa shpenzimet kapitale në vitin 2012 në sektorin e arsimit kishin rënë nga 10.1% në 6% nga totali i shpenzimeve të alokuara për këtë sektor. Kjo rënie sipas Ministrisë së Arsimit është si rezultat që qeveria ka eliminuar të gjitha shkollat me tri ndërrime. Pavarësisht eliminimit të shkollave me tri ndërrime, shpenzimet kapitale ende janë nën mesataren e vendeve të OECD-së. Vendet e OECD-së rreth

8.7% të shpenzimeve në arsim i alokojnë në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Sipas Bankës Botërore, rritja e pagave dhe mëditjeve nga 76 për qind në 83 për qind të buxhetit total të arsimit gjatë viteve 2008 dhe 2012 nuk kanë qenë ekonomikisht racionale, por të motivuara politikisht.

Grafiku 3. Shpenzimet në arsim sipas kategorive ekonomike, % e BPV-së



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës (ESK). Të dhënat janë të përpunuara.

Ndër të tjera, Kosova ka një popullsi të re dhe gjithnjë në rritje. Papunësia në Kosovë sipas raportit të Bankës Botërore është me normën më të lartë krahasuar nga të gjitha vendet e Evropës, që është vlerësuar në 30.9% në vitin 2012 sipas Entit të Statistikave të Kosovës. Çdo vit tregut të punës i shtohen rreth 25000 punëtorë të rinj, derisa rreth 15000 vende të reja pune krijohen çdo vit. Kosova mund të përfitojë nga kjo popullsi e re përmes investimeve në kapitalin njerëzor, andaj investimet e qeverisë në sektorin e arsimit dhe në aftësimin e mirëfilltë do t'u ndihmonte punëtorëve të rinj që i shtohen tregut të punës të gjejnë punësim sa më parë. Kjo fuqi punëtore e pajisur me njohuri dhe aftësi të kualifikuar do t'u ndihmojë ndërmarrjeve private dhe publike që të arrijnë qëllimin e tyre që është maksimizimi i fitimit dhe, në anën tjetër, punësimi i punëtorëve të rinj do të rriste kontributet tatimore në vend. Prandaj investimet në këtë sektor duhet të rriten dhe të mirëmenaxhohen, sepse do të rrisin produktivitetin e fuqisë punëtore dhe do të ndikojnë në rritjen ekonomike të Kosovës.

Përshkrimi i variablave dhe modeli ekonometrik

Ky punim ka të bëjë me shpenzimet publike në arsim si një nga faktorët më të rëndësishëm të performancës së sektorit publik dhe

rritjes ekonomike. Për të vlerësuar efektin e këtij faktori në rritjen ekonomike është përcaktuar ekuacioni i mëposhtëm (1). Ky funksion është bazuar në modelet endogjene të rritjes të hartuar nga Barro R., 1990; Barro & Sala-i-Martin, 1990 dhe Devarajan.

$$BPV = f(Shpnz\acute{c}e, Shpnz\grave{c}s, Shpnzshnd, Tattb, Exp, Shpnzars) \dots \dots \dots (1)$$

Variabli i varur është shënuar me BPV, që përkufizohet si **bruto prodhimi vendor** dhe është përdorur nga autorët për të vlerësuar rritjen ekonomike (Hamzah, 2011; Tang, 1998; Sinha, 1998; Albatel, 2000; Muhlis & Hakan, 2003; Ram, 1986). Ndërsa variablat e pavarura janë: shpenzimet për shëndetësi (*Shpnzshnd*), shpenzimet për arsim (*shpnzars*), shpenzimet për çështje sociale (*Shpnzçs*), shpenzimet për çështje ekonomike (*Shpnzçe*), niveli i investimeve të huaja direkte (*IHD*) dhe eksportet (*Exp*). Të gjitha variablat e pavarura në ekuacionet e mësipërm janë variabla ekzogjene dhe pritet që të kenë efekt pozitiv në rritjen ekonomike.

Ndër të tjera, në këtë punim për të vlerësuar koeficientet e variablave në këtë ekuacion përdorim metodën e katrorëve të vegjël (OLS). Të gjitha parametrat e variablave të pavarur në këto regresione karakterizohen si investime dhe sipas supozimit logjik priten që të kenë shenjë pozitive. Bazuar në literaturën dhe objektivat e këtij studimi, ekuacioni i mësipërm paraqitet sipas këtij modeli:

$$\Delta Y = \lambda_0 + \lambda_1 Shpnz\acute{c}e + \lambda_2 Shpnz\grave{c}s + \lambda_3 Shpnzshnd + \lambda_4 Tax + \lambda_5 Exp + \lambda_6 Shpnzars + \epsilon \dots$$

Megjithatë, në ekuacionet konstanta është e shënuar me **λ_0** , ndërsa parametrat e variablave ose koeficientet e pavarur të regresit janë të shënuara me **λ_1** n, kurse me **ϵ_{it}** shënohet termi i gabimit. Vlerësimet e marra nga këta parametra do të tregojnë ndikimin e shpenzimeve në arsim dhe përbërësve të tyre në rritjen ekonomik.

Modeli

Rezultatet e testimit të stacionaritetit (Unit Root tests) për modelin e katërt

Edhe në modelin e katërt është vërtetuar nëse seritë janë stacionare dhe gjithashtu për këtë qëllim është kryer testi statistikor Augmented Dickey-Fuller (ADF), rezultatet e të cilit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. Rezultatet e analizës së ADF-së për modelin e katërt

Variables	Level	P-value	Second difference	P-value
BPV	-3.756	0.024	-3.756	0.007
Shpnzce	-3.466	0.041	-3.466	0.017
Tax	-4.771	0.0080	-4.771	0.005
Shpnzshnd	-6.38	0.000	-6.381	0.000
Shpnzçs	-3.526	0.061	-3.388	-0.015
Shpnzars	-4.974	0.004	-4.974	0.001
Exp	-3.751	0.028	-3.751	0.013

Burimi: Përlllogaritja nga vetë autori (Eviews 7).

Shënim: Të gjitha vlerat kritike janë në nivelin 5% të rëndësisë bazuar në vlerat kritike MacKinnon (5%=-2.945).

Nga rezultatet e tabelës shohim se seritë nuk janë stacionare sepse vlerat statistikore *P – value* janë më të larta se probabiliteti prej 0.05, që do të thotë se hipoteza H_0 qëndron. Prandaj për këtë arsye të gjitha seritë janë diferencuar dhe janë kthyer në stacionare të rendit të dytë.

Specifikimi i modelit:

Në tabelën më poshtë jepen rezultatet nga përpunimi i të dhënave nga modeli i mësipërm dhe marrin formën:

Tabela 3. Koeficientet e regresionit nga modeli

Variables	Model A4 Coefficient	Model B4 Coefficient	Model C4 Coefficient	Model D4 Coefficient	Model E4 Coefficient
Constant	1.57E+09	1.58E+09	1.53E+09	1.54E+09	1.26E+09
	7.157966	8.432932	8.056370	8.179880	8.4977
Exp	1.198259	1.166356	1.027563	1.023346	1.751**
	2.095393	2.492984	2.177281	2.187734	5.0182
Shpnzçe	0.123062	-	-	-	-
	0.118693	-	-	-	-
Shpnzçs	4.299761	4.627652	2.676087	-	-
	0.971709	1.444325	0.917617	-	-
Shpnzshnd	15.68194	15.92436	6.766802	11.06267	10.313*
	1.558272	1.743424	1.164455	3.241921	2.645
Shpnzars	2.596689	1.165154	-	-	-
	0.111615	0.798969	-	-	-
Tax	3.375705	3.449878	2.161917	2.150182	-
	2.016867	2.397069	2.041769	2.048896	-
R2	0.987	0.987	0.984	0.983	0.975
F-statistic	79.35	110.83	128.33	173.89	196.04
Durbin-Watson	1.93	1.874	1.250	1.492	2.167

Shënim: shifrat në italic tregojnë vlerën e t-statistikës. *p-value < 0.05, **p-value < 0.01, ***p < 0.001.

Pra, bazuar te tabela e mësipërme, ekuacionet matematikore mund të shkruhen si më poshtë:

<i>Modeli</i>	<i>A4</i>	-
$\widehat{BPV} = 1.57E+09 + 0.12 * Shpnzçe + 4.62 * Shpnzçs + 3.44 * Tax + 15.92 Shpnzshnd + 2.59 Shpnzars + 1.16 * Exp$		

<i>Modeli</i>	<i>B4</i>	-
$\widehat{BPV} = 1.58E+09 + 4.62 * Shpnzçs + 3.44 * Tax + 15.92 Shpnzshnd + 1.65 Shpnzars + 1.16 * Exp$		

<i>Modeli</i>	<i>C4</i>	-
$\widehat{BPV} = 1.53E+09 + 2.67 * Shpnzçs + 2.161 * Tax + 6.76 * Shpnzshnd + 1.02 * Exp$		

<i>Modeli</i>	<i>D4</i>	-
$\widehat{BPV} = 1.54E + 09 + 2.15 * Tax + 11.06 * Shpnzshnd + 1.02 * Exp$		

<i>Modeli</i>	<i>E4</i>	-
$\widehat{BPV} = 1.26E + 09 + 10.31 * Shpnzshnd + 1.75 * Exp.$		

Analiza e shpenzimeve sipas kriterit funksional është shumë e rëndësishme, pasi që në këtë mënyrë mund të shpjegohet se cilët sektorë të ekonomisë ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Nga vlerësimi i Modelit A4 janë eliminuar shpenzimet për çështje ekonomike, edhe pse teorikisht janë një nga shpenzimet më të rëndësishme të rritjes ekonomike sidomos për vendet në tranzicion. Një nga shpjegimet se pse ky variabël shumë i rëndësishëm për nga funksioni ka rezultuar statistikisht i parëndësishëm, mund të jetë niveli i ulët i mjeteve që alokohen për çështje të tjera ekonomike, siç janë: shpenzimet për sektorin e bujqësisë, për sektorin e minierave dhe energjinë elektrike. Siç dihet, mbi 70% të shpenzimeve për çështje ekonomike janë alokuar për ndërtimin e autostradave të reja dhe shumë pak mjete janë alokuar nga këto shpenzime për sektorët e tjerë që janë shumë të rëndësishëm për rritjen ekonomike. P. sh. shumë pak fonde janë alokuar për energji elektrike, ku, sipas Bankës Botërore, furnizimi i

pamjaftueshëm me energji elektrike u kushton bizneseve kosovare rreth 260 milion euro në vit ose 5 për qind të BPV-së çdo vit.

Nga vlerësimi i Modelit B4 dhe C4 janë eliminuar shpenzimet në arsim, edhe pse nga aspekti teorik janë një nga shpenzimet më të rëndësishme të rritjes ekonomike sidomos për vendet e zhvilluara, sepse reflektojnë kryesisht në stimulimin e sektorit privat drejt rritjes së prodhimit dhe eksportit. Historia e zhvillimit ekonomik të vendeve të zhvilluara ka vërtetuar se investimet në sektorin e arsimit janë faktor përcaktues në zhvillimin ekonomik ndërmjet rritjes së produktivitetit të punës dhe të zhvillimit teknologjik, mirëpo në Kosovë shpenzimet publike në këtë sektor kanë rezultuar pozitiv, që janë statistikisht të parëndësishme.

Shpenzimet në arsim dhe shpenzimet publike për çështje sociale në modelin B4 dhe C4 rezultuan të parëndësishëm dhe janë hequr nga modelet bazuar nga probabiliteti që është më i vogël se 0.05. Efekti i shpenzimeve të sektorit të arsimit në rritjen ekonomike, për dallim nga evidencat teorike dhe empirike është pozitiv, mirëpo statistikisht joignifikant.

Arsyet për këtë përfundim ndoshta lidhen edhe me specifikat e zhvillimit ekonomik dhe politikën e vendit. Nga evidencat empirike ka shumë shpjegime të mundshme pse mund të ndodhë që shpenzimet në këtë sektor janë statistikisht josignifikante. Së pari, njëra nga shpjegimet mund të jetë sidomos reformat e shpeshta që po ndërmerren në këtë sektor nuk po japin rezultate të duhura për ndikimin e këtij sektori në rritjen ekonomike. Së dyti: këto rezultate mund të jenë për shkak të efektit “Crowding-out”, aktivitetëve “rent seeking” dhe sidomos faktori tjetër që ka ndikuar shumë është edhe “Brain drain”. Së treti, pavarësisht rritjes së shpenzimeve publike në këtë sektor shtimi i nivelit të papunësisë është vazhdimisht në rritje, që nënkupton ineficiencë të shpenzimeve publike në këtë sektor. Së katërti, një tjetër arsye e mundshme për josignifikancën e këtij parametri është se pjesa më e madhe e shpenzimeve publike në këtë sektor alokohet në paga dhe mëdijtje e shumë pak nga këto shpenzime alokohen për përmirësimin e cilësisë në shërbime dhe gjithashtu procesi i vendimmarrjes për investime kapitale është shumë i dobët. Së pesti, është edhe harmonizimi i politikave, pra orientimi i politikave të këtij sektori të fokusohet drejt kërkesave të sektorit privat. Së gjashti, ky sektor është ballafaquar gjatë viteve edhe me llogaridhënie të paqartë ndërmjet qeverisë qendrore dhe komunave.

Nga formulimi i mësipërm i ekuacioneve arrijmë në përfundim se Modeli E4 është përzgjedhur si më i përshtatshëm në analizën e regresionit nga specifikimi i modelit të katërt dhe tregon se shpenzimet në shëndetësi janë të lidhura pozitivisht dhe përcaktojnë ndryshim në ndryshimin e BPV-së. Vlerat e koeficientit pranë këtij koeficienti tregojnë se rritja e shpenzimeve publike në shëndetësi do të sjellë rritje të BPV-së, duke mbajtur konstant variablin tjetër shpjegues (Exp) në këtë model. Meqenëse vlera statistikore p-value (0.0245) për shpenzimet publike në shëndetësi është më e vogël se 0.05, që është e rëndësishme në nivelin 5%, nënkupton se refuzohet hipoteza bazë dhe pranohet hipoteza alternative pasi që është sinjifikante me nivel të besueshmërisë prej 95%. Sipas këtyre rezultateve shpenzimet publike në sektorin e shëndetësisë duhet të inkurajohen për shkak të ndikimit të tyre pozitiv në rritjen ekonomike, edhe pse koeficienti pranë këtij variabli është i vogël për nga ndikimi, nënkupton që koeficienti pranë këtij variabli mund të korrigjohet me politika dhe veprime vendimtare. Gjithashtu, ky sektor është i rëndësishëm, sepse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëqenien e popullsisë, që nënkupton se popullata mund të ketë një ndikim të menjëhershëm nga zhvillim i këtij sektori, kështu që sipas rezultateve, ky sektor ka potencial të madh në nxitjen e rritjes ekonomike.

Në modelin E4 ndikimi i eksportit në BPV është treguar të jetë pozitiv dhe statistikisht sinjifikant. Koeficienti i përcaktimit në këtë model është relativisht i lartë (97%), që tregon se ndryshimi në BPV shpjegohet nga ndryshimi i shpenzimeve publike në shëndetësi dhe nga niveli i eksportit. Me fjalë të tjera, variancat e variablave të pavarura shpjegojnë me sukses variancën e variablit të varur (BPV). Gjithashtu, rezultatet empirike të kësaj analize janë në përputhje të plotë me konkluzionet teorike. Për më tepër, kjo tregon se politikëbërësit në Kosovë duhet të përqendrohen në shpenzimet publike në shëndetësi si faktor shumë i rëndësishëm i rritjes ekonomike.

Pavarësisht rezultateve, edhe në këto ekuacione regresi, është e rëndësishme që të bëhen analizat e testeve për mbetjen e modelit. Siç e kemi përmendur në metodologjinë e këtij studimi, varianca e termit të gabimit është konstante, me heteroskedasticitet është provuar me testin Breusch-Pagan-Godfrey dhe vlerat e fituara nga ky test janë më të larta se probabiliteti prej 5%, atëherë nuk mund ta refuzojmë hipotezën bazë H_0 . Pra, tabela 4 tregon se modeli E4 nuk vuan nga heteroskedasticiteti.


Tabela 4. Rezultatet e testit të heteroskedasticitetit për modelin E4

Test performed	Model E4
Breusch-Pagan-Godfrey	7.874 <i>0.0658</i>
Ho: Data is homoscedasticity H1: Data is heteroscedasticity	H0 accepted
Shënim: Shifrat e theksuara tregojnë $n \cdot R^2$ të vrojtuar, ndërsa vlerat në italik paraqesin vlerën e p -së	

Gjithashtu, mbetjet e termit të gabimit nga modeli i përzgjedhur regresi E4 kanë shpërndarje normale, pra nga tabela vërehet se vlerat statistikore $P - value$ janë më të larta se probabiliteti prej 0.05, që do të thotë hipoteza zero H_0 nuk mund të hidhet poshtë.

Rezultatet e testeve mbi normalitetin për modelin

Shpërndarja normale e mbetjeve për modelin E4



Seria e mbetjeve	
Periudha 2003-2015	
Vrojtime 14	
Mesatarja	1.59e-07
Mediana	14262598
Maksimumi	3.25e+08
Minimumi	-2.38e+08
Devijimi standard	1.58e+08

Tabela 5. Rezultati i shpërndarjes normale nga ekuacioni i modelit E4

Test performed	Model E4
Jarque-Bera	0.112 <i>0.945</i>
Ho: Data comes from a normal distribution H1: Data does not come from a normal distribution	H0 accepted
Shënim: Vlerat në italik paraqesin vlerën e p -së.	

Po ashtu në tabelë vërehet se modeli E4 nuk vuan nga autokorrelacioni. Prandaj nga rezultatet e testit të Breusch-Godfrey arrijmë në përfundim se pranojmë hipotezën bazë H_0 lidhur me autokorrelacionin.

Tabela 6. Testimi për autokorrelacionin dhe korrelacionin e pjesshëm për modelin e E4

Test performed	Model E4
Breusch-Godfrey Serik	1.606
Correlation LM	0.901
Ho: There is no serial correlation	H0 accepted
H1: There is serial correlation	

Shënim: Shifrat e theksuara tregojnë $n \cdot R^2$ të vrojtuar, ndërsa vlerat në italic paraqesin vlerën e ρ -së.

Përfundim

Qëllimi i këtij kapitulli është të analizohet ndikimi që kanë shpenzimet publike në arsim në rritjen ekonomike. Në këtë punim është përdorur modeli OLS për ndikimin e shpenzimeve publike në rritjen ekonomike. Vlerësimet janë bërë për periudhën 2002-2015. Fillimisht seritë kohore janë testuar nëse ishin stacionare. Testet statistikore të stacionaritetit rezultuan se seritë nuk ishin stacionare, pastaj ato u integruan në seri stacionare të rendit të parë dhe të rendit të dytë. Modelet e regresionit kanë përmbushur të gjitha testet e diagnostikimit. Në këto kushte, nga analiza e përgjithshme e modelit arrihet në përfundim se modeli i ndërtuar është i rëndësishëm nga pikëpamja statistikore dhe mund të marrim vlerësime të qëndrueshme në lidhje me ndikimin e shpenzimeve publike në arsim. Rezultatet e arritura tregojnë se variablat e përdorur në vlerësim, shpenzimet publike në shëndetësi (*Shpnzshnd*) dhe eksportet (*Exp*) kanë efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike, ndërsa variablat tjera, të ardhurat totale buxhetore (Tax), shpenzimet në arsim (*Shpnza*), shpenzimet publike për çështje ekonomike (*Shpnzçe*) dhe shpenzimet publike për çështje sociale (*Shpnzçs*) janë gjetur të jenë pozitive, por statistikisht të parëndësishme.

Megjithatë, përbërja e buxhetit dhe efikasiteti i shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës duhen përmirësuar me kalimin e kohës. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e rezultateve dhe do të krijojë hapësirë për investime më të larta dhe më produktive në sektorët prioritarë të ekonomisë siç janë arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura, të cilat janë kritike për të rritur produktivitetin dhe për të siguruar rritje më të shpejtë ekonomike. Për këtë qëllim duhet rritur investimet, e sidomos ato në sektorin e shëndetësisë, se edhe sipas rezultateve ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike dhe, në anën tjetër, duhet të rriten shpenzimet edhe në sektorin e arsimit, mirëpo vetëm në përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e shpenzimeve kapitale dhe jo vetëm në rritjen e pagave. Gjithashtu, shpenzimeve në këtë sektor duhet t'u kushtohet rëndësi efiçiente të përdorimit të burimeve, sepse nga rezultatet arritëm në përfundim që këto shpenzime janë pozitive, por si parametër rezultuan josingifikante. Megjithatë, shpenzimet kapitale në këto dy sektorë prioritarë të ekonomisë duhet rritur se, sipas literaturës, kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa këto shpenzime në vendin tonë krahasuar me vendet e rajonit janë nën mesataren e vendeve të rajonit.

Megjithatë, efekti i shpenzimeve të përgjithshme publike dhe disa nga përbërësit e saj në Kosovë kanë pasur ndikim të rëndësishëm në arritjen e objektivave ekonomike. Kjo shpjegohet që hartuesit e politikave ekonomike në Kosovë kanë orientuar shpenzimet publike në sektorë produktivë të ekonomisë. Ky përfundim vjen për shkak se vendi ynë është një vend në tranzicion, ku shpenzimet publike janë mjaft të rëndësishme në ecurinë e reformave ekonomike dhe në përmirësimin e infrastrukturës si bazë e rëndësishme për zhvillimin e sektorit privat. Megjithatë, sipas studimeve empirike dhe fakteve praktike, roli i shpenzimeve publike në ekonominë në tranzicion konsiderohen shumë thelbësore në përshpejtimin e tranzicionit.

THE IMPACT OF PUBLIC EXPENDITURE ON EDUCATION IN ECONOMIC GROWTH

Lekë PULA

Faculty of Economics, University of Prishtina “Hasan Prishtina”
leke.pula@uni-pr.edu

Abstract

In this paper we will address the impact of public spending on education on economic growth in Kosovo. Time series data include the period from 2002 to 2016. The methodology used in this paper for the assessment and comparability of the impact of public spending on education and economic growth, will be the multiple linear regression (OLS). The evaluation of this OLS regression model will only be performed after we apply the Augmented Dickey-Fuller (ADF) test to estimate time series data, if stationary. Then, after the model's assessment, statistical tests have been carried out to ensure that this study will yield the best results and conclusions as to the impact of public spending on economic growth. The model has met all the assumptions of statistical tests, such as: The error terms have normal distribution (*the Jarque-Bera test*), there is no autocorrelation between variables (*the Breusch-Godfrey test*), error variants are constant, thus known as the principle of homoschedasticity (*the Breusch-Pagan-Godfrey test*).

The data on the domestic GDP as a dependent variable are obtained from the Central Bank database, the Ministry of Finance and the Kosovo Agency of Statistics. Whereas public expenditures on education (*Shpnz A*), private investments (*INV*), exports (*EXP*) and total budget revenue (*TRtax*) are assumed as exigent variables. After analyzing the data, we found that public spending on education has a negative and completely significant impact on economic growth. Exports also have a positive impact, while overall budget revenues have a positive impact on economic growth, but are not statistically significant.

Keywords: GDP, public spending, economic growth, education.

Bibliography

1. Afonso, A., & Furceri, D. (2010). Government size, composition, volatility and economic growth. *European Journal of Political Economy*, 517-532.
2. Afxentiou P.C., A. (1998). "Modeling the Relationship between Output and Government Expenditure in Canada". *Keio Economic Studies*, 17-43.
3. Agresti, A., & Finlay, B. (2007). *Statistical Methods for social Sciences*. Prentice Hall.
4. Ahmed, H., & Miller, S. (2000). Croëding-out and Crowding-in effects of the components of government
5. in the Gulf Co-operation Council Countries. *Applied Economics*, 1187-1195.
6. Al-Sarareh, S. I. (2014). The Relationship between Unemployment Rate in Jordan ëith Rates of Foreign Labor Force, Government Expenditure, and Economic Growth. *International Journal of Business and Social Science*.
7. AmirKhalkhali, S., & Dar, A. A. (2001). Government size, factor accumulation, and econimc growth: evidenca from OECD countries. *Journal of policy Modeling*, 679-692.
8. Annicchiaricoa, B., Pellonib, A., & Rossic, L. (2011). *Endogenous growth, monetary shocks and nominal rigidities*. Available online.
9. Engen, E. M., & Skinner, J. (1992). Fiscal Policy and Economic Growth. *National Bureau of Economic Research* (No. 4223).
10. Fan, S., & Chan-Kang, C. (2004). Public expenditure, growth, and poverty reduction in rural Uganda. Development Strategy and Governance Division Discussion. *Food Policy* 29.4, 431-444.
11. Fan, S., Hazell, P., & Thorat, S. (2000). Linkages Between Government Spending, Growth and Poverty in Rural India. *American journal of agricultural economics*, 82(4), 1038-1051.
12. Florentina Xhelili Krasniqi, Kontributi i disa nobelistëve në zhvillimin e shkencës ekonomike, IFK, 2018.
13. Folste, S., & Henrekson, M. (2001). Growth effects of Government Expenditure and Taxation in Rich Countries. *Eropean Economic Revieë*, 1501-1520.
14. Forsyth, P. (1992). A perspective on microeconomic reform. *Microeconomic Reform in Australia, Allen\& Unëin, Sydnej*, 3-23.
15. Galbraith, J. K. (1987). *Historia e ekonomisë*. Boston Instituti i Dialogut & Komunikimit.
16. Gaurav, D. (2011). Has India's Economic Growth Become More Pro-Poor in the wake of Economic Reforms. *World Bank Economic Review Volume 25, Issue 2 Published*;, 157 - 189.

17. Gemmell, N., Kneller, R., & Sanz., I. (2013). Fiscal decentralization and economic growth: spending versus revenue decentralization. *Economic Inquiry*, 1915-1931.
18. Gemmell, N., Kneller, R., Sanz, & Ismael. (1999). Fiscal Policy Impacts on Growth in the OECD. *Journal of Public Economics* 74, , 171-190.
19. Ghartey, E. E. (2010). Cointegration and Causal Relationship betëeen Taxes and Spending for Kenya, Nigeria and South Africa. *International Economic Journal*, 267-282.
20. Ghosh, S., & Gregoriou, A. (2008). The Composition of Government Spending and Growth: Is Current or Capital Spending Better ? *Oxford Economic Papers* 60, 484-516.
21. Ghosh, S., & Gregoriou, A. (2008). The composition of government spending and growth: is current or capital spending better? *Oxford Economic Papers* , 484-516.
22. Goffman, I. (1968). Empirical Testing of Wagner's Law- Technical Note. *Public Finance (Finances Publiques)*, 359-366.
23. Gomanee, K. (2003). Aid, Pro-poor Government Spending and Welfare.
24. Gray, C., Lane, T., & Varoudakis, A. (2007). Fiscal Policy and Growth in ECA: Lessons for Eastern Europe and Central Asia. *Washington DC: The World Bank Publications*.
25. Gregory, M., & Taylor, M. (2010). *Ekonomiksi*. Thomson.
26. Grier, K., & Tullock, G. (1987). An Empirical Analysis of Cross National Economic Growth 1950-1980,. *Working Paper, California State Institute of Technology*.
27. Grier, K., & Tullock, G. (1987). An Empirical Analysis of Cross-national Economic Growth: 1951-1980. *Journal of Monetary Economics* 24, 259-276.
28. Gujarati, N. D. (2003). *Basic Econometric*. McGraw-Hill Companies.
29. Gujarati, N. D. (2003). *Basic Econometric*. McGraw-Hill Companies.
30. Gupta, S. (1967). Public Expenditure and Economic Growth: A Time-series Analysis. *Public Finance (Finances Publiques)*, 423-454.
31. Gylfason, T. (2001). Natural resources, education, and economic development. *European economic review*, 847-859.
32. Hall, R. E., & Jones, C. (1999). Ëhy Do Some Countries Produce So Much more Output per Worker than Others ? *Quarterly Journal of Economics*, vol. 114 n, 83-116.
33. Hamilton, L. (1992). *Regression with graphics*. Belmont.
34. Hamzah, K. S. (2011). *The Association betëeen Government Expenditure and Economic Growth in Malaysia*. Malaysia.
35. Hamzah, K. S. (2011). *The Association betëeen Government Expenditure and Economic Growth in Malaysia*.

36. Hanushek, E. A., Schөөrdt, G., Woessman, L., & Zhang, L. (2017). General education, vocational education,
37. Lucas, R. (1988). On mechanics of Economic Development. *Journal of Monetary Economics*, 3-42.
38. Lynch, R. G. (2004). Rethinking growth strategies: How state and local taxes and services affect economic development. In *Economic Policy Institute*.
39. Magazzino, C. (2012). Wagner versus Keynes: Public spending and national income in Italy. *Journal of Policy Modeling*, 890-905.
40. Magazzino, C. (2012). Wagner versus Keynes: Public spending and national income in Italy. *Journal of Policy Modeling*, 890-905.
41. Maingi, J. N. (2011). The impact of Government Expenditure on Economic Growth in Kenya: 1963-2008. *Department of Economics, Kenyatta University*.
42. Maingini, J. N. (2011). The Impact of Government Expenditure on Economic Growth In Kenya: 1963-2008. *Department of Economics, Kenyatta University*.
43. Maku, O. E. (2009). Does government spending spur economic growth in Nigeria.
44. nd Economic Growth: The Turkish Case. *Journal of Economic and Social Research* 6, 53-72.
45. Musgrave, R. (1969). heories of fiscal federalism. *Public Finance (Finances Publiques)*, 521-36.
46. the theory of economic growth. *The Quartely Journal of Economics*, 65-94.
47. Stiglitz, J. E. (1999). *Economics of the Public Sector*. New York/London: W.W. Norton & Company.
48. Stiglitz, J. E. (1999). *Economics of the Public Sector*. New York/London: W.W. Norton & Company.
49. Swan, T. W. (1956). Economic Growth and Capital Accumulation. *Economic Record* (32.2), 334-361.
50. Tanzi, V. (2009). The Economic Role of the State Before and After the Current Crises. in *presentazione in sessione planaria del 65th Congress of the International Institute of Public Finance, Citta del Copa(Sud Africa)*.
51. Tanzi, V., & Schuknecht, L. (2000). *Public Spending in the 20th Century*. Cambridge University press.
52. Tanzi, V., & Zee, H. (1997). Fiscal policy and Long-run Groөth. *IMF Staff paper*, 179-209.
53. Tanzi, V., & Zee, H. (1997). T Fiscal policy and long-run groөth. *IMF Staff Papers* . *IMF Staff Papers* 44, 179–209.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË KOSOVË DHE POTENCIALET TURISTIKE TË BJESHKËVE TË NEMUNA

Petrit HASANAJ¹
Simona MARTINOSKA²

Përmbledhje

Turizmi është aktivitet ekonomik i cili është i orientuar në shfrytëzimin e potencialeve turistike. Me vështirësi që ka kaluar në faza të ndryshme në Republikën e Kosovës, zhvillimi i kësaj veprimtarie ka arritur të merr hov krahas zhvillimit ekonomik të vendit. Edhe pse Republika e Kosovës ka potenciale turistike të mjaftueshme, ende këtë veprimtari nuk trajtohet në vendin e duhur për zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillimi i tij do të ndikojë në ngritjen e brutoproduktit vendor dhe në këtë mënyrë do të radhitet në vendin e merituar në strategjinë ekonomike zhvillimore të vendit. Turizmi në Kosovë nuk është më i zhvilluari, por është më pak i identifikuar dhe më pak i zhvilluar dhe ka nevojë të madhe për të ofruar një marketing nacional, shtetëror dhe të jetë i organizuar nga një komision shtetëror në mënyrë që të zhvillohet dhe të identifikohet si turizëm ideal për të vizituar dhe për të tërhequr vizitorë vendorë dhe të huaj. Turizmi si një orientim strategjik i zhvillimit të Kosovës kërkon një politikë të përshtatshme në fushën e arsimit dhe kulturës. Zhvillimi i një sistemi të kualifikimeve profesionale në turizëm është një nga nevojat më të domosdoshme për zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Aftësimi profesional është qenësish i lidhur me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ngritjen e nivelit të ofertës turistike të vendit.

Fjalët çelës: Turizmi, potencialistik, strategji turizmi, destinacion, arsimi.

Hyrje

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara, por edhe në disa shtete në tranzicion, është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshin një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa në realizimin e tij futet

¹ Kolegji ILIRIA, Prishtinë, petrit.hasanaj@uiliria.org

² University "St. Climent Ohridski" – Bitola, Ohrid, simonabojadzi@yahoo.com

thellë jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor të jetës.

Edhe në Kosovë turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Industria Turistike e Kosovës ka realizuar 8-10% të produktit shoqëror vendor, varësisht nga fakti se për cilin vit është fjala dhe a janë marrë parasysh të gjithë faktorët e drejtpërdrejtë (industria hoteliere, gastronomia) ose faktorët indirekt (bujqësia, ndërtimtaria, etj.).

Natyra me format e saj të larmishme dhe trashëgimia kulturore me mozaikun e saj janë gjeneratorët e turizmit. Nëpërmjet eksperiencës dhe kënaqësisë që buron prej kontaktit me natyrën, artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore (materiale dhe shpirtërore) të vendeve pritëse, turizmi shndërrohet në një mekanizëm gjenerues të natyrshëm të shkëmbimit të kulturave dhe të marrëdhënieve midis njerëzve të të gjitha moshave, besimeve dhe racave në mënyrë shumë më tërheqëse se format mekanike të tregtisë globale dhe ato të zhvillimit ekonomik. Tregjet turistike po bëhen gjithnjë e më shumë konkurruese me aplikimin e llojeve dhe formave të shumëllojshme të lëvizjes turistike. Tashmë format tradicionale të saj po zëvendësohen me forma të reja, duke i dhënë një shtrirje mbarëbotërore dhe heqjen e monopolit turistik të vendeve të zhvilluara ekonomikisht.

Potencialet turistike në trevat e Kosovës

Resursi strategjik i turizmit kosovar duhet të mbetet hapësira me shumë vlerë, deri tani e ruajtur, që në afat të gjatë gjithnjë e më shumë do të ketë rëndësi.

Vlera turistike kanë pothuaj të gjitha trevat e Kosovës në format dhe dimensionet, varësisht nga resurset dhe shkalla e zhvillimit. Fizionomia e elementeve tërheqëse të Kosovës udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimet e transitit turistik, qytetet e mëdha, banjat, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat.

Duke u nisur nga trendet aktuale dhe trendet e parashikuara të kërkesës ndërkombëtare turistike, mundësi reale në plasimin e ofertës turistike në tregjet ndërkombëtare mund të priten në qendrat rajonale të Kosovës në malet e larta, në drejtimet e transitit ndërkombëtar rrugor, në komplekset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore me vlerë shumë të madhe dhe në vendet më të rëndësishme të gjuetisë. Kërkesa vendore turistike edhe më tej do të realizohet në qytetet e mëdha të

Kosovës dhe në banja, por pritjet edhe pjesëmarrja në rritje e kërkesave për turizmin malor, fshatar dhe për turizëm në rajonet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Në etapën e parë të zhvillimit të turizmit theksi do të vihet në koncentrimin e ofertës së vendosur mirë për pjesën kryesore të kërkesës turistike, ashtu që pjesa më e madhe e kapaciteteve të gjendet shumë afër atyre që dëshirojnë të gjenden në natyrë, të zhvillojnë alpinizëm, të merren me gjueti dhe peshkim, të kënaqen me vlerat kulturore si në sezonin veror, ashtu dhe atë dimëror.

Tri nivelet e ndryshme që krijojnë hierarkinë e ofertës turistike të Kosovës janë:³

1. Niveli i parë, nivelet kulminante turistike të Kosovës, që përfshijnë rrethin më të gjerë të kërkesës lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, siç janë:

a. Peizazhet masive malore të Bjeshkëve të Nemuna, që kanë kapacitet të madh pranimit, natyra e ruajtur, sidomos flora pyjore dhe fauna;

b. Lartësitë malore që arrijnë mbi 2600 m me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror, e sidomos atij dimëror;

c. Rrjeti i qyteteve dhe vendbanimeve me ofertën e organizuar të serviseve shërbyese që lidhen me korridoret kryesore të komunikacionit (qendrat kryesore: Prishtina, Prizreni dhe Peja).

2. Niveli i dytë, oferta turistike kosovare me rëndësi dhe një rreth i ngusht ndërkombëtar (Kosova, rajonet kufitare të Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë), siç janë:

a. Masivet malore të Kopaonikut dhe Mokra Gorës si hapësira jashtëzakonisht cilësore për turizëm gjatë gjithë vitit (kanë rëndësi sekondare kryesisht për shkak të faktit se në të njëjtin rajon gjenden Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri);

b. Qendrat termale si Ilixha (Banja e Pejës), Kllokoti (afër Gjilanit) dhe Banjska (afër Mitrovicës);

c. Sistemi i atraksioneve natyrore me bukuri të veçantë si Kanioni dhe Ujëvarat e Mirushës, kanioni i Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Bigëzimi i Nerodimes, Shpella e Mermerit dhe e Radavcit etj.

³ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor "Strategjia e zhvillimit hapësinor, plani hapësinor dhe i mjedisit të Kosovës", 2014.

ç. Pasuria, shumëllojshmëria etnike dhe kulturore, por edhe tërësitë e ruajtura kulturore-historike dhe monumentet e veçanta, midis të cilëve ka të tilla që janë atraksione unike për një klientelë të caktuar.

Niveli i tretë është oferta turistike e ekskursioneve ditore dhe të fundjavës pranë qendrave urbane, në bazë të elementeve ekzistuese natyrore që ka si qëllim rekreacionin dhe pushimin e vazhdueshëm të banorëve. Përveç vendosjes së hierarkisë së niveleve të ofertës turistike është bërë edhe rajonizimi i hapësirës turistike të Kosovës në bazë të tërësisë teknologjike dhe të tregut të rajoneve të caktuara.

Produktet turistike

Turizmi rural

Siç e theksuam më lart, fshatrat janë një pasuri e madhe në trevat e Kosovës dhe një faktor tërheqës në rajon. Megjithatë është e rëndësishme përmirësimi, zgjerimi dhe zhvillimi i këtij produkti potencial. Disa pika të cilave duhet kushtuar rëndësi janë:

- Inkurajimi i fshatarave për të zhvilluar dhe ofruar produkte të veçanta të secilit fshat, duke u siguruar atyre një identitet më të qartë dhe për të ofruar një produkt turistik rural më të zgjeruar dhe më të pasur;
- Identifikimi i segmenteve të ndryshme të tregut, p. Sh. i atyre që duan vetëm ta vizitojnë fshatin, të atyre që duan të drekojnë apo darkojnë në fshat e të atyre që duan të kalojnë dhe natën, si dhe ofrimi i paketave të ndryshme në ueb site në shqip, anglisht, por gjithashtu edhe në gjuhe të tjera.
- Vendosja e pikave të informacionit në secilin fshat;
- Listimi i akomodimit të mundshëm i restoranteve dhe i specialiteteve të tyre si dhe aktiviteteve të mundshme në guidat turistike;
- Vendosja e një sinjlistike të qartë dhe të një harte të atraksioneve lokale në qendër të fshatit;
- Krijimi i itinerareve rrethore dhe ofrimi i gatshëm i tyre të turistët, operatorët që të përfshihen në paketat e tyre;
- Ftesë turistëve, operatorëve dhe gazetarëve për të parë produktin turistik rural;

- Organizimi i trajnimeve me pronarë dhe punonjës të restorantëve të cilat duhet të njihen me kërkesat e shërbimit ndaj turistit;
- Inkurajimi i restoranteve për të përkthyer menutë të paktën në anglishtë, por edhe në gjuhë të tjera të mundshme;
- Inkurajimi i restoranteve për të ofruar dhe promovuar kuzhinën lokale të çdo fshati, duke u siguruar që ajo të jetë specifike për zonën dhe duke krijuar një dallim ndërmjet fshatrave;
- Për t'u siguruar që turistët do të shijojnë vizitën e tyre në këto fshatra të qëndrojnë më gjatë si dhe të shpenzojnë para duhet që të zhvillohen aktivitete të ndryshme, si p. sh. inkurajimi i vendasve për të zhvilluar kalërimin, shëtitjet me bicikleta, peshkimin, skitë, dhënien me qira të pajisjeve të ndryshme etj.;
- Organizimi dhe promovimi i një shumëllojshmërie aktiviteteve që mund të ndiqen në fshat, si p. sh. vizita në ferma, mbrëmje folklorike etj.;
- Të sigurohet respekti i orareve të hapjes së atraksioneve në mënyrë që turistët të kenë mundësi t'i vizitojnë pa pasur nevojën e dikujt për t'i hapur ato;
- Inkurajimi dhe organizimi i shitjeve të prodhimeve artizanale të produkteve artizanale.

Turizmi urban

Qytetet janë pjesa qendrore ku bëhet përqendrimi më i madh i turistëve gjatë qëndrimit të tyre, ku njëkohësisht ato edhe shpenzojnë shumicën e kohës. Përmirësimi, zgjerimi dhe zhvillimi i këtij produkti do të konsistonte në:⁴

- Identifikimin e segmenteve të tregut që duhet të tërhiqen për të vizituar qytetet e rajonit;
- Zbulimin e kërkesave të tregut për të përshtatur zhvillimin e produktit turistik;
- Promovimin e qyteteve, duke i përfshirë materialet informuese si: fletëpalosjet, reklamat nga palët e interesuara locale, përditësimin e tyre rregullisht;

⁴ Dr.F.Ukaj “Promocioni dhe segmentet bashkëkohore promociionale në turizëm”, Pejë, 2006.

- Rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse në fushën e turizmit;
- Inkurajimin, përmirësimin dhe krijimin e kategorive të ndryshme të cilësisë së akomodimit, duke rishikuar buxhetet;
- Sigurimin e shenjave të qarta në mënyrë që turistët të mund të gjejnë strehim dhe informacion për shërbimet që janë në dispozicion;
- Organizimin e trajnimeve me pronarët dhe menaxherët e njësive akomoduese dhe të restoranteve veçanërisht në nivelin e kërkuar të shërbimit për turistët;
- Organizimin e trajnimeve për personelin e shërbimit me trajnerë nga punonjësit e institucioneve përkatëse dhe
- Zhvillimin e kurseve "Trajnime për trajnerë" për të siguruar rritje kapacitetesh të vazhdueshme.

Turizmi historik dhe kulturor

Kosova njihet si për kulturën dhe historinë, ashtu dhe për natyrën e shkëlqyer dhe klimën e përshtatshme. Asetet kulturore dhe historike kanë ngjallur interesin e turistëve që ta vizitojnë këtë vend. Për përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e turizmit historik dhe kulturor duhet të merren parasysh rekomandimet e mëposhtme:⁵

- Promovimi i librave udhëzues turistikë të historisë dhe kulturës, vënia në dispozicion e informacionit në faqet e internetit për turistët, hapja e librarive dhe e agjencive të udhëtimit;
- Sigurimi i guidave turistike dhe sinjaleve turistike të cilat, të paktën të jenë të përkthyer në anglisht, por edhe në gjuhë të tjera;
- Promovimi aktiviteteve kulturore si udhëtime në itinerare turistike, shfaqje folklorike, muzikë dhe valle tradicionale, si dhe fletëpalosje dhe internet;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, historike dhe festivaleve në intervale të rregullta, sidomos të fokusuar në personalitete të shquara të rajonit;
- Promovimi i shërbimit të shoqëruesve të tureve turistike;

⁵ Punimi i prezantuar në Simpoziumin Ndërkombëtar "Prirodno i kulturnohistorijsko nasljedje i novi modeli upravljanja razvojem turizma", Vlasica, 14-15 Mars 2008, BiH.

- Organizimi i kurseve dhe trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të shoqëruesve të turistëve, mundësisht certifikimi i tyre;
- Targetimi i tregjeve speciale nëpërmjet shoqatave kulturore, historike, zanateve dhe artizanateve, folklorit, valleve, muzikës etj . dhe faqet speciale të internetit;
- Pas përmirësimit të produkteve turistike të ftohen operatorët turistikë dhe gazetarët për të parë mundësitë që disponon rajoni.

Turizmi natyror

Pavarësisht burimeve të mëdha natyrore, turizmi natyror nuk është i zhvilluar mirë. Përmirësimi i produktit, zgjerimi dhe zhvillimi për turizmin e natyrës përfshin rekomandimet në vijim si:⁶

- Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve që mund të gjenden në natyrë përmes broshurave dhe reklamave në internet;
- Inkurajimi i ofruesve të shërbimeve për të siguruar dhe promovuar aktivitetet që janë të disponueshme dhe produktet që ato ofrojnë (p.sh. udhëzues; marrja me qira e pajisjeve të tilla si bicikleta, ski, etj..., shëtitje me kalë, peshkim, gjueti, ngjitje në shkëmb dhe alpinizëm ...);
- Tregjet e veçanta përmes shoqatave të specializuara, ngjitje në shkëmb, peshkim, gjueti, zbulim i shpellave, etj. – të gjitha të përfshihen në informacionet e faqeve të internetit të specializuara, si dhe në informacionet e revistave;
- Organizimi dhe promovimi i ngjarjeve të tilla si garat sportive për të tërhequr vizitorët në zonat natyrore;
- Nxitja e operatorëve turistikë dhe gazetarëve për të parë natyrën si dhe mundësitë turistike që ofron ajo;
- Te marrë pjesë në panairët tregtare të specializuara që fokusohen në turizmin e aventurës, të natyrës dhe të sportit;
- Inkurajimi i banorëve të fshatrave për sigurimin e strehimit, mundësi kjo për promovimin e aktiviteteve në natyrën përreth tyre;

⁶ Punimi i prezantuar në Simpoziumin Ndërkombëtar “Prirodno i kulturnohistorijsko nasljedje i novi modeli upravljanja razvojem turizma”, Vlasica, 14-15 Mars 2008, BiH.

- Nxitja e tyre për të ofruar udhëzime (në shtëpi ose nga shoqëruesit lokalë të turistëve);
- Paraqitja e mundësive ekologjike me ndikim në shëndetin e mirë për të tërhequr specialistët e tregjeve vendase dhe të huaj.

Artizanati dhe specialitetet lokale

Prodhimet e shkëlqyera vendase dhe specialitet vendore nuk janë duke u promovuar ose duke u shitur mjaftueshëm në tregun turistik. Ka mundësi për ta zhvilluar këtë sektor. Për përmirësimin e produktit turistik, zgjerimin dhe zhvillimin e zejtarisë dhe specialiteteve lokale vlejnë rekomandimet në vazhdim si:

- Bashkëpunimi mes fondacioneve, shoqatave dhe organizatave për mbështetje teknike dhe financiare;
- Formimi i shoqatës së zejtarëve dhe shoqata e specialistëve lokalë që lidhet me pika të tjera të rajonit;
- Fuqizimi i markës së ushqimit të rajonit turistik si dhe zhvillimi i markës së produkteve artizanale që liodhen me rajonin;
- Organizimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të fermerëve;
- Trajnimi për standardet e BE-së në lidhje me ushqimin (verë e raki, reçel, lëng frutash etj.), trajnim për paketimin profesional të produkteve, etj.;
- Organizimi i panairove speciale dhe
- Pjesëmarrja në panairot turistike, panairot artizanale, panairot e gastronomisë etj. në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ku ofrohen produkte të rajoneve të ndryshme turistike.

Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna

Bjeshkët e Nemuna janë rajoni potencialisht më i rëndësishëm turistik i Kosovës. Hapësirat natyrore jashtëzakonisht cilësore, mundësitë e mëdha të pranimi të vizitorëve dhe monumentet kulturore-turistike krijojnë kushte të pakufizuara të zhvillimit turistik. Ndër vlerat më të rëndësishme duhet të theksojmë vetë masivin malor të Bjeshkëve të Nemuna dhe të Moknës (si degë e ndarë), fushat dhe kanionet e Drinit të Bardhë, të Bistricës së Pejës dhe të Deçanit, të

Erenikut dhe të Mirushës, të liqeneve malore, qytetet si Peja, Deçani dhe Gjakova, burimet termale dhe rrjeti i mirë rrugor.

Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna ka karakter policentrit dhe si i tillë edhe do të zhvillohet në të ardhmen. Peja është qendra me e shquar turistike e rajonit, por edhe e gjithë Kosovës dhe ajo edhe më tej do të mbajë këtë vend. Por këtu janë edhe qytetet e Deçanit dhe Gjakovës si dhe qendrat komunale të Rahovecit, të Klinës dhe Burimit (jashtë orientimeve të drejtpërdrejta të rrjedhave turistike, por në lidhje të ngushtë me hapësirat kryesore turistike të rajonit) Peja, Deçani dhe Gjakova do të jenë pikënisje të vajtjes deri të kapacitetet turistike malore, duke koncentruar të gjithë veprimtaritë përcjellëse të serviseve dhe të tjera gjëra.

Vetë rajoni i Bjeshkëve të Nemuna do të shfrytëzohet për organizimin e ofertës së tërësishme turistike me një afarizëm gjatë gjithë vitit (sidomos në sezonin e verës dhe të dimrit). Veç zhvillimit të të gjitha llojeve të sporteve dimërore në lartësi mbi 1000 m, ofrojnë mundësi ideale për turizmin veror malor (ecja, alpinizmi) si dhe zhvillim të turizmit shëndetësor. Sipas specifikave dhe karakteristikave natyrore, sidomos sipas veçorive të relievit, të shumëllojshmërisë biogjeografike të resurseve jashtëzakonisht të pasura ujore, të pasurisë së peizazheve dhe të motiveve të mjedisit, Bjeshkët e Nemuna pa dyshim janë masivi më unik malor në Ballkanin Perëndimor.

Bjeshkët e Nemuna kanë vlerë kulmore në:

- Pasurinë, shpeshtësinë, shumëllojshmërinë dhe veçantitë gjeomorfologjike të objekteve (malet, grykat, kanjonet, shpellat etj. me veçoritë e tyre atraktive),
- Kushtet morfologjike për zhvillimin e sporteve dimërore, të alpinizmit dhe të speloturizmit,
- Denivelimi dhe kapacitetet potenciale të shtigjeve të skijimit (65.396 m dhe po aq skiatorë në një orë), me hapësira dhe kushte të tjera për zhvillimin e turizmit sportiv-dimëror, etj.

Pozita gjeografike

Bjeshkët e Nemuna paraqesin një zonë malore në pjesën veriperëndimore të Kosovës, që kanë vazhdimësi në pjesën veriore të Shqipërisë dhe juglindjes së Malit të Zi. Bjeshket e Nemuna në pjesën periferike perëndimore të Kosovës zbresin gati vertikalisht në Rrafshin e Dukagjinit. Duke u ngritur vertikalisht nga Rrafshi i

Dukagjinit, masivi i madh i Bjeshkëve të Nemuna ofron pamje madhështore dhe paraqet potencial të madh turistik.

Bjeshket e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtim verijug me gjatësinë afro 50 km, ndërsa gjerësia e tyre nuk e kalon 26 kilometërshin. Bjeshkët e Nemuna prehen nga luginat e thella e tërthore, shpesh në formë kanjonike të Bistricës (Lumbardhit) të Pejës, Deçanit, Erenikut. Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna ndahet në tri pjesë:

Pjesën veriore e përbëjnë malet që ndodhen në veri dhe verilindje të Bistricës (Lumbardhit) të Pejës, e cila butësisht fillon në Malin e Thatë mbi Fushëgropën e Dukagjinit dhe Mognën. Prej Mognës ky brez malor shmanget në drejtim të jugperëndimit dhe shkon deri te Maja e Re (1812 m), e nga këtu zgjatet në perëndim dhe vazhdon përmes Majës Pogled (Shikimi, 2155 m) në Zhleb me Majën e Rusolisë (2381 m). Këtij grupi malesh më tutje në perëndim i takojnë edhe Shtedimi (2272 m), Lajla (2400 m), Mali i Shishkës me Majën e Hasanit (1871 m), Mali i Begut me Majën e Velekutit (2015) dhe Pokleni (1376).

Pjesën Qendrore e përbëjnë malet ndërmjet Bistricës (Lumbardhit) së Pejës dhe Deçanit si: Koprivniku me Kërshin e Çvërlanit (2460 m), Bjeshkët e Strellcit me Majën e Strellcit (2377 m), Qafa e Nekut dhe e Mylishevcit etj. Më në perëndim kësaj pjese i takojnë Malet e Lumbardhit me majën Guri i Kuq (2522 m), Malet e Nexhinatit (2341 m) dhe Staraci (Plaku, 2426 m).

Pjesa jugore shtrihet në jugperëndim të Bistricës së Deçanit dhe përbëhet nga Malet e Deçanit, Malet e Vokshit (1641), Bjeshka e Junikut me Majën Rrasa e Zogut (2296 m), Gjeravica (2656 m), Bogiçevica (2103 m), Maja e Ropës (2505 m), Maja e Qenit (2406 m) dhe Marjashi (2530 m).


Bjeshkët e Nemuna me lartësinë, strukturën e relievit, ndërtimin gjeologjik, elementet klimatike dhe botën organike na përkujtojnë alpet.

Tabela 1. Zonat dhe objektet e mbrojtura deri më tani në territorin e Bjeshkëve të Nemuna⁷

Zona/ objekti	Sipërfaqja në ha	Viti i vënies nën mbrojtje	Rëndësia e mbrojtjes	Kategoria
Maja e Ropsit	25	1955 nr.277/55	Rëndësi botanike me llojet e ruajtur të molikës, bredhit, pishës dhe ahut	Rezervat bimor Ia
Kozhnjari	161	1955 nr. 337/58	Rendësi faunistike, rezervat ku jeton dhia e egër (Rupicapra rupicapra L.)	Rezervat shtazor Ia
Malet e Prilepit	0.92	1963 nr. 05-6/9/63	Rëndësi botanike, përbërje e paster e panjës malore (Acer heildreichii)	Rezervat bimor Ia
Gubavci	38	1959	Rëndësi botanike, jeton lloji endemo-relikt boshtra (Forsythia europeae)	Rezervat bimor Ia
Gryka e Rugovës	4301	1988	Rëndësi gjologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike, botanike	Monument natyre III
Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit	89.94	1983, GZK 2/83	Rëndësi hidrologjike, pejsazhore, gjeologjike, speleologjike	Monument natyre III

Madhësia dhe kufinjtë e territorit të Bjeshkëve të Nemuna

Sipërfaqja e propozuar për Park Nacional të Bjeshkëve të Nemuna është 62.488 ha dhe paraqet 5.7% të sipërfaqës së Kosovës. Territori i Parkut Nacional shtrihet në 4 Komuna: Pejë me 32.500 ha, Deqan 22.000 ha, Istog 5065 ha dhe Gjakovë 2833 ha.

Fig. 1. Sipërfaqja në ha e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna sipas komunave⁸

⁷ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, "Plani hapësinor i Bjeshkëve të Nemura", Prishtinë, 2014.

⁸ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, "Plani Hapësinor i Bjeshkëve të Nemuna", Prishtinë 2014.

Popullsia dhe vendbanimet

Në territorin e Bjeshkëve të Nemuna të propozuara për Park Nacional ekzistojnë një numer i vendbanimev që përfshihen tërësisht ose pjesërisht në kuadër të parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna.

Popullsia e Parkun Nacional përbëhet nga banorët e përhershëm të komunitetit vendor, të cilët merren me veprimtari të caktuara si: bujqësi, pylltari dhe popullsia e përkohshme e cila përkohsishtë qendron në Park dhe i shfrytizon terrenet sportive, kullotat dhe burimet tjera natyrore.

Në territorin e propozuar për Park Nacional Bjeshket e Nemuna hyjnë gjithsej 18 fshatra me 4354 banorë (sipas regjistrimit të vitit 1981).

Gryka e Rugovës ka sipërfaqe 197 km², ose 32% e teritorit të Komunës së Pejës dhe me 2449 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 13 banorë në km² (sipas regjistroimit të vitit 1981).

Popullsia e Grykës së Rugovës që nga viti 1948 e deri në vitin 1971 ka pasur një rritje të vogël të popullsisë, kurse pas vitit 1971 është zvogëluar edhe më shumë. Prej vitit 1948 deri në vitin 1971 numri i banorëve është rritur në 163 persona, ndërsa nga vitit 1971 e deri në vitin 1981 numri i banorëve është zvogëluar për 979 banorë, por edhe pas vitit 1981 numri i banorëve është gjithnjë duke u zvogëluar.

Migrimet e popullsisë nga ky territor janë pasojë e moszhillimit ekonomik, sipërfaqja e vogël e tokës bujqësore, mungesa e infrastructures etj. Këto kanë ndikuar në migrimin e popullsisë, ku disa fshatra po mbesin pa banorë dhe kryesisht po zbresin në viset më të ulëta të Kosovës.

Nga mesatarisht 241 banorë për fshat, këto fshatra bëjnë pjesë në grupin e fshatrave më të vogla të Kosovës, numri i banorëve lëviz nga 9 banorë në (Bellej) dhe deri në 1431 banorë (Irnziq II) si fshati më i madhë i Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna (sipas regj. të vitit 1981).

Lidhshmëria administrative e vendbanimeve në Grykën e Rugovës është e realizuar në dy bashkësi locale: në Drelaj më 7 fshatra dhe në Haxhaj me 6 fshatra.

Në Bjeshkët e Nemuna dominojnë krysisht vendbanimet që i përkasin tipit të fshatrave të shpërndara. Karakteristikë tjetër e vndbanimeve është ai i vendbanimeve të përkohshme ose i tabaneve të barinjve që kanë karakter sezonalë.




Fig. 2. Numri i vendbanimeve dhe i popullsisë që hyjnë në hapësirën e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna⁹

Kushtet klimatike

Bjeshkët e Nemuna në bazë të pozitës gjeografike, përthyeshmërisë vertikale e horizontale të relievit dhe evolucionit morfoklimatik paraqesin ekosistem malor specifik. Për shkak të sipërfaqes së madhe hapsinore, drejtimit të shtrirjes dhe disecimit nga rrjedhat ujore, Bjeshkët e Nemuna formojnë një malësi komplekse. Kështu kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna diferencohen me laryshi të theksuar të kushteve klimatike, morfohidrike dhe biodiversitetit. Bjeshkët e Nemuna me rolin e tyre orografik ndikojnë që në një hapësirë relativisht të vogël të krijohen tipe të ndryshme klimatike. Njohja e kushteve mikroklimatike ka rëndësi të madhe jo vetëm për ekzistencën dhe zhvillimin e bimëve e shtazëve, por edhe për jetën dhe veprimtarinë e njeriut.

Në Bjeshkët e Nmunana, të ndikuara nga kushtet klimatike subalpine dhe alpine, është ruajtur flora dhe vegjetacioni subpolar, duke e renditur atë në provincë të veçantë alpiko-nordike fitogjeografike dhe ekologjike të lartë. Njohja e kushteve paleoklimatike, e sidomos gjatë glacialit të fundit në rrethanat e ndikimit të elementeve mediterane ka rëndësi shkencore për kuptimin e krijimit të llojeve të reja - neospecia si faktor identifikues me rëndësi për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional. Proceset historike të zhvillimit të botës organike (begatia floristike dhe e

⁹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, "Plani hapësinor i Bjeshkëve të Nemuna", Prishtinë, 2014.

vegjetacionit) qëndrojnë në ndërvare si me kushtet klimatike, madje me proceset historike në botën inorganike, në rend të parë me kushtet klimatike, hidrike dhe gjeomorfologjike. Laryshia e madhe vertikale dhe horizontale e botës organike (flora, vegjetacioni, fauna, fitocenoza dhe ekosistemet) në Bjeshkët e Nemuna në rend të parë kushtëzohet nga pozita dhe ndryshimet e theksuara të klimës dhe elementeve klimatik.

Elementet kryesore klimatike në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna kanë këto vlera:

Dielllosja. - Sipas gjerësisë gjeografike, lartësisë mbidetare dhe shkallës së vrërësive dielllosja reale në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna është përafërsisht 44% e vlerës potenciale (4459 orë me diell). Kjo vlerë ndryshon nga rrezet malore (1945 orë) deri në afro 2200 orë me diell në lartësitë mbidetare mbi 2000 m.

Temperatura. - Vlera mesatare vjetore e temperaturës së ajrit në zonën rrëzëmalore është rreth 10.2 gradë C, kurse në lartësi mbi 2000 rreth 5 gradë C, amplitudat vjetore zvogëlohen me rritjen e lartësisë mbidetare nga 21.3 gradë C në rrëzën malore, deri në 17 gradë C në pjesët më të larta, ku muaji më i ngrohtë është korriku, kurse më i ftohtë janari.

Reshjet atmosferike. – Reshjet lëkunden nga 1000 mm në zonën rrëzëmalore deri në 1500 mm në terrenet mbi 2000 m, duke arritur vlerën maksimale në skajin perëndimor të pjesës burimore të Bistricës së Deçanit. Mbulesa e borës në lartësitë mbidetare mbi 2000 m zgjatë afërsisht 60% të vitit. Mbulesa e borës, zgjatja dhe koha e paraqitjes është jashtëzakonisht e favorshme për sportet dimërore. Në këtë mënyrë reshjet e bollshme të borës paraqiten si element komplementar për aktivitet polifunksionale në Bjeshkët e Nemuna.

Vlerat turistike të Bjeshkëve të Nemuna


Nga aspekti turistik Parku Nacional Bjeshkët e Nemuna është njëri prej territorëve më interesant në Kosovë dhe më gjerë. Ka vegjetacionin më të llojllojshme e të ruajtur pyjorë, me një varg të llojeve të florës endemike dhe të relikteve të florës, gje që në pikëpamje shkencore e turistike është mjaft e rëndësishme dhe atraktive. Kjo, natyrisht, plotësohet edhe me karakteristikat morfologjike dhe hidrografike dhe po ashtu edhe me motive të rëndësishme turistike.

Resurset e përmendura natyrore të Bjeshkëve të Nemuna determinojnë në mënyrë pozitive funksionin rekreativ dhe ekonomik të tyre, baraspeshën ekologjike të bashkësive dhe të strukturave natyrore, gjë që mund të merret si bazë e shëndoshë për zgjerimin kualitativ dhe kuantitativ të atraktivitetit që janë në funksion të turizmit dhe për mbajtjen dhe përparimin e këtij mjedisi natyror.

Vetëm përmes turizmit mund të prezantohen dhe propagandohen këto vlera të mbrojtura natyrore, e në sajë të saj mund të realizohen mjetet e nevojshme për mbrojtje.¹⁰

Ndërlikushmeria e formave të relievit, shpërndarja vertikale, kushtet e përshtatshme klimatike, të mbajturit e gjatë të borës dhe karakteristikat e tjera të shumta të teritorit të Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna japin mundësi të jashtzakonshme për zhvillimin e aktiviteteve të llojllojshme turistike e rekreative. Hapësira e Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna përbënë një tërsi tejet të vlefshme peizazhore, të cilën e karakterizojnë një sërë lokalitetesh më vlera të llojllojshme natyrore. Tërësinë më atraktive peizazhore dhe turistike e përbëjnë pyjet, barishtorët, livadhet, degëzimi i relievit i krijuar me prerjen e një sërë të luginave dhe grykave, lumenjve dhe përrockave, bjeshkët e thepisura dhe liqenet e shumtë i plotësojnë veçoritë e peizazhit dhe sigurojnë përjetim të këndshëm të kësaj natyre të bukur më vlera joshëse të larta turistike. Masivet e larta malore e shkëmbore mbi 2500 m i jep mundësinë e shëtitjes së alpinistëve. Edhe hapësira prej livadheve me kodrina dhe shpatije dhe atyre alpike të përshkuar me burime të medha uji ofrojnë mundësi për shëtitje dhe rekreacion. Vlera të larta turistike dhe studimore kanë edhe shpellat e shumta, siç është Shpella e Radavcit, e Karamakazit, shpellat e vogla të princeshës, shpellat përgjatë Gërlës së Koshutanit, shpella afer Gurrës së Rutës etj., që në të ardhmen mund të jenë edhe si qendra të studimeve nga spelologët.

¹⁰ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, “Plani hapësinor i Bjeshkëve të Nemuna”, Prishtinë, 2014.

Fig. 3. Numri i turistëve të informuar në zyrën për turizëm¹¹

Zhvillimi i aktiviteteve turistike-rekreative është i mundur në tri forma themelore: stacionare, vikendshëtitje dhe transit.

Kushtet natyrore me një përkufizim mundësojnë zhvillimin si të turizmit veror, ashtu edhe të atij dimëror.

Turizmi stacionar

Ka karakteristika të qëndrimit më të gjatë në zona të ndryshme të Bjeshkëve të Nemuna qoftë gjatë sezonit veror, qoftë dimëror.

Turizmi veror. – Ky lloj turizmi ka kushte shumë të përshtatshme para së gjithash për pushimin e familjarëve, punëtorëve, mjekimit shëndetësor, qëndrimit në natyrë të lirë, alpinizmit, gjuetisë, peshkimit etj. Këto kushte mund të zhvillohen në shumë lokalitete e sidomos në Kuqishtë dhe në Bogaj. Klima malore gjatë sezonit veror i favorizon pa rezervë turistet që atje të thithin ajrin e pastër, që është stimulim për shëndetin e njeriut. Në përgjithësi kompleksi malor i Bjeshkëve të Nemuna kanë kushte të volitshme të klimës malore, me ndryshime vertikale të theksuara të vegjetacionit, ekosistemeve të ndryshme, peizazheve pitoreske, begatisë ujore, që për turistet paraqet vertet klimë të shëndetshëm. Jo vetëm ajri i pastër, por edhe prania e një larmie të botës së gjallë që të humbë në mendim e meditim, e bën vizitorin vertet të jetojë në harmoni me veten dhe natyrën.

Kur flasim për alpinizmin si degë e bjeshkatarisë, kjo gjenë shprehje dhe mundësi të zhvillimit të shkëlqyeshëm në masivin shkëmbor, në rajonin e dytë të Bjeshkëve të Nemuna, si maja e

¹¹ Agjencia e Statistikave e Kosovës, “Enti Statistikor i Kosovës”.

Gjeravicës 1656 m, duke shkuar në drejtim të trekufirit në Boriq me 2330 m dhe në majet shkëmbore në veriun e Shqipërisë si Maja e Hekurave e Shkëlzeni. Këtu mund të futen në këtë fushë të turizmit edhe Maja e Ropsit – 2502 m, Maja e Rusolisë – 2381 m, Kurvalla - 2303 m, Maja e Strellcit – 2377 m, Maja e Qenit -2406 m, Koprivniku (Kërshi i Çverlës) – 2460 m, Marjashi (Bagdash) - 2530m, Leqinati – 2341 m, Maja e Lumbardhit -2522 m, Hajla – 2400 m, Gusani - 2539, Kota – 2130 m, Maja e Bajrakut – 2078 m, Mali Kozhner – 2107 m etj.

Kushte mjaft të përshtatshme ofron edhe territori i burimeve të Drinit të Bardhë, mandej territori i liqeneve të Leqinatit dhe disa terrene të tjera ku do të mund të zhvilloheshin kapacitetet për pushim veror dhe për mjekim.¹²

Gjithashtu, pos burimeve të lumenjve si Drini i Bardhë, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit dhe burimet tjera me sasi më të vogël të ujit siç janë: Vrella - Istog, Vrella - Vrellë, Gurra e Radavcit, Uji i Bardhë - Pejë, Uji i Zi - Pejë, Vrella e Gubavcit - Pejë, Vrella e Lubeniqit - Lubeniq, Vrella e Jasiqit - Jasiq, Vrella e Livadheve të Mëdha - Jasiq, Vrella e Isposnicës (Bistrica e Deçanit), Vrella e Belajes (Bistrica e Deçanit), Vrella e Junikut - Junik, Vrella në Haxhaj etj, si vëndburime uji të pastër dhe të shëndetshëm, janë shumë atraktive dhe tërheqëse për vizitorë.

Turizmi dimëror. - Turizmi i till zë një vend të rëndësishëm, duke pasur parasysh terrenet shumë të përshtatshme hapësinore, natyrore e klimatike për zhvillimin e shumë disiplinave të skitarisë. Sipas të dhënave në Bjeshkët e Nemuna janë rreth 31.500 m dhe mund t'i përballojë deri në 30.000 skitarë. Terrenet kryesore për skitari janë; Kopraniku, Maja e Rusolisë, Malet e Leqinatit dhe Bjeshkët e Moknës.

Studimet e deritanishme janë bërë në Kopranik, që është hartuar programi investiv më titull “Qendra sportive rekreative turistike e Dukagjinit”. Gjatësia e tërësishme e shtigjeve të skitarisë në këtë territor është 29.513 m.

Parakushte mjaft të mira për zhvillimin e turizmit kanë edhe viset në teritorrin e Bogës, Kuqishtës, Bjeshkët e Lumbardhit, Moknës dhe disa terrene të tjera.

¹² Plani Hapësinor i Bjeshkëve të Nemuna, Prishtinë, 2014.

Turizmi vikend-shëtitës

Atraktiviteti i territorit, e para së gjithash i Grykës së Rugovës, përmendoret kulturore-historike në rrethinën e afërt dhe të largët, vlerat tjera natyrore e raritetet kanë një ndikim të rëndësishëm në motivimin e turizmit vikend-shëtitës. Trashëgimia e pasur kulturore-etnografike, vendbanimet dhe fshatrat në viset e Rugovës (punëdoret, folklori i Rugovës) janë po ashtu motiv i madh për ardhje në këtë Park Nacional.

Turizmi tranzitor

Pozita e tij dhe kalimi i rrugës Pejë - Çakor (nëse asfaltohet) do të krijojë kushte që të kthehet rrjedha turistike nga drejtimi i jugut mandej kah territori i Adriatikut. Për turistët tranzitorë nuk është e nevojshme ndërtimi i ndonjë objekti të posaçëm, përveç ndonjë përmbajtjeje plotësuese të cilat do t'i sigurojnë nevojat e këtyre turistëve.¹³

Këto mund të llogariten pasi që është shpallur si Parkë Nacional, që po vërehet dhe do të vërehet edhe në të ardhmen nga ekskurzionet shkollore e universitare, nga puna arsimore e edukative, puna shkencore e hulumtuese, manifestimet e ndryshme e deri te ato tradicionale si pushim në natyrë, shëtitje, trajning i sportistëve, vizitat masovike te agjencive turistike dhe motivet tjera të ndryshme.

Arsimi si faktor i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit

Burimet njerëzore për turizmin përbëjnë një nga çështjet më të rëndësishme që një destinacion turistik duhet t'i marrë parasysh për zhvillimin e turizmit. Turizmi si një orientim strategjik i zhvillimit të Kosovës kërkon një politikë të përshtatshme në fushën e arsimit dhe kulturës. Kultura e jetës dhe e komunikimit është pjesë integrale e produktit turistik dhe një parakusht thelbësor për zhvillimin e turizmit. Progresi në këtë fushë arrihet duke përmirësuar sistemin arsimor dhe kushtet e përgjithshme socioekonomike të zhvillimit. Sistemi aktual i arsimit mbi turizmin në Kosovë nuk i përmbush kërkesat për cilësi të

¹³ Plani hapësinor i Bjeshkëve të Nemuna, Prishtinë, 2014.

industrisë së turizmit. Programet universitare janë kryesisht teorike dhe e humbin orientimin profesional dhe praktik dhe kështu nuk përputhen me kërkesat e industrisë. Zhvillimi i një sistemi të kualifikimeve profesionale në turizëm është një nga nevojat më të domosdoshme për zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Aftësimi profesional është qenësisht i lidhur me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ngritjen e nivelit të ofertës turisike të vendit. Parakusht për një cilësi të lartë dhe rritje të konkurrencës së turizmit kosovar është orientimi i tregut drejt arsimit profesional, me qëllim të krijimit të fuqisë punëtore të kualifikuar në të gjitha fushat dhe nivelet e veprimtarisë turistike.¹⁴ Për sa i përket përgatitjes së punonjësve në sektorin e turizmit, duhet të theksohet se ofruesit e arsimit mbi turizmin dhe trajnimeve profesionale janë kryesisht shkollat e mesme dhe universitetet. Përveç universiteteve publike, programe për turizmin në nivelin master kanë edhe disa universitete private. Për nivele të ndryshme të arsimit është e nevojshme një qasje e ndryshme ndaj turizmit si për nga roli arsimor, ashtu edhe ai i zhvillimit të turizmit. Niveli i arsimit të lartë duhet:¹⁵

- T'i aftësojë pjesëmarrësit potencialë në industrinë e turizmit për qëndrim të përgjegjshëm, kompetent dhe aktiv ndaj mjedisit,
- T'i aftësojë pjesëmarrësit potencialë në industrinë e turizmit për pozicionimin e turizmit në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm,
- Që planet dhe programet mësimore të profileve të studimit të përshtaten me planprogramet e vendeve me turizëm të zhvilluar,
- Të planifikohet një rrjet i institucioneve të arsimit të lartë që do të krijojnë personel me arsim të lartë në fushën e turizmit dhe hotelerisë,
- Të shfrytëzojë potencialin dhe kulturën ndërmarrëse në hotelieri (ngritja e kapaciteteve në arsim të lartë) dhe
- Të bëjë aftësimin profesional me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve.

¹⁴ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Profili i sektorit të turizmit, mars 2014.

¹⁵ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018 – 2022.

Përfundim

Kosova si term gjeografik dhe si rajon me ofertë turistike është e lokuar në qendër të Ballkanit Perëndimor dhe ka trashëguar nga e kaluar përafërsisht të njëjtat vlera kulturoro-historike si edhe shtetet fqinje, me dallim se në një periudhë të gjatë kohore nuk ka mund të kujdeset dhe t'i ruaj vlerat e tilla nga dëmtimet, ndikimet dhe keqpërdorimet. Pas vitit 1999 Kosova ka pasur një zhvillim të turizmit dhe rritje të ofertës turistike, por kjo ndodh falë rrethanave dhe iniciativës së individëve dhe grupeve për aksione në afat të shkurtër dhe jo nga koordinimi apo planifikimi i organizuar dhe në afat të gjatë.

Turizmi në Kosovë është një dege e ekonomisë që ka një rritje në pjesëmarrjen e saj në aktivitetin ekonomik. Kjo nga se në përgjithësi Kosova e ka trashëguar edhe një traditë turistike e cila me vite ka qenë e pa avancuar duke ju referuar situatës politike dhe të sigurisë jo të volitshme dhe jo stimuluese për zhvillimin e turizmit.

Kosova është dhe duhet të jetë vend turistik në të ardhmen, kurse tani gjithësesi është vend i orientuar kah zhvillimi i turizmit. Një rritje e investimeve dhe qarkullimit turistik na bind se turizmi për vendin është dhe do të jetë një forcë shtytëse e zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi. Gjithësesi duhet konstatuar se për të arritur një zhvillim dhe efekte pozitive ekonomike nga turizmi në Kosovë është e domosdoshme që i gjithë ky zhvillim të vëhet nën kontroll dhe të nxirret në nivel vendi strategjia e zhvillimit të turizmit, e cila do të mundësojë një ecje përpara me orientime në ato forma të turizmit të cilat i përgjigjen më së shumti ka bazë të mirë për rritje, të cilat do të sjellin përfitime për të gjithë pjesëmarrësit në “industrinë turistike” të Kosovës.

Duke pasur si njohuri dhe orientim se vendi përbëhet nga disa rajone specifike për turizëm të ndueardurt, i cili nëse arrihet që të ndërlihdhet në një tërësi do të krijojë një ofertë turistike sa specifike në vete, aq edhe komplementare me ofertat turistike të vendeve në rajon dhe ky duhet të jetë orientim afatgjatë i punonjësve turistikë kosovarë dhe i atyre të rajonit.

Bashkëpunimi rajonal në nivel të vendeve të Ballkanit në lëmin e turizmit është i paragjykuar, përkatësisht plotëson ofertën turistike të njëri-tjetrit dhe mundëson një përjetim unik për turistët që gjatë një

pushimi të shijojnë dhe shfrytëzojnë llojllojshmërinë e pashoqe në një hapësirë të vogël gjeografike.

Prurja e situatës kur mund të konkludohet se e kemi formësuar ofertën turistike kosovare mund të ndodhë vetëm atëherë kur të jemi në gjendje që të bëjmë formësimin turistik të një hapësire, p.sh. rajoni i Prizrenit, i Pejës a i Dukagjinit, etj. Kjo është një detyrë tejet komplekse dhe në vete duhet të përmbajë analiza gjithëpërfshirëse kulturore, historike, etnike-demografike dhe parashikimin e ruajtjes, kultivimit dhe zhvillimit në të ardhmen. Për këtë nevojitet kohë e ajo është gjithnjë e më e pakët nëse dëshirohet që të zihet hapi me procesin që vetëm se po ndodh në rajon dhe në vendet me të cilat Kosova kufizohet dhe korrespondon në lëmin e turizmit.

Një ndër çështjet themelore në të cilat do të bazohet zhvillimi i turizmit në Kosovë janë edhe sesi do të funksionalizohen trashëgimia kulturo-historike e cila me të vërtetë nuk i mungon, por nuk është e evaluar sa duhet, e sistemuar dhe e prezantuar para publikut të gjerë.

Duke shikuar rajonet e ndryshme gjeografike apo subrajonet nëpër Kosovë, konkludojmë se ato kanë veçoritë e veta me nivel të ndryshëm të traditës dhe nivel të qasjes ndaj organizimit të degës së turizmit. Por vërtetojmë se nga laramania e evidentuar e përparësive natyrore (flora dhe fauna), trashëgimisë kulturo-historike nëpër rajonet e veta, vendi mundet që në një fundament të fortë të ndërtojë përparësi dhe identitet të produktit turistik në formë dhe përmbajtje shumë kualitative, produkt i cili do të jetë konkurrent dhe komplementar me ofertën e vendeve të Ballkanit dhe në veçanti të jetë plotësuese e ofertës së Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Në baze të përvojave të deritanishme në turizëm dhe hotelieri, rajonet e Kosovës, por edhe në nivel vendi, do të duhej të ndërtojnë konceptin e bazuar në ndërtimin e identitetit të “Vendit turistik”, i cili do të bëhej sinonim për vizitorët - shfrytëzuesit e ofertës ekzistuese turistike dhe përparimin e përmbajtjeve të reja të bazuara në trashëgiminë kulturo-historike me të cilën disponojnë rajonet dhe Kosova si destinacion turistik.

Mund të konstatojmë se zhvillimi i turizmit në Kosovë në përgjithësi ka qenë jo i koncentruar, e kjo duke pasur parasysh faktin se edhe lokalitetet dhe destinacionet turistike janë të shpërndara gjithandej, pra ka një disperzion në hapësirën e gjithë vendit, e që ky është shkak i faktorëve shoqëro-ekonomik të ndryshëm nëpër rajone.

Se a është më mirë që zhvillimi i turizmit të jetë i koncentruar apo i shpërndarë në aspektin gjeografik, në nivelin e teorisë nuk mund të jepet një konstatim i prerë, sepse secila formë, edhe ajo kur zhvillimi i turizmit dhe i hotelerisë bëhet më shumë dhe më shpejt në disa rajone se në tjerat, por edhe kur zhvillimi i turizmit dhe i hotelerisë është i koncentruar në të njëjtën kohe në të tre rajonet a në nivel vendi, ka përparësitë krahasuese dhe mangësitë, kështu që sugjerojmë që arsyetimin e zhvillimit të koncentruar apo të shpërndarë-disperziv të vërtetohet sipas rasteve konkrete, duke u bazuar edhe në caqet shoqëro-ekonomike të cilat dëshirohen të arrihen me këtë zhvillim.

Nëse nuk punohet sistematikisht në krijimin e imazhit pozitiv të vendit, atëherë edhe zhvillimi i turizmit mund të mos jetë ai që ne presim, por ky imazh duhet ndërtuar edhe me mundin dhe investimet në ruajtjen e trashëgimisë kulturo-historike, ruajtjen e ambientit, ruajtjen e baraspeshës ekologjike të florës dhe faunës, ujit dhe ajrit si mundësi për të avancuar ofertën turistike me markën “ekologjike”.

Në mënyrë që të nxitet dhe ndihmohet turizmi kosovar si cak, propozojmë njërën nga masat e nevojshme futjen e konceptit të marketingut në veprimtarinë turistike, e cila do të shërbente si mjet për shpalosjen e potencialeve turistike të rajoneve kosovare, por edhe të ofertës turistike të Kosovës në përgjithësi.

Rekomandime

Në analizën e zhvilluar mbi mundësitë që ofron rajoni i Kosovës mendoj se në të ardhmen do të ketë mundësinë të zhvillojë turizmin në mënyrë të tillë që sjellë të ardhura të konsiderueshme për ekonominë vendase. Për ta arritur këtë nevojitet:

- Hartimi i një strategjie më specifike turistike e cila do të zbatohet me përpikmëri në mënyrë që të shmangen masakrat urbane dhe natyrore;
- Zgjidhja e problemeve të pronësisë në bazë të ligjit, i cili shpesh bëhet pengesë për investime;
- Respektimi i planifikimit urban në mënyrë që të mos dëmtohet urbanistika e zonës më tepër;
- Mbrojtja e zonave me rëndësi të veçantë historike, kulturore dhe natyrore;

- Një bashkëveprim i ngushtë i të gjithë aktorëve të cilët krijojnë kushtet e duhura infrastrukturore për zhvillimin e turizmit;
- Hartimi dhe ndjekja me përpikëri e planeve dhe strategjive për fushën e turizmit dhe fushat tjera të lidhura më të;
- Çdo njësi vendore të përpiqet për mbrojtjen e pasurive natyrore dhe kulturore në hapësirën e tyre;
- Ngritja e kapaciteteve turistike për çdo njësi vendore duhet bërë për çdo resurs turistik;
- Ndërgjegjësimi i komunitet vendës mbi përfitimet që sjell zhvillimi i turizmit në rajon dhe
- Trajnimi i atyre segmenteve të popullsisë që janë të implikuar në pritjen e turistëve.

TOURISM DEVELOPMENT STRATEGY IN KOSOVO AND TOURISTIC POTENTIALS OF THE "ACCURSED MOUNTAINS"

Petrit HASANAJ

ILIRIA College, Prishtina
petrit.hasanaj@uiliria.org

Simona MARTINOSKA

"St. Kliment Ohridski" University, Bitola, Ohrid
simonabojadzi@yahoo.com

Abstract

Tourism is an economic activity that is oriented towards the utilization of touristic potentials. With the difficulties the Republic of Kosovo has passed in various stages, the development of this activity matches the economic development of the country. Although the Republic of Kosovo has sufficient touristic potential, this activity does not occupy the proper place in the country's economic development. Its development will have an impact on the growth of the local GDP, and it will take its deserved place in the country's economic development strategy. Tourism in Kosovo is not developed, and it is less identified and less developed, and is in great need for national and state marketing, and be organized by a state commission in order to develop and identify as an ideal tourism destination to visit and attract local and foreign visitors. As a strategic orientation of Kosovo's development, tourism requires an appropriate policy in the field of education and culture. Developing a system of professional qualifications in tourism is one of the most essential needs for the development of this sector in Kosovo. Vocational training is essentially linked to improving the quality of services and increasing the level of tourism supply in the country.

Keywords: Tourism, tourism potential, tourism strategy, destination, education.

Literatura

1. Dr.F.Ukaj “Promocioni dhe segmentet bashkëkohore promocionale në turizëm”, Peje, 2006.
2. Gashi Ferim, (15-17.09. 2010), Kosovo Forest Inventory Project 2002-2003, SDI conference, Shkupë, 249-259.
3. Gashi Musa, (1977), Doktorska disertacija, Uslovi i mogućnosti za razvoj turizma u SAP Kosovu, Prishtinë, FSHMN-UP.
4. Ibrahim Halil, Kucinic Mladen, Gashi Agim dhe Grapci Kotori Linda, (2012), “The caddisfly fauna (Insecta, Trichoptera) of the rivers of the Black Sea basin in Kosovo ëith distributional data for some rare species. Zookeys 182:71–85.
5. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor “Plani hapësinor i Bjeshkeve të nemura”, Prishtinë 2014.
6. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
7. Perrau Michael, 2008 “Pavicevicia N. Gen., A New Genus ëith One Neë Species Of Bathyciotina From Kosovo (Coleoptera, Leiodidae, Cholevinae, Leptodirini)”, Advances in study of Balkan Fauna, 177-180.
8. Punimi i prezantuar në Simpoziumin Ndërkombëtar “Prirodno i kulturnohistorijsko nasljedje i novi modeli upravljanja razvojem turizma”, Vlasica, 14-15 Mars 2008, BiH.
9. Savić Ivan, (2008), Diversification of the Balkan fauna: its origine, historical development and present status. Advances in Arachnology and Developmental Biology 12: 57-78.
10. Shuka Lulëzim, Tan Kit dhe Krasniqi Elez, (2012), “Tulipa kosovarica (Liliaceae), a new species of tulip from Kosovo, Fitotaxa 62: 1-9.
11. Simpson Genai, (27 shtator 2010), The importance of tourism and biodiversity, Ministria e Turizmit, Trinidad & Tobago.
12. Trashëgimia historike e Kosovës në dritën e trendeve të reja të zhvillimit të turizmit”.

Burimet tjera:

1. www.ks-gov.net/ESK/
2. www.visitkosova.org
3. www.kotas-ks.org
4. www.kosovundp.org
5. www.euinkosovo.org
6. www.rugovaexperience.org.

PUNËKËRKUESIT DHE SEKTORI PRIVAT NË KOMUNËN E GJILANIT

Hidajete JASHARI – LATIFT¹
Minire REXHEPI²
Blerta DUSHICA³

Abstrakt

Tregu i punës paraqet sfidën më të madhe në ekonomi, prandaj si i tillë duhet të hulumtohet dhe të studiohen fushat me interes të veçantë. Këto fusha janë shumë të rëndësishme e të cilat në njëfarë forme karakterizohen me zbutjen e problemit social, avancimin e shërbimeve kuantitative dhe kualitative për punëkërkuesit në rajonin e Gjilanit, por ato kanë të bëjnë edhe me gjithë rajonin e Kosovës. Po ashtu, krijimin e kushteve dhe mundësive për punësim dhe afatësime profesionale konform nevojave të tregut të punës.

Tregu i punës në sektorin privat është në një proces të përhershëm të zhvillimit dhe të ndryshimeve të shpejta. Tregu i punës karakterizohet edhe me ndryshime të mëdha të cilat reflektohen me masë të madhe sidomos te të punësuarit dhe te të papunët.

Punëkërkuesit në këtë studim duhet të jenë pjesë e kontributit profesional dhe shkencor. Siç dihet, punësimi mbete ende sfidë, mirëpo papunësia është ende shumë e lartë, shpeshherë përjashton edhe mundësinë për format profesionale të rekrutimit.

Të punësuar në sektorin privat janë së pari të afërmit apo familjarët e pronarit, pastaj vijnë të tjerët në strukturën vendimmarrëse. Me fjalë tjera, janë njerëzit më të besuar të pronarit, por jo edhe ekspertët apo profesionistët që ushtrojnë detyra të punës.

Përmes këtij hulumtimi synojmë, që tregu i punë në sektorin privat të jetë në koherencë me nevojat e tregut. Kërkesat për forcën e punës duhet t’u adresohen aktorëve të tjerë relevantë të cilat kanë mundësi reale për ngritjen e njohurive dhe aftësive të tyre.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka evidencën nga tregu ekonomik – sektori privat që operon në Komunën e Gjilanit, në mënyrë që hartimi i politikave komunale të jetë në harmoni me kërkesat e tregut të punës.

¹ Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Kosovë. hidajete.jashari@uni-gjilan.net

² Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Kosovë. minire.rexhepi@uni-gjilan.net

³ Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Kosovë. blerta.dushica@uni-gjilan.net

Informata mbetet resursi më i rëndësishëm, prandaj studimet e tilla ndihmojnë të gjithë akterët e tregut të punës e sidomos marrësit e vendimeve.

Një dinamike e tillë e zhvillimit të iniciativës private manifestohet me rëndësi gjithnjë e më të madhe të ekonomisë private në aktivitetet e përgjithshme ekonomike në Kosovë. Kjo bën që roli i ekonomisë private të jetë gjithnjë më i madh, si dhe të rritet vetëdija mbi rëndësinë e zhvillimit të saj.⁴

Të dhënat e kërkuara në këtë formular shërbejnë për nevojat studimore dhe sektorin privat me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe punëkërkesve për të krijuar mundësi dhe kushte për mbështetjen e bizneseve nga ana e institucionit komunal, qendror dhe atyre ndërkombëtar; plotësimi i këtij formulari nuk ka të bëjë për regjistrimin apo verifikimin e biznesit për të vendosur tatimin apo ndonjë taksë.

Politikat aktive në tregun e punës pa evidencë cilësore dhe pa studim të mirëfilltë shkencor të tregut të punës nuk do të arrinin rezultatet e pritura. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është mbledhja e informatave të duhura mbi punësimin në sektorin privat, pagat e të punësuarve në tregun e punës, mosha e të punësuarve, problemet e tregut të punës, etj.

Metodologjia

Procesi i hulumtimit është zhvilluar përmes metodës së anketimit me pyetësorë, është zhvilluar duke i kontaktuar drejtpërdrejt personat përgjegjës të bizneseve në Komunën e Gjilanit, pra intervistat e zhvilluara sy më sy. Pyetjet e pyetësorit janë përgatitur asisoj që të mundësojnë realizimin e qëllimeve të synuara dhe janë të sinkronizuara njëra me tjetrën.

Gjithashtu janë përfshirë edhe dy sektorët e Komunës së Gjilanit (të cilët kanë ndihmuar në realizimin e hulumtimit) dhe ato janë:

- Qendra e Regjistrimit të Bizneseve dhe
- Sektori i Taksave Komunale.

⁴ Prof. Dr. Justina SHIROKA – PULA, Sfidat dhe perspektiva e NVM-ve në Kosovë: MASHT, Prishtinë, 2013, fq. 20.

Mostra

Në këtë hulumtim nuk kemi të bëjmë me përzgjedhjen e mostrës, por janë intervistuar të gjithë bizneset sy më sy në Komunën e Gjilanit.

Analiza e përgjithshme e bizneseve në Komunën e Gjilanit

Rajoni i Gjilanit renditet i dyti për nga numri i bizneseve të regjistruara me gjithsej 21.513 biznese apo, shprehur në përqindje, 20.73% të bizneseve nga numri i tërësishëm i bizneseve të regjistruara.⁵ Nga kjo përqindje Komuna e Gjilani renditet e dyta në rajonin e Gjilanit, me numër të bizneseve prej 6.686 biznese (6.45%).

Rëndësia e jetëgjatësisë në treg të ndërmarrjeve është jashtëzakonisht e madhe, pasi në bazë të kësaj dëshmohet për një treg stabil.

Përgjegjshmëria e bizneseve për hulumtimin e krijimit të data bazës së bizneseve në Komunën e Gjilanit ka qenë mjaft e lartë dhe bashkëpunuese. Shkalla e përgjigjeve ka qenë rreth 86%, e cila ka dëshmuar një bashkëpunim të lartë në këtë hulumtim.

Praktika e ka vërtetuar se faktori vendimtar për suksesin apo dështimin e një biznesi është aftësia e ekipit menaxhues.⁶ Shumë biznese kanë vështirësi t'u rezistojnë ndryshimeve të cilat ndodhin në ekonomi, mirëpo përkundër kësaj në përgjithësi Gjilani ka pasur një treg inkurajues.

Punësimi në sektorin privat

Struktura e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike është e rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar llojin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike në vend, por edhe për të përcjellë trendin e rritjes apo të zvogëlimit të të punësuarve.⁷

⁵ Prof. Dr. Justina SHIROKA – PULA, Sfidat dhe perspektiva e NVM-ve në Kosovë: MASHT, Prishtinë, 2013, fq. 49.


⁶ Po aty, fq.11.

⁷ Prof. Dr. Justina SHIROKA – PULA, Sfidat dhe perspektiva e NVM-ve në Kosovë: MASHT, Prishtinë, 2013, fq. 100.


Tregu i punës, niveli i formimit profesional dhe shkathhtësitë e burimeve njerëzore në krahasim me nevojat e tregut të punës për departamentin e punës dhe punësimit do të ishin informatat kryesore nga të cilat do të duhej të zhvilloheshin politikat e punësimit në ndërmarrjet private.

Numri i përgjithëshëm i të punësuarve në bizneset në Komunën e Gjilanit

Punësimi në tregun e punës në Komunën e Gjilanit është **3050 biznese**, të anketuar kemi **8699 të punësuar**.



PUNËSIMI SIPAS GJINISË



E rëndësishme do të jetë që të shikohet trendi i punësimit duke pyetur respondentët se sa persona keni të punësuar aktualisht dhe duke përfshirë edhe veten si dhe sa punëtorë i keni pasur në të njëjtën periudhë vitin e kaluar.

Punëdhënësit për plotësimin e vendeve të lira të punës ende përdorin forma të ndryshme, mirëpo duhet cekur se ka lëvizje në tregun e punës, kur ka filluar ngritja e vetëdijes dhe kultura e punës dhe përzgjedhja duhet të bëhet përmes formave më të avancuara, siç janë shpalljet apo shërbimet publike të punësimit. Është për të ardhur keq që shumë pak ndërmarrje në tregun e punës përzgjedhin shërbimin institucional të punësimit (Enti i Punësimit në Kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale).

Niveli i kualifikimeve të të punësuarëve

Punësimi mbete ende sfidë, mirëpo papunësia është ende shumë e lartë, shpeshherë përjashton edhe mundësinë për format profesionale të rekrutimit. Duke pasur parasysh që organizimi i brendshëm i ndërmarrjeve private gjithashtu ballafaqohet me dobësi të shumta dhe ato shprehen me nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik, angazhimin e aftësive dhe trajnimin e personelit, zgjedhjen e tyre joadekuate, dobësitë në zhvillimin e funksioneve të menaxhmentit dhe marketingut.⁸

Sipas hulumtimit në fjalë, kemi të punësuar me kualifikim të lartë 1125 persona, ndërsa me shkollë të mesme 6257. Personat që nuk janë deklaruar lidhur me kualifikimet janë 1317.



Analiza e këtij hulumtimi dëshmon se rezultatet janë të kënaqshme, por jo edhe në nivelin e duhur edhe pse akoma është në trend punësimi “Përmes të afërmeve apo miqve”, e cila kategori është mjaft sfiduese dhe ndoshta kjo ndërlidhet me natyrën e bizneseve tona, ku shumica janë ndërmarrje të vogla me më pak se 10 të punësuar (1 - 9).

Kualifikimi dhe njohuritë e tyre kur përzgjedhja e punëkërkuesve nuk janë të nivelit profesionalë, në këtë situatë ata nuk u përgjigjen nevojave të tregut të punës. Inovimi dhe rikonstruktimi i njohurive të tyre është i domosdoshëm. Karakteristikë e këtyre në tregun e punës, e sidomos e atyre në fushën e agrobiznesit është se u mungojnë:


⁸ Po aty, fq. 23.

- Njohurit për afarizëm në kushtet e tregut,
- Qasja me orientim kah tregu dhe
- Menaxhmenti bashkëkohor i firmës.⁹

Të punësuar në sektorin privat janë së pari të afërmit apo familjarët e pronarit, pastaj vijnë të tjerët në strukturën vendimmarrëse. Me fjalë të tjera, janë njerëzit më të besuar të pronarit, por jo edhe me ekspertët apo profesionistët që ushtrojnë detyra të punës.¹⁰

Kohëzgjatja e të punësuarve

Në pyetjen tonë se kontratat e punës që i kanë punëtorët tuaj, për çfarë periudhe kohore lëshohen ato, ndërmarrjet janë përgjigjur si në vijim:



Realisht shumica e ndërmarrjeve (bizneseve) kanë kontrata të ndryshme me punëtorët, varësisht prej dinamikës së punëve dhe zhvillimit të ndërmarrjes.

Të gjitha format e kontratës i gjen të pranishme apo të lidhura në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në bazë të rezultateve kemi këtë përbërje: punëtorët me afat kohe të përhershme janë 7654 (88%), kurse

⁹ Baki Rexhepi, Bizneset e vogla familjare garant i zhvillimit ekonomik e social, nr.1, 2015, fq 145.

¹⁰ <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/punesimi-ne-sektorin-publik-dhe-privat>.

punëtorë sezonal kemi vetëm 378 (4%) dhe bizneset që nuk kanë deklaruar kohëzgjatje të kontratës së punëtorëve janë 667 persona (8%).

Mosha e të punësuarve


Është e rëndësishme të ceket se kemi grupmosha të ndryshme që janë të punësuar në sektorin privat.

MOSHA E TË PUNËSUARVE

Mosha	Persona(Nr)
Deri 25 vjet	1329
26-30	1262
31-35	1086
36-45	1541
46-55	943
56-65	182
mbi 65	25

Nga tabela e sipërme kemi rezultatet se në Komunën e Gjilanit mosha e të punësuarve në tregun e punë - në sektorin privat është e ndryshme, duke filluar nga më pak se 25 e deri në 65 vjet.

PUNËSIMI SIPAS MOSHËS NË SEKTORIN PRIVAT



Numri më i madh i të punësuarve sipas moshën është prej 26 – 45 vjet e punëtorëve të punësuar në Komunën e Gjilanit (24%) apo 1541 persona të punësuar. Këtë shifër e përcjellë pastaj mosha deri në

25 vjet (21%) apo 1329 persona dhe në vazhdim kemi moshën prej 26 – 30 (20%), apo 1262 persona; moshën nga 31 – 35 (17%) apo gjithsej 1086 persona, pastaj kemi moshën prej 46 – 55 (15 %) apo numrin e përgjithshëm 943 persona, kurse numrin më të vogël e përcjell mosha 56 – 65 (3%) apo 182 persona dhe numrin e personave të punësuar në moshë të shtyrë (pensionistëve) është rreth 25 person (0.7%).

Paga mesatare në sektorin privat në Komunën e Gjilanit

Studimi i pagës mesatare në tregun e sektorit privat në Komunën e Gjilanit, në kuadër të këtij hulumtimi ka qenë i një rëndësie të veçantë për arsye se paga është elementi më i rëndësishëm që determinon rendësinë e marrëdhënies së punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Hulumtimi i cili është realizuar për nevojat e tregut të punës në gjithë rajonin e Gjilanit ka mbuluar 3050 biznese, ku janë të punësuar 8699. Por bizneset që kanë deklaruar pagën mujore ishin vetëm 2406. Duke u bazuar në deklaratat e bizneseve në sektorin privat prej 2406 bizneseve, kemi pagën mesatare, pra pagën mujore prej 186.96 euro muaj, kurse 449.825,76 euro brenda vitit.

Paga sipas rajoneve të Kosovës

Duke pasur parasysh pagën mesatare në gjithë territorin e Gjilanit jo vetëm në sektorin privat dhe po të bëjmë krahasimin me rajonet e tjerat të Kosovës do të kemi këtë përbërje:

Nr.	Rajonet e Kosovës	2010	2011	Ndryshimi
1	Prishtina	338	343	1.42
2	Prizreni	291	328	12.86
3	Peja	260	321	23.39
4	Ferizaji	249	320	28.67
5	Gjilani	236	316	33.84
6	Gjakova	260	314	20.92
7	Mitrovica	244	299	22.36

Pagat mesatare për vitin 2011 janë paguar nga rajonet e Prishtinës (343 euro) dhe Prizrenit me (328), ndërsa sa i përket

rajoneve tjera pagat më të ulëta janë paguar në rajonin e Mitrovicës (299) dhe Gjakova (314).


Duke u bazuar në faktin se gjatë vitit 2011 Gjilani kishte pagën mesatare (sektori privat, publik, organizatat e huaja, OJQ-të e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore që kryejnë aktivitetet e tyre në Gjilan...) kishte 316, kurse gjatë vitit 2012 vetëm në sektorin privat kemi mesataren prej 186,96 eurosh për person.

Paga mesatare neto e sektorëve ekonomikë në Kosovë për vitet 2012 – 2016¹¹

Sektori publik në vitin 2012 kishte një pagë mesatare neto 353 euro, ndërsa në vitin 2016 mesatarja e pagave arrinte në 449 euro. Te ndërmarrjet publike paga mesatare neto për vitin 2012 arrinte nivelin 465 euro, ndërsa në vitin 2016 arrinte në 586 euro, kurse sektori privat në vitin 2012 kishte pagë mesatare prej 333 eurosh, ndërsa në vitin 2016 paga mesatare arrinte në 337 euro.

Shihet qartë që punëkërkuessit e sektorit privat në Kosovë kanë ende shumë vështirësi, ndonëse janë bërë shumë përpjekje që sektori privat ta ketë më të lehtë punën në treg, është marrë vendimi për lirim të bizneseve nga taksa komunale për të vetmen arsye të krijimit të një klime sa më të përshtatshme për ta. Meqenëse pagat e ulëta të cilat i marrin punëtorët shpeshherë krijojnë pakënaqësitë e tyre dhe ato manifestohen në forma të ndryshme.

¹¹ <http://ask.rks-gov.net/media/3846/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2012-2016-date-20112017-wfinal.pdf>



Është bërë e mundur që disa biznese të ofrojnë beneficione apo lehtësira të konsiderueshme të cilat sadopak do të ndikojnë në jetesën dhe stardardin e të punësuarve.

Në fakt, disa nga ndërmarrjet ofrojnë lehtësira ose subvencionojnë stafin e tyre përmes formave të ndryshme, kështu që, në bazë të analizës, kemi “ushqim apo pagesa të ushqimit” të cilët rreth 55.2% i respektojnë ndërmarrjet, ndërsa rreth 12.5% nuk e respektojnë këtë shërbim, mirëpo kemi biznese të padeklaruara për këtë shërbim, 33.7%.

Pozita e të punësuarve sot sipas rezultateve nga ky punim është mjaft diskriminues, duke pasur parasysh se shumë benefite që është dashur t’u takojnë, ato nuk realizohen dhe kjo mbetet një sfidë për organet mbikëqyrëse të ligjit të punës.

Bizneset me numrin më të madh të të punësuarve

Analiza jonë në bazë të këtij hulumtimi është fokusuar kryesisht të ndërmarrjet në sektorin privat, ku numri më i madh i ndërmarrjeve të anketuar ka qenë në sektorin privat, por kishte p. sh. edhe KEK-un, POSTËN, etj.

Bizneset private në Komunën e Gjilanit kanë qenë synimi ynë, pasi që ato do të pasqyrojnë dinamicitetin më të madh në tregun e punës dhe orientimin për më shumë vende pune. Krijimi i vendeve të punës dhe identifikimi i nevojave për aftësim dhe riaftësim profesional do të azhurnohet nga sektori më dominant i këtij studimi.

Rajoni i Komunës së Gjilanit është i pasur me të gjitha llojet e bizneseve

Nr.	Emri i biznesit	Pronari	Nr. i punëtorëve
1	Jugterm	Qamil Hamiti	280
2	KEK	Ramadan Ahmeti	235
3	Ptk	Hajrulla Hajrullahu	202
4	VivaFresh	Ilir Qerimi	198
5	AskFood	Erton Namoni	157
6	Shaqa	Ekrem Shaqiri	150
7	CompactGroup	Saqip Shala	95
8	Fluidi	Fejzullah Mustafa	85
9	Fbm Kualiteti	Sylë Deshishku	80
10	Agmia	Ahmet Demiri	70
11	Restorant Bujana	Naser Shabani	61
12	Elkos	Ramiz Kelmendi	60
13	Sela	Selami Azizi	59
14	3Tex	Orhan Selimi	55
15	Drita Security	Nexhmedin Ismajli	50
16	Hoteli Kristal	Mustaf Shala	49
17	Protec	Xhemajl Shabani	47
18	Proex	Tarik Joniot	47
19	Konsoni	Zef Pjetri	45
20	Moea	Armend Malazoku	39

Përfundim

Punësimi në tregun e punë në Komunën e Gjilanit përbëhet prej 3050 bizneseve me 8699 të punësuar. Nga numri i përgjithshëm prej 8699 të punësuarish kemi 6621(55%) të punësuar meshkuj, ndërsa 2078 (45%) të punësuarat ferma në sektorin privat. Punësimi mbetet ende sfidë, mirëpo papunësia është ende shumë e lartë dhe kjo shpeshherë përjashton mundësinë për format profesionale të rekrutimit. Me kualifikim kemi 1125 (13%) persona, ndërsa me shkollë të mesme 6257 (72%) individë. Ata që nuk janë deklaruar për kualifikimet e tyre janë 1317 (15%) persona.

Punëdhënësit për plotësimin e vendeve të lira të punës ende përdorin forma të ndryshme, mirëpo duhet cekur se ka lëvizje në tregun e punës, kur ka filluar ngritja e vetëdijes dhe kultura e punës ku përzgjedhja duhet të bëhet përmes formave më të avancuara, siç janë shpalljet apo shërbimet publike të punësimit.

Në bazë të rezultateve kemi këtë përbërje: punëtorët me afate kohore të përhershme janë 7654 (88%), kurse punëtorë sezonalë kemi vetëm 378 (4%) dhe biznese që nuk kanë deklaruar kohëzgjatje të kontratës së punëtorëve janë 667 persona (8%).

Analiza e këtij hulumtimi dëshmon se rezultatet janë të kënaqshme, por jo edhe në nivelin e duhur edhe pse akoma është në trend punësimi “Përmes të afërmeve apo miqve”.

Numrin më të madh të të punësuarve sipas moshën e përbën mosha prej 26 – 45 e popullsisë së punësuar në rajonin e Gjilanit (24%), apo 1541 persona të punësuar. Kjo shifër është e realizuar me moshën deri në 25 vjet (21%) apo 1329 persona dhe kemi moshën në vazhdim prej 26 – 30 (20%), apo 1262 persona, moshën nga 31 – 35 (17%) apo gjithsej 1086 persona, moshën prej 46 – 55 (15%) apo numrin e përgjithshëm 943 persona, kurse numrin me të vogël e përcjell mosha 56 – 65 (3%) apo 182 persona dhe numrin e personave të punësuar në moshë të shtyrë (pensionistët) është rreth 25 person (0.7%).

Është bërë e mundur që disa biznese të ofrojnë beneficione apo lehtësira të konsiderueshme, të cilat sadopak do të ndikojnë në jetesën dhe stardardin e të punësuarve, mirëpo pozita e të punësuarve sot sipas rezultateve nga ky punim është mjaft diskriminuese, duke pasur parasysh se shumë benefite të cilat është dashur t’i takojnë, ato nuk realizohen dhe mbetet një sfidë për organet mbikëqyrëse të ligjit të punës.

Duke u bazuar në deklaratat e bizneseve në sektorin privat prej 2406 bizneseve, kemi pagën mesatare mujore rreth 186 euro.

Bizneset me numrin më të madh të punëtorëve në rajonin e Gjilanit janë: Jugoterm 280, KEK 235, PTK 202, VivaFresh 198, AskFood 157, Shaqa 150, Kompaktgroup 95, Fluidi 85, fabrika Kualiteti 80, etj.

Rekomandimet

Aleanca Kosovare e Biznesit është duke luajtur një rol të rëndësishme në zhvillimin e bizneseve, hapjen e vendeve të reja të punës, kërkimin e tregjeve të reja si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Konsiderojmë se duhet bërë edhe më shumë, prandaj kërkohet nga të gjithë akterët me ndikim, duke filluar prej qeverisë, institucioneve tjera relevante që të luajnë rol në krijimin e kushteve më të mira për punësim dhe për një mirëqenie më të begatshme për të gjithë qytetarët.

Duhet të sensibilizohen punëdhënësit që për vendet e lira të punës të bëjnë deklarinë në zyrat e punësimit dhe jo ato vende të plotësohen përmes formave të ndryshme, siç janë ato të familjarëve dhe miqve.

Përshtatja e sistemit të arsimit dhe të aftësisht profesional me nevojat e tregut të punës duhet të jenë në harmoni dhe në funksion të punësimit.

Rekomandojmë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale se përmes politikave të punësimit, gjegjësisht masave aktive në tregun e punës duhet të ketë parasysh punëkërkuesit me profesione elementare të cilët janë në listat e pritjes më shumë se 12 muaj. Po ashtu, me ngritjen dhe avancimin e formimit profesional duhet të listohen profesionistët deficitarë, të cilët duhet të shërbejnë për përfituesit si shpërblim për nxënien e një vendi pune.

JOB SEEKERS AND PRIVATE SECTOR IN THE GJILAN MUNICIPALITY

Hidajete JASHARI-LATIFI

"Kadri Zeka" University, Gjilan, Kosovo
hidajete.jashari@uni-gjilan.net

Minire REXHEPI

"Kadri Zeka" University, Gjilan, Kosovo
minire.rexhepi@uni-gjilan.net

Blerta DUSHICA

"Kadri Zeka" University, Gjilan, Kosovo
blerta.dushica@uni-gjilan.net

Abstract

The labor market poses the biggest challenge to the economy, which requires the research and study of areas of special interest. These areas are very important, since in some ways they are characterized by the alleviation of the social problems, and the advancement of quantitative and qualitative services for job seekers in the Gjilan region, but they also relate to Kosovo as a whole, as well as to the creation of conditions and opportunities for employment and professional qualifications in line with labor market needs.

The labor market of the private sector is in a permanent process of rapid development and change. The labor market is also characterized by major changes which are largely reflected on the employed and the unemployed.

The job seekers in this study should be part of the professional and scientific contribution. As is acknowledged, employment remains a challenge, but unemployment is still very high and often excludes the possibility for professional recruitments.

It takes into account that the internal organization of private enterprises also faces numerous weaknesses expressed by the low level of partnership development, skills engagement and staff training, inadequate arrangements, weaknesses in the development of management functions, marketing etc.

Employees in the private sector are first relatives or family members of the owner, then come the rest in the decision-making structure. In other words, they are the most trusted people of the owner, but not the experts or professionals who carry out work assignments.

Through this research, we aim to ensure that the private sector labor market is in coherence with the needs of the market. Labor force demands should be addressed to other relevant stakeholders who have real opportunities to increase their knowledge and skills.

Literatura

1. Prof. Dr. Justina Shiroka – Pula, Sfidat dhe perspektiva e NVM-ve në Kosovë, Prishtinë, 2013.
2. Justina Shiroka – Pula & Besnik A. Krasniqi, Vendimmarrja menaxheriale, Prishtinë, 2012.
3. Baki Rexhepi, Bizneset e vogla familjare garant i zhvillimit ekonomik e social, Thesis, nr.1, 2015, fq. 145.
4. <http://ask.rks-gov.net/media/3846/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2012-2016-date-20112017-wfinal.pdf>
5. <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/punesimi-ne-sektorin-publik-dhe-privat>.
6. Procesi i hulumtimit është zhvilluar përmes metodës së anketimit me pyetësorë, pra duke i kontaktuar drejtpërdrejt personat përgjegjës të bizneseve në Komunën e Gjilanit dhe intervista u zhvillua sy më sy.

SISTEMI I ARSIMIT, TREGU I PUNËS
DHE ZHVILLIMI EKONOMIK -
SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT

2019

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shfqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 23 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

311.312(496.51)

331.54(96.51)

Sistemi i arsimit, tregu i punës dhe zhvillimi ekonomik -
sfidat dhe perspektivat / këshilli organizues Isa Mustafa...[et al.]. -
Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2019. -
368 f. ; 24 cm. - (Seksioni i Shkencave Shoqërore).

1.Mustafa, Isa

ISBN 978-9951-26-006-0